



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Raporti Vjetor i Punës së Qeverisë për vitin 2016

Shkurt, 2016

Prishtinë

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive.....	3
ZBATIMI I PRIORITETEVE STRATEGJIKE TË QEVERISË	6
- Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik, Punësimi dhe Mirëqenia	7
- Sundimi i ligjit dhe shteti i së drejtës	12
- Agjenda evropiane dhe politika e jashtme	12
- Arsimi, Shkenca, Kultura, Sporti dhe Zhvillimi Rinor	14
- Shëndetësia Moderne	15
ZBATIMI I PRIORITETEVE SEKTORIALE	16
- ZYRA E KRYEMINISTRIT.....	16
- MINISTERIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE	24
- MINISTERIA E ADMINISTRIMIT DHE PUSHTETIT LOKAL.....	29
- MINISTERIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË.....	34
- MINISTERIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL.....	39
- MINISTERIA E DREJTËSISË	42
- MINISTERIA E DIASPORËS	44
- MINISTERIA E FINANCAVE	47
- MINISTERIA E FORCËS DHE SIGURISË SË KOSOVËS	52
- MINISTERIA E INFRASTRUKTURËS	59
- MINISTERIA E INTEGRIMIT EVROPIAN	62
- MINISTERIA PËR DIALOG	65
- MINISTERIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM.....	70
- MINISTERIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT	74
- MINISTERIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	80
- MINISTERIA E PUNËVE TË BRENDSHME.....	82
- MINISTERIA E PUNËVE TË JASHTME.....	85
- MINISTERIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE	89
- MINISTERIA E SHËNDETËSISË	94
- MINISTERIA E TREGTISË DHE INDUSTRIE.....	96
- MINISTERIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK.....	100
Shtojca 1: ZBATIMI I PLANIT VJETOR TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE PËR VITIN 2016	103
Shtojca 2: ZBATIMI I PROGRAMIT LEGJISLATIV PËR VITIN 2016	111
Shtojca 3: PROCESI I HARTIMIT TË KONCEPT DOKUMENTEVE	113

Përmbledhje ekzekutive

Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të prezantimit të të arriturave gjatë vitit 2016 ka përgatitur Raportin Vjetor të Punës së Qeverisë i cili është një mundësi e mirë për të informuar lidhur me arritjet e saj në veçanti Kuvendin e Kosovës, donatorët dhe qytetarët në përgjithësi.

Ky Raport gjithëpërfshirës, ka për qëllim që t'i nënvizojë progresin e arritur në realizimin e prioriteteve të Qeverisë, me theks të veçantë progresin e arritur përgjatë vitit 2016. Në këtë aspekt, ky Raport ka si pikë reference Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në kuadër të të cilit nënvizohen pesë prioritete strategjike të përcaktuara për vitin 2016.

Poashtu, Raporti Vjetor është një mjet i komunikimit të të arriturave të Qeverisë, përkushtimit, angazhimit dhe vendosmërisë së treguar në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve në përgjithësi duke ndërmarrë veprimet e nevojshme në kuadër të kompetencave të veta.

Në arritje të progresit dhe sigurimin e një trendi zhvillimor për vendin, është e nevojshme që të sigurohet stabilitet politik dhe institucional, në kuadër të kësaj, është e qartë që të gjithë mund të kontribuojnë akoma më shumë, në arritje të objektivave të paracaktuara, si dhe atyre që Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i përcaktojë për vitet në vijim.

Gjatë vitit 2016, Qeveria ka punuar në realizimin e 5 prioriteteve të cilat janë edhe shtyllat e Programit të Qeverisë 2015-2018; *Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, punësimi dhe mirëqenia, Sundimi i Ligjit dhe Shteti i së Drejtës, Agjenda evropiane dhe politika e jashtme; Arsimi, Shkenca, Kultura, Sporti dhe Zhvillimi Rinor* si dhe *Shëndetësia moderne*.

Përmes këtij raporti do të shpalosen të arriturat konkrete, të cilat i Qeveria e Republikës së Kosovës i ka pasur gjatë kësaj periudhe.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka arritur suksese të jashtëzakonshme, jo vetëm karshi situatës me të cilën është ballafaquar, por edhe karshi sfidave të cilat kanë përcjell vitin 2016.

Rritja ekonomike e Kosovës është shënuar si më të lartë në rajon për dy vite me radhë, Gjatë këtij viti Kosova ka pasur buxhetin më të lartë në histori, mbi 2 miliardë euro, uljen rekorde të papunësisë nga 35 % në vitin 2014, në 26 % në vitin 2016, ka nënshkruar MSA-në, me përmbushjen e kriterëve dhe marrjen e rekomandimit për liberalizimin e vizave, marrjen e kodit telefonit, rritjen më të madhe të pensioneve dhe përkrahjes sociale që ka ndodhur ndonjëherë mbi 25 % deri në 70 % për pensionet, adresimin e çështjes së veteranëve, e cila çështje është zgjidhur pas 17 viteve, anëtarësimin në UEFA dhe FIFA, vlerësimet më të larta ndërkombëtare të FMN-së dhe Bankës Botërore lidhur me qëndrueshmërinë makroekonomike dhe qëndrueshmërinë buxhetore. Poashtu Kosova a demonstruar stabilitet institucional e shtetëror dhe lidhshëm politik për të mos lejuar zhytjen e vendit në kaos dhe anarki.

Në *ekonomi* janë shënuar rezultate të prekshme, të vlerësuara nga institucionet ndërkombëtare dhe të vërtetuara me të dhëna reale pozitive.

Në *fushën e financave*, kemi rezultate të mëdha në reformat fiskale, të cilat kanë rezultuar me përmirësimin e kushteve të të bërit biznes, të cilat janë vlerësuar shumë lart nga Raporti i Bankës Botërore për vitin 2016 në dy indikatorë.

Në fushën e *zhvillimit ekonomik*, është miratuar Ligji për Trepçën, aq shumë i pritur nga minatorët dhe qytetarët tanë, i cili ka hapur mundësi për zhvillimin e kësaj ndërmarrje vitale për ekonominë e Kosovës dhe është punuar dhe po punohet intensivisht në përgatitjet në ngritjen e Termocentralit “Kosova e Re”.

Në *bujqësi* është rritur ndjeshëm përkrahja për bujqit duke arritur rezultate të konsiderueshme në sasi dhe cilësi të prodhimeve vendore. Është rritur konsumi i prodhimeve vendore, janë shtuar sipërfaqet e mbjella për shkak të rritjes të interesit të bujqve që ata të merren me bujqësi, sepse është treguar fushë shumë e rëndësishme për ne.

Në *infrastrukturë* është punuar fuqishëm në përfundimin e rrugës për Shkup, si arterie e rëndësishme ekonomike, është punuar në autostradën për Pejë, për Mitrovicë, dhe planifikojmë të nisim punën për ndërtimin e autostradës për Gjiilan e Podujevë. Janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e rikonstruimit të hekurudhës, në zgjerimin e hyrje-daljeve nëpër qytetet më të mëdha të Kosovës.

Në *Tregti dhe Industri* si rezultat i punës së madhe, Banka Botërore ka renditur Kosovën në raportin e të “Bërit Biznes 2017” në vende shumë më të lartë dhe masat të cilat po i merr kjo ministri tani, konsideroj se të avancojnë Kosovën edhe më tutje në të ardhmen.

Në *politikën e jashtme* kemi fuqizuar subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës në shumë aspekte. Jemi njohur nga Suriname dhe Singapori, kemi vendosur marrëdhënie diplomatike, jemi anëtarësuar në disa organizata dhe konventa ndërkombëtare. Jemi anëtarësuar në UEFA, FIFA, jemi pranuar në Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit, ka hyrë në fuqi Konventa e Apostiles, po ashtu Ministria e Brendshme ka nënshkruar marrëveshjen me Agjencinë Evropiane FRONTEX. Kemi zhvilluar dhjetëra vizita bilaterale dhe kam marr pjesë në forume multilaterale në disa kontinente. Kemi takuar udhëheqësit kryesor të botës demokratike, Presidentin Barack Obama, sekretarin Kerry, sekretarin e ri dhe të kaluarin të Kombeve të Bashkuara, kemi takuar mbretër, presidentë, kryeministra, ministra e drejtues organizatash ndërkombëtare dhe me të gjithë këta kemi biseduar për bashkëpunimin me Kosovën për avancimin e marrëdhënieve tona.

Në *rrugën evropiane*, kemi avancuar agjendën integruese. Kemi zhvilluar në Bruksel takimin e parë të Këshillit për Implementimin e MSA-së, që ka qenë një takim shumë i rëndësishëm për ne. Kemi prezantuar në Prishtinë me komisionerin Hahn, Agjendën e Reformave Evropiane, që kryesisht mbështetet në ekonomi, e cila i mundëson Kosovës avancimin e proceseve eurointegruese.

Në raport me NATO-n, Sekretari i saj, ka konfirmuar avancim substancial të bashkëpunimit si dhe pjesëmarrjen e Kosovës në programet e ndryshme të NATO-s. Këshilli i Atlantikut Verior është pajtuar për fuqizimin e bashkëpunimit të NATO-s me Kosovën, duke përfshirë aktivitete shtesë të dizajnuara për të fuqizuar bashkëveprimin e Kosovës me NATO-n.

Sa i takon *dialogut* të ndërmjetësuar nga BE-ja me Serbinë, është vazhduar me konstruktivitetin, të cilin e konsiderojmë vlerë edhe përkundër sabotimit të procesit nga ana e Serbisë,

Për vitin 2016, duhet veçuar, *alokimin e Kodit Telefonik 383* për Republikën e Kosovës duke e konsideruar arritje të madhe dhe duke bërë një hap të rëndësishëm në kompletimin e elementit të shtetësisë edhe në këtë fushë.

Janë fuqizuar kontaktet me *diasporën*, janë rritur aktivitetet dhe është arritur edhe një bashkëpunim edhe më i madh. Ka angazhim në bashkëveprimin e bashkatdhetarëve me Kosovën në interesimin e tyre për të investuar

në Kosovë, në inkuadrimit në jetën politike, në jetën sociale dhe në jetën kulturore, duke besuar se po krijohet një bazament gjithnjë e më i madh që ata të bëhen një element shumë i rëndësishëm i zhvillimeve.

Në fushën e *rendit dhe ligjit* është punuar me përkushtim në përgatitjen e legjislacionit dhe fuqizimin e sektorit të drejtësisë, si një prej prioriteteve themelore për perspektivën e shtetit tonë.

Policia dhe organet tjera të zbatimit të ligjit, kanë punuar mirë në parandalimin dhe zbardhjen e krimeve. Janë dhënë vlerësime të larta për policinë e cila renditet si më të besueshmet në rajonin. Është bërë punë e jashtëzakonshme e organeve të rendit, Policisë dhe AKI-së, në parandalimin e dhunës dhe të akteve, të cilat do të rrezikonin jo vetëm Kosovën, por edhe vendet fqinje. Organet tona, kanë dhënë kontribut esencial edhe në disa raste tjera shumë të rrezikshme, që do të mund të ndodhnin, të cilat do ta destabilizonin këtë pjesë të Evropës. Është intensifikuar lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe mund të them se në Qeveri gjatë gjithë kësaj periudhe kemi marrë vendime shumë të rëndësishme konkrete.

Forca e Sigurisë së Kosovës ka vazhduar ngritjen e kapaciteteve, duke u dëshmuar gjithnjë e më shumë si një forcë e gatshme për t'u shndërruar në Forcë të Armatosur të Kosovës. Në raport me avancimin substancial të bashkëpunimit me NATO-n, do të konsiderohet mënyra që FSK, në suaza të mandatit të saj, të marrë pjesë si vëzhguese në ushtrimet e Qendrës Koordinuese Euro-Atlantike për Reagim në Fatkeqësi (EADRCC). Po ashtu, do të eksplorohehen mënyrat që FSK-ja, në koordinim me Ekipin Këshilldhënës Ndërlidhës, të marrë pjesë edhe në ushtrimet e KFOR-it, në përputhje me mandatin e saj.

Në *arsim*, po kompletohet në tërësi infrastruktura dhe tashmë fokusi është krejtësisht në ngritjen e kualitetit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në të gjitha nivelet.

Në *shëndetësi*, janë bërë përgatitjet në fillimin e funksionalizimit të sigurimeve shëndetësore të cilat do të startojnë nga mesi i vitit 2017. Ka filluar puna në ndërtimin e disa objekteve shëndetësore të rëndësishme, siç është objekti i Emergjencave në Prishtinë dhe spitalet rajonale në disa qendra.

Në sferën e *Kulturës, Rinisë dhe Sportit*, përveç anëtarësimit historik në UEFA dhe FIFA, duhet theksuar debutimin në xhudo, në futboll, në futsall, në basketboll, në boks, në not e shumë disiplina tjera. Është duke u punuar në përmirësimin e infrastrukturës së stadiumeve dhe të sallave sportive nëpër komuna. Janë përkrahur të gjitha aktivitetet kulturore, zonat arkeologjike, është punuar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në sfera të ndryshme dhe mund të them se rinia ka pasur mbështetje në realizimin e aktiviteteve të saja në mënyrë që të hapen mundësitë e shprehjes së kreativitetit të tyre.

Në fushën e *mjedisit* është treguar kujdes në marrjen e Masave dhe në Përmirësimin e Cilësisë së Ajrit dhe Gjendjes së Mjedisit në Kosovë, duke përfshirë tejkalimin e gjendjes së cilësisë së ajrit me të cilin ne po ballafaqohemi dhe masave të cilat duhet të ndërmerren në parandalimin e ndotjes. Është përgatitur plani i masave për zvogëlimin e ndotjes me masa afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

Në fushën e *mirëqenies sociale*, është vazhduar me përkrahjen përmes skemave sociale dhe rasteve konkrete. Është zbatuar rritja historike prej 25 % për rastet sociale dhe rritjen deri në 50 % të pensioneve kontributdhënëse, varësisht nga përvoja e punës dhe kriteret tjera. Ka rënie të papunësisë, si dhe nga masat aktive të tregut të punës, kanë përfituar mbi 8 mijë qytetarë. Janë krijuar mundësi të punësimit sezonal jashtë vendit si dhe projekte të praktikës në punë e shumë projekte të tjera të dobishme për punëkërkuessit kosovarë.

Ka vazhduar *reforma në administratën publike* edhe tashmë janë bërë përgatitjet e duhura që deri në muajin e parë të vitit të ardhshëm, të miratohen dokumentet për Ligjin mbi Shërbimin Civil, Ligjin për Pagat dhe Ligjin për Organizimin e Administratës Shtetërore. Po ashtu, këtë gjatë vitit 2016 janë vënë bazat në racionalizimin e të gjitha Agjencive edhe ato që janë përgjegjësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës, edhe ato që janë përgjegjësi e Parlamentit dhe të agjencive tjera të pavarura.

Janë arritur rezultate të rëndësishme edhe në *pushtetin lokal*. Vlerësojmë se është rritur performanca e komunave, ka progres në administrimin lokal, në ofrimin e shërbimeve dhe në përmirësimin e jetës për qytetarët.

Në përgjithësi është rritur përkrahja për komunitet tjera jo shumicë, si ato boshnjake, turke, rome, ashkalinjtë dhe egjiptasit.

ZBATIMI I PRIORITETEVE STRATEGJIKE TË QEVERISË

Qeveria e Republikës së Kosovës për vitin 2016 është përcaktuar për zbatimin pesë prioriteve strategjike:

- *Prioriteti I - Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik, Punësimi dhe Mirëqenia*
- *Prioriteti II - Sundimi i Ligjit dhe Shteti i së Drejtës*
- *Prioriteti III - Agjenda Evropiane dhe Politika e Jashtme*
- *Prioriteti IV - Arsimi, Shkenca, Kultura, Sporti dhe Zhvillimi Rinor, dhe*
- *Prioriteti V - Shëndetësia Moderne*

Të gjitha aktivitetet për arritjen e objektivave në kuadër të prioriteve strategjike, rrjedhin nga Programi i Qeverisë së Kosovës dhe janë të bazuara në dokumentet tjera strategjike ndër-sektoriale e sektoriale të renditura në vijim:

Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, Programin e Reformave Ekonomike, Strategjia për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike 2015-2019, Plani i veprimit të Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-Formale, Shpëlarjes së Parasë dhe Financimit të Terrorizmit, Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018, Strategjia e Modernizimit të Administratës Publike 2015 - 2020, Programi për Projektet e Zhvillimit Rural 2016, bazuar në Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020, Strategjia për Asistencë në Fushën e Sundimit të Rendit dhe Ligjit, Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit 2013-2017, Strategjia Kundër Krimit të Organizuar, Strategjia kundër Terrorizmit, Strategjia kundër Drogave, Strategjia kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore; Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, Strategjia për Sigurinë Kibernetike, Strategjia kundër Korrupsionit; Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, Strategjia e Evropës Juglindore 2020, Strategjia Kombëtare për Zhvillim Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2011-2016; Strategjia Kosovare për Rini 2013-2017, Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2016-2020, Programi Kombëtar i Shkencës; Strategjia Sektoriale Punësimi dhe Politikat Sociale, Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2015-2020 dhe Planet Zhvillimore Strategjike Sektoriale.

Në përmbledhjen ekzekutive më lartë u përmendën në mënyrë të përmbledhura të arriturat kryesore, ndërsa në vijim do të paraqiten aktivitetet dhe të arriturat kryesore në kuadër të secilit prioritet strategjik të Qeverisë për vitin 2016.

- Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik, Punësimi dhe Mirëqenia

Në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, është arritur progres në përmirësimin e politikave ekonomike fiskale me theks te veçantë zbatimi i pakos fiskale e cila ka hyr në fuqi në shtator 2015 dhe efektet që ka prodhuar kjo pako. Progres, gjithashtu është arritur në hartimin dhe zbatimin e **Programit të Reformave Ekonomike**, Programin me Fondin Monetar Ndërkombëtar, në Disiplinë, menaxhim dhe transparencë buxhetore, në Marrëveshjet financiare ndërkombëtare, ka filluar me sukses Zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe është shënuar ngritje e realizimit tek të ardhurat tatimore dhe doganore.

Hapat në përmirësimin e reformave të lartcekura sigurojnë stabilitet financiar dhe ambient të favorshëm për zhvillim ekonomik, sigurojnë politika tregtare konkurruese dhe përmirësimin e mjedisit në të bërit biznes, mundësojnë përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, promovimin e investimeve, si dhe efikasitetin e shpenzimeve dhe rregullativës fiskale. Më konkretisht janë realizuar masat si në vijim:

Efektet e pakos fiskale -

- Gjatë vitit 2016 bizneset kanë përfituar lirime në shumën prej 47 milion euro.
- Numri i shoqërive tregtare të mëdha që, për shkak të qarkullimit të madh apo numrin të madh të të punësuarve, obligohen të dorëzojnë pasqyrat financiare në Këshillin Kosovar për Raportim Financiar është rritur nga 221 në 248. Kjo është një rritje prej 12% e numrit të kompanive të mëdha në vend. Rritja e punësimit vetëm në këto kompani ka qenë 11% apo 4,924 punëtorë më shumë (rritja nga 44,101 punëtorë në 49,029 punëtorë).
- Përfitimet nga qytetarët për shkak të lirimeve në normën e TVSH-së nga 16% në 8% kanë qenë në vlerë prej 21 mil euro (6.06 mil euro për tetor-dhjetor 2015 dhe 14.9 mil euro për periudhën janar-tetor 2016).
- Numri i bizneseve me llogari aktive në TVSH është rritur me 3 mijë gjatë këtij viti, nga 16 mijë sa ka pasur më 2015 në 19 mijë.
- ATK ka lejuar rreth 1.3 mil euro zbritje të bazës tatimore për shpenzimet e kompanive për pagesa në emër të bamirësive apo për asete speciale, bazuar në ligjin për të ardhurat e korporatave dhe ligjin për të ardhurat personale.

Avancimi i politikat ekonomike dhe fiskale

Propozim-politikat e reja fiskale: Ministria e Financave ka hartuar politikat e reja fiskale për përmirësimin e ambientit për biznes.

Buxheti për 2017

Është përgatitur buxheti për 2017 në linjë me objektivat e Qeverisë për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe qëndrueshmëri fiskale. Buxheti arrin që t'i financojë kërkesat me prioritet të secilës organizatë buxhetore dhe njëkohësisht ta ruaj stabilitetin buxhetor. Të hyrat për 2017 janë planifikuar 1 miliard e 725 mil euro, 6% më shumë se 2016 dhe 17% më shumë se 2015. Shpenzime janë planifikuar 2 miliard euro, një rritje prej 15% krahasuar me 2016 dhe 28% me 2015. Rritja më e madhe është tek investimet kapitale prej 46% krahasuar me vitin 2016. Buxheti ka pajtimin e plotë të Fondit Monetar Ndërkombëtar në të gjitha pozicionet kryesore buxhetore.

Të ardhurat nga dogana kanë pësuar rritje. Të hyrat nga Dogana e Kosovës për vitin 2016 janë **1,051.4 mil euro, që është 100 milion euro (apo 12%)** më shumë se vitin paraprak, me gjithë zvogëlimin e të hyrave doganore prej 22.8 mil euro për shkak të zbatimit të MSA-së.

Dogana ka bërë progres të madh në thjeshtëzimin e procedurave doganore, të dëshmuar në raportin e Bankës Botërore për vitin 2016. Indikatorin "Tregtia përmes kufijve", që ka të bëjë me Doganën, ka pasur ngritje për 8 pozita krahasuar me vitin paraprak. Ndërkaq, krahasuar me tri vite më parë, kemi një përmirësim të rangimit ndërkombëtar të Kosovës për 70 pozita, nga pozita 122 në pozitën 51.

Të ardhurat tatimore kanë pësuar rritje. ATK sivjet ka realizuar të hyra prej 386.4 mil euro, që është 54 mil (apo 16%) më shumë se në vitin paraprak. Janë pajisur me arka fiskale 2,308 biznese të reja, ndërkaq rimbursim i TVSH-së për qytetarë nga kuponët fiskal ka arritur shumën prej 13.1 mil euro.

Progres i mirë është arritur në fiskalizimin e pikave të karburanteve, ku rreth 60% e tyre janë fiskalizuar apo janë në proces të fiskalizimit. Nga Ligji për Faljen e Borxheve Publike, ATK ka falur borxhe prej 216 mil euro, ndërkaq janë mbledhur të hyra si rezultat i këtij ligji në shumë prej 24.2 mil euro. ATK ka bërë reformë të thellë në shërbimet për tatimpagues. Në raportin e të bërit biznes të Bankës Botërore, Kosova ka përmirësuar rangimin ndërkombëtar për 34 pozita në fushën e pagesës së taksave, nga pozita 77 në pozitën 43.

Zbatimi me sukses i Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit - Dogana e Kosovës nga data 1 prill 2016 ka filluar me zbatimin e MSA-së. Gjatë kësaj periudhe është përshtatur sistemi i doganimit në përputhje me kërkesat e MSA-së. Sot rreth 75% e mallrave që vijnë nga vendet e BE-së i nënshtrohen normës së reduktuar të tatimit doganor, me tendencë që sipas planit deri më 2022 rreth 99% e mallrave që vijnë nga vendet e BE-së të jenë të liruar nga tatimi doganor. Si rezultat i kësaj, kjo marrëveshje i ka reduktuar të hyrat nga Dogana për 22.8 mil euro.

Programi me Fondin Monetar Ndërkombëtar - Kosova është në program me FMN nga muaji korrik 2015. Të gjitha kriteret e programit janë përmbushur me sukses dhe në afat nga Ministria e Financave.

Marrëveshjet financiare ndërkombëtare

Janë nënshkruar 5 marrëveshje për kredi në vlerë prej 182.5 milion euro:

1. Marrëveshja me Kfë për projektin për masat e Efiçencës në Energji në nivel komunal (pjesa e kredisë 2.5 mil euro);
2. Protokollin Financiar me Qeverinë Franceze në vlerë prej 66 mil euro kredi për impiantin e ujërave të zeza në Prishtinë;
3. Marrëveshja me Qeverinë e Hungarisë për themelimin e programit kornizë për bashkëpunim financiar në vlerë prej 62 mil euro kredi;
4. Marrëveshja për ndryshimin e marrëveshjes për bashkëpunim financiar me qeverinë Austriake në vlerë prej 30 milionë euro kredi;
5. Marrëveshja me Bankën Botërore për rehabilitimin e kanalit të Ibër-Lepencit në vlerë prej 22 mil euro kredi (në proces të nënshkrimit/ratifikimit);

Janë nënshkruar 4 marrëveshje për grante në vlerë prej 88.5 milion euro:

1. Marrëveshja me KfË për projektin për masat e Efiçencës në Energji në nivel komunal (pjesa e grantit 5 mil euro);
2. Marrëveshja për asistencë teknike me Qeverinë Federale të Gjermanisë për vitin 2014 dhe 2015 në vlerë prej 20 mil euro grant;
3. Minutat e Takimit me Qeverinë Gjermane për periudhën 2016-2017 në vlerë prej 46.9 mil euro grant;
4. Marrëveshja me KfË dhe Qeverinë Zvicerane për projektin për trajtimin e ujërave të zeza në Pejë në vlerë prej 16.6 mil euro grant;

Janë nënshkruar 2 garanci shtetërore prej 34 mil euro për institucione/ndërmarrje publike:

1. Marrëveshja e garancisë shtetërore për projektin Trafiku Urban i Prishtinës në vlerë prej 10 mil euro si garanci shtetërore;
2. Marrëveshja e garancisë shtetërore për linjën e re kreditore të FSDK-së në vlerë prej 24 mil euro si garanci shtetërore (në proces të nënshkrimit/ratifikimit);

Ministria e Financave ka avancuar negociatat për eliminimin e tatimit të dyfishtë me vendet ku kemi diasporë të madhe, si në Austri dhe Zvicër. Janë iniciuar bisedat për marrëveshje të tillë me Gjermaninë, Danimarkën, Bullgarinë, Luksemburgun, Suedinë dhe Malin e Zi. Sivjet, një marrëveshje të tillë është nënshkruar me Qeverinë e Emirateve të Bashkuara Arabe.

Me qëllim të zhvillimit të sektorit privat dhe tërheqjes së investimeve janë miratuar 4 ligje, **Ligji për Falimentim, Ligji për Investime Strategjike, Ligji për Kamatëvonesat në Transaksionet Tregtare dhe Ligji për Akreditim.**

Politikat tregtare - Është krijuar platforma elektronike për raportimin e barrierave tregtare dhe është përgatitur broshura për ueb-platformën; Është përfunduar memorandum i bashkëpunimit në mes të agjencive kufitare, si obligim i dalë nga negociatat e lehtësimit të tregtisë në mes vendeve të CEFTAs;

Gjatë këtij viti Kosova ka arritur shkëmbimet tregtare (janar – tetor 2016) = 2 536 000 000.00 €, Mallrat e eksportuara = 253 milion €, Mallrat e importuara = 2 283 000 000.00 €

Produkte kosovare të ekspozuara brenda dhe jashtë vendit janë **1166 produkte ndërsa janë 33 kontrata** të lidhura për eksport.

Në funksion të përmirësimit të ambientit të biznesit Qeveria ka bërë unifikimin e numrit të regjistrimit të biznesit me numrin për eksport dhe import; po punohet edhe me ATK-në që bizneset ta kenë vetëm një numër. Është shkurtuar afati kohor për regjistrimin e bizneseve dhe janë zbatuar rekomandimet e task forcës "Doing Business" të udhëhequr nga MTI. Prej 3.5 ditëve sa është dashur më herët për regjistrimin e biznesit është shkurtuar afati kohor në 1.9 ditë.

Në raportin e Bankës Botërore në të bërit biznes jemi renditur në vendin e 13 për regjistrim të biznesit. Janë bërë eliminime dhe reduktime të tarifave për shërbimet e ofruara për bizneset në procesin regjistrimit të tyre. Është zhvilluar moduli për regjistrimin online të bizneseve. Është avancuar regjistri i pengut dhe ofron shërbime shumë të avancuara sipas kërkesave të bankave. Janë regjistruar 10,549 biznese ndërsa janë shuar 2,328 biznese. Nr. i bizneseve me pronarë të huaj – 656; shoqëri me përgjegjësi të kufizuar – 3868.

Gjatë vitit vlera e *Investimeve të huaja direkte* (janar – shtator 2016) sipas BQK-së është 218.4 milionë €. Shtetet që kanë investuar më së shumti janë: Zvicra, Britania e Madhe, Turqia, Shqipëria, Gjermania, Amerika, Austria. Ndërsa, sektorët ku është investuar janë: patundshmëria, qiradhënia dhe aktivitetet tjera biznesore, ndërtimi, shërbimet tregtare, shërbime tjera, shërbime financiare, dhe energjetika.

Qeveria me qëllim të *përmirësimit të qasjes në financa dhe certifikim të produkteve* ka funksionalizuar Fondin Kosovar për Garanci Kreditore dhe **deri tani ka lëshuar rreth 63 kredi për bizneset vendore**. Nga projekti për certifikimin e produkteve kosovare me standarde të cilësisë të njohura ndërkombëtarisht, i cili po zbatohet nga BERZH në bashkëpunim me USAID dhe donatorët tjerë, kanë përfituar rreth 20 ndërmarrje kosovare. Me qëllim të gjetjes së **tregjeve të reja për kompanitë kosovare**, janë përkrahur dhe realizuar pjesëmarrja në panairë të ndryshme ndërkombëtare. Kosova ka bërë progres në drejtim të anëtarësimit në strukturat rajonale dhe globale dhe lidhjes së marrëveshjeve të tregtisë së lirë.

Gjatë vitit 2016 nga Qeveria është finalizuar pakoja e ligjeve të **sektorit të energjisë** dhe janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës këto ligje të cilat janë në përputhje me paketën e tretë të direktivave të BE-së. Ligjet e miratuara janë si në vijim: Ligji për Energjinë nr. 05/L-081; Ligji për Energjinë Elektrike me nr. 05/L-085; Ligji për Rregullatorin e Energjisë nr. 05/ L- 084; Ligji për Gazin natyror me nr. 05/L- 082.

Projekti i TC Kosova e Re - Bisedimet për mbylljen e fazës së parë të projektit "Mbyllja Komerciale" kanë vazhduar intensivisht edhe gjatë kësaj periudhe, dhe nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve pritet të bëhen në fillim të vitit 2017. Njëkohësisht, po punohet në përgatitje të finalizimit të fazës së dytë të projektit "Mbyllja financiare", e cila pritet të kryhet në K3-2017. Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve në nivel të transmisionit, përgjatë vitit 2016 është realizuar projekti kapital Vendosja e infrastrukturës për rregullimin sekondar të Linjës së Transmisionit Kosovë-Shqipëri.

Në kuadër të zbatimit të politikave për zhvillimin e sektorit minerar në lidhje me rregullimin e statusit të ndërmarrjes "Trepça" është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës Ligji për Trepçën nr. 05/L-120.

Qeveria në kuadër të zhvillimit të sektorit të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural ka arrite progres të kënaqshëm gjatë vitit 2016.

Për Zhvillimin rural - Programi për Zhvillim Rural 2016 (Programi i granteve), si program vjetor i mbështetjes së fermerëve dhe agro përpunuesve në vend ka pas buxhet të planifikuar në vlerë prej **23 milionë euro** dhe është shpërndarë në pesë masat kryesore: **Masa për investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore**, me 342 përfitues, në vlerë prej 15.29 milion euro; **Masa për investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore**, me 25 përfitues, në vlerë prej 4,29 milion euro; **Masa për diversifikimin në fermë dhe zhvillimin e bizneseve**, me 98 përfitues, në vlerë prej 1,59 milion euro; **Masa për Grupet Lokale të Veprimit**, me 12 përfitues, në vlerë prej 80.000 euro dhe **Masa për ujitjen e tokave bujqësore**, me 8 përfitues, në vlerë prej 1.12 milion euro. Vlen të theksohet se gjatë këtij viti ka pasur një shtim të konsiderueshëm të sipërfaqes me pemë, veçanërisht me mjedër. batimin e këtij Programi ka qenë 23 milionë euro.

Bujqësia - Buxheti i planifikuar për zbatimin e këtij Programi ka qenë **26 milion euro** dhe është shpërndarë në këta nën sektorë: drithëra, blegtori, hortikulturë. Numri i aplikimeve përfituese nga ky program për vitin 2016 është mbi 42000 fermerë.

Ndikimi i investimeve në sektorin e bujqësisë - Si rezultat i investimeve të bëra në sektorin e bujqësisë gjatë vitit 2016, përveç tjerash është rritur niveli i prodhimtarisë bujqësore dhe agro përpunuese në vend, është rritur sipërfaqja e punueshme e tokave bujqësore, janë hapur mbi 2500 vende të reja të punës, është rritur dukshëm eksporti i produkteve bujqësore dhe në një masë është bërë zëvendësimi i produkteve të importit nga produktet bujqësore të prodhuara në vend.

Me qëllim të **përmirësimit të mirëqenies sociale dhe ruajtja e kohezionit social** - **Janë licencuar 145 ofrues të shërbimeve sociale**, prej tyre 87 ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare për nivel superior dhe 58 për nivel bazik. Poashtu **janë licencuar 18 organizata jo qeveritare** që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.

Gjatë vitit 2016 ka vazhduar **përkrahja për strehim familjar brenda familjes për 557 fëmijë**, me kompensim prej 75.00 në muaj, dhe strehim alternativ jashtë familjes për 84 fëmijë me pagesë 150.00 në muaj.

Në fushën e bashkëpunimit me OJQ, **janë ofruar shërbime në 6 strehimore regjionale për mbrojtje nga dhuna në familje**. MPMS ka përzgjedhë dhe mbështetë financiarisht projekte të 20 OJQ-ve, me mbi 50% të financimit të shpenzimeve të secilit projekt i destinuar për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

Janë ofruar shërbime sociale për 423 raste të dhunës në familje, nga të cilat 237 gra, respektivisht 186 fëmijë viktimat të dhunës në familje. Janë strehuar 29 persona që kanë pësuar nga trafikimi me qenie njerëzore, nga të cilat 11 të moshës madhore, dhe 18 të mitur dhe **56 fëmijë janë larguar nga format e rënda të punës së fëmijëve**. Është bërë decentralizimi i shërbimeve për Shtëpitë e Personave të Moshuar në Istog (Gurakoc), Graçanicë dhe Shtëpitë e Personave me Aftësi të Kufizuara në Shtime, Vushtrri, Deçan Ferizaj, Lipjan dhe Kamenicë. Në kuadër të skemave të **Ndihmës Sociale**, gjatë vitit 2016, **ndihmë sociale kanë përfituar 26.302 familje me 107.575 anëtarë të familjeve**. Varësisht nga numri i anëtarëve, **familjet kanë përfituar mes 50 deri 150 euro**.

- **Sundimi i ligjit dhe shteti i së drejtës**

Qeveria e Republikës së Kosovës ka shënuar progres në kuadër të arritjes së prioritetit lidhur me qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit. Janë miratuar 42 projektligje, të cilat janë proceduar në Kuvend.

Miratimi i këtyre Projektligjeve lidhet direkt me zhvillimin ekonomik, proceset integruese evropiane, arsimin, sigurinë, luftën kundër korrupsionit dhe avancimin e shumë proceseve të tjera të rëndësishme për të ardhmen e vendit.

Gjatë vitit 2016 është përmirësuar më tej infrastruktura fizike e sektorit të drejtësisë. Ka përfunduar ndërtimi i Objektivit për të Mitur me Masë Edukuese-Korrektuese.

Në nëntor të vitit 2016 është miratuar *Rishikimi FunkSIONAL për Sektorin e Sundimit të Ligjit* me qëllim të ngritjes së efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë, duke bërë analizën e sistemit të drejtësisë në tërësi. Rishikimi do të bëhet me qëllim të krijimit të një baze për *Hartimin e një Strategjie gjithëpërfshirëse për Rendin dhe Ligjin* e cila do të adresoj të gjitha problemet.

Në kuadër të sistemit të Përmbarrimit Privat është themeluar mekanizmi mbikëqyrës Komisioni për Inspektimin e ligjshmërisë së punës së Përmbarruesve privat dhe Odës së përmbarruesve privat.

Poashtu lidhur me sistemin e Ekzekutimit të sanksioneve penale është hartuar *Strategjia për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale*, e cila synon të përmirësoj administrimin e ekzekutimit të sanksioneve penale në Kosovë.

Në kuadër të unifikimit të sistemit të vetëqeverisjes lokale Qeveria ka bërë progres në funksionalizimin e organeve komunale në katër komunitet: Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok si dhe ka avancuar sistemin e komunikimit.

Në vitin 2016 Qeveria ka hartuar politikat e reja fiskale me qëllim përmirësimin e ambientit për biznes.

Në përputhje me agjendën e integritetit evropian, në muajin janar 2016 është dorëzuar "Programi për Reforma në Ekonomi 2016" në Komisionin Evropian i cili dokument është bazë për vlerësimet për raportin e progresit të Komisionit Evropian.

Një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës është edhe lufta kundër krimeve të rënda, terrorizmit, krimit të organizuar dhe luftimi i korrupsionit, i cili dëmton ekonominë, konsolidimin demokratik dhe imazhin e vendit ku është bërë rishikimi dhe vlerësimi i strategjive nacionale në fushën e drogave, krimit të organizuar, terrorizmit, sigurisë kibernetike dhe policimi i udhëhequr nga inteligjenca. Poashtu janë finalizuar strategjitë e reja për sigurinë në bashkësi dhe kontrollin e armëve të vogla, lehta dhe eksplozivëve.

Qeveria e Republikës së Kosovës e konsideron si një hap të rëndësishëm për të ndërtuar një shtet dhe shoqëri të fortë dhe të qëndrueshme për të luftuar këtë dukuri globale dhe për të siguruar që kjo dukuri nuk ka vend në Kosovë.

Qeveria gjatë vitit 2016 ka qenë e përkushtuar në kompletimin e kornizës strategjike për Reformën e Administratës Publike, si dhe kompletimin e kornizës ligjore në fushën e Administratës Publike.

- **Agjenda evropiane dhe politika e jashtme**

Kosova deri me sot është njohur nga 113 vende të botës, përfshirë edhe vendet lidere të botës. Kosova sot është anëtare e institucioneve më të rëndësishme financiare ndërkombëtare.

Marrëveshja për Stabilizim Asociim ka hyrë në fuqi në muajin prill 2016 e cila është marrëveshja ndërkombëtare më e rëndësishme dhe më gjithëpërfshirëse që ka lidhur ndonjëherë Kosova, dhe ka vendosur kornizën e marrëdhënieve tona me shtetet anëtare të BE-në dhe institucionet e saj, si dhe mekanizmat dhe afatet zyrtare për reformat që në mënyrë progresive do ta përafrojnë Kosovën me standardet e BE-së, do të krijojnë stabilitet politik e institucione demokratike, dhe do ta bëjnë ekonominë e saj të integruar në BE dhe të aftë për të përballuar forcat e tregut dhe presionin e konkurrencës brenda tregut të brendshëm të BE-së. MSA mbulon të gjitha sferat e qeverisjes, në kuadër të 144 neneve, të ndarë në dhjetë (10) tituj, si dhe në shtatë (7) shtojca, pesë (5) protokolle e një deklaratë të përbashkët.

Dialogu për liberalizimin e vizave me Bashkimin Evropian mbetet një nga prioritetet kryesore afat-shkurtë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Zhvillimi kryesor i këtij viti sa i përket *liberalizimit të vizave* është dhënia e rekomandimit nga ana e Komisionit Evropian dhe nga Parlamenti Evropian. Përveç kësaj, kanë vazhduar përpjekjet për zbatimin e dy rekomandimeve të mbetura: ratifikimi i marrëveshjes për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi dhe rezultatet në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Që nga dhënia e rekomandimit Kosova gjithashtu i ka dorëzuar KE-së dy raporte rreth përmbushjes së këtyre dy rekomandimeve të mbetura.

Poashtu është hartuar dhe miratuar Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) e cila është lansuar zyrtarisht nga Kryeministri Mustafa dhe Komisioneri i BE-së për Negociata të Zgjerimit në *Konferencën e Nivelit të Lartë Kosovë-BE për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit*. Qëllimi i ERA-s është fokusimi i zbatimit të MSA-së dhe që të shërbejë si instrument i Dialogut të rregullt të Nivelit të Lartë që do të zhvillohet në kuadër të strukturave të stabilizim-asociimit.

Anëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare ka qenë një ndër prioritetet parësore të politikës së jashtme edhe gjatë vitit 2016. Gjatë vitit 2016, Kosova ka vendosur marrëdhënie diplomatike me Gambinë, Malaëin, Bregun e Fildishtë dhe Singaporin. Aktualisht, Kosova ka vendosur marrëdhënie diplomatike me 86 shtete në tetë vitet e pavarësisë së saj.

Me qëllim të forcimit të shtetësisë dhe thellimit të fqinjësisë së mirë e të bashkëpunimit rajonal dhe në funksion të forcimit të paqes rajonale janë zhvilluar aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit me shtetet e rajonit.

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar që të ketë sa më shumë bashkëpunim më mërgatën me qëllim të ruajtjes së identitetit kombëtar dhe promovimit të vlerave kulturore.

Janë zbatuar politika promovuese dhe mbështetëse për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike nga diaspora. Është promovuar kultura, gjuha dhe historia shqiptare nëpërmjet diasporës, me qëllim ruajtjen e identitetit kombëtar.

Për të përkrahur mbarëvajtjen e mësimin të gjuhës shqipe, janë shpërndarë më shumë se 30 mijë libra dhe materiale të tjera shkollore në Diasporë.

Qeveria i ka kushtuar rëndësi mbështetjes së të rinjve në diasporë me qëllim edukimin e tyre më vlerat kombëtare dhe ruajtjen e gjuhës amtare.

- **Arsimi, Shkenca, Kultura, Sporti dhe Zhvillimi Rinor**

Në kuadër të *Rritjes së nivelit të gjithpërfshirjes së fëmijëve në shkollimin parashkollor dhe parafillor* është në proces draftimi i kurrikulës bërthamë për edukimin parashkollor (mosha 0-5 vjeç), si dhe janë trajnuar 933 edukatore të klasave parafillore për zbatimin e dokumentit të Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç. Gjatë këtij viti janë licencuar 62 institucione parashkollore private, me ç' rast është rritur përfshirja e fëmijëve në këtë nivel me rreth 3300 fëmijë.

Me qëllim të lehtësimit për regjistrim të **studentëve të komuniteteve në universitetet publike**, MASHT ka miratuar Udhëzimit Administrativ për aplikimin e masave afirmative dhe kuotave për regjistrim të studentëve nga komunitetet joshumicë në Universitetet Publike, gjithashtu ka ndarë 500 bursa për nxënësit e shkollave të mesme të larta për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe ka ndarë, poashtu 52 bursa për studentë të komuniteteve.

Kosova ka zhvilluar sistemin arsimor në të gjitha nivelet, ku theks të veçantë meritojnë arritjet në përfshirje të nxënësve në këtë sistem. Në kuadër të vlerësimit ndërkombëtar është përgatitur raporti kombëtar për rezultatet e PISA 2015, si dhe kanë filluar përgatitjet për PISA 2018.

Autoriteti Kombëtar të Kualifikimeve gjatë këtij viti ka vazhduar me popullimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve duke validuar dhe **aprovuar 6 kualifikime të reja në KKK si dhe akredituar për herë të parë 15 ofrues për akreditimin e këtyre kualifikimeve**. Në total deri tani janë aprovuar 27 kualifikime në nivelet kualifikimeve të para në nivelet 2, 3, 4 dhe 5 në KKK, si dhe janë akredituar 36 ofrues të cilët ofrojnë, lëshojnë dhe certifikojnë kualifikimeve profesionale.

Është draftuar **formula e financimit të Institucionet e Arsimit të Lartë**, është nënshkruar dokumentacioni për themelimin dhe funksionalizimin e SMIAL-it, si dhe ka filluar pilotimi në tri institucione të arsimit të lartë.

Në fushën e **hulumtimit dhe inovacionit**, janë botuar rreth 300 libra të kumtesave nga "Java e Shkencës 2015". Janë përkrahur 11 institucione hulumtuese nga granti për projekte të vogla shkencore në shumë prej 76870 €, 54 hulumtues nga granti për mobilitete afatëshkurtëra në shumë prej 35,000.00 €, si dhe 11 botime dhe publikime shkencore në shumë prej 45000 €. Kosova ka filluar të jetë aktive në Programin Kornizë të BE-së për Kërkim dhe Inovacion - Horizon 2020.

Qeveria është angazhuar në harmonizimin e arsimit dhe aftësisimit profesional me kërkesat e tregut të punës, duke realizuar një mori projektsh dhe aktivitete, si: është hartuar Plani Mësimor i veçantë për AAP që është duke u pilotuar në 24 shkolla; të gjitha shkollat e AAP kanë koordinatoret për sigurim të cilësisë; Qendra Kosovare e firmave ushtrimore është anëtarësuar në EUROPEAN PEN International; janë trajnuar 15 mësime të AAP-së për zbatimin e Office 365 në 7 rajone të Kosovës; është në proces trajnimi për zhvillimin e kompetencës së ndërmarrësisë (60 mësime të IAAP dhe 5 trajnerë të trajnerëve); është lansuar programi Master për AAP (DAAPARr dhe Fakulteti i Edukimit) gjenerata e parë; janë pajisur punëtoritë në 4 shkolla profesionale dhe është mbajtur trajnim për përdorim të tyre në 4 shkolla; është hartuar standardi i profesionit për nivelin e 5 për këshilltarin në karrierë dhe instruktorin e komunikacionit, si dhe 10 standarde të profesionit në bashkëpunim të ngushtë me bizneset; ka filluar zbatimi i partneritetit në mes të QK Ferizaj dhe QK Prizren dhe kompanisë ndërkombëtare PEARSON në njohjen ndërkombëtare të kualifikimeve që ofrohen në këto QK; janë hartuar kurrikula të integruara për 4 profile dhe tani kemi gjithsej 24 kurrikula të integruara; janë nënshkruar 5 marrëveshje me bizneset (në nivel qendror) për pranimin e nxënësve për

praktikën profesionale, si dhe janë rishikuar planet zhvillimore të 8 shkollave dhe janë trajnuar drejtorët dhe personat përgjegjës për planifikim.

Me qëllim të **zhvillimit dhe promovimit të aktivitete kulturore**, Kosova ka marr pjesë në bienalen e Venedikut për vitin 2017, gjithashtu për herë të parë ka marrë pjesë në Lojërat e Frankofonisë në Abidjan të Bregut të Fildishtë. Sa i përket pjesëmarrjes së Kosovës në festivalet ndërkombëtare vlen të theksohet pjesëmarrja e QKK-së në festivalet ndërkombëtare të filmit, pjesëmarrja e artistëve në festivalet ndërkombëtare të profileve të ndryshme. Është bërë anëtarësimi i Kosovës në Federatën Ndërkombëtare të Këshillave të Artit dhe të Kulturës me seli në Sidnei të Australisë.

Në vazhden e bashkëpunimit kulturor ndërkombëtar janë lidhur marrëveshje për bashkëpunim kulturor me shtetet: me Kroacinë dhe Bullgarisë. Poashtu, ka vazhduar me zbatimin e Protokollit të Bashkëpunimit Kulturor me Ministrinë e Kulturës së Republikës së Shqipërisë.

Në kuadër të **zhvillimit dhe ndërkombëtarizimi i mëtëjshëm i sportit të Kosovës**, gjatë vitit Kosova është përfaqësuar në Lojërat Olimpike verore Rio 2016, duke u shpërblyer me medale të art, si dhe në:

- Kampionatet Botërore, Evropiane, Mesdhetare dhe Ballkanike;
- Kupat Botërore, Evropiane, Mesdhetare dhe Ballkanike;
- Turne zyrtare ndërkombëtare të kategorive junior dhe senior;
- Turne mbarëkombëtare të karakterit tradicional.

- **Shëndetësia Moderne**

Me qëllim të orientimit strategjik të reformës në sektorin e shëndetësisë Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Strategjinë Sektoriale Shëndetësore 2017-2021 që synon ruajtjen e shëndetit.

Është miratuar statuti i Fondit të sigurimeve shëndetësore dhe Rregullorja për Menaxhim Financiar e Fondit të Sigurimeve shëndetësore. Qeveria gjithashtu ka marrë vendim për datën e mbledhjes së premieeve.

Gjatë vitit janë funksionalizuar Odat e Profesionistëve Shëndetësorë përmes nxjerrjes së statuteve dhe akteve tjera nënligjore dhe ka bartur kompetencat siç është përcaktuar me ligj. Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës është funksionalizuar si formë e integruar e shërbimeve në nivelin dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve spitalore në sistemin shëndetësor me mbështetje të Emirateve të Bashkuara Arabe është inauguruar Spitali i Vushtrrisë, në kujdesin parësor shëndetësor është përruar Qendra Kryesore Familjare në Kaçanik si dhe është përfunduar ndërtimi i Qendrës Kryesore Familjare në Skenderaj. Me qëllim të avancimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës janë siguruar pajisje për institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor në vlerë prej 1,6 milion euro. Janë siguruar tri autoambulanca për nevoja të institucioneve shëndetësore.

Sa i përket shërbimeve të reja këtë vit janë **realizuar 106 operime në kardiokirurgji që janë kursyer afër 1.500.000 euro.**

Duke marrë parasysh zotimin për më shumë fonde për të gjitha komunat, Qeveria ka ngritur grantin shëndetësor për komuna nga 40 milion euro në 44 milion euro për vitin 2017. Poashtu zotimi për personel mjekësor të rritur është realizuar me punësim të përkohshëm të 153 specialistëve si dhe specialistët voluntarë janë sistemuar me pagesë nga performanca. Furnizimi me barna dhe materiale mjekësore ka arritur mbi 70% në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor.

Sa i përket luftimit të kancerit janë realizuar 2792 mamografi si dhe Klinika e Onkologjisë ka trajtuar të gjithë pacientët në nevojë. Ka filluar programi i vizitave shëndetësore në shtëpi për kujdesin e nënës dhe fëmijë.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar është bërë ratifikimi i Marrëveshjes me Austrinë për modernizimin e shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në QKUK. Poashtu është nënshkruar marrëveshje për Akreditimin ndërkombëtar të Specializimit të Mjekësisë Familjare të Kosovës nga Kolegji Britanik. Kosova e Shqipëria kanë nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e shëndetësisë publike si dhe marrëveshje bashkëpunimi në mes Inspektoratit Shëndetësor i Kosovës dhe Shqipërisë.

Edhe mbështetja e donatorëve për sektorin e shëndetësisë është siguruar përmes nënshkrimit të marrëveshjeve me Qeverinë e Luksemburgut në vlerë prej 9.5 milion euro, Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim 6 milion euro dhe, Emiratet e Bashkuara Arabe 22 milion euro. Sektori i shëndetësisë është mbështetur edhe nga "Globus Relief" nga SHBA në vlerë 3.5 milion euro. Ministria e Shëndetësisë dhe TIKA kanë nënshkruar Marrëveshjen për Njësinë e re të Kujdesit Intensiv në QKUK.

ZBATIMI I PRIORITETEVE SEKTORIALE

Zbatimi i **prioriteteve sektoriale** në këtë raport paraqet të arriturat dhe zbatimin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të Qeverisë si tërësi, përmes raporteve individuale të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Secili institucion ka shënuar arritje domethënëse në sektorin apo fushën që mbulon të cilat në mënyrë të detajuar janë paraqitur në vijim.

- ZYRA E KRYEMINISTRIT

Zyra e Kryeministrit në rolin udhëheqës të koordinimit të punës së Qeverisë gjatë vitit 2016 është fokusuar në përmbushjen e detyrave të caktuara në kuadër të prioriteteve strategjike të Qeverisë, si dhe në përmbushjen e detyrave në kuadër të prioriteteve të vet ZKM-së.

Rezultate të veçanta janë shënuar në **koordinimin e politikave dhe planifikimit strategjik, hartimit dhe mbikëqyrjes së legjislacionit në përputhje me agjendën evropiane dhe fushat e tjera që i mbulon Zyra e Kryeministrit**

Me qëllim të diskutimit, shqyrtimit, aprovimit dhe në përgjithësi në funksion të vendimmarrjes së Qeverisë për politikat e ndryshme qeveritare, gjatë vitit 2016 janë organizuar 55 (pesdhjetëepesë) mbledhje të Qeverisë, janë nxjerr 479 vendime, janë mbajtur 31 (tridhjetë e një) mbledhje të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe , Qeveria ka miratuar 26 koncept dokumente.

Janë proceduar në Kuvend: 51 projektligje, 34 vendime të Qeverisë, si dhe janë pranuar nga Kuvendi dhe janë përcjellë ministrive 139 pyetje parlamentare, janë proceduar të Presidenti i Kosovës 10 vendime të Qeverisë. Janë hartuar 9 raporte për zbatimin e PVPQ, zbatimin e vendimeve të Qeverisë dhe procesin e hartimit të koncept dokumenteve për vitin 2016.

Për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2017 është rishikuar Udhëzuesi për hartimin e dhe Monitorimin e PVPQ. Për herë të parë në këtë vit ka pas një unifikim të kërkesave për hartimin e PVPQ-së, Programit të Dokumenteve Strategjike dhe të Programit Legjislativ që janë përfshi brenda udhëzuesit për hartim të PVPQ-së me qëllim që të tri këto dokumente të jenë në përputhshmëri të plotë. Për tu njoftuar me udhëzuesin e ri është organizuar punëtori me përfaqësuesit e zyrave ligjore dhe departamenteve për koordinim të politikave nga të gjitha ministrinë.

Në kuadër të procesit të integritimit evropian, ZKM ka dorëzuar dy Inpute për raportin e Komisionin Evropian për Kosovën për vitin 2016, ka udhëhequr 4 kapituj për sa i përket rishikimit të PKZMSA: *Reforma zgjedhore dhe Kuvendi, Të drejtat e Njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve, Bashkëpunimin Rajonal dhe obligimet ndërkombëtare si dhe Statistikat*. Ndërsa me qëllim të përcjelljes së zbatimit të obligimeve nga ky proces janë hartuar 4 Raporte për PKZMSA 2016.

Zyra e Kryeministrit ka rishikuar *Strategjinë për Rregullim më të mirë 2017-2021* dhe *Strategjinë për Përmirësimin e Planifikimit si dhe Koordinimit të Politikave*, të cilat janë miratuar në dhjetor të vitit 2016. Këto dy strategji njëherit janë pjesë e Shtyllës së Parë të Kornizës Strategjike të Reformës së Administratës Publike dhe po ashtu janë bazë për përkrahje buxhetore të Kosovës nga Komisioni Evropian në kuadër të këtij procesi.

Është finalizuar *Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021*, e cila është miratuar në Qeveri më 22 janar 2016, si mekanizëm kryesor për të konsoliduar procesin strategjik të prioritizimit, e cila do të sigurojë që të gjitha prioritetet e politikës kombëtare, përfshirë integritimin në BE, janë reflektuar në mënyrë të përshtatshme. Pas miratimit, ZPS ka hartuar dhe ka dërguar Udhërrëfyesit për zbatimin e SKZH-së së bashku me Instruksionin për përgatitjen e Udhërrëfyesit tek ministrinë përkatëse të linjës. Gjithashtu, në kuadër të këtij procesi, ZPS ka bërë prezantimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim në takimet rajonale në Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Ferizaj gjatë muajit prill me organizatat e shoqërisë civile dhe hisedarët e tjerë.

Programi Për Reforma Ekonomike- Bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 07/56, ZPS së bashku me Departamentin për Politika Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar (MF) dhe nën udhëheqjen e Koordinatorit Nacional, Ministrin të Financave, ka koordinuar procesin e hartimit të Programit të Reformave Ekonomike 2016-2018 (PRE), si pjesë e dialogut ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës në kuadër të qeverisjes ekonomike, i cili më pastaj është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 29 janar dhe është dorëzuar tutje tek Komisioni Evropian.

Ndërlidhja e prioriteteve të SKZH-së dhe PRE-së me prioritetet afatmesme dhe procesin buxhetor/KASH – Zyra për Planifikim Strategjik ka përgatitur Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme (DPA) të Qeverisë së Kosovës në pajtim të plotë me prioritetet e vendosura në kuadër të katër shtyllave të SKZH-së, si dhe Programit për Reforma Ekonomike, si pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2017-2019. Kjo është bërë në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave. DPA për KASH 2017-19 është miratuar dhe tani përfshin një kornizë të prioriteteve për të udhëhequr planifikimin buxhetor në ministrinë e linjës. Në këtë

drejtim, ZPS ka marrë pjesë edhe në procesin e dëgjimeve buxhetore, në mënyrë që të sigurohemi se kjo kornizë e prioritetëve është e reflektuar edhe në buxhetin vjetor për vitin pasues.

Ngjashëm, ZPS ka hartuar listën e prioritetëve strategjike për Planin Vjetor të Punës së Qeverisë dhe ka ndihmuar institucionet duke dhënë shpjegimet e duhura për procesin e ndërlidhjes së aktivitetëve të Ministrive me listën e prioritetëve strategjike.

Vendosja e Sistemit të Planifikimit të Integruar - Në kuadër të SPI-së, Qeveria më 21 janar 2016, ka themeluar edhe Komisionin e Planifikimit Strategjik (KPS), i kryesuar nga Kryeministri i Kosovës dhe i cili përfshinë të gjithë ministrat kryesorë. KPS është takuar dy herë gjatë vitit 2016 për të shqyrtuar aspekte strategjike që ndërlidhen me MCC dhe PRE.

Planifikimi Strategjik dhe i Politikave - ka vazhduar me koordinimin e procesit të hartimit të dokumenteve strategjike në pajtim me Udhëzimin Administrativ 02/2012. Në bazë të PVDS 2016 janë paraparë të hartohen 41 dokumente strategjike. Deri më tani janë miratuar 11 dokumente strategjike, ku 4 prej tyre janë nga PVDS 2015. Aktualisht, në proces të hartimit ose finalizimit janë 20 dokumente strategjike, ndërsa disa prej tyre janë bartur përsëri në vitin 2017. Po ashtu, gjatë muajit tetor ZPS ka konsoliduar listën e përgjithshme të dokumenteve strategjike valide duke zvogëluar numrin e tyre nga 67 sa ishin nga periudha paraprake në 55 dokumente strategjike aktuale. Në pajtim me objektivat e vendosur në Strategjinë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave, ZPS është në proces të konsolidimit të kornizës strategjike, duke lëvizur drejt qasjes sektoriale të hartimit të dokumenteve strategjike, gjë që do ndikojë në zvogëlimin e mëtejshëm të numrit të përgjithshëm të dokumenteve strategjike.

Programi Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2016 - përmban gjithsej 108 Projektligje, janë miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës 42 Projektligje. Qeveria ka miratuar tridhjetë (31) akte nënligjore, Ndërsa, gjatë kësaj periudhe në regjistrin e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat janë miratuar gjithsej 137 Akte nënligjore .

Me Rregulloren nr. 09/2011 e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës përcaktohen rregullat dhe procedurat për hartimin e legjislacionit dhe rekomandimeve të politikave nga Qeveria dhe Ministrinë.

Qeveria e Republikës së Kosovës në përputhje me Rregulloren e punës së saj çdo vit përgatit Planin Vjetor të Punës, i cili përfshin aktivitetet legjislative dhe jo-legjislative. Aktivitetet legjislative përmbledhen në një Shtojcë të veçantë të Planit Vjetor të Punës me qëllim të lehtësimit të menaxhimit dhe monitorimit të iniciativave legjislative të Qeverisë- Programi Legjislativ.

Programi Legjislativ përmban ministrinë bartëse të projektligjeve si dhe datat se kur parashihet që Ministrinë t'i dërgojnë projektligjet për shqyrtim dhe miratim në Qeveri.

Për më tepër ky program më tutje përdoret nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për të planifikuar seancat gjatë tërë vitit, si dhe hartimin e planeve të punës për komisionet parlamentare.

Zyra e Kryeministrit monitoron zbatimin e Programit Legjislativ të Qeverisë dhe në këtë raport mund të gjeni të dhënat për realizimin e Programit Legjislativ gjatë vitit 2016.

Programi Legjislativ 2016 përmban gjithsej 112 Projektligje, prej të cilave janë miratuar gjithsej **53 Projektligje**.

Në kuadër të 112 Projektligjeve të parapara për vitin 2016, prej tyre 51 janë parapa në PKZMSA, ku vetem 12 prej tyre janë miratu ndërsa 39 nuk janë miratuar.

Me qëllim të pasqyrimin të realizimit të Programit legjislativ gjatë vitit 2016, më poshtë gjeni të paraqitur gjendjen e realizimit të projektligjeve.

Me qëllim të *informimit të publikut* për aktivitetet e Kryeministrit dhe Zyrës së Kryeministrit në përgjithësi, janë dhënë 527 informata, 162 njoftime për agjendën e Kryeministrit dhe të Zëvendëskryeministrave dhe Zyrat përkatëse të ZKM-së, 21 konferenca për shtyp me gazetarë për Kryeministrin, Zëvendëskryeministrat, Ministrat dhe Zyrat përkatëse të ZKM-së. Janë kryer 243 raporte të monitorimit të mediave vendëse dhe regjionale. Është hartuar Zyra për Komunikim publik ka hartuar Raportin Gjithëpërfshirës 2015, ZIP ka pranuar gjatë këtij viti 18 kërkesa për qasje në dokumente publike, është përgjigjur pozitivisht në 10 prej tyre, dy janë ende në proces ndërsa ka refuzuar 6 kërkesa.

Në kuadër të qeverisjes së mirë - është aprovuar rregullorja për Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik, zhvillimi i Platformës Online, është bërë raporti për vitin 2015 dhe Plani i punës për vitin 2016 për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile. Është finalizuar zhvillimi i Platformës Online, e cila do të sigurojë zbatimin e standardeve minimale për konsultime publike sipas Rregullores nr. 05/2016. Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve për nëpunës civile për zbatimin e rregullores për standard minimale për konsultime me publikun. Me Vendim të Qeverisë Nr. 05/89 të datës 25.05.2016, është bërë përzgjedhja e modelit MIX për financim të OJQ-ve, me të cilin obligohet ZKM/ZQM dhe Ministria e Financave të hartojnë Rregulloren mbi standardet, kriteret dhe procedurat për shpërndarjen e fondeve. Janë organizuar dhe mbajtur e takime të rregullta të Këshillit, takime të koordinatorëve, punëtori e takime të Ekipeve të Këshillit si dhe mekanizmave përkrahës të tij

Është kryer Raporti mbi pajtueshmërinë e legjislacionit të Republikës së Kosovës me Konventën e Këshillit të Evropës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimet Seksual të njohur si “Konventa e Lanzarotes”, Aplikimi dhe pranimi i projekt propozimit në fazën e parë “Politikbërja e fëmijëve bazuar në dëshmi” në kuadër të IPA 2017. Është hartuar raporti për monitorimin e të drejtave të fëmijëve i njohur si “Karta raportuese”. Janë realizuar takimet e Komitetit Ndërmnistrorë për të Drejtat e Fëmijëve. Është hartuar raporti i monitorimit të treguesve të drejtësisë për fëmijë. Është organizuar seanca plenare e improvizuar në Kuvendin e Kosovës për “Shënimin e 1 Qershorit”. Ka përfunduar procesi i hartimit të Strategjisë për përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021. Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues për të Drejtat e Komunitetit (LGBTI), ka aprovuar planin e tij të punës për vitin (2016-2018). Është hartuar Raporti i Progresit për vitin 2015 për zbatimin e Planit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2015, Është hartuar Plani Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës (2017-2019), Është miratuar Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, Janë mbajtur dy takimet e Këshillit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, Hartimi i koncept dokumentit për gjithpërfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuar, Konferencë me temën Politikat Nacionale në mbrojtje të të drejtave të Personave me Autizëm në Republikën e Kosovës, Shënimi i Ditës dhe Javës Ndërkombëtare për Personat e Shurdhër, Shënimi i Ditës dhe Javës Ndërkombëtare për Mundësi të Barabarta për Personat me Aftësi të Kufizuar. Duke marrë parasysh Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 07/157, të datës 22.11.2013, për aprovimin e Programit Kombëtar për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave për Personat e Shurdhër në Republikën e Kosovës, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka hartuar rregulloren për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave për Personat e Shurdhër ndërsa më 15 Tetor 2014 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës si dhe qasje në shërbimet e interpretimit, nëpërmjet Interpretëve të Gjuhës së Shenjave.

Si rrjedhojë mbi bazën e këtij dokumenti nga muaji prill 2016 Republika e Kosovës ka jetësuar me sukses të drejtën e qytetarëve të shurdhër për të marr shërbime në gjuhën e shenjave sipas nevojave të tyre në të gjitha institucionet publike në vend.

Pra, tani një qytetarë i shurdhër në Republikën e Kosovës nuk është i izoluar, por gëzon absolutisht mundësin e barabartë të komunikimit (në gjuhën e shenjave) në të gjitha institucionet publike

Për më tepër ky vendim e ka pozicionuar Republikën e Kosovës në një ndër vendet e para në Ballkan që ka marrë këtë hap, dhe që përbën një shembull pozitiv për vendet e rajonit dhe më tej.

Sigurisht kjo e arritur është mundësuar përmes bashkëpunimit shumë të mirë të institucioneve dhe vet komunitetit të personave të shurdhër të cilët kanë qenë një nga promotorët e rëndësishëm që ky proces të përmbillet me sukses.

Gjatë periudhës raportuese në fushën e bashkëpunimit rajonal **Zyra e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal** është përfaqësuar në takimin e 28 dhe 29 me radhë të Bordit të RCC-së ku është diskutuar mbi draftin e Strategjisë së Punës dhe Programit të RCC-së 2017-2019. Si dhe ka kryer obligimet e saj financiare në kuadër të buxhetit të Sekretariatit të RCC-së për vitin 2015 dhe vitin 2016 .

Në përmbushje të mandatit ligjor të **Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur**, Komisioni ka vazhduar me organizimin dhe mbajtjen e takimeve të rregullta, me pjesëmarrjen, krahas anëtarëve të Komisionit, edhe të akterëve vendor e ndërkombëtar të angazhuar në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur. Janë mbajtur tri takime të Grupit Punues për Persona të Zhdukur, në mes të Delegacionit të Kosovës dhe Delegacionit të Serbisë, me ndërmjetësimin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, si dhe tri takime të Nëngrupit Punues për Mjekësi Ligjore. Janë realizuar më shumë se 20 operacione fushore apo aktivitete gjermuese, të realizuara në 15 lokacione të shënjuara në kërkim të mbetjeve mortore të viktimave të luftës. Nga 15 lokacionet e proceduara, brenda territorit të Republikës së Kosovës, gjatë këtij viti, me gjetje të mbetjeve mortore të viktimave të luftës, kanë rezultuar 6 lokacione, ku janë zhvarrosur mbetjet mortore të 7 personave (numri minimal i individëve: 7) Në 3 lokacione, nga 15 lokacionet e proceduara në kuptimin e gjurmimit vlerësues, kanë prezantuar edhe përfaqësuesit e Delegacionit të Serbisë. Ju janë kthyer për rivarrim mbetjet mortore të më shumë se 65 personave të zhdukur, të identifikuar. Nga rastet e dorëzuara, janë përfshirë edhe 5 raste që iu janë dorëzuar familjarëve dhe autoriteteve të Serbisë, në Pikë Kalimin Kufitar Porta 3, në Merdar. Gjatë këtij viti, në bashkëpunim me Shoqatat Familjare të Personave të Zhdukur dhe janë realizuar edhe një sërë aktiviteteve me rastin e shënimit të 27 Prillit – Dita e të Pagjeturve të Kosovës dhe 30 Gushtit – Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur. Qeveria ka aprovuar Vendimin për ndarjen e 20,000.00 (njëzetmijë Euro), për përkrahje të familjeve të personave të zhdukur përmes projektit për rehabilitim në banja.

Për çështjen e komuniteteve, Qeveria, Qeveria ka miratuar Programin për Komunitete, është hartuar Strategjia për afirmimin dhe integrimin e Komunitetit Malazez ne Republikën e Kosovës. Deri më tani janë verifikuar gjithsejtë 135 diploma. janë organizuar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve për të përkrahur komunitetet në fusha të ndryshme përmes ftesave për propozime për Media të financuara deri në vlerë prej 200.000 euro, ftesa për propozime për OJQ në vlerë prej 150.000 euro. Projekti për përkrahjen e Komunave të sapoformuara në Veri të Kosovës për zhvillimin e kulturës, rinisë dhe sportit në këto komuna është përkrahur OJQ Aktiv 88.000 euro. Programi i praktikës në bashkëpunim me Ambasadën Norvegjeze është përkrahur me

90.000 euro për një periudhë gjashtë (6) mujore, së bashku me kurse të gjuhës shqipe/serbe për praktikantët. Në bashkëpunim me Universitetin Amerikan në Kosovë janë ofruar bursa për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në Kosovë në vlerë prej 36.000 euro.. Në bashkëpunim me UNDP është implementuar programi Rapid Response (thirje e shpejtë) në vlerë prej 150.000 euro, ndërsa në bashkëpunim me MKK janë dhënë shuma prej 150.000 euro për blerjen e materialit ndërtimor për raste sociale si dhe është financuar ndërtimi i dy shtëpive për Komunitetin Egjiptian në vlerë prej 5.000 euro.

Grupi Punues për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtim (GP BmKP). Është finalizuar dokumenti për analizimin e legjislacionit. Si rezultat, është hartuar dokumenti bazik për dizajnimin e procesit të konsultimeve në Kosovë, përfshirë aktivitetet dhe afatet kohore. Është hartuar drafti i parë i dokumentit referues për Strategjinë për Drejtësi Tranzicionale, Grupi punës ka hartuar planin konkret për procesin e konsultimeve, të cilat do të organizohen nga janari deri në korrik të vitit 2017, i ndarë në 7 komuna, me të gjitha kategoritë e viktimave duke përfshirë edhe komunitetet jo shumicë.

Në kuadër të **Zyrës së Komisionerit për Gjuhët** -Ka përfunduar programi i kurseve në dymbëdhjetë (13) komuna ,projekt ky i bashkë financuar nga Zyra e Komisionerit për gjuhët dhe Komisioneri i lartë për pakica kombëtare (HCNM); Janë dërguar rekomandime në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike për përfshirjen e mësimit të gjuhëve zyrtare në kurrikulën e trajnimeve të AKSP-ës përmes projektit IPA . Gjatë këtij viti në ZKGJ janë parashtruar 41 ankesa, 21 janë zgjidhur 20 janë në proces të zgjidhjes, janë lëshuar rekomandime në bazë të ankesave për komunat. Është bërë publikimi i Raportit vjetor të punës së ZKGJ-ës, raportimi në baza tremujore si dhe raportim për Bordin dhe për Vëzhguesit.

Është bërë hartimi dhe publikimi i “Udhërrëfyesit për nëpunësit civilë për zbatimin e të drejtave gjuhësore”. Është punuar mjeti monitorues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve për komunat. Në bazë të monitorimit të institucioneve janë lëshuar 33 rekomandime (Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, Ministrisë së infrastrukturës, Agjencisë Kosovare për Siguri Publike, Organit Shqyrtues të Prokurimit, Komunave: Graçanicë, Klllokot, Partesh, Ranillug dhe Zyrës Administrative e Mitrovicës së Veriut. Zyra ka rregulluar aplikacionet e ngjyrave të veturave dhe të ndërtimit të automjeteve, në bashkëpunim me QAK-un. Janë përgatitur dhe shpërndarë ‘Fletëudhëzuesit për të drejtat e përdorimit të gjuhëve zyrtare’ për nivelin qendrorë dhe komunal të cilët me ndihmën e anëtarëve të Rrjetit për politika të gjuhëve janë vendosur në pothuajse të gjitha institucionet që janë nën juridiksionin e Zyrës. Me përkrahjen e Ambasadës Zvicerane në Prishtinë në kuadër të Festivalit ndërkombëtarë të filmit është punuar dhe shfaqur filmi me temën: Shumëgjuhësia vlerë dhe /apo obligim.

Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare ka bërë Publikimi i akteve juridike në formë të shtypur / ueb -faqe të Gazetës Zyrtare të : 41 Numra të Gazetës Zyrtare janë shtypur në formë të librit, 1 Amendament Kushtetues, 48 Ligje, 2 Tabela të Ligjit për Buxhet, 12 Marrëveshje Ndërkombëtare të ratifikuara me ligje, 1 Vendim i Kuvendit, 25 Marrëveshje Ndërkombëtare të ratifikuara me dekret të Presidentes, 1 Dekret, Presidenca, 1 Vendim për zgjedhje, Presidenca, 7 Njoftime për akreditim të ambasadorëve nga Presidenca, 2 Udhëzim Administrativ(QRK), 1 Rregullore (QRK), 36 Vendime të Qeverisë, për shpronësime me tabela përcjellëse, 74 Vendime, Rregullore, Udhëzime Administrative e akte tjera të ministrive, 134 Vendime, Aktvendime, Aktgjykime, rregullore e akte tjera të Gjykatës Kushtetuese, 487 Vendime, Aktvendime, shpallje e akte të tjera të Gjykatave Themelore të Kosovës, 106 Vendime, Rregullore, Udhëzime Administrative e akte të tjera të Komunave, 38 Vendime dhe Udhëzime të institucioneve tjera të pavarura. **Në këtë periudhë raportuese gjithsejtë janë publikuar 974 akte normative** në 5 gjuhë (shqipe, angleze, serbe, turke dhe boshnjake).

Për *Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike*, Komisioni i cili vepron në kuadër të ZKM-së për këtë qëllim (KHAIA), ka përfaqësuar Republikën e Kosovës në rrjetin Evropian të Hetuesve të Aviacionit Civil, dhe në rrjetin Evropian të Aksidenteve Hekurudhore ERA,

Gjatë këtij viti është janë hetuar një rast në Kosovë dhe për një rast tjetër KHAI ka qenë vëzhgues. Është nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit me Agjencionin për Hetimin e Aksidenteve në trafikun Ajror, Detar dhe Hekurudhor (AIN) i Republikës së Kroacisë i cili ka për qëllim shkëmbimin e eksperiencave, trajnime të përbashkëta, ofrimi i eksperteve dhe hetuesve në rast të një aksidenti si dhe ofrimi i programit për dekodimin e qipave të Trenave të gjitha me kosto zero. Në vazhdimësi janë realizuar kontakte të vazhdueshme me Institucionet homologe dhe rritja e marrëdhënieve në bashkëpunim në Aviacion dhe Hekurudha me Kroacinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Shqipërinë, Turqinë, Gjermaninë, Francën dhe Anglinë. Janë punuar dhe përgatitur dy rregullore për Aviacion të cilat janë transpozim të rregullores 996/2010 të BE dhe Anex 13 të Konventës së Chicago-s. Këto rregullore janë në fazën e diskutimit publik. Gjatë vitit 2016 në Aeroportin e Prishtinës kemi pasur 107 raste të cilat janë përcjell me vëmendje. Sipas ligjit dhe nevojës janë lëshuar rekomandime lidhje me rritjen e Sigurisë në Aviacion Civil. Është ofruar shërbim i kujdestarisë për të gjithë qytetarët 24/7 ku kemi pasur në dispozicion një numër të tel dhe një Email.

Agjencioni për Barazi Gjinore-ABGJ ka hartuar Udhëzimi Administrativ (QRK Nr 03/2016) – si masë e veçantë për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshorteve. ABGJ në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale ka monitoruar zbatimin e këtij udhëzimi dhe të dhënat për 6 mujorin e parë që nga hyrja në fuqi, janë 124 raste të cilat kanë përfituar nga ky UA. ABGJ ka subvencionuar pjesërisht 12 projekte të cilat kanë për qëllim ndërgjegjësimin e përgjithshëm të qytetarëve për barazi gjinore, fuqizim ekonomik të grave, si dhe të promovojnë gratë në kulturë dhe ndërmarrësi. Projektet e financuara në total 30.000 euro. ABGJ ka publikuar Raportin e dytë Monitorues për Progresin e Implementimit të Planit të Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325¹ “Gratë, Paqja dhe Siguria” me 25 Nëntor/2016. ABGJ Gjatë vitit 2016 ka vazhduar me ofrimin e trajnimeve për Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (PSV) trajnimin e ndoqën 260 pjesëmarrës. ABGJ ka shënuar 25 Nëntorin, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas –(16 Ditët e Aktivizmit) përmes fushatës senzibilizuese si dhe është iniciuar procedura e realizimit të hulumtimit “ Gratë në mediat e shkruara 2014-2015”, raporti pritet të finalizohet në shkurt 2017.

Agjencioni Kosovar për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore në kuadër të aktiviteteve të veta ka realizuar këto aktivitete me qëllim të zbatimit të objektivave të parapara. Në këtë drejtim është hartuar projektligji për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore i cili është miratuar në Qeveri, si dhe është punuar më 2 rregullore nga fusha e mbrojtjes nga rrezatimi, është duke u rishikuar dhe rivlerësuar Strategjia dhe Plani i Veprimit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore për periudhën 2017 - 2027; Është hartuar drafti i Strategjisë për Menaxhimin e Uraniumit të Varfëruar në territorin e Republikës së Kosovës për periudhën tremujore. Qeveria ka themeluar Grupin Ndërmintor për hartimin e Strategjisë nacionale për mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë. Janë hartuar dhe miratuar dy plane të Inspektiveve për vitin 2016, në përgjithësi janë realizuar 112 inspektive, gjatë vitit 2016 janë lëshuar gjithsej 52 autorizime.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës- Janë përpunuar dhe rregulluar **383 metra gjatësi** lineare e lëndës arkivore; janë pastruar, dezinfektuar, restauruar dhe konservuar 2937 fletë, janë lidhur 99 libra si dhe janë përgatitur 14.350 këmishëza; janë shërbyer 5850 pale dhe hulumtues. (Gjatë vitit 2016 janë skanuar **4622** dokumente; **3630** mikrofilma; 1906 dokumente për përshkrimin e lëndës arkivore janë futur në data bazë, janë indeksuar 3509 dokumente si dhe janë digjitalizuar **8250** emra. Është bërë migrimi i **188.944** dokumente digjitale nga mediumet tjera (CD, DVD, Backup, PC) në server.)

Janë pranuar **13.80 metër gjatësi lineare** e lëndës arkivore. Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me Arkivin Shtetëror të Malit të Zi. Gjithashtu është bërë ripërtëritja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Bullgarisë. Këtë vit Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës ka botuar 6 libra: Revistën *“Vjetari”*, doracakun për arkivist *“Dokumente Elektronike”*, *“Bibliografia e botimeve të veçanta të ASHAK-së 1965-2015”*, autor Sadik Mehmeti dhe Nuridin Ahmeti; *“Suhareka gjatë Luftës së Dytë Botërore 1941-1945”*, autore Zeliye Shala, *“Shqiptarët në politikën e jashtme të Austro – Hungarisë (1912-1914)”*, autor Selim Bezeraj, si dhe me rastin e 65 vjetorit botimin e veçantë *“Arkivat e Kosovës (Jubileu i 65-të)”*. Janë bërë promovime të botimeve: *“Fjalorit Shqip të Termave Arkivor”*, në Prishtinë dhe Tiranë; Monografisë *“Drenica e epërme dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës”*, e autorit Selman Krasniqi, Prishtinë; Librit *“The Serb Government’s Crimes in Kosova 1998-1999”*, e autorit Prof.Dr. Jusuf Osmani, Prishtinë.

Agjencia e Statistikave të Kosovës: janë publikuar gjithsej 110 publikime, prej tyre, 31 publikime në baza vjetore, 52 publikime në baza tremujore, dhe 24 publikime në baza mujore; 2 publikime të specializuara nga Regjistrimi i Bujqësisë 2014; dhe 1 (një) publikim në baza dyvjeçare. Ndërkaq, nga aktivitetet e tjera janë realizuar edhe dy anketa: Anketa mbi Eficiencën e Energjisë në sektorin e ndërmarrjeve dhe Anketa për Azhurnimin e Regjistrimit të Bizneseve. Kurse, në kuadër të IPA 2014 janë duke u kryer të gjitha aktivitetet për 13 pilot-projekte.

Në fushën e aktiviteteve të përgjithshme, gjatë vitit 2016, janë realizuar: i) përgatitja dhe dërgimi në Qeveri i PVPQ-së për vitin 2017, në fushën e statistikave; ii) hartimi i Raportit Vjetor të punës për vitin 2015, sipas Ligjit mbi Statistikat Zyrtare, duke matur performancën mbi realizimin e Planit të Punës; iii) Përgatitja e Planit Vjetor të Punës për vitin 2017 dhe aprovimi nga Qeveria; iv) përgatitja (rishikimi) e Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së, pjesa për statistikat; v) hartimi i Hartës Rrugore për vitin 2017; vi) monitorimi i programit dhe planit vjetor të punës përmes kornizës vlerësuese të performancës; vii) implementimi i rregullores për riorganizimin e ASK-së; viii) realizimi dhe zbatimi i të gjitha obligimeve nga Korniza Ligjore në nivel të brendshëm (plotësim ndryshimi i UA nr 08/2012) mos aprovimi i tij ende mbetet sfide për ASK-ne dhe qeveritar (Plotësim ndryshimi i Ligjit mbi Statistikat Zyrtare) i cili është aprovuar nga qeveria me ndryshime nga versioni i dërguar nga ASK-ja.

Në fushën e TI, është zhvilluar Ueb-faqja e re e ASK-së sipas standardeve më të avancuara evropiane. Ndërkohë, që të gjithë serverët për prodhim janë virtualizuar, duke përfshirë ASKData, eDAMIS dhe platformën e UN për shpërndarja e të dhënave DevInfo. Po ashtu, është krijuar dokumentimi për sistemin e TI-së. Kurse, për ta mbajtur kodin burimor në një sistemi të mirë të kontrollit, është instaluar TFS (Team Foundation Server). Lidhur me ruajtjen-beckup, pasi është instaluar dhe konfiguruar Data Protection Manager (DPM), shumica e dosjeve dhe bazave të të dhënave janë ruajtur-backup. Ndërkaq, Strategjia dhe Politika e Shpërndarjes (Diseminimit), tashmë është krijuar dhe është online në ueb faqen e ASK-së. Kurse, Sistemi i Informatave Gjeografike (GIS), ka azhurnuar qarqet regjistruese për komunat veriore, si dhe në vazhdimësi ka krijuar harta tematike për tema të ndryshme statistikore, e në veçanti për rezultatet e regjistrimeve paraprake.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë janë hartuar 5 Rregullore dhe 1 udhëzim administrativë me ndalimin e përdorimit në ferma të substancave të caktuara të cilat kanë veprim hormonal ose tireostatik dhe ß-agonistët; në fushën e mbrojtjes së shëndetit të kafshëve- gjatë vitit 2016, kemi pasur shpërthim të sëmundjes Gungore të Gjedhit (Lumpy Skin Disease), për këtë smundje KE ka dhuruar 25.000 doza të vaksinës, ndërsa nga buxheti janë siguruar 235.000 doza të vaksinave, vaksinimi masiv ka filluar me 15 shtator ndërsa ka përfunduar 6 tetor, ku janë vaksinuar 241.000 gjedhe Në Programet e vaksinimit kundër sëmundjeve të ndryshme janë vaksinuar gjithsejtë 370.331 krerë kafshë (kundër LSD janë vaksinuar 241.000 kafshe , kundër brucelozës janë vaksinuar 95.100 kafshë, kundër mortajës klasike janë vaksinuar 27497 derra dhe kundër

antraksit janë vaksinuar 6734 kafshë).Edhe këtë vit, AUV, ka ndërmarrë aksionin për eliminimin e rriqrave si burim i sëmundjes se etheve hemorragjike, në 70 fshatrat e komunave Malishevë, Suharekë Rahovec, Klinë ku janë spërkatur 55276 krerë gjedhe. Janë dhënë 223 leje importi, ushqimit për kafshë, materialit gjenetike dhe produkteve mjekësore veterinarë (PMV)dhe marketing autorizimi- 50 leje importi. Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve të gjalla (i gjedheve) në tërë territorin e Kosovës, duke përfshi, Identifikime të e reja (162560), lëvizjet (28473).

Aktivitetet në *fushën e inspektimit* – janë kryer aktivitetet si në vijim : 7008 inspektime të operatorëve të biznesit me qëllim të arritjes përputhshmërisë me rregullat e definuar me legjislacion nga ana e inspektoratit të brendshëm; 47889 lëndë të inspektuara nga ana e inspektoratit kufitar (ai veterinar dhe fitosanitar); 162 fletëparaqitje për shkeljet e kryera nga operatorët e bizneseve të dorëzuara në gjykata përkatëse; Janë lëshuar 375 certifikata veterinarë për eksport dhe 2266 fito certifikata për eksport , të produkteve të ndryshme për eksport në vendet tjera; Janë marrë 5353 mostra të produkteve të ndryshme për analiza laboratorike si dhe 978 strisho nga sipërfaqet punuese, stabilimentet dhe pajisjet tek prodhuesit e ushqimit.

Inspektoriati i Agjencisë ka sjellë vendime për asgjësime të produkteve ushqimore dhe joushqimore, të dëmshme për konsum human si dhe të rrezikshëm për shëndet publik , shëndet te kafshëve dhe bimëve, janë asgjësuar si në vijim: 213.489 kg artikuj ushqimor, produkte ushqimore me origjinë shtazore, 355.547 kg produkte ushqimore me origjinë bimore. 94.064 litra lëngje. Si pasojë e sëmundjeve të ndryshme janë asgjësuar; 279 gjedhe, 48 dele, 8000 pula dhe 232shoqëri bletësh. Gjatë këtij viti në laboratorët e LUV, respektivisht në laboratorin e shëndetit të kafshëve janë sjellur 16221 mostra . ne laboratorin e sigurisë ushqimore janë sjellur 970 mostra, ndërsa në laboratorin e qumështit janë sjellur 17176 mostra .Të gjitha mostrat janë analizuar sipas procedurave standarde operative .

- **MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Ministria e Administratës Publike, gjatë vitit 2016 ka qenë e përkushtuar në realizimin e objektivave të përcaktuara në Strategjinë për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020. Në bashkëpunim më Komisionin Evropian janë hartuar tri Koncept Dokumente bazike për harmonizimin e politikave në fushën e


administratës publike. Është punuar në avancimin Sistemit të Informatave për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, si dhe ndërlidhja e këtij sistemi më disa sisteme tjera. Rendësi e veçantë i është kushtuar procesit për Hapjen e të Dhënave (Open Data).

Reforma në Administratën Publike – Ministria e Administratës Publike ka hartuar raportin gjashtëmuor “Progresi i Zbatimit të Strategjisë për Modernizim të Administratës Publike 2015 – 2020”, raport ky i cili është miratuar në takimin e Këshillit të Ministrave për Reformë të Administratës Publike në muajin nëntor 2016.

Është kryer analiza agjencive të pavarura të Kuvendit dhe organeve qendrore të Qeverisë. Në këtë analizë është identifikuar numri i agjencive në kuadër të Kuvendit si dhe numri i agjencive në kuadër të Qeverisë. Po ashtu është identifikua themelimi i tyre struktura organizative, marrëdhënia e punës së nëpunësve brenda agjencive si dhe pagat e tyre.

Klasifikimi i vendeve të punës si prioritet i Qeverisë ka rezultuar me aprovimin e vendimit nr.04/89 datë 25.05.2016 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil. Gjatë kësaj përdudhe 86 institucione e kanë kryer sistematizimin për 10,967 nëpunës civil, të cilat janë vendosur në SIMBNJ. Katalogu përmban 1700 tituj të vendeve të punës.

Institucionet te cilat i kanë dorëzuar propozimet e tyre për klasifikimin e vendeve të punës dhe propozimet e të cilave janë miratuar.



Funksionalizimi i Sistemit të Informatave për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në institucionet e Republikës së Kosovë, ka qenë një nga objektivat e Ministrisë, ku janë shtuar edhe tre module të reja; Moduli i Planifikimit Personelit në shërbimin civil, Moduli i rekrutimit për pozitat e larta drejtuese dhe Aplikimi “Online” për pozitat në shërbimin civil.

Në funksion të zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil dhe përmirësimit të menaxhimit të burimeve njerëzore në shërbimin civil, gjatë këtij viti të raportimit janë aprovuar: Strategjia e Trajnimit për nëpunësit Civilë 2016-2020, Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë së Trajnimit të Nëpunësve Civil 2016-2018, ndërsa është finalizuar drafti i Projekt Rregullore për Trajnimin e Nëpunësve Civil.

Legislacioni në fushën e Administratës Publike - Një rëndësi e veçantë i është kushtuar legjislacionit në fushën e administratës publike, ku është miratuar: Ligji Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative, ligji i cili ka qenë edhe parakusht për miratimin e projektit IPA 2014, me të cilin do të mbështetet zbatueshmëria e këtij ligji. Është miratuar ne Qeveri Projektligji për pagat i cili paraqet një koncepti të ri bazik për zbatimin e reformës në lëmin e pagave dhe kompensimeve tjera për të punësuarit që përfitojnë pagë nga buxheti i Kosovës.

Gjithashtu është miratuar, rregullorja QRK NR. 02/2016 për koordinim ndërmjet Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit dhe strukturave organizative/zyrtarëve të TIK në IRK. Ndërsa janë hartuar dhe finalizuar 6 projektregullore.

Trajnimet dhe Aftësimet e Nëpunësve Civilë - Gjatë vitit 2016 janë trajnuar 3761 nëpunës civil nëpërmjet 135 moduleve të trajnimit në gjithsej 619 ditë trajnim. Nëpunësit e trajnuar ishin nga niveli qendror dhe lokal i administratës publike. Në trajnime kanë marrë pjesë nëpunës nga nivelet drejtues, profesional dhe administrative. Struktura gjinore e pjesëmarrësve në trajnim përbëhet nga 40.63% gjinia femërore dhe 59.37% të gjinisë mashkullore, 14.09% ishin nga minoritetet që flasin gjuhën serbe.

Trajnimet dhe Aftësimet e Nëpunësve Civilë - Gjatë vitit 2016 janë trajnuar 3597 nëpunës civil nëpërmjet 119 moduleve të trajnimit në gjithsej 574 ditë trajnim. Nëpunësit e trajnuar ishin nga niveli qendror dhe lokal i administratës publike. Në trajnime kanë marrë pjesë nëpunës nga nivelet drejtues, profesional dhe administrative. Struktura gjinore e pjesëmarrësve në trajnim përbëhet nga 40.70% gjinia femërore dhe 59.30% të gjinisë mashkullore, 14.327% ishin nga minoritetet që flasin gjuhën serbe.

Fusha e Shoqërisë së Informacionit - Është finalizuar Strategjia për Qeverisje Elektronike dhe Planin e Veprimtimit 2016-2020, pritet miratimi në Qeveri. Sa i përket shërbimeve për qytetarët është finalizuar projekti e-Kutia, i cili pritet që në vitin 2017 të fillojë më matjen e kënaqshmërisë së qytetarëve për shërbimet që ofrohen nga institucionet, ku janë identifikuar shërbimet që ofrohen nga institucionet. Është themeluar Grupi Punues për Open Data, që është duke punuar në këtë proces. Po ashtu, është hostuar ëb aplikacioni dhe është vendosur në portal qeveritar, ku mund të postohen të dhënat nga institucionet. Sistemi i menaxhimit të pasurisë e-Pasuria ky projekt gjendet në fazën e implementimit ku jemi duke u koordinuar më të gjitha institucionet me qëllim të ndërveprimtimit të sistemeve dhe regjistrimit sa më të saktë të pasurisë shtetërore.

Është realizuar “Studimi i Fizibilitetit për E-Qeverisje dhe investime në IT në institucionet e Republikës së Kosovës” dhe “Studimi i fizibilitetit për ndërveprimin e sistemeve elektronike të Qeverisë së Kosovës, që lidhen me mjedisin e Biznesit”. Kemi menaxhuar dhe administruar rrjetin shtetërorë të Republikës së Kosovës, Qendrën e të Dhënave Shtetërore, postën elektronike zyrtare (e-maili zyrtar), me softuer të licencuar të Microsoft-it, etj..

Është realizuar projekti e-Kutia, përmes së cilit qytetarët ofrojnë opinionet e tyre lidhur me shërbimet që ofrohen nga administrata publike. Janë identifikuar shërbimet që ofrohen nga institucionet. Është zhvilluar portali shtetërorë për Hapjen e të Dhënave dhe ka filluar popullimi i tij me të dhëna. Gjithashtu, është zhvilluar Sistemi Elektronik për Organizata jo-Qeveritare (SEOJQ). Është bërë unifikimi i Sistemit të Arkivimit Elektronik të Dokumenteve Shtetëror me Sistemin e Menaxhimit të Dokumenteve në një sistem të përbashkët (Sistemi i Menaxhimit dhe Arkivim Elektronik të Dokumenteve-SMAED). Është avancuar Sistemi i Menaxhimit të Aseteve- e-Pasuria dhe Sistemi i ID kartelave, i cili është sinkronizuar me aplikacionin e


Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) dhe Sistemin e Gjendjes Civile. Është zgjeruar dhe avancuar Sistemi i Menaxhimit të Vijueshmërisë Punë dhe do të ndërlihet me SIMBNJ dhe me Sistemin e Gjendjes Civile.

Në procese të regjistrimit dhe raportimit të organizatave jo-qeveritare, ka përfunduar Sistemit Elektronik për OJQ-të (SEMOJQ), i cili pritet të lansohet nga janari i vitit 2017.

Departamenti për OJQ - Është hartuar dhe miratuar Koncept Dokumente për Rregullimin dhe Funksionimin e OJQ-ve.


Në procese të regjistrimit dhe raportimit të organizatave jo-qeveritare, ka përfunduar Sistemit Elektronik për OJQ-të (SEMOJQ), i cili pritet të lansohet nga janari i vitit 2017. Po ashtu jemi në përfundim të skanimit të dosjeve të OJQ-ve të regjistruara dhe digjitalizimin e arkivës për OJQ-të. Gjatë vitit 2016 në Departamentin për OJQ janë regjistruar 564 OJQ, prej tyre 559 OJQ Vendore dhe 5 ndërkombëtare. Vlen të theksohet se në Departamentin për OJQ, kanë parashtruar kërkesa për të regjistruar OJQ pjesëtar të SHC nga tërë territori i Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2016 janë regjistruar 16 OJQ ku themelues kanë qenë nga komunitet e ndryshme-multietnike, ndërsa minoriteti serb janë regjistruar 64 OJQ.

Pasqyra e shpenzimeve Buxhetit për Ministrinë e Administratës Publike - Ministria e Administratës Publike ka realizuar buxhetin 73% deri më tani, deri në këtë datë janë alokuar buxhet në vlerë prej 14,541,162.38€. Buxheti i aprovuar në këtë Ministri për vitin 2016 është 15,880,758€. Të gjitha licencat do të paguhen deri në fund të vitit, ku si rezultat i saj do të rritet realizueshmëria e buxhetit mbi 95%.



Pasqyra e shpenzimeve Buxhetit për Ministrinë e Administratës Publike - Ministria e Administratës Publike ka realizuar buxhetin 99.2% , deri në fund te vitit 2016 janë alokuar buxhet në vlerë prej 17,279,233.16€ ndërsa realizimi i buxhetit për vitin 2016 është në vlerë prej 17,139,924.38 €. Buxheti i aprovuar në këtë Ministri për vitin 2016 është 16,179,637€.Ndryshimi i buxhetit të alokuar ne krahasim me buxhetin e aprovuar ka ndodhur

me vendim te qeverisë për pagesat e licencave të Microsoft it dhe pagesën e shpenzimeve komunale për Ndërtesat Qeveritare.



Menaxhimi i Objekteve Qeveritare - Konform kompetencave dhe përgjegjësiëve MAP-it si dhe konform marrëveshjeve të arritura me MASHT, MD dhe KGJK për menaxhimin e projekteve kapitale për ndërtimin e objekteve shkollore, qendrave të paraburgimit, prokurorive dhe gjykatave, për renovime të ndryshme, shpronësime ka menaxhuar që nga planifikimi buxhetor, përgatitje të dokumentacionit teknik, procedim për procedura të prokurimit, mbikëqyrje të punimeve e inspektimet finale teknike. Kanë përfunduar punimet në shkollat fillore në: Gjilan dhe Kishnarekë, Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, Qendra për të Mitur në Lipjan, ndërtimi i Universitetit të Mitrovicës-Faza e II, III dhe IV. Renovimi i hapësirave për Akomodimin e Avokatit të Popullit i cili ka qene edhe një ndër masat për MSA.

Ka vazhduar ekzekutimi i punimeve me progres ne projektet e shkollave fillore të filluara në vitin 2015 në: Llapushnik, Kishnicë, Salla e edukatës fizike në Pograxhë.

Janë nënshkruar kontratat gjatë 2016 dhe inicuar punimet në: Ndërtimi i objektit të IKAP, shkollat fillore ne Magure-Lipjan, Pjetershtice-Shtimje, Bajqine-Podujevë, Pozharan-Viti, Salla e Edukatës Fizike në Komoran-Drenas, Ratkoc-Rahovec. Gjithashtu ka pasur progres dhe ende janë në vazhdim projektet: ndërtimi i Prokurorisë Themelore në Gjakove; ndërtimi i Gjykatës Themelore ne Gjakove, ndërtimi i gjykatës Themelore ne Novobërdë.

Ndërtimi i Universitetit të Mitrovicës-Faza e II, III dhe IV. Renovimi i hapësirave për Akomodimin e Avokatit të Popullit i cili ka qene edhe një ndër masat për MSA dhe njësiëve tjera qeveritare - AKK - OSHP.

Ka vazhduar ekzekutimi i punimeve me progres ne projektet e shkollave fillore të filluara në vitin MM- 2015-2018 në: Llapushnik, Kishnicë, Salla e edukatës fizike në Pograxhë.

Janë nënshkruar kontratat gjatë 2016 dhe inicuar punimet në nga 'projektet e shkollave MM-2016-2019': Ndërtimi i objektit të IKAP, shkollat fillore ne Magure-Lipjan, Pjetershtice-Shtimje, Bajqine-Podujevë, Pozharan-Viti, Salla e Edukatës Fizike në Komoran-Drenas, Ratkoc-Rahovec. Gjithashtu ka pasur progres dhe

në vazhdim ne ndërtimin e projektve: ndërtimi i Prokurorisë Themelore në Gjakove; ndërtimi i Gjykatës Themelore ne Gjakove, ndërtimi i Gjykatës Themelore ne Novobërdë. Vazhdimi kontinual i mirëmbajtjes teknike te ndërtesave qe menaxhohen nga MAP.

- **MINISTRIA E ADMINISTRIMIT DHE PUSHTETIT LOKAL**

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – në përputhje me mandatin dhe misionin e saj dhe konform objektivave të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026, si dhe planit vjetor të punës për vitin 2016, ka vazhduar me mbështetjen e pushtetit lokal me qëllim që pushteti lokal të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim, MAPL ka bashkëpunuar dhe koordinuar proceset e rëndësishme për avancimin e vetëqeverisjes lokale me: ministritë e linjës, komunat, si dhe partnerët të cilët kanë dhënë një kontribut jashtëzakonisht të lartë në promovimin dhe avancimin e mëtejshëm të vetëqeverisjes lokale në Kosovë.

Të arriturat e përgjithshme të punës së MAPL-së gjatë vitit 2016 janë, si vijon:

Vlerësimi pozitiv për MAPL-në nga Raporti i KE-së për Kosovën 2016

Progresi është arritur në qeverisjen lokale, veçanërisht në marrëdhëniet mes pushtetit qendror dhe lokal, përfshirë këtu komunat me shumicë serbe në veri. Ka pasur përmirësime të mëtejshme në përputhjet e komunave me Ligjin për vetëqeverisjen lokale. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka udhëhequr hartimin dhe zbatimin e planeve komunale në lidhje me obligimet e lidhura me BE-në për 38 komuna.

Gjithashtu, vlerësimin pozitiv si njëri nga institucionet qendrore që më së miri e ka të organizuar zyrën e arkivit e ka marrë nga Agjencia Shtetërore të Arkivave të Kosovës, ku thuhet se "MAPL është një ndër institucionet që më së miri e ka të rregulluar dhe të klasifikuar materialin regjistraturik".

Zhvillimi i politikave, strategjive dhe legjislacionit për vetëqeverisje lokale efektive

Me qëllim të avancimit të politikave strategjike për zhvillimin e vetëqeverisjes lokale përmes një qasje të koordinuar për politikën e zhvillimit ekonomik lokal, qeverisjen e mirë, transparencën e punës së organeve komunale për të siguruar shërbime efikase dhe cilësore për qytetarët e Komunave, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar "Strategjinë për Vetëqeverisjen Lokale 2016-2026".

Në kuadër të zhvillimit të politikave dhe avancimit të vetëqeverisjes lokale është hartuar projektligji për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës - Prishtinën. Po ashtu, është bërë plotësim - ndryshimi i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencave të komiteteve konsultative në komuna i cili ka hyrë në fuqi në tetor të vitit 2016.

Janë hartuar dokumente, raporte, analiza, projekte, si dhe janë themeluar grupe punuese, si vijon:

- Raporti gjashtëmujor për zbatimin e Strategjisë për VQL;
- Raporti nëntë mujor i funksionimit të komunave;
- Raporti nëntë mujor i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane;
- Analiza e të hyrave vetanake të komunave për 2011-2015;
- Analiza e investimeve kapitale për komuna për periudhën 2011-2015;
- analiza për përmbushjen e obligimeve të komunave nga agjenda evropiane.
- Grupi Punues për hartimin e Komentarit për Ligjin për Vetëqeverisje Lokale;
- Hartimin e strategjive për zhvillim socio-ekonomik lokal, në fazën e parë janë përzgjedhur komunat: Gjilan, Obiliq, Shtërpçë dhe Graçanicë;
- Doracaku për Koordinim të Politikave dhe Pyetëtori i integruar i raportimit;
- Doracaku për përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal;
- Doracaku për Bashkëpunim ndër komunal dhe komunal ndërkombëtar;
- Projekti ideor për krijimin e platformës softuerike për raportimin online të të dhënave;

Janë hartuar 17 dokumente dhe shkresa informuese për komuna, si dhe janë përgatitur 6 shkresa ligjore lidhur me obligimet e komunave që dalin nga legjislacioni në fuqi. Krahas kësaj, gjithashtu janë dhënë 3 opinione ligjore (a) për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Është plotësuar granti i përgjithshëm i financimit për komunat që kanë popullsi nën 20 mijë banorë, me një grant shtesë prej 5 milion euro.

Monitorimi i komunave dhe zbatimi i ligjshmërisë

Në fushën e monitorimit dhe zbatimit të legjislacionit janë shënuar këto të arritura:

- Janë dërguar për vlerësim të ligjshmërisë në ministritë e linjës dhe komisione sektoriale gjithsej 785 akte të miratuara nga organet e komunave.
- Janë monitoruar 403 mbledhje të mbajtura të kuvendeve të komunave të Republikës së Kosovës, 349 kanë qenë mbledhje të rregullta, 41 të jashtëzakonshme, 1 mbledhje urgjente dhe 12 solemne. Për të gjitha mbledhjet e monitoruara, MAPL ka hartuar raportet e monitorimit.
- Nga 1398 akte të miratuara nga kuvendet e komunave, (1286 vendime dhe 112 rregullore), MAPL ka vlerësuar 577 akte të ligjshme, 36 të kundërligjshme, ndërsa 785 akte janë përcjellë për shqyrtim të ligjshmërisë në Ministritë tjera.
- Është realizuar monitorimi i drejtpërdrejtë i komunave, sipas Planit të Monitorimit, me qëllim të monitorimit të përmbushjes së obligimeve ligjore, verifikimin e zbatimit të kërkesave të MAPL-së për rishqyrtimin e akteve të kundërligjshme dhe përcaktimin e hapave për përmirësimin e zbatimit të ligjit.

Janë shqyrtuar 8 ankesa, 11 kërkesa dhe 2 prapësime, si dhe janë dhënë deklaratat e harmonizimit për: 12 Projektligje, 7 Projekt-Rregullore, 16 Projekt-Udhëzime Administrative dhe 5 Koncept-Dokumente. Në ueb faqen e MAPL-së janë publikuar raportet lidhur me funksionimin e komunave.

Menaxhimi i Performancës Komunale

Qeveria e Republikës së Kosovës përmes MAPL-së, si dikaster përgjegjës për vetëqeverisjen lokale me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve komunale, ka vendosur sistemin e menaxhimit të performancës së komunave. Kosova mbetet i vetmi vend në rajon që ka instaluar sistemin e menaxhimit të performancës komunale (sistem të cilin e kanë të vendosur shtetet e BE-së dhe Amerika).

Në bashkëpunim me USAID dhe UNDP, MAPL ka realizuar Mozaikun (anketën) me qytetarë në të gjitha komunitat e Republikës së Kosovës për vitin 2015, për cilësinë e ofrimit të shërbimeve nga organet komunale.

Është hartuar dokumenti i parë punues për fushat, rezultatet dhe treguesit e performancës. Në këtë dokument janë shqyrtuar 14 fusha të shërbimeve që i ofron komuna, nga të cilat janë synuar të arrihen 25 rezultate të rëndësishme për qytetarët, arritja e të cilave është paraparë të matet me 66 tregues nëpërmjet 183 të dhënave të ndryshme.

Është hartuar dokumenti i përgjithshëm i SMP-së, në kuadër të së cilit janë të përfshira disa dokumente themelore, si: modeli i SMP, korniza e SMPK, harta e treguesve, korniza e treguesve, dokumenti krahasues ndërmjet sistemit aktual dhe atij të rishikuar të SMP dhe kartela e treguesve me formularët 1 dhe 2 për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave nga komunitat. Po ashtu, janë hartuar udhëzimet specifike për mënyrën e mbledhjes, verifikimit dhe raportimit të dokumentuar të 183 të dhënave për 67 tregues të SMP.

Në vitin 2016 është bërë rishikimi i sistemit ekzistues të menaxhimit të performancës komunale, proces i cili do të finalizohet në fund të këtij viti.

Unifikimi i sistemit të vetëqeverisjes lokale

Qeveria ka punuar ngushtë me institucionet relevante duke arritur kështu unifikimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale. Katër komunitat: Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, kanë avancuar sistemin e komunikimit si dhe kanë bërë progres në funksionalizimin e organeve komunale.

Në katër komunitat: Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, është vendosur sistemi i free balancit (sistem unik i menaxhimit financiar për të gjitha institucionet publike në Kosovë).

Në proces është sistematizimi i vendeve të punës (në kuadër të procesit të reformës së administratës publike, si proces në të cilin po kalojnë të gjitha institucionet publike). Gjatë vitit 2016, kuvendet e këtyre komunave kanë vazhduar mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve ashtu siç përcaktohet me LVL. Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun. Ftesat janë dërguar me kohë në MAPL për t'i monitoruar këto mbledhje. Deri në këtë periudhë ato kanë mbajtur 35 mbledhje të kuvendeve të komunave.

Gjithashtu, Komunitat Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, kanë miratuar buxhetet për vitin 2017, si një proces të cilin e kanë kaluar edhe të gjitha komunitat tjera të Republikës së Kosovës.

Zhvillimi i kapaciteteve institucionale të komunave dhe transparenca komunale

Me qëllim që të zhvillohet një sistem i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të komunave në proces të draftimit janë politikat për zhvillimin e kapaciteteve të komunave. Gjatë gjithë vitit në fokus ishte hartimi dhe realizimi i programeve për edukimin e vazhdueshëm profesional për zyrtarët komunal. Janë dizajnuar mbi 15 module trajnimi, ndërsa në bashkëpunim me partnerët janë realizuar 40 trajnime (mbi 500 zyrtarë komunal kanë marrë pjesë në këto procese trajnimi).

Është realizuar programi 5 ditor i trajnimeve për fushën e integritit evropian për zyrtarët komunal të integritimeve evropiane dhe zyrtarët e nivelit qendror për integritime evropiane.

MAPL në bashkëpunim me OSBE-në ka implementuar programin për përfshirjen e studentëve të rinjë në punë praktike në institucionin publike. Nga ky projekt kanë përfituar 25 studentë të fushave të ndryshme, prej të cilëve 6 janë angazhuar në MAPL.

Janë respektuar në përpikëri të plotë kërkesat nga mediat dhe organizatat jo- qeveritare në raport me respektimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjin për Gjuhët zyrtare.

Në vitin 2016, në faqen zyrtare të Ministrisë janë postuar gjithsej 171 informata (ngjarje, dokumente) të ndryshme. Në media janë publikuar 31 informata dhe 27 përgjigje për tema të caktuara. Janë pranuar 5 kërkesa për qasje në dokumente publike të paraqitura nga 2 gazetarë dhe 3 përfaqësues nga shoqëria civile. Informatat për palët janë ofruar me kohë dhe sipas afateve ligjore.

Në vazhdimësi është bërë monitorimi i ueb-faqeve të komunave, si dhe monitorimi i transparencës në fushën e prokurimit publik të komunave. Komunitat janë informuar për obligimet ligjore për hartimin e planeve për transparenca.

MAPL ka nënshkruar edhe kontratën me një kompani për zbatimin e projektit "Zhvillimi i Solucioneve të integruara të IT-së për komunitat".

Është finalizuar projekti për komunikimin elektronik, i unifikuar për 38 komunitat e Republikës së Kosovës, projekt i cili përfshinë transparençën dhe komunikimin e drejtpërdrejtë të komunave me qytetarët përmes transmetimit të mbledhjeve të kuvendeve të komunave.

Investimet publike

Në vitin 2016, nga granti i përgjithshëm për komunitat në vlerë 420 mil €, vetëm për investime kapitale janë dedikuar 120 milion €. Ndërkaq, bashkëfinancimi me IPA, vetëm për zhvillimin lokal janë paraparë 7 mil€, për fushën e arsimit në nivel lokal (qerdhe, objekte parashkollore) MAPL & MASHT, si dhe 7 mil € për përmirësimin e infrastrukturës lokale që ndikon direkt në përmirësimin e kushteve për zhvillimin e biznesit dhe turizmit.

Janë pranuar 85 kërkesa për financim të projekteve nga komunat, ndërkaq janë aprovuar 44 projekte për 25 komuna nga fondet e MAPL-së. Në proces të zbatimit janë 13 projekte (rrugë, objekte publike, kanalizime, ambient, lumenj, etj.) në vlerë prej 525.000,00 €.

Fillimi i 3 programeve të BNK-së me IPA II Kosovë-Shqipëri; Kosovë-Maqedoni dhe Kosovë-Mali i ZI, si dhe finalizimi i 3 programeve të BNK-së me IPA I. Pra, sa i përket programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, (me IPA 2) për secilin program është paraparë vlera 4.2 mil €.

Avancimi i vetëqeverisjes lokale në përputhje me kërkesat e Agjendës Evropiane

Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar një strukturë institucionale dhe ka vendosur sistemin e monitorimit të implementimit të agjendës evropiane nga komunat e Republikës së Kosovës (planet e integruara komunale për obligimet nga agjenda evropiane, për secilën komunë), ku përfshihen të gjitha detyrimet nga agjenda evropiane, si: dialogu i procesit të stabilizim asociimit, programi kombëtar për zbatimin e MSA-së, si dhe adresimi i sfidave nga raporti i vendit.

Janë mbajtur konferenca informuese për MSA-në në nivelin lokal në 3 regjione (Prishtinë, Pejë dhe Ferizaj).

Sistemi i raportimit tremujor i monitorimit ka dhënë rezultatet e veta në kuadër të përmbushjes së detyrimeve nga agjenda evropiane.

Lidhur me koordinimin ndërinstitutional për procesin e integritit evropian, janë mbajtur takime të ndryshme të përbashkëta me MIE-në, Kolegjiun për IE (AKK), institucionet e tjera qeveritare dhe joqeveritare, si dhe institucionet tjera ndërkombëtare;

Në ueb aplikacionin e MAPL-së është publikuar linku me informatat e nevojshme për procesin e integritimeve evropiane.

- **MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është angazhuar në zbatimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë për fushën e arsimit, si dhe përmbushjen dhe realizmin e objektivave, programeve dhe projekteve në arsim, si pjesë e dokumenteve strategjike të MASHT.

Gjatë këtij viti ka përgatitur Planin Strategjik për Arsim në Kosovës për periudhën 2017-2021, i cili është aprovuar me datë 7 dhjetor 2016, dhe përbënë dokumentin më të rëndësishëm strategjik, qëllimi i të cilit është të përcaktojë kahet e zhvillimit të sistemit të arsimit në periudhën 2017-2021, në mënyrë që arsimit të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. Si i tillë, Plani Strategjik për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë 2017-2021 përfshijnë masat që kanë të bëjnë me rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në edukimin parashkollor, rritjen e kualifikimit dhe përgatitjen e mësimitdhënësve, përmirësimin e relevancës së ofrimit të shkollimit për kërkesat e tregut të punës, si dhe forcimin e mekanizmave të llogaridhënies përmes vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve, inspektimit dhe testeve të jashtme.

Në **ARSIMIN PARASHKOLLOR**, është në proces draftimi i kurrikulës bërthamë për edukimin parashkollor (mosha 0-5 vjeç), si dhe janë trajnuar 933 edukatore të klasave parafillore për zbatimin e dokumentit të Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijëri dhe Hershme 0-6 vjeç. Në bashkëpunim me Save the Children është zhvilluar projekti “Kujdesi dhe zhvillimi gjatë fëmijërisë së hershme dhe promovimi i shëndetit dhe ushqyeshmërisë të grupet e ndjeshme në Kosovë”. Sa i përket përmirësimit të infrastrukturës në këtë nivel ka vazhduar zbatimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me CARITAS-in e Zvicrës për mobilimin e 50 klasave parafillore me inventarë dhe me material didaktik në 4 komuna. Gjithashtu, MASHT, ka licencuar 62 institucione parashkollore private, me ç’rast është rritur përfshirja e fëmijëve në këtë nivel me rreth 3300 fëmijë.

Në **ARSIMIN FILLOR DHE TË MESËM** - kemi vazhduar zbatimin e kurrikulës së re. Këtë vit është rishikuar dhe botuar Korniza e Kurrikulës së Arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës, si dhe janë rishikuar tri Kurrikula Bërthamë për tri nivelet e arsimit parauniversitar. Janë hartuar 61 planprograme lëndore për klasat 0, 1, 6, 10, përfshirë edhe planprogramet e komunitetit boshnjak dhe turk. Është mbajtur seminar informativ për zbatimin e planprogrameve të reja në nivel rajoni për shkollat që janë në zbatim të kurrikulës. Në bashkëpunim me projektin e Binjakëzimit është hartuar udhërrëfytyesi për zbatimin e Kurrikulës së Kosovës për vitet 2017-2021. Në kuadër të zbatimit të Kurrikulës së Re është hartuar edhe dokumentacioni pedagogjik sipas KKK, si dhe janë funksionalizuar mekanizmat për sigurimin e cilësisë në shkolla. Rishikimi i përmbajtjeve të teksteve shkollore (Janë rishikuar brenda vitit 86 tekste shkollore) dhe përgatitja e materialeve tjera për mësimitdhënie, zbatimi i praktikave të reja të vlerësimit të njohurive të nxënësve dhe aktivizimi i aktiveve profesionale në shkollat pilotuese janë disa aspekte me rëndësi të këtij procesi.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit është shënuar një bashkëpunim i mirë me Republikën e Shqipërisë në institucionalizimin e mësimit plotësues në diasporë duke përkrahur fëmijët e diasporës dhe të mërgatës, përmes furnizimit me libra dhe mbështetje të aktiviteteve të ndryshme edukativo-arsimore, me qëllim të

ruajtjes së gjuhës dhe të identitetit kombëtar. Bashkëpunimi me Shqipërinë po vazhdon edhe në zhvillimin profesional për unifikimin e kurrikulave. Gjithashtu ka vazhduar bashkëpunimi me Shqipërinë në fushën e përafrimit të kurrikulës për arsimin parauniversitar me theks të veçantë në rishikimin e Kornizës së Kurrikulës, planit mësimor, planprogrameve për lëndë dhe klasë, praktikat e vlerësimit të nxënësve dhe reformimit e avancimit të cilësisë së teksteve shkollore.

Gjatë vitit 2016, ka filluar zbatimi i Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020, e cila parasheh masa konkrete për përmirësimin e shërbimeve arsimore dhe rezultateve të arsimit, për ndërtimin e mekanizmave efektiv për sigurimin e cilësisë, ngritjen e sistemit efikas për vlerësim të shkollës, fuqizimin e organeve shkollore (aktivet dhe këshillat), funksionalizimin e sistemit të licencimit të mësimitdhënësve, planifikimin zhvillimor dhe monitorimin e zbatimit të tyre, për punësimin e pedagogëve dhe psikologëve në shkolla, për rezultatet e testeve kombëtare dhe ndërkombëtare, për digjitalizimin e shkollave dhe promovimin e sukseseve dhe shpërblimin e arritjeve. Gjatë katër viteve të ardhshme të zbatimit të kësaj strategjie, në të gjitha shkollat publike do të angazhohen koordinatorët e përhershëm të cilësisë të cilët do të jenë përgjegjës për planifikimin e zhvillimit të cilësisë në nivel shkolle dhe komune.

Gjatë kësaj periudhe, MASHT në bashkëpunim me partnerët zhvillimor ndërkombëtar ka vazhduar zbatimin e dy projekteve të rëndësishme për integrimin e teknologjisë informative në sistemin arsimor, përkatësisht krijimin e platformave të hapura, zhvillimin e materialeve me përmbajtje elektronike për shkollat tona dhe zbatimin e platformave për digjitalizimin e përmbajtjeve mësimore në formë audio-vizuale të programit shkollor. Është realizuar faza e dytë e pilotimit të Digjitalizimit të Maturës, ku janë përfshirë 15 shkolla me rreth 300 nxënës. Ka vazhduar realizimi e projektit të BE-së: "TIK dhe Mësimi Elektronik në Arsim". Gjatë vitit 2016 janë realizuar dy faza të projektit: në fazën e parë janë përfshirë 27 shkolla, ndërsa në fazën e dytë 33 shkolla, gjithashtu, në kuadër të këtij projekti janë trajnuar 1773 mësimitdhënës në 6 komponenta që ndërlidhen me TIK dhe mësimin elektronik.

Në kuadër të projektit për nxënësit e riatdhesuar, ka vazhduar organizimi i mësimin plotësues për nxënësit e riatdhesuar në 16 komuna, ku janë përfshirë 345 nxënës, në 65 shkolla.

MASHT ka realizuar testin për kl.e 5-të (me mostër prej 4096 nxënësve), Testin e arritshmërisë me nxënës të kl.9-të (34012 nxënës) dhe Testin e Maturës (31482 nxënës) në gjuhët shqipe, turke dhe boshnjake. Gjitha raportet dëshmojnë për një avancim të dukshëm në pjesën përgatitore dhe zbatuese të administrimit të Testit të Maturës 2016, falë mobilizimit dhe seriozitet të lartë në insistimin për të siguruar mbarëvajtje të administrimit të Testit të Maturës.

Në kuadër të vlerësimit ndërkombëtar është përgatitur raporti kombëtar për rezultatet e PISA 2015, si dhe kanë filluar përgatitjet për PISA 2018.

Në fushën e të drejtave të njeriut/ fëmijëve, përveç aktiviteteve të rregullta për zbatimin e dokumenteve nacionale, veçojmë: hartimin e *Planit të veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2016-2018*, *Kornizë monitoruese të planit kundër braktisjes*, *Planin dinamik të trajnimeve kundër braktisjes*, sesionet informative kundër dhunës në shkolla në 22 komuna, hartimin e udhëzuesve për mbrojtjen e fëmijëve në internet (për klasat 3-5 dhe 6-9), si dhe trajnimin e mësimitdhënësve të 8 shkollave (në 7 komunat e mëdha) për përdorimin e *Manualit didaktik për parandalimin e dhunës në shkolla*. Ndërsa, në fushën e barazisë gjinore janë realizuar aktivitete të shumta për zbatimin e dokumenteve strategjike në nivel qendror.

Në bashkëpunim me partnerët dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare këtë vit është realizuar një numër të konsiderueshëm të programeve trajnuese me mësimdhënës, si: ka menaxhuar dhe financuar programin për trajnimin e mësimdhënësve për zbatimin e Kurikut të Ri të Kosovës; ka trajnuar 200 mësimdhënës të arsimit dhe aftësimin profesional në programet e akredituara metodikë-didaktikë dhe didaktikë profesionale; ka certifikuar 40 trajnerë sipas 8 fushave kurikulare; ka hartuar dhe publikuar 9 udhëzues sipas fushave të kurrikulit dhe ka organizuar trajnimet me 2115 mësimdhënës të 71 shkollat pilote; në bashkëpunim me GIZ ka realizuar trajnimin e 2100 mësimdhënësve për shkencat e natyrës, në kuadër të Projektit të Binjakëzimit ka organizuar 115 trajnime informative gjysëmditore për TIK për rreth 2000 pjesëmarrës/e; për sigurimin e cilësisë në arsimin dhe aftësimin Profesional ka organizuar 4 trajnime 2 ditore me 98 pjesëmarrës në 18 shkolla pilotuese; në kuadër të sigurimit të cilësisë ka organizuar 3 punëtori 1 ditore, me rreth 20 inspektorë; në arsimin gjithëpërfshirës ka organizuar 7 trajnime 2 ditore, me rreth 120 pjesëmarrës; si dhe për fushën kurrikulare “Shëndeti dhe mirëqenia” janë organizuar 2 module 2 ditore me 22 trajnerë të MASHT-it. Në procesin e licencimit të mësimdhënësve janë përgatitur 950 dhe janë realizuar 300 aplikime të reja.

Instituti Pedagogjik i Kosovës, në kuadër të veprimtarisë kërkimore shkencore, ka realizuar hulumtime të veçanta dhe analiza/trajtesa në kuadër të revistës së përvitshme “Kërkime Pedagogjike”. Për këtë vit janë hartuar gjithsej gjashtë hulumtime dhe pesë analiza, të cilat trajtojnë çështjet të ndryshme në arsim. Është realizuar trajnimi i mësimdhënësve të shkollave të mesme profesionale për punë me të rritur. Janë trajnuar dhe certifikuar 54 mësimdhënës të cilët janë aftësuar për metodologjinë e punës me të rritur. Trajnimi është akredituar dhe ka pesë module dhe 195 kredi.

ARSIMIMI I FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA - Përkrahja e fëmijëve me nevoja të veçanta, gjithashtu ka qenë njëri ndër prioritet e MASHT-it. Kështu, janë hartuar Parametrat e financimit për nxënësit me nevoja të veçanta, si dhe është finalizuar programi “Mësimdhënia bazuar në fusha të aktiviteteve”. Gjatë vitit 2016 janë themeluar 14 ekipe vlerësuese, ndërsa në 14 komuna tjera kanë vlerësuar gjithsej 397 fëmijë/nxënës. Janë hartuar standardet e profesionit dhe kurrikuli për asistentë që punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta, janë hartuar standardet për 2 profile, janë përgatitur dhe akredituar edhe dy programe trajnimi për gjuhën e shenjave dhe programi për shkrimin e Brajtit, si dhe është rishikuar dokumenti “Plani Individual i Arsimit për nxënësit me aftësi të kufizuara”. Në qendrën burimore “Xheladin Deda” është hapur konkursi për regjistrimin e kandidatëve të moshës së rritur. Gjithashtu, janë trajnuar 490 mësimdhënës dhe 80 zyrtarë të DKA-ve dhe anëtar të ekipeve vlerësuese për arsimin gjithëpërfshirës. Në qendrën burimore “Përparimi” në Prishtinë është përgatitur dhoma sensorike e kompletuar me të gjitha pajisjet.

ARSIMIMI I KOMUNITETEVE - Korniza e Kurrikulës së Kosovës përfshinë edhe shkollat ku mësojnë nxënësit e komuniteteve. Janë përkthyer dhe botuar planprogramet e arsimit profesional të klasës së 12-të nga gjuha shqipe në gjuhët turke dhe boshnjake. MASHT ka siguruar tekstin shkollor Gjuha Rome 1, si dhe ka bërë të gjitha përgatitjet edhe për dy tekste të tjera. Gjithashtu, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës është bërë zgjerimi i mësimin të gjuhës rome edhe në 4 komuna. Në Prizren është duke u zbatuar kurrikula e gjuhës rome, ku janë përfshirë nxënësit e klasave 2, 3 dhe 4. Me qëllim të lehtësimin për regjistrim të studentëve të komuniteteve në universitetet publike, është miratuar Udhëzimit Administrativ për aplikimin e masave afirmative dhe kuotave për regjistrim të studentëve nga komunitetet joshumicë në Universitetet Publike, gjithashtu janë ndarë 500 bursa për nxënësit e shkollave të mesme të larta për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, poashtu, janë ndarë 52 bursa për studentë të komuniteteve.

Në **ARSIMIN PROFESIONAL** edhe këtë vit është angazhuar në harmonizimin e arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës, duke realizuar një mori projektsh dhe aktivitetsesh, si: është hartuar

Plani Mësimor i veçantë për AAP që është duke u pilotuar në 24 shkolla; të gjitha shkollat e AAP kanë koordinatorët për sigurim të cilësisë; janë hartuar 7 udhëzues për kurse për arsimin për të rritur për programet: autocad, dizajn mode, ndërmarrësi, konstruksione të thata, udhëzues për vetëmenaxhimin e shkollës dhe metodat e mësimdhënies dhe udhëzues për trajnimin e mësimdhënësve; Qendra Kosovare e firmave ushtrimore është anëtarësuar në EUROOPEN PEN International; janë trajnuar 15 mësimdhënës të AAP-së për zbatimin e Office 365 në 7 rajone të Kosovës; është në proces trajnimi për zhvillimin e kompetencës së ndërmarrësisë (60 mësimdhënës të IAAP dhe 5 trajnerë të trajnerëve); është lansuar programi Master për AAP (DAAPARr dhe Fakulteti i Edukimit) gjenerata e parë; janë pajisur punëtoritë në 4 shkolla profesionale dhe është mbatur trajnim për përdorim të tyre në 4 shkolla; është hartuar standardi i profesionit për nivelin e 5 për këshilltarin në karrierë dhe instruktorin e komunikacionit, si dhe 10 standarde të profesionit në bashkëpunim të ngushtë me bizneset; ka filluar zbatimi i partneritetit në mes të QK Ferizaj dhe QK Prizren dhe kompanisë ndërkombëtare PEARSON në njohjen ndërkombëtare të kualifikimeve që ofrohen në këto QK; janë hartuar kurrikula të integruara për 4 profile dhe tani kemi gjithsej 24 kurrikula të integruara; është aprovuar koncepti i themelimit të zyrave të modelit të biznesit në QK në Ferizaj dhe Prizren; janë ngritur kapacitete të mësimdhënësve të fushës së turizmit përmes partneritetit të arritur me kompaninë vendore të specializuar në sektorin e turizmit GEARSUP- Solution specifikisht në kurset e IATA; janë nënshkruar 5 marrëveshje me bizneset (në nivel qendror) për pranimin e nxënësve për praktikën profesionale, si dhe janë rishikuar planet zhvillimore të 8 shkollave dhe janë trajnuar drejtorët dhe personat përgjegjës për planifikim.

Autoriteti Kombëtar të Kualifikimeve gjatë këtij viti ka realizuar rreth 17 procese të validimit të standardeve të profesionit që ka rezultuar me ngritjen e standardeve të aprovuara në nivel shteti në 60 sosh. Poashtu, AKK gjatë këtij viti ka vazhduar me popullimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve(KKK) duke validuar dhe aprovuar 6 kualifikime të reja në KKK si dhe akredituar për herë të parë 15 ofrues për akreditimin e këtyre kualifikimeve ndërsa ka bërë rishikimin e kushteve tek 13 ofrues të akredituar me kusht. Në total deri tani janë aprovuar 27 kualifikime në nivelet kualifikimeve të para në nivelet 2,3,4 dhe 5 në KKK, si dhe janë akredituar 36 ofrues të cilët ofrojnë, lëshojnë dhe certifikojnë kualifikimeve profesionale.

INFRASTRUKTURA SHKOLLORE- kanë përfunduar investimet në 12 objekte të reja shkollore, me hapësirë të re rreth S=59,840.00 m². Vazhdojnë punimet në ndërtimin e 5 objekteve të reja shkollore dhe 3 sallave të edukatës fizike. Në ndërtim e sipër janë 6 objekte të reja në bashkëfinansim me komunën e Skenderaj dhe Klinës. MASHT përmes Memorandumit të Mirëkuptimi ka bartur në MAP menaxhimin dhe ndërtimin e 8 objekteve të reja shkollore dhe një salle sportive. Poashtu, përmes marrëveshjeve të mirëkuptimit me komunat e veriut, ka përfunduar investimet në renovimin e 7 objekteve shkollore, ku 3 projekte janë në Mitrovicën e Veriut dhe 4 në komunën e Zveçanit. Janë furnizuar me inventar shkollor 10 objekte të reja të ndërtuara nga MASHT, 8 shkolla dhe 1 qerdhe të ndërtuara nga komunat dhe donatorët, si dhe 10 objekte shkollore ekzistuese. Poashtu janë pajisur edhe 16 salla të edukatës fizike me pajisje sportive.

Në **ARSIMIN E LARTË**, janë duke realizuar projekte dhe aktivitete të ndryshme, si: është funksionalizuar Unioni Nacional të Studentëve; është hapur një program i doktoratës në Fakultetin Ekonomik, ku ligjërimi është në gjuhën angleze; është themeluar Konferenca e Rektorëve, është nënshkruar UA për njohje të diplomave, gradave dhe kualifikimeve të fituara jashtë Kosovës.

Me qëllim të nxitjes dhe stimulimit të studentëve në fusha të ndryshme të orientuara në degë të rëndësishme strategjike për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, me fokus të veçantë në shkencat ekzakte, bujqësi, inxhinieri,

mjekësi, shkencat matematiko-natyrore dhe edukim ka ndarë rreth 170 bursa për studentët elitarë të institucioneve publike të arsimit të lartë në programet deficitare.

Janë ndarë 18 bursa nga Qeveria Hungareze dhe është nënshkruar në dhjetor 2016 Programi i ri Bashkëpunimit me Qeverinë Hungareze për ofrimin e 50 bursave për tri nivelet e studimit, 1 bursë nga Qeveria Japoneze, 32 bursa të plota dhe 25 të pjesësoshme në bazë të marrëveshjes së MASHT me Universitetin e Sheffield-it, si dhe janë ndarë fondet për studentët në programin e TLP dhe për Fondacionin Fulbright;

Është nënshkruar dokumentacioni për themelimin dhe funksionalizimin e SMIAL-it, si dhe ka filluar pilotimi në tri institucione të arsimit të lartë; janë përkrahur 9 profesorë dhe studentëve me mobilitete nga projekti CEPUS; si dhe janë ndarë fondet për studentët në programin e TLP dhe për Programin Fulbright.

Gjatë vitit është bërë vlerësimin, **akreditimin si dhe monitorimin e institucioneve publike** dhe private të arsimit të lartë në Kosovë, duke filluar për herë të parë zbatimin e plotë të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e IAL-ve në Kosovë. Në përputhje me kërkesat e këtij Udhëzimi, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) ka trajtuar aplikacionet e institucioneve të arsimit të lartë dhe vetëm IAL-të të cilat kanë plotësuar këto kritere janë lejuar të futen në proces të vlerësimit dhe akreditimit.

Deri në Korrik të vitit 2016, kanë qenë gjithsejtë 468 programe të akredituara të studimit në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë, përkatësisht 262 në publik dhe 206 në sektorin privat, të ofruara nga gjithsejtë 38 IAL. Megjithatë, me zbatimin e plotë të UA për akreditim (kërkesën për 3 PhD për program të studimit) ka pasur një zbritje domethënëse të programeve të akredituara të studimit për shkak se disa institucione kanë dështuar që të plotësojnë këto kritere. Për më tepër, 6 institucione private të arsimit të lartë nuk janë lejuar të regjistrojnë studentë të rinj për shkak se nuk kanë arritur të marrin ri/akreditimin institucional.

Në fushën e **SHKENCËS**, gjatë vitit 2016, është organizuar “Java e Shkencës 2016”, janë botuar rreth 300 libra të kumtesave nga “Java e Shkencës 2015”, si dhe është bërë thirrja publike për aplikim për “Java e Shkencës 2017”. Janë përkrahur 11 institucione hulumtuese nga granti për projekte të vogla shkencore në shumë prej 76870 Euro, 54 hulumtues nga granti për mobilitete afatëshkurtëra në shumë prej 35,000.00 euro, si dhe 11 botime dhe publikime shkencore në shumë prej 45000 Euro. Kosova ka filluar të jetë aktive në Programin Kornizë të BE-së për Kërkim dhe Inovacion - Horizon 2020.

REFORMA LEGJISLATIVE NË ARSIM - Gjatë periudhës një (1) vjeçare, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka punuar në ndryshime substanciale të legjislacionit për arsim, duke rishikuar/hartuar:

1. Projektligji për Inspektoratin e Arsimit, *i miratuar në Qeveri dhe i dorëzuar për shqyrtim/miratim në Kuvend.*
2. Koncept Dokumenti Inovacion dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë.
3. Koncept Dokumenti për Botimin e Teksteve dhe Mjeteve Shkollore, Lektyrës Shkollore dhe Dokumentacionit Pedagogjik,
4. Gjithashtu, janë miratuar 28 Udhëzime Administrative, si dhe është në proces rishikimi i Projektregullores nr. 13/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë.

- MINISTERIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

MBPZHR gjatë vitit ka punuar në përgatitjen e legjislacionit primar dhe atij sekondar. Janë hartuar projektligjet: Projektligji për Pyjet; Projektligji për Ushqimin; Projektligji për Pijet e Forta Alkoolike; Projektligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural; Projektligji për plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit 2006/41 për Gjuetinë. Ndërsa, ka filluar punën në hartimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit 2004/21 për Veterinarinë dhe Projektligjit për farëra dhe material fidanor.

Janë hartuar dhe miratuar 13 udhëzime administrative si dhe 10 të tjera janë hartuar dhe janë në procedurë të miratimit. Po ashtu janë aprovuar rreth 40 vendime për rregullimin e çështjeve të caktuara brenda sektorit të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural.

Strategjitë sektoriale të ministrisë

Gjatë vitit MBPZHR ka punuar në përgatitjen e disa dokumenteve afatgjata dhe afatmesme strategjike, siç janë: Strategjia për pyje 2016-2020, Strategjia për sektorin e vreshtarisë, verëtarisë dhe rrushit të tryezës 2016-2021, Programi kombëtar i pyllëzimit dhe ripyllëzimit 2016-2025, Programi kombëtar për shëndetin pyjor 2016-2025, Programi i reformës ekonomike për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural 2017-2019.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, është në proces të negocimit marrëveshja për bashkëpunim në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural ndërmjet Kosovës dhe Bullgarisë. Po ashtu kemi pranuar nismën nga Mali i Zi për negocim të marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural në mes të dy vendeve tona..

Ministri i Bujqësisë ka marrë pjesë në një numër të madh të forumeve ekonomike, si: Forumi Global për Ushqim dhe Bujqësi 2017 (GFFA) në Gjermani, takimi vjetor i Asociacionit Kombëtar të Departamenteve Shtetërore të Bujqësisë së SHBA-ve në Nebraska, Forumi ekonomik gjermano-kosovar në Gjermani etj.

Të arriturat kryesore në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural

Për vitin 2016, MBPZHR ka pasur në dispozicion buxhetin në shumën prej 54,968,113 euro.

1. **Zhvillimi rural** - Është hartuar, miratuar dhe zbatuar Programi për Zhvillim Rural 2016 (Programi i granteve), si program vjetor i mbështetjes së fermerëve dhe agro përpunuesve në vend. Buxheti i planifikuar për zbatimin e këtij Programi ka qenë 23 milionë euro dhe është shpërndarë në pesë masat kryesore: Masa për investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore, me 342 përfitues, në vlerë prej 15.29 milion euro; Masa për investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, me 25 përfitues, në vlerë prej 4,29 milion euro; Masa për diversifikimin në fermë dhe zhvillimin e bizneseve, me 98 përfitues, në vlerë prej 1,59 milion euro; Masa për Grupet Lokale të Veprimit, me 12 përfitues, në vlerë prej 80.000 euro dhe Masa për ujitjen e tokave bujqësore, me 8 përfitues, në vlerë prej 1.12 milion euro. Vlen të theksohet se gjatë këtij viti ka pasur një shtim të konsiderueshëm të sipërfaqes me pemë, veçanërisht me mjedër.
2. **Bujqësia** - Është hartuar, miratuar dhe zbatuar Programi i Pagesave Direkte 2016 (Programi i subvencioneve), si program vjetor i mbështetjes së fermerëve. Këtë vit për herë të parë ka filluar mbështetja me pagesa direkte edhe për: elbin, thekrën, bujqësinë organike, akuakulturën, arrën, lajthinë, aroninë dhe është rritur shuma e subvencionimit për bletët, si një sektor me rëndësi në vend.

Buxheti i planifikuar për zbatimin e këtij Programi ka qenë 26 milion euro dhe është shpërndarë në këta nën sektorë: drithëra, blegtori, hortikulturë. Numri i aplikimeve përfituese nga ky program për vitin 2016 është mbi 42000 fermerë.

3. **Ndikimi i investimeve në sektorin e bujqësisë** - Si rezultat i investimeve të bëra në sektorin e bujqësisë gjatë vitit 2016, përveç tjerash është rritur niveli i prodhimit të bujqësore dhe agro përpunuese në vend, është rritur sipërfaqja e punueshme e tokave bujqësore, janë hapur mbi 2500 vende të reja të punës, është rritur dukshëm eksporti i produkteve bujqësore dhe në një masë është bërë zëvendësimi i produkteve të importit nga produktet bujqësore të prodhuara në vend.
4. **Shërbimet këshilluese** - duke qenë se shërbimet këshilluese janë element thelbësor i zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë, MBPZHR, ka konsoliduar dhe ka funksionalizuar shërbimet këshilluese, duke bërë për herë të parë Certifikimin e 136 këshilltarëve bujqësor, publik dhe privat. Gjatë vitit është bërë mobilizimi i këshilltarëve komunal në 34 komuna të Kosovës, janë organizuar 400 këshillimeve nga ekspertë në sektorë të ndryshëm, ku kanë marrë pjesë mbi 5500 fermerë, janë organizuar 16 vizita për fermerë brenda vendit, janë botuar 10 broshura për fermerë dhe janë shpërndarë 10 spote në medie elektronike. Po ashtu në drejtim të mbështetjes së fermerëve ka pasur një aktivitet të vazhdueshëm në Qendrat Këshilluese Informativ Komunale për bujqësi dhe zhvillim rural në të gjitha komunat e vendit.
5. **Vreshtaria dhe verëtaria** - Në këtë sektor kanë vazhduar aktivitetet, si: mirëmbajtja e Kadastrit të Vreshtave, Regjistrin të kultivuesve të vreshtave dhe Regjistrin të prodhuesve të verës, menaxhimi dhe monitorimi i kontrollit të kualitetit të verës, menaxhimi dhe monitorimi në tregtinë e brendshme, eksport dhe import. Ka vazhduar lëshimi i licencave për prodhuesit vendor, eksportuesit dhe importuesit. Janë instaluar tre stacione Agrometeorologjike (2 në Rahovec dhe 1 në Suharekë). Në bashkëfinancim me Komunën e Rahovecit është investuar në ndërtimin e tregut të rrushit dhe produkteve të tij.
6. **Përgatitja e institucioneve për akreditim për IPARD II** - Në kuadër të përgatitjeve të procesit të akreditimit të institucioneve për IPARD II, janë përgatitur një numër i madh i dokumenteve, procedurave dhe doracakëve për Autoritetin Menaxhues dhe Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë.
7. **Ruajtja e tokës bujqësore** - Përmes koordinimit me drejtoritë komunale për planifikim hapësinor janë pranuar 135 kërkesa për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore, nga të cilat janë aprovuar 98.
8. **Rregullimi i papërfunduar i tokës** - Zbatimi i projekteve të rregullimit të papërfunduar të tokës bujqësore është duke vazhduar në 21 Zona Kadastrale në Komunën e Drenasit me sipërfaqe rreth 4,725 ha, dhe në Komunën e Vushtrrisë në 5 Zona Kadastrale me sipërfaqe rreth 470 ha. Po ashtu rregullimi i tokës po vazhdon edhe në Komunën e Vitisë.
9. **Regjistrimi i plehrave artificiale, produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe varieteteve të reja të grurit, patates dhe misrit** - Janë regjistruar 44 loje të plehrave artificiale, 38 Produkte për Mbrojtjen e Bimëve, 3 varietete te reja të grurit, 13 të patates dhe 11 të hibrideve të misrit.
10. **Analiza sektoriale** - Janë përgatitur analizat e zinxhirit të vlerës për tre sektorë: pemë të imta, perime në fushë të hapur dhe vreshtari, duke përfshi edhe verën. Po ashtu janë përgatitur analiza të tregut për këto produkte bujqësore: ftoi, fasulja, domatja, vezët dhe mishi i pulës. Është punuar në modelet e kostove të prodhimit dhe investimit.
11. **Lansimi i qumështit të freskët vendor** - Në bashkëpunim me USAID-in, AUV-në dhe dy shoqatat përfaqësuese të sektorit të qumështit është lansuar fushata për rritjen e përdorimit të qumështit të freskët vendor nga industria përpunuese e qumështit.

12. **Menaxhimi dhe mbrojtja e pyjeve** - Gjatë vitit 2016 janë pyllëzuar 295 ha toka pyjore dhe janë mirëmbajtur 172 ha sipërfaqe të pyllëzuar në vitin 2015. Janë përgatitur planet menaxhuese të pyjeve për afro 25,000 ha pyje publike, është investuar në përmirësimin e infrastrukturën fizike në vendgjuetitë me rëndësi të veçantë në Blinajë dhe Duboqak.
13. **Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA)** - MBPZHR është angazhuar në zbatimin e obligimeve sektoriale që rrjedhin nga MSA, duke azhurnuar Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (Kapitujt 11, 12, 13 dhe 27) dhe duke raportuar për zhvillimet në sektor.
14. **IPA II** - Në kuadër asistencës IPA II per Programim 2017 janë përgatitur 3 Projekt propozime: 1. Mbështetja e mëtejshme e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, për forcimin e sektorit agro-ushqimor, 2. Rritja e ndërgjegjësimit dhe ndërtimi i kapaciteteve të fermerëve, përpunuesve agro - ushqimor dhe palëve të tjera relevante, në lidhje me standardet e prodhimit ne sektorin e bujqësisë, 3. Vlerësimi dhe përgatitja e Programit për bujqësi dhe zhvillimi Rural 2021-27.
15. **Kompensimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore në bujqësi** - Gjatë vitit janë pranuar dhe përpunuar kërkesat e fermerëve për kompensimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore, me ç' rast Ministria, me vendim të Qeverisë, ka ndarë buxhet për kompensimin e dëmeve të të gjithë fermerëve, në vlerë prej 25% të dëmit të shkaktuar.
16. **Menaxhimi i sëmundjes Lumpy skin disease (sëmundja gungore e gjedhit)** - Në bashkëpunim me AUV-në, gjatë vitit MBPZHR është angazhuar në trajtimin e sëmundjes.

Promovimi i prodhimtarisë bujqësore

Gjatë vitit 2016 ka vazhduar mbështetja e aktiviteteve për promovimin dhe marketingun e prodhimtarisë bujqësore si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Brenda vendit janë mbështetur aktivitetet e shoqatave dhe asociacioneve të fermerëve për promovimin e prodhimtarisë bujqësore, përmes aktiviteteve, si: Dita e mollës, Dita e mjedrës, Dita e boronicës, Dita e domates, Dita e patates, Festivali i rrushit "Hardhfest", etj. Në aspektin ndërkombëtar janë mbështetur fermerët dhe agro përpunuesit për pjesëmarrje në panairët e rëndësishme ndërkombëtare, si: International Green Eëek në Berlin, SIAL në Paris, EXPO Antalya, Panairi Bujqësor në Viroviticë, etj.

- MINISTERIA E DREJTËSISË

Ministria e Drejtësisë (MD) gjatë kësaj periudhe kujdes të veçantë i ka kushtuar zbatimit të aktiviteteve që janë në funksion të objektivave dhe prioriteteve programore të Qeverisë. Këtu hyjnë përmbushja e obligimeve që dalin nga agjenda Evropiane në fushëveprim të MD-së, Raporti i fundit për Vendin të Komisionit European, prioritetet e përfshira në Planin e Veprimit për zbatimin e Programit të Qeverisë 2015-2018, Plani Vjetor i Punës 2016, Procesit liberalizimit të vizave dhe dokumentet tjera përkatëse.

Në kuader të agjendes Evropiane Ministria e Drejtësisë ka përgaditur analizën gjithëpërfshirëse të fushës së legjislacionit penal dhe kundër korrupsion të Kosovës, që do të shërbejë gjatë procesit të rishikimit të Kodit Penal dhe Kodit të Procedures Penale.

Gjatë kësaj periudhe janë bërë reforma të vazhdueshme në avancimin e kornizës ligjore, përkatësisht **8 Projektligje** janë proceduar për në Kuvend siç janë:

- *Projektligji për plotësimin- ndryshimin e Ligjit për Procedurën Përmbartimore,*
- *Projektligji për Akademinë e Drejtësisë,*
- *Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e kodit të Procedurës Penale,*
- *Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Ekzekutimin e sanksioneve penale,*
- *Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ndërmjetësimin, Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,*
- *Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033*
- *Projektligji Për Kodin e Drejtësisë për të mitur - është miratuar*
- *Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-010 për Noterinë*
- *Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Trashigimin e Kosovës*
- *Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën Jokontestimore*

Me vendim të Qeverisë është miratuar **Rishikimi Funkcional për Sektorin e Sundimit të Ligjit** me qëllim të ngritjes së efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë, duke bërë analizën e sistemit të drejtësisë në tërësi. Rishikim do të bëhet me qëllim të krijimit të një baze për **Hartimin e një Strategjie gjithëpërfshirëse për Rendin dhe Ligjin** e cila do të adresoj të gjitha problemet.

Gjithashtu, konform Planit të Dokumenteve Strategjike është hartuar *Strategjinë Kombëtare për mbrojtje nga Dhuna në Familje* cila ka për qëllim të konsolidojë bashkëveprimin mes akterëve duke themeluar mekanizma për reagim të shpejtë për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje etj.

Lidhur me sistemin e Ekzekutimit të sanksioneve penale është hartuar *Strategjinë për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale*, e cila synon të përmirësoj administrimin e ekzekutimit të sanksioneve penale në Kosovë. Në lidhje me **infrastrukturën fizike ka përfunduar** ndërtimi i Objektivit për të Mitur me Masë Edukuese-Korrektuese. Dhe së shpejti do të funksionalizohet **Qendra e Paraburgimit në Gjilan dhe Prishtinë**.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe, në Shërbimi Sprovues i Kosovës ka pasur shtim të volumit të punës. Numri i Masave dhe Dënimeve Alternative dhe persona të Liruar me Kusht, në vitin 2016 ka qenë 1376 raste.

Agjencisa për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar (AAPSK), gjatë kësaj periudhe janë ekzekutuar 93 vendime të cilat kanë të bëjnë me pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, të cilat arrijnë shumën e përafërt në total prej €624,689.49, nga të cilat të sekuestruara janë €497,696.85 ndërsa të konfiskuara janë €126,992.64, dhe janë realizuar gjithsej 13 ankande publike.

Lidhur me Profesionet e lira vlen të theksohet se sistemi i Përmbarimit Privat është funksionalizuar, aktualisht janë emëruar 35 Përmbarues privat. **Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur tre afate të provimit ku janë Certifikuar 41 kandidatë të cilët kanë dhënë provimin për përmbarues privat. Në këtë periudhën numri i përgjithshëm i lendeve të zgjidhura nga përmbaruesit privat është 4532;**

Në kuader të sistemit të Përmbarimit Privat është themeluar mekanizmi mbikqyres Komisioni për Inspektimin e ligjshmerise së punës së Përmbaruesve privat dhe Odës së përmbaruesve privat. Sa i përket sistemit të Noterisë vërehet rritje e lendeve gjithsej 357.386 të zgjedhura nëpërpermejet zyreve noteriale. Poashtu është formuar Komisioni për mbikqyrjen e aktiviteteve noteriale si mekanizem mbikqyres. Ndërsa sa i përket Falimentimit janë licencuar 6 administrator falimentues dhe vazhdojnë ushtrimin e detyres.

Poashtu fusha e *Ndërmjetësimit* ka pasur rritje të vazhdushme në zgjidhjen e lëndëve. Kjo vërehet në rritjen e numrit të lëndëve gjithsej gjatë vitit 2016, gjithsej 1506 lende të cilat janë referuar për ndërmjetësim. Sa i përket Provimit të Jurisprudences gjatë kësaj periudhe janë mbajtur tre afate të provimit ku gjithsej kanë kaluar 196 kandidatë.

Në fushën e bashkëpunimit Juridik Ndërkombëtar gjatë kësaj periudhe me shtetin e Sllovenisë është nënshkruar Marrëveshja për Ekstradim, Ndihmë Juridike të Ndërsjellë në Çështjet penale dhe Ekzekutim të Vendimeve gjyqësore në çështjet penale. Ndërsa marrëveshja për transferim të personave të dënuar e nënshkruar në vitin 2010, është ratifikuar në Belgjikë dhe do të hyjë në fuqi me 24 dhjetor 2016. Kurse me Malin e Zi është finalizuar Marrëveshja për ekstradim, Ekzekutim të Vendimeve gjyqësore në çështjet penale dhe Marrëveshja për Ndihmë të ndërsjelle Juridike në çështjet penale, dhe së shpejti pritet të nënshkruhet. Si dhe me shtetin e Hungarisë Marrëveshja për Ekstradim dhe Marrëveshje për Transferim të Personave të dënuar është finalizuar dhe pritet nënshkrimi i tyre.

Instituti i Hulmtimeve të krimeve të Luftes ka vazhduar me hulmtimet e lokacioneve të ndryshme të masakrave të kryera gjatë luftës në Kosovë, si dhe me një numer publikimeve. Ndërsa, *Avokatura Shtetërore* ka përfaqësuar Qeverinë e Republikës së Kosovës në gjithsej **3864** seanca gjyqësore.

- MINISTERIA E DIASPORËS

Gjetja e modeleve për qendrat e përbashkëta kulturore

Për funksionim sa më të suksesshëm dhe për zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për hapje të qendrave të përbashkëta kulturore në Diasporë, Këshilli Britanik, në bashkëpunim me Ministrinë e Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrinë e Kulturës të Republikës së Shqipërisë, ka realizuar një hulumtim për gjetjen e modeleve më të përshtatshme për funksionimin e këtyre qendrave. Projekti është mbështetur nga Ambasada Norvegjeze, ndërsa hulumtimi është realizuar nga z. John Kieffer, Creative Consultancy (Britani e Madhe).

Qendrat Kulturore të Republikës së Kosovës në Diasporë, të themeluara me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Turqi, 30/01/2013, Zvicër, 25/10/2013, Suedi, 18/04/2014, misionin e tyre e realizojnë përmes aktiviteteve të shumta të cilat organizohen në qendrat kulturore në vendet ku janë themeluar. Qëllimi i aktiviteteve është ruajtja e gjuhës, kulturës dhe trashëgimisë kulturore të Kosovës, përmes kurseve të gjuhës shqipe, aktiviteteve të ndryshme kulturore, shkencore dhe sportive me bashkatdhetarë, si dhe aktivitete tjera përmes të cilave synohet ruajtja, kultivimi dhe promovimi i imazhit dhe identitetit tonë kulturor, historik, gjuhësor dhe kombëtar në diasporë.

Hulumtimi është bërë me qëllim të krijimit të një pasqyre krahasuese midis modeleve të ndryshme ekzistuese të qendrave kulturore nëpër botë - si misione kombëtare, në aspektin konceptual, po ashtu edhe atë ligjor, krijojnë një kuptim të jetës, në veçanti të jetës kulturore të Diasporës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet intervistave dhe krahasimit të të dhënave. Raportet ofrojnë një listë të modeleve dhe/ose kombinimeve të modeleve të qendrave kulturore bazuar në modelet ekzistuese efektive, duke marrë parasysh specifikat e jetës kulturore të Diasporës shqiptare dhe nevojat e prezantimit të kulturës shqiptare jashtë vendit.

Investimet e Huaja

Me qëllim të rritjes së funksionalitetit të shtetit tonë sa i përket sundimit të ligjit në fushën e ekonomisë, përkatësisht në aspektin e tërheqjes së investimeve nga diaspora, Ministria ka insistuar në funksionalizmin e divizionit për kontestet e investitorëve të huaj që vepron në kuadër të Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Panairi i punës “ Diaspora dhe investimet”

Në funksion të gjenerimit të vendeve të reja të punës për qytetarët e Kosovës, Ministria e Diasporës, në bashkëpunim me programin DIMAK të GIZ-it, Ambasadën Gjermane në Kosovë dhe institucione e ministri të linjës, ka organizuar një panair të punës me bizneset e diasporës “DIASPORA - INVESTIMET DHE PUNËSIMI”, sidomos me bizneset nga vendet gjermano-folëse, të cilat operojnë në diasporë dhe Kosovë, panair ky që ka krijuar rreth 1000 vende pune. Në kuadër të këtij aktiviteti janë prezantuar edhe mundësi të ndryshme të investimit nga institucionet lokale të Kosovës para bizneseve të diasporës.

Kthimi i trurit në atdhe

Në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, Ministria e Diasporës ka organizuar një konferencë me titull “MUNDËSITË E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET JURISTËVE TË DIASPORËS DHE INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS”, me pjesëmarrje të rreth 20 juristëve e avokatëve nga diaspora dhe të gjitha institucioneve relevante të Republikës së Kosovës, për t'i gjetur modelet më të mira të përfshirjes së këtyre juristëve dhe avokatëve nga diaspora në mekanizmat e përfaqësimit juridik në Kosovë. Në bazë të rekomandimeve të kësaj

konferencë, edhe lista e avokatëve të diasporës është në dispozicion të qytetarëve të Kosovës, përmes Odës së Avokatëve.

Në kuadër të kthimit të trurit, është organizuar edhe një konferencë me titull "Roli i diasporës në botën shqiptare", së bashku me organizatën "Alba Shkenca", me pjesëmarrjen e studiuesve të ndryshëm nga diaspora.

Krijimi i mundësive për kryerjen e praktikës së punës nga studentët e diasporës

Pas nënshkrimit të marrëveshjes me Ministrinë e Rinisë dhe të Mirëqenies Sociale të Republikës së Shqipërisë, gjatë vitit 2016 janë hapur 3000 vende për punë praktike në institucionet e Republikës së Kosovës dhe në ato të Republikës së Shqipërisë për studentë nga diaspora. Ky program do të vazhdojë edhe më tutje, ndërsa studentët nga diaspora kanë realizuar punë praktike në institucione të ndryshme lokale dhe qendrore, sipas kërkesës së tyre.

Fushata për regjistrimin e diasporës "TI JE PJESE E ATDHEUT"

Pas ridizajnit të qasjes së regjistrimit të diasporës, si dhe në bashkëpunim të ngushtë më të gjitha institucionet e Kosovës, UNDP-në dhe IOM-in, si dhe me mbështetje edhe të Qeverisë Finlandeze, përmes fushatës "TI JE PJESE E ATDHEUT" dhe angazhimit të mbi 200 zyrtarëve për regjistrim në çdo komunë të Kosovës, kemi arritur t'i regjistrojmë rreth 400.000 pjesëtarë të diasporës. Në kuadër të zyrtarëve për regjistrimin e diasporës, ka pasur zyrtarë nga të gjitha komunitetet pakicë në Kosovë, si dhe zyrtarë nga komunitetet me nevoja të veçanta.

Pjesa tjetër e procesit të regjistrimit do të vazhdojë përmes regjistrimit në ambasada dhe konsullata të Kosovës në botë, si dhe përmes platformës "online".

Bashkëpunimi me institucionet e tjera

Për realizimin e aktiviteteve në diasporë, gjithmonë jemi në koordinim të plotë me ambasadat dhe konsullatat tona në botë. Përpos realizimit të aktiviteteve të përbashkëta gjatë ditëve të diasporës, si dhe për krijimin e lehtësirave administrative për bashkatdhetarët, jemi në koordinim të plotë me komunat e Kosovës. Gjithashtu, kemi iniciuar edhe vendosjen e zyrtarëve ndërlidhës lokalë për diasporë dhe trajnimin e tyre.

Për informimin e bashkatdhetarëve lidhur me kolonat e gjata në kufij, sidomos në muajt e verës, jemi në koordinim të plotë me MPB-në dhe me Policinë e Kosovës.

Në kuadër të "Ditëve të Diasporës", e kemi përkrahur Kuvendin e Kosovës për aktivitetet për diasporën. Gjithashtu, zyra e Kryetarit të Kuvendit e përkrahur plotësisht programin për regjistrin e diasporës

Në kuadër të organizimit të mësimit plotësues në diasporë jemi në koordinim të plotë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Gjithashtu, për promovimin e pjesëmarrjes së fëmijëve në klasat e mësimit plotësues, kemi bashkëpunuar ngushtë edhe me Radiotelevizionin e Kosovës, por edhe me institucionet fetare në Kosovë.

Po ashtu, për punën e saj, Ministria e Diasporës ka marrë përkrahje të plotë nga Komisioni parlamentar për punë të jashtme.

Samiti i Diasporës

Samiti i parë i Diasporës shqiptare u organizua nën përkujdesin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Diasporës së Republikës së Kosovës. Në këtë samit morën pjesë rreth 1000 përfaqësues të diasporës nga 40 shtete të ndryshme.

Në kuadër të punimeve të Samitit të Diasporës Shqiptare në Tiranë u organizuan edhe 8 panele, përmes të cilave u zhvillua një bashkëbisedim i hapur mes bashkatdhetarëve dhe përfaqësuesve të të dyja shteteve,

Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës, si dhe u trajtuan tema të ndryshme në interes të diasporës dhe atdheut.

Aty u theksua edhe nevoja e një raporti të ri cilësor me diasporën, duke pasur parasysh se diaspora jonë sot ka krijuar burime të jashtëzakonshme njerëzore.

Samiti i ardhshëm do të organizohet në Prishtinë!

Ditët e kulturës shqiptare

Organizuar nga Ministria e Diasporës, në bashkëpunim me ambasadat e Kosovës në Berlin, Bernë dhe Londër, u organizuan “Ditët e kulturës shqiptare” në Gjermani, Suedi, Zvicër dhe në Britani të Madhe.

Ndër të tjera, pjesë e këtij aktiviteti ishin edhe ekspozita e fotografive të fotografit të mirënjohur shqiptar Fadil Berisha, me titull “Albanian Beauty”, shfaqja e aktorëve shqiptarë nga Kosova “Sikur kjo të ishte shfaqje”, “Dita e filmit” me filma të metrazhit të shkurtër, duke përfshirë edhe filmin e nominuar për OSCAR “SHOK”, si dhe një koncert i xhazkëngëtares Elina Duni.

Ditët e kulturës shqiptare funksionon si një mekanizëm i ruajtjes së lidhjeve të diasporës sonë me atdheun, por edhe si një mekanizëm i diplomacisë publike përmes veprave të artit shqiptar të prezantuara në botë.

Aktivitete të tjera

Me qëllim të njohjes së atdheut dhe ruajtjes së lidhjeve me vendin, edhe këtë vit ka vazhduar organizimi i vizitave studimore me nxënës, studentë dhe mësues nga diaspora. Janë përfshirë mbi 250 pjesëmarrës (nxënës, mësues, studentë dhe prindër shqiptarë) nga Turqia, Austria, Gjermania, Suedia etj. Organizimi i kuizit të diturisë, me nxënës nga diaspora në Suedi, Gjermani, Greqi, Zvicër dhe Slloveni.

MeD ka bërë shpërndarjen e mbi 30 mijë librave, lektyrave, hartave dhe materialeve të tjera shkollore për të përkrahur mbarëvajtjen e mësimit të gjuhës shqipe në SHBA, Gjermani, Zvicër, Slloveni, Kroaci, Austri, Itali, Francë, Angli, Suedi, Belgjikë, Danimarkë, Greqi, Turqi, Australi dhe Kanada. Më 2016, në Diasporë janë hapur 14 paralele të reja të mësimit të gjuhës shqipe,

Organizuar nga RRBDSH dhe mbështetur nga Ministria e Diasporës është mbajtur Forumi i I-rë ekonomik i bizneseve të diasporës shqiptare në Neë York me prezencën e 600 afaristëve shqiptarë nga mbarë bota, e në të cilin morën pjesë Presidenti i Shqipërisë, z.Bujar Nishani, Kryeministri i Kosovës z.Isa Mustafa, etj

Janë hartuar edhe dokumentet:

- Rregullorja nr. 1/2016 për subvencionimin e projekteve për Diasporën,
- Rregullorja nr. 2/2016 – MeD për ndarjen e çmimeve vjetor nga ministria e diasporës
- Është hartuar Koncept dokumenti për diasporën,
- Është përgatitur Projekt-rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Diasporës

- MINISTERIA E FINANCAVE

Përgatitja e legjislacionit nga ministria

Ministria e Financave në vitin 2016 në Programin e saj legjislativ ka pasur gjithsej 19 Projektligje, nga 112 Projektligje sa i ka Qeveria e Republikës së Kosovës². Thënë ndryshe, Ministria e Financave ka bartur afro 17 % të agjendës legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Nga gjithsej 19 Projektligje, 15 Projektligje janë miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës, 1 Projektligji është në procedurat e miratimit në ZKM ndërsa 3 Projektligje janë akoma në procedurat brenda Ministrisë së Financave. Pra, bazuar në këto shifra rrjedh se Ministria e Financave ka realizuar rreth 80% të Programit të saj Legjislativ. Krahasuar me vitin 2015, në vitin 2016 MF ka rritur për 20% përqindjen e realizimit të Programit Legjislativ. Shikuar nga realizimi i Programit Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Financave me 15 Projektligje të miratuara në Qeveri ka realizuar afro 30% të Programit Legjislativ³. Sa i përket akteve nënligjore, Ministria e Financave brenda vitit 2016 ka miratuar dhe sponsoruar gjithsej 13 akte nënligjore, ku 7 akte nënligjore ka miratuar Ministri i Financave dhe 6 akte nënligjore të sponsoruar nga MF janë miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Krahasuar me vitin 2015, në vitin 2016 MF ka miratuar dhe sponsoruar 4 akte nënligjore më shumë. Qeveria e Kosovës gjatë periudhës raportuese ka aprovuar në mbledhjet e saja 97 pika që janë propozuar nga Ministria e Financave, që kthyer në përqindje i bie 16 për qind e numrit të pikave të aprovuara.

2. Dogana e Kosovës

² Sipas raportit përfundimtar për Programin Legjislativ 2016

³ Sipas raportit përfundimtar për Programin Legjislativ 2016

Dogana e Kosovës vitit 2016 ka mbledhur mbledh 1,051.4 mil euro, që është 100 milion euro (apo 12%) më shumë se vitin paraprak, me gjithë zvogëlimin e të hyrave doganore prej 22.8 mil euro për shkak të zbatimit të MSA-së. Dogana ka bërë progres të madh në thjeshtëzimin e procedurave doganore, të dëshmuar në raportin e Bankës Botërore për vitin 2016. Indikatorin “Tregtia përmes kufijve”, që ka të bëjë me Doganën, ka pasur ngritje për 8 pozita krahasuar me vitin paraprak. Ndërkaq, krahasuar me tri vite më parë, kemi një përmirësim të rangimit ndërkombëtar të Kosovës për 70 pozita, nga pozita 122 në pozitën 51. Ky përmirësim në rangim është bërë falë zbatimit të procedurave të thjeshtëzuara të eksportit, ku eksportuesve ju ofrohen shërbime gjatë 24 orëve, kalimi i kontrollit doganor përmes kanalit të verdhë për 5 minuta, zbatimi i procedurave siç parashihen me MSA etj. Dogana ka themeluar transitin e përbashkët me Shqipërinë, e cila gjë ka shmangur kontrollet e panevojshme kufitare. Dogana ka qenë shumë e angazhuar në luftimin e informalitetit. Në këtë drejtim është shtuar bashkëpunimi ndërkombëtar në parandalimin e evazionit fiskal.

3. Administrata Tatimore e Kosovës

ATK sivjet ka realizuar të hyra prej 387.8 mil euro, që është 54.2 mil (apo 16.2%) më shumë se në vitin paraprak. Progres i mirë është arritur në procesin e fiskalizimit, ku deri më tani janë fiskalizuar gjithsej 25,726 biznese, nga këto biznese, 44 janë nga sektori i shitjes së karburanteve. Gjatë vitit 2016 janë pranuar gjithsej 399 kërkesa për rimbursim, ku shumica e mjeteve të aprovuara ka qenë 18.9 milionë euro. Ndërsa rimbursimi për qytetarë nga kuponët fiskal ka arritur shumën prej 12 mil euro. Nga Ligji për Faljen e Borxheve Publike, ATK ka falur borxhe prej 216 mil euro, ndërkaq janë mbledhur të hyra si rezultat i këtij ligji në shumë prej 24.2 mil euro. ATK ka bërë reformë të thellë në shërbimet për tatimpagues. Janë ofruar gjithsej 415,654 shërbime për tatimpagues. Në raportin e të bërit biznes të Bankës Botërore, Kosova ka përmirësuar rangimin ndërkombëtar për 34 pozita në fushën e pagesës së taksave, nga pozita 77 në pozitën 43.

4. Zbatimi me sukses i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

Dogana e Kosovës nga data 1 prill 2016 ka filluar me zbatimin e MSA-së. Gjatë kësaj periudhe është përshtatur sistemi i doganimit në përputhje me kërkesat e MSA-së. Sot rreth 75% e mallrave që vijnë nga vendet e BE-së i nënshtrohen normës së reduktuar të tatimit doganor, me tendencë që sipas planit deri më 2022 rreth 99% e mallrave që vijnë nga vendet e BE-së të jenë të liruara nga tatimi doganor. Si rezultat i kësaj, kjo marrëveshje i ka reduktuar të hyrat nga Dogana për 22.8 mil euro.

5. Efektet e pakos fiskale

Disa nga efektet e pakos fiskale që ka hyrë në fuqi në shtator 2015 janë si në vijim:

- i. Gjatë vitit 2016 bizneset kanë përfituar lirime në shumën prej 47 milion euro.
- ii. Trend pozitiv vërehet në qarkullimin e shoqërive tregtare të mëdha. Numri i shoqërive tregtare të mëdha që, për shkak të qarkullimit të madh apo numrin të madh të të punësuarve, obligohen të dorëzojnë pasqyrat financiare në Këshillin Kosovar për Raportim Financiar është rritur nga 221 në 248. Kjo është një rritje prej 12% e numrit të kompanive të mëdha në vend. Rritja e punësimit vetëm në këto kompani ka qenë 11% apo 4,924 punëtorë më shumë (rritja nga 44,101 punëtorë në 49,029 punëtorë).
- iii. Përfitimet nga qytetarët për shkak të lirimeve në normën e TVSH-së nga 16% në 8% kanë qenë në vlerë prej 21 mil euro (6.06 mil euro për tetor-dhjetor 2015 dhe 14.9 mil euro për periudhën janar-tetor 2016).
- iv. Numri i bizneseve me llogari aktive në TVSH është rritur me 3 mijë gjatë këtij viti, nga 16 mijë sa ka pasur më 2015 në 19 mijë.
- v. ATK ka lejuar rreth 1.3 mil euro zbritje të bazës tatimore për shpenzimet e kompanive për pagesa në emër të bamirësive apo për asete speciale, bazuar në ligjin për të ardhurat e korporatave dhe ligjin për të ardhurat personale.

- vi. ATK ka pranuar rreth 850 mijë pliko të kuponëve fiskalë nga qytetarët nga tetori i vitit të kaluar, dhe ka rimbursuar TVSH në total prej 13.1 mil euro për qytetarë. Ky projekt ka ndikuar shumë në rritjen e vetëdijes së qytetarëve për të blerë vetëm nga kompanitë e fiskalizuara, duke ndikuar kështu në rritjen e ekonomisë formale.

6. Avancimi i politikave ekonomike dhe fiskale

Propozim-politikat e reja fiskale: Ministria e Financave ka hartuar politikat e reja fiskale për përmirësimin e ambientit për biznes. Këtu përfshihen:

- i. Zgjerimi i listës së produkteve që konsiderohen si lëndë e parë për lirim nga tatimi doganor;
- ii. Heqja e normës së akcizës në mazut;
- iii. Ndryshim/plotësimi i listës së produkteve që i nënshtrohen normës 0 për qind apo normës së reduktuar 8 për qind të TVSH-së;
- iv. Udhëzimi Administrativ për Pushimet Tatimore;
- v. Nxjerrja e akteve të nevojshme legislative për kushtet e veçanta të evidentimit, kontrollit dhe shënjjimit të miellit i cili vendoset në qarkullim të lirë në tregun e Republikës së Kosovës;
- vi. Nxjerrja e akteve të nevojshme legislative për kushtet e caktuara nën të cilat pranohen (njihen) humbjet nga prishja, avullimi apo humbja e peshës së naftës dhe produkteve të saj;
- vii. Krijimi i kodeve të reja doganore për disa produkte, sipas praktikave të BE-së

Programi i Reformave Ekonomike: Në përputhje me agjendën e integritit evropian, Ministria e Financave në janar 2016 ka dorëzuar "Programin për Reforma në Ekonomi 2016" në Komisionin Evropian. Ky dokument është bazë për vlerësimet për raportin e progresit të Komisionit Evropian.

7. Programi me Fondin Monetar Ndërkombëtar

Kosova është në program me FMN nga muaji korrik 2015. Të gjitha kriteret e programit janë përmbushur me sukses dhe në afat nga Ministria e Financave. Në masat dhe reformat strukturore të parapara në program me FMN janë:

- (i) rregulla për pagat në sektorin publik, e aprovuar në fillim të vitit 2016 nga Kuvendi përmes ndryshimit të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;
- (ii) aprovimi i klauzolës së investimeve nga Kuvendi, ku i lejohet Qeverisë të financoj projekte me interes publik përmes huamarrjes mbi nivelin e deficitit prej 2%. Kjo i ka mundësuar Qeverisë të planifikojë projekte të mëdha kapitale për vitin 2017 e tutje,
- (iii) Agjencia Qendrore e Prokurimit ka kompletuar procesin e prokurimit për tri produktet/shërbime bazike, që mbulojnë një numër të konsiderueshëm të organizatave buxhetore, dhe ka zgjeruar listën e mallrave dhe shërbimeve përmes prokurimit të centralizuar në të ardhmen.

8. Disiplina, menaxhimi dhe transparenca buxhetore

Ministria e Financave në baza mujore ka raportuar në Qeveri për të hyrat dhe shpenzimet, përfshirë gjendjen e projekteve kapitale. Këtë vit Ministria e Financave për herë të parë ka përgatitur skemën vendore për certifikimin e auditorëve të brendshëm, e cila është akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe deri më tani janë certifikuar 105 auditor të brendshëm në sektorin publik ndërsa të tjerët janë në proces. Me rastin e rishikimit të buxhetit në korrik 2016, për herë të parë është rritur parashikimi i të hyrave dhe si rezultat janë shtuar projekte të reja kapitale. Ministria e Financave ka marrë vlerësim të lartë nga Departamenti i Shtetit për Transparencën Buxhetore. Gjatë vitit 2016, Agjencia Qendrore e Prokurimit ka kryer 49 aktivitete të prokurimit, përfshirë prokurimet e centralizuara. Janë nënshkruar kontrata në vlerë prej 44.7 mil euro, krahasuar me vlerën e parashikuar prej 51 mil euro. Kjo i ka kursyer buxhetit të shtetit 6.3 mil euro.

9. Reforma e Administratës Publike

Në kuadër të Reformës së Administratës Publike (RAP) shtylla e tretë, MF ka hartuar Strategjinë e Reformave në MFP (Menaxhimi i Financave Publike). Bazuar në të gjeturat e vlerësimit të PEFA, SIGMA raportit TADAT të FMN-së dhe Raportit të ZAP për vitin 2014, Ekipi i përkrahur nga OECD/SIGMA ka analizuar sfidat e dala, ka identifikuar katër fushat ku kërkohet intervenim dhe ka përgatitur aktivitetet për 12 prioritetet e dakorduara. Draft strategjia është shpërndarë pjesëmarrësve në takimet konsultative të mbajtura më 26-27 Prill 2016 me shoqërinë civile dhe partnerët zhvillimorë. Vlen të theksohet se është përgatitur dhe është mbajtur sesioni i parë i dialogut për MFP, në nivel operacional dhe teknik, më 01 Qershor 2016. Pas konsultimeve me Zyrën e BE, nisur nga përmbajtja e takimit të parë të Dialogut për MFP, në takimin e Qeverisë së datës 29.06.2016 është aprovuar Strategjia e Reformës në MFP dhe Plani i veprimtimit. Strategjia për Reformën e MFP-së është prezantuar në takimet e rregullt të Grupit të Veçantë për Reformën e Administratës Publike të mbajtur më 02 Qershor dhe më 02 Dhjetor 2016.

10. Marrëveshjet financiare ndërkombëtare

Janë nënshkruar 5 marrëveshje për kredi në vlerë prej 182.5 milion euro:

- (i) marrëveshja me KfË për projektin për masat e Efiçencës në Energji në nivel komunal (pjesa e kredisë 2.5 mil euro);
- (ii) Protokollin Financiar me Qeverinë Franceze në vlerë prej 66 mil euro kredi për impiantin e ujërave të zeza në Prishtinë;
- (iii) marrëveshja me Qeverinë e Hungarisë për themelimin e programit kornizë për bashkëpunim financiar në vlerë prej 62 mil euro kredi;
- (iv) marrëveshja për ndryshimin e marrëveshjes për bashkëpunim financiar me qeverinë Austriake në vlerë prej 30 milionë euro kredi;
- (v) marrëveshja me Bankën Botërore për rehabilitimin e kanalit të Ibër-Lepencit në vlerë prej 22 mil euro kredi (në proces të nënshkrimit/ratifikimit);

Janë nënshkruar 4 marrëveshje për grante në vlerë prej 88.5 milion euro:

- (i) marrëveshja me KfË për projektin për masat e Efiçencës në Energji në nivel komunal (pjesa e grantit 5 mil euro);
- (ii) marrëveshja për asistencë teknike me Qeverinë Federale të Gjermanisë për vitin 2014 dhe 2015 në vlerë prej 20 mil euro grant;
- (iii) Minutat e Takimit me Qeverinë Gjermane për periudhën 2016-2017 në vlerë prej 46.9 mil euro grant;
- (iv) Marrëveshja me KfË dhe Qeverinë Zvicerane për projektin për trajtimin e ujërave të zeza në Pejë në vlerë prej 16.6 mil euro grant;

Janë nënshkruar 2 garanci shtetërore prej 34 mil euro për institucione/ndërmarrje publike:

- (i) marrëveshja e garancisë shtetërore për projektin Trafiku Urban i Prishtinës në vlerë prej 10 mil euro si garanci shtetërore;
- (ii) marrëveshja e garancisë shtetërore për linjën e re kreditore të FSDK-së në vlerë prej 24 mil euro si garanci shtetërore (në proces të nënshkrimit/ratifikimit);

11. Marrëveshjet për eliminim të tatimit të dyfishtë

Ministria e Financave gjatë vitit 2016, ka përfunduar negociatat me Zvicrën. Gjithashtu, është mbajtur raundi i parë i negociatave me Austrinë. Janë iniciuar shkresat përcjellëse për fillimin e negociatave me shtetet si;

Gjermania, Franca, Danimarka, Bullgaria, Luksemburgu, Suedia Mali i Zi dhe Itali. Në vitin 2016 është nënshkruar marrëveshja me Qeverinë e Emirateve të Bashkuara Arabe.

12. Letrat me vlerë

Janë mbajtur 19 ankande për shitjen e Letrave me Vlerë. Janë ngritur 100 milionë euro për financimin e buxhetit dhe 320 milion euro për ri-financimin e maturimeve. Është zgjatur koha mesatare e maturitetit si rezultat i emetimit të instrumenteve 3 vjeçare dhe 5 vjeçare. Është shtuar interesimi i personave privat për Letra me Vlerë, duke dyfishuar pozicionin e tyre krahasuar me vitin paraprak në total prej 17 mil euro.

13. Këshilli Kombëtar për Investime

Këshilli Kombëtar për Investime ka mbajtur 5 takime të rregullta, ku ka aprovuar 20 projekt të ndryshme me vlerë totale rreth 900 mil euro kredi dhe grante. Ministria e Financave, pas aprovimit të projekteve këto Këshill, bazuar në ligjet në fuqi ka filluar identifikimin e burimeve të financimit. Si rezultat, gjatë këtij viti janë nënshkruar 14 marrëveshje dhe janë negociuar apo janë në procedura të nënshkrimit edhe 6 marrëveshje.

14. Komiteti për Partneritet Publik-Privat

Komiteti për Partneritet Publik Privat ka mbajtur 7 takime të rregullta, ku ndër të tjera janë marrë këto vendime: ndërtimi i mbikalimit në Mitrovicë; qendra e turistike BOREA në Pejë; procedimi në Qeveri i projekteve ENVIDITY dhe SHARRCEM etj.

15. Krijimi i Agjencisë së Tatimeve dhe Doganës së Kosovës

Me Programin e Qeverisë për 2015-2018, është planifikuar që të bëhet unifikimi i ATK-së dhe Doganës. Deri më tani është draftuar dhe proceduar për në Qeveri Projektligji për Agjencinë e Tatimeve dhe Doganës së Kosovës dhe është hartuar plani detal për themelimin e Agjencisë. Ky proces është përkrahur me ekspertizë nga FMN, GIZ, Komisioni Evropian dhe Ambasada Britanike.

16. Buxheti për 2017

Është përgatitur buxheti për 2017 në linjë me objektivat e Qeverisë për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe qëndrueshmëri fiskale. Buxheti arrin që t'i financojë kërkesat me prioritet të secilës organizatë buxhetore dhe njëkohësisht ta ruaj stabilitetin buxhetor. Të hyrat për 2017 janë planifikuar 1 miliard e 725 mil euro, 6% më shumë se 2016 dhe 17% më shumë se 2015. Shpenzime janë planifikuar 2 miliard euro, një rritje prej 15% krahasuar me 2016 dhe 28% me 2015. Rritja më e madhe është tek investimet kapitale prej 46% krahasuar me vitin 2016. Buxhet ka pajtimin e plotë të Fondit Monetar Ndërkombëtar në të gjitha pozicionet kryesore buxhetore. Të gjitha komunat e Kosovës, përfshirë komunat në veri të vendit, i kanë aprovuar buxhetet e tyre sipas qarkoreve buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave. Sistemi SIMFK i Thesarit tani është shtrirë në të gjitha komunat pa përjashtim, dhe po bëhen përpjekje për shtrirje të aktiviteteve për inkasim të tatimit në pronë edhe në komunat në veri.

- **MINISTRIA E FORCËS DHE SIGURISË SË KOSOVËS**

Përmbushja e programit legjislativ me procesin e plotësimit/ndryshimit dhe hartimit të akteve të planifikuara - MFSK ka ndjekur të gjitha procedurat për ndryshimin e kuadrit ligjor ekzistues mbi bazën e rekomandimeve të dala nga RSSS. Ndryshimet dhe plotësimet e legjislacionit ekzistues janë riproceduar si pjesë e pakos së Projektligjit për ndryshimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura të Kosovës. Pas rishqyrtimit të tërësishëm të draftit të këtij projektligji në nivel ndërinstytucional, MFSK ka organizuar dhe realizuar edhe Dëgjimin Publik me institucione dhe me OJQ të ndryshme që në fokus të tyre kanë sferën e sigurisë. Në pajtim me dispozitat përkatëse, procedurat e vendimmarrjes së Qeverisë si dhe rregullat dhe procedurat për hartimin e legjislacionit dhe rekomandimeve të politikave nga Qeveria dhe ministritë, MFSK, këtë projektligj, në muajin Tetor të këtij viti e ka riproceduar për miratim në Qeveri.

2.Procesi i implementimit të politikave qeveritare si dhe zhvillimi dhe koordinimi i politikave sektoriale dhe nënsektoriale - MFSK, në kuadër të procesit të zhvillimit dhe koordinimit të politikave sektoriale, ndërsektoriale dhe nënsektoriale gjatë vitit 2016, ka vazhduar procesin e rishikimit të pakos së dokumenteve strategjike si instrument të funksionimit sipas misionit aktual dhe ka vazhduar angazhimin në procesin e përgatitjes së draft- dokumenteve strategjike, doktrimore dhe planifikuese për misionin e ri.

3.Avancimi i mëtejshëm i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare - Gjatë këtij viti, MFSK nga prioritetet sektoriale kyçe ka pasur në fokus angazhimin në *avancimin e mëtejshëm të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore* në bashkëpunim të ngushtë dhe me mbështetje nga partnerët amerikanë (Defense Institution

Building- DIB) dhe Defense Institutional Reform Initiative- DIRI) , në kuadër të Projektit “Mbështetje të Zhvillimit të Personelit në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës” të financuar nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes (Centre for Integrity in the Defence Sector- CIDS) e Ministrisë së Mbrojtjes së Norvegjisë. Krahas angazhimit në hartimin e Strategjisë së MBNJ , MFSK, i ka kushtuar kujdes të vazhdueshëm procesit të rishikimit të akteve nënligjore ekzistuese si dhe zhvillimit dhe hartimit të politikave të reja sipas standardeve bashkëkohore të MBNJ në kuadër të procesit përgatitor për misionin e ri të Ministrisë dhe Forcave.

Edhe gjatë këtij viti kemi vazhduar me *zhvillimin profesional të burimeve njerëzore*. Pjesëtarët aktiv kanë vazhduar me shkollime profesionale dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit. Ka vazhduar me sukses zhvillimi dhe edukimi i kadetëve në QSU dhe kadetëve që vazhdojnë studimet ushtarake në AU në SHBA, Gjermani, Turqi, Kroaci dhe Maqedoni. Numri aktual i kadetëve që studiojnë në QSU dhe akademitë e ndryshme jashtë vendit është 91. Poashtu në këtë vit kanë diplomuar 14 kadetë – oficerë: 9 kadetë nga QSU, 4 nga AU e Maqedonisë si dhe 1 nga AU në Turqi. Personeli civil dhe ushtarak edhe në këtë vit kanë ndjekur dhe marrë pjesë në konferenca, seminare dhe trajnime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Personeli aktiv dhe personeli i komponentës rezervë të FSK-së, me sukses ka zhvilluar 75 trajnime jashtë vendi me pjesëmarrje të 140 pjesëtarëve si dhe trajnime përkatëse të planifikuara për këtë vit. Duke pasur për bazë planifikimet vjetore të parapara për vitin 2016, MFSK, edhe përgjatë vitit 2016 ka vazhduar me *procesin e rekrutimit të personelit*, me qëllim të përmbushjes së kapaciteteve të nevojshme me personel.

Proces me rëndësi të veçantë vazhdon të mbetet *rekrutimi cilësor i kadetëve të rinj* dhe shkollimi i tyre në QSU të FSK-së si dhe në akademitë ushtarake të shteteve partnere. Në vazhden e këtij angazhimi, gjatë vitit 2016, në pajtim me nevojat e FSK-së, është realizuar fushata e rekrutimit të kadetëve të cilat kanë rezultuar me përzgjedhjen e 31 kadetëve (26 meshkuj dhe 5 femra), prej të cilëve 4 janë nga radhët e komuniteteve joshumicë. QSU e FSK-së- 17, prej të cilëve njëri nga FA Rep. së Shqipërisë; AUT në Rep. të Turqisë- 3; AUM në Rep. e Turqisë- 2 ; AU Rep. së Maqedonisë - 2 ; Kolegji Mjekësor i Nënoficerëve në Rep. e Turqisë- 1 ; AU të Rep. së Gjermanisë- 3; AU e Rep. e Kroacisë- 1; AU “Ëest Point” në SHBA- 2 kadetë. Në pajtim me Planin Vjetor të Veprimit për vitin 2016, Planprogramin e trajnimit të pjesëtarëve rezervë për vitin 2016, dhe Urdhrin e Komandantit të FSK-së “Për trajnimin dhe angazhimin e pjesëtarëve të komponentës rezervë në njësitë e tyre” si dhe në Ushtrimin fushor “Shqiponja 5”, gjatë këtij viti janë angazhuar dhe trajnuar 369 pjesëtarë të komponentës rezervë.

Strukturat e *menaxhimit të mbështetjes logjistike dhe resurseve materiale* krahas detyrave dhe përgjegjësiive të përhershme dhe intenzive kanë vazhduar me zhvillimin e mëtejshëm të politikave të reja në funksion të fuqizimit të sistemit dhe menaxhimit të burimeve përkatëse. Gjatë vitit fiskal 2016 janë zhvilluar 154 *aktivitetet e prokurimit* konform kërkesave të njësisë kërkuese dhe në përputhje me planin e prokurimit duke nënshkruar gjithsej 90 kontrata me vlerë të madhe, të mesme, të vogël dhe minimale. Sipas planit të prokurimit, është realizuar *procesi i blerjeve, prokurimit dhe kontraktimit me pajisje specialistike, automjete, pajisje dhe makineri ushtarake, mallra dhe shërbime të mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve dhe automjeteve* duke veçuar : pajisjet operacionale fushore, pjesët rezervë për armë, pajisjet për çminim (deminim), municion, rimorkio për materie të rrezikshme, automjete për transportim të personelit, 3T Pirunjer, automjete jotaktike etj. Të kontraktuara dhe në pritje të furnizimit sipas planit kemi : Automjete taktike të terrenit; Automjete taktike të blinduara (APV); pushkë të standardizuara, autoblanda, autoambulanca, pajisje për kërkim-shpëtim, kamion për tërheqje 5T. Gjatë vitit buxhetor 2016 , në kazernat e FSK-së janë realizuar *projekte të rëndësishme infrastrukturore ku janë krijuar kushte më të mira për punë, mësim, trajnime dhe akomodim të pjesëtarëve të FSK-së*.

Projekte të cilat kanë filluar në vitin paraprak (2015) dhe kanë përfunduar gjatë vitit 2016 ishin gjithsej 9 projekte. Projekte kapitale në infrastrukturë të cilat kanë filluar në vitin 2015 dhe vazhdojnë edhe në vitet tjera janë dy projekte në proces (2015-2017) . Edhe gjatë vitit 2016 si rezultat i procesit tani më të organizuar me shtetet partnere në kuadër të Konferencës “FSK dhe Partnerët” janë ofruar *donacionet e zotuar në pajisje dhe projekte infrastrukturore nga miqtë donatorë* si në vijim: Qeveria amerikane: Pajisje të kërkim- shpëtimit (SAR) , asgjësimit të mjeteve të pashpërthyer dhe deminimit humanitar (EOD), Mbrojtjes Kimike, Atomike dhe Biologjike (HAZMAT) dhe pajisje të komunikimit, në vlerë të përgjithshme prej 10,825,037.67 \$; Qeveria gjermane: Automjete të përdorura, pjesë

rezervë dhe pajisje për mirëmbajtje në vlerë të përgjithshme prej 27,985 €; Qeveria holandeze: Pajisje për mbushjen e baterive në vlerë të përgjithshme prej 7,500 € dhe Fondi i Mirëbesimit (Trust fund) : Ndërtimi i aneksit të Servisit të automjeteve dhe renovimi i servisit aktual në Kazermën e FSK-së në Prishtinë në vlerë të përgjithshme prej 233,752.89 €.

Gjatë vitit 2016 me qëllim të zhvillimit, profesionalizimit dhe mbajtjes së kapaciteteve dhe gatishmërisë operationale të komunikimit në FSK, në kuadër të rrjetit të komunikimit me radio pajisjeve taktike, Qeveria e SHBA-së ka dhuruar donacion-pajisje në vlerë prej 9.2 milion \$ me zgjerimin e kapaciteteve të sistemeve të komunikimit në mbështetje të sistemeve të C2, C3 dhe C4. Më qëllim të ngritjes së kapaciteteve për siguri kibernetike në MFSK dhe FSK, në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e ekspertëve të Gardës Kombëtare të IOËA-s (FA të SHBA-së) janë identifikuar rreziqet dhe dobësitë e mundshme në rrjetin e FSK-së.

Në funksion të zbatimit të politikës përkatëse gjatë kësaj periudhe në harmoni me Strategjinë Shtetërore për Sigurinë Kibernetike është hartuar edhe Strategjia për Siguri Kibernetike në MFSK dhe FSK. Me qëllim të mirëmbajtjes së nivelit të lartë të gatishmërisë operationale dhe ngritjes cilësore të burimeve njerëzore është zhvilluar procesi i ekzaminimeve mjekësore për të gjithë pjesëtarët e FSK-së dhe kadetët e QSU-së, krahas shqyrtimit sistematik të të gjitha rasteve mjekësore me rekomandimet përcjellëse profesionale për rastet përkatëse. Bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit në mes të MFSK-së dhe SHP të FA të Rep. së Turqisë deri më tash në Akademinë Mjekësore Ushtarake (GATA) të Turqisë deri më tash për trajtim mjekësor janë dërguar 38 pacientë, 7 prej të cilëve gjatë vitit 2016, ndërsa 9 raste janë në procedurë për dërgim.

Sikur edhe në vitet e mëparshme, MFSK dhe FSK, si rezultat i planit të analizuar, vlerësuar dhe përcaktuar mirë me kufijë dhe linja në përputhje të plotë me objektivat dhe prioritet e përcaktuara të lidërshiptit të saj , është në prag të përmbylljes së suksesshme të *buxhetit për vitin 2016*. Bazuar në procesin e planifikuar të shpenzimit të buxhetit në të gjitha kategoritë ekonomike gjatë tërë vitit fiskal dhe procesit aktual bashkë edhe me deklaratimet për kursime buxhetore, mundësojnë parashikimin e qëndrueshëm të realizimit të përgjithshëm të buxhetit në shkallën mbi 95 % .

4. Mirëmbajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe aftësive aktuale operationale - FSK edhe gjatë këtij viti me sukses ka arritur të mirëmbajë dhe të avancojë cilësinë e gatishmërisë operationale në personel, pajisje, infrastrukturë, trajnime etj. Gjatë këtij viti *operacionet e deminimit* kanë filluar me datën 28 mars dhe kanë përfunduar më datë 30 nëntor 2016. Njësitë e FSK-së kanë zhvilluar operacionet e deminimit humanitar në pesë lokacione : Ferizaj brenda kazermës së FSK-së, Zagrimle, Hoçë të Qytetit, Paldenicë dhe në Parkun e Lirisë në Ferizaj. Njësitë e EOD-së së FSK-së kanë intervenuar në 293 raste dhe ka demoluar 356 mjete të ndryshme eksplozive. Njësitë e deminimit kanë arritur të pastrojnë 242,840 metra katrorë, operacion gjatë të cilit janë gjetur 72 mjete të ndryshme eksplozive të pashpërthyer.

Përveç njërive që zhvillojnë operacionet e deminimit humanitar, FSK ka edhe dy njësi kujdestare pandërprerë gjatë 24 orëve në të gjitha ditët e javës për intervenime në raste të njoftimit nga qytetarët të cilët hasin në mjete të ndryshme të paeksplojuara. Në kuadër të bilancit të përgjithshëm vjetor të raportuar nga Qendra e Situatave të MFSK-së gjatë vitit 2016, kemi këto të dhëna mbi numrin e operacioneve dhe projekteve që kanë realizuar njësitë e specializuara të FSK-së: Operacione të Kërkim-shpëtimit, vërshime dhe incidente - 13; Inspektimet e Njësisë së Mbrojtjes Kimike, Atomike dhe Biologjike (MKAB) -24; Vlerësimi i rreziqeve të mundshme nga Njësia Ndërlidhëse e Reagimit në Kriza (NJNRK) - 67; Zjarrëfikje nga Regjimenti i Mbrojtjes Civile (RMC) -1; Zhblllokim i rrugëve nga bora nga Batalioni i Xhenios (BXH) - 4.

5.Realizimi i suksesshëm i planit vjetor të trajnimeve dhe ushtrimeve brenda dhe jashtë vendit - Bazuar në *planin vjetor të trajnimeve* me institucionet vendore janë planifikuar dhe realizuar 14 trajnime e në proces janë duke u realizuar edhe 11 trajnime me institucione vendore. Nga numri i trajnimeve individuale me Ekipet Mobile Trajnuese Bilaterale dhe KFOR-it janë realizuar me GK të IOËA-s dhe KFOR-in amerikan -22, Britaninë e Madhe -6, Turqinë-4,

KFOR-in-4 dhe Slloveninë -1. Nga trajnimet e planifikuara jashtë vendit, gjatë vitit 2016 janë realizuar 165 trajnime e në proces janë duke u realizuar edhe 72 trajnime tjera. Stërvitjet jashtë vendit: "Kampi Veror 2016" -Maqedoni, "Immediate Response-16"- Slloveni/Kroaci, "Joint Effort 16"-Shqipëri, "Cambrian Patrol"- Britani e Madhe, "Combined Resolve ' 16"- Gjermani. Më 28 shtator, Forca e Sigurisë së Kosovës(FSK), në kazermën „Evropianët e rinj” të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, në Bardh të Vogël (Pomozatin), përuroi *Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim*, e para e këtij lloji në rajon. Krahas suksesit të Rreshtermajor Genc Metaj, Toger Manushaqe Nurës, ekipit të parashutistëve të FSK-së, më 22.10.2016, Skuadra e Brigadës së Reagimit të Shpejtë të FSK-së është dekoruar me Medaljen e artë në një ndër ushtrimet më sfiduese dhe më prestigjioze në botë „Cambrian Patrol” në Ëells të Mbretërisë së Bashkuar.

6. Thellimi i mëtejshëm i bashkëpunimit civil-ushtarak dhe forcimi i marrëdhënieve me institucionet vendore dhe ndërkombëtare - MFSK dhe FSK, në kuadër misionit të saj, përmes strukturave të bashkëpunimit civil dhe ushtarak edhe gjatë këtij viti , ka vazhduar me intenzitet angazhimin në realizimin e shumë projekteve humanitare, të cilat kanë ndikuar fuqishëm në forcimin e mëtejshëm të imazhit të FSK-së në mesin e qytetarëve të vendit. Gjatë vitit 2016 janë realizuar: *9 projekte humanitare infrastrukturore, 35 operacione mbështetjeje për komunitetin dhe institucionet vendore dhe OJQ-të.* Ekipet mjekësore të FSK-së, krahas detyrimeve të përditëshme, kanë vazhduar me realizimin e *projektit humanitar të përmuajshëm, duke ofruar asistencë mjekësore dhe barna esenciale për komunitetin serb në fshatrat e komunës së Istogut, si Dragolevc, Serbobran, Zallq dhe Gurakoc.* Angazhimi i ekipeve mjekësore të FSK-së me profesionalitet e seriozitet të lartë çmohet lartë edhe nga banorët serbë lokal, të cilët për një kohë të gjatë falas pranojnë këto shërbime shëndetësore. Strukturat e menaxhimit të sistemit mjekësor dhe atij të bashkëpunimit civilo-ushtarak të MFSK-së në koordinim me strukturat e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës (QKTGJK) kanë vazhduar traditën e organizimit të përvjetshëm (gjatë muajit shkurt dhe gusht) të *aksionin humanitar për dhurimin vullnetar të gjakut.* Kjo traditë ka rezultuar si edhe herave tjera me përgjigje masive nga ana e zyrtarëve të MFSK-së si dhe oficerëve, nënoficerëve dhe ushtareve të FSK-së duke dhuruar gjithsej 1245 doza të gjakut për nevoja të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës. Nga 15 janar deri më 4 shkurt 2016, instruktorët e deminimit, përveç operacioneve të deminimit, kanë realizuar edhe mbajtjen e ligjëratave nëpër shkolla fillore dhe ato të mesme për vetëdijësimin e nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyer në Republikën e Kosovës.

7.Fuqizimi i kontrollit të brendshëm, transparencës, llogaridhënies dhe integritetit institucional - Në pajtim me ligjin, Kuvendi i Republikës së Kosovës edhe gjatë vitit 2016 në kuadër të kompetencave të veta ligjore ka ushtruar *kontrollin demokratik parlamentar* mbi MFSK-në dhe FSK-në përmes Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së dhe Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme në Kuvendin e Republikës së Kosovës. *Struktura e brendshme audituese*, në kuadër të aktivitetit zyrtar edhe gjatë vitit 2016 , në përputhje me planit të saj ka vazhduar zbatimin me dhënie e këshillave dhe nxjerrjen e rekomandimeve për subjektet e audituara në funksion të përmirësimit të punës dhe në përmbushjen e aktiviteteve.

Me qëllim të ngritjes së vazhdueshme profesionale të burimeve të saja njerëzore në hap me ndryshimet dhe standardet si dhe të mbikëqyrjes në kryerjen e detyrimeve profesionale dhe ligjore, MFSK dhe FSK ,përmes *Inspektoriatit të FSK-së* sistematikisht ka mbikëqyrrur saktësinë, efektshmërinë dhe zbatueshmërinë e të gjitha detyrimeve ligjore në të gjitha nivelet e strukturës së MFSK dhe FSK-së përmes inspektimeve. MFSK, edhe këtë vit i ka kushtuar rëndësi *procesit të menaxhimit të aktiviteteve administrative të zyreve* në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse, ofrimit të shërbimeve cilësore në lekturimin, përkthimin dhe arkivimin e të gjitha dokumenteve të paklasifikuara dhe atyre të klasifikuara.

Strukturat për marrëdhënie me publikun, gjatë të vitit 2016, kanë prezantuar punën e MFSK-së dhe FSK-së duke qenë të hapur, transparent , korrekt dhe bashkëpunues me mediet në çdo kohë. Kujdes dhe përkushtim veçantë, përveç monitorimit dhe raportimit në media të aktiviteteve të MFSK/FSK-së i është kushtuar edhe mirëmbajtjes dhe azhurnimit me informacionet e nevojshme të ëeb-faqes së MFSK-MKBS-MKSF (<http://ëëë.mksf-ks.org/>),pastaj Facebook, Flicker dhe Tëitter, përgatitjes së spoteve informuese për ngjarje të veçanta. Publikimet me karakter

informues të vazhdueshëm janë përmbledhur edhe në gazetën periodike mujore “Forca Jonë”, gazetën elektronike mujore „Neësletter”. Edhe këtë vit ka vazhduar pjesëmarrja në cilësinë e trajnerëve (dy zyrtarë) në trajnimet periodike (3 cikle) krahas trajnimeve të pjesëtarëve të MFSK-së dhe FSK-së në Qendrën Rajonale për Marrëdhënie me Publikun (Public Affairs Regional Centre -PARC) në Maqedoni. Informimi me kohë dhe transparenca në komunikim me mediat me qëllim të informimit sa më të shpejt dhe objektiv, ka bërë që Institucioni i MFSK/FSK të jetë institucioni i sigurisë më i besueshëm në vend, në të gjitha matjet e opinionit publik, në pesë vitet e fundit në Republikën e Kosovës. Pra edhe këtë vit,

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) vazhdon të jetë ndër institucionet më të besueshme në Kosovë, sipas të dhënave të publikuara nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) me temën: “Monitorimi i Sektorit të Sigurisë së Kosovës: nëntor 2015 - mars 2016”. *Plani i Integritetit të MFSK-së (2016-2018)* që është hartuar gjatë vitit 2016, në përkrahje të Qeverisë së Norvegjisë, është lansuar në korrik 2016 që nënkupton edhe fillimin e implementimit të aktiviteteve që përkufizohen në intervalin kohor brenda vitit përkatës. Ky plan, MFSK-në e identifikon si institucionin e parë në kuadër të dikastereve të Qeverisë së Republikës së Kosovës që ka hartuar dhe zhvilluar një politikë të tillë. MFSK, përmes njësisë së saj të protokollit, ka realizuar një gamë të madhe të *aktiviteteve protokollare* si brenda Ministrisë dhe Forcës gjithashtu edhe në organizime të larta të protokollit shtetëror.

8. Vazhdimi i aplikimit cilësor të politikave jodiskriminuese për personelin e Ministrisë dhe Forcës - MFSK dhe FSK që nga themelimi ka krijuar infrastrukturën ligjore, e cila garanton *pjesëmarrje e barabartë të femrave dhe meshkujve, pozitë të barabartë dhe mundësi të barabarta për të gjithë pa dallim etnie apo gjinie*. Perspektiva gjinore në MFSK dhe FSK është një dimension jetësor, tashmë i shtrirë edhe në objektivat e Ministrit të MFSK-së si dhe në politikat dhe në planet sektoriale në të gjitha nivelet dhe strukturat e organizimit të MFSK-së dhe FSK-së.

Femrat në FSK janë duke luajtur rol të jashtëzakonshëm që po e afirmojnë FSK-në si organizatë bashkëkohore e sigurisë e ndërtaur dhe funksionale në përputhje me standardet e vendeve anëtare dhe atyre partnere të NATO-s. Aktualisht në Forcën e Sigurisë së Kosovës, janë të inkuadruara 206 femra në pozita të rëndësishme komanduese e drejtuese në të gjitha nivelet e organizimit. Njësisë për të Drejtat e Njeriut me qëllim të ngritjes së transparencës, ka vazhduar monitorimin e proceseve rekrutuese që kanë për qëllim ofrimin e mundësive të barabarta për të gjithë pa dallim gjinie apo etnie dhe pas çdo procesi ka përgatitur raportet e veçanta me përparësitë dhe mangësitë e procesit dhe duke dhënë rekomandimet për vendimmarrësit.

Promovimi medial i femrës dhe barazisë gjinore në MFSK dhe FSK ka vazhduar edhe gjatë këtij viti, duke veçuar tryezën e organizuar nga NJDNJ e mbështetur nga Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (Democratic Control of Armed Forces-DCAF) e cila është mbajtur në prag të 10 dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. *Zyra për Çështje të Komuniteteve* në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës edhe gjatë vitit 2016, ka vazhduar me rezultate të mira në mbështetje të procesit të integritetit të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në Forcën e Sigurisë së Kosovës si dhe zhvillimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë.

Një nga aktivitetet kryesore të Zyrës për Çështje të Komuniteteve të parashikuar me planin ishte organizimi dhe realizimi i takime të rregullta vjetore me pjesëtarët e komuniteteve pakicë në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Këto takime edhe gjatë kësaj periudhe kanë ofruar mundësinë për të u njoftuar dhe vlerësuar me situatën reale në zbatimin dhe respektimin e të drejtave të pjesëtarëve të FSK-së nga radhët e komuniteteve joshumicë, gjetjen e zgjidhjeve për problemet praktike të tyre, monitorimin e zbatimit të masave të ndërmarra nga MFSK-së në funksion të të drejtave të tyre si dhe krijimit të komunikim sistematik dhe efektiv me ta. Zyra për Çështje të Komuniteteve ka punuar në fushatën e informimit për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë në Kosovë dhe mundësitë e aplikimit për kadetë në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Informimi ka përfshirë komunitet me komunitetet joshumicë në tërë Kosovën.

Nga ky proces ka rezultuar që në studimet akademike në AU të Republikës së Maqedonisë kanë filluar vijimin dy pjesëtarë të komuniteteve joshumicë: një serbe dhe një boshnjak, kurse në QSU në Prishtinë është pranuar një pjesëtarë nga komuniteti boshnjak. Më 10 Tetor 2016 në Akademinë Ushtarake të FA të Rep. së Maqedonisë diplomuan për herë të parë katër kadetët e FSK-së, dy nga komuniteti serb dhe dy nga ai boshnjakë. Kjo është gjenerata e parë e të diplomuarëve nga radhët e komunitetit joshumicë nga FSK. Bazuar në Politikën e për integrimin e komuniteteve joshumicë të miratuar nga ana e Ministrit të FSK-së, Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së me vendim të posaçëm ka ngritur Grupin punues për hartimin e Strategjisë së Integritit të Komuniteteve Joshumicë i cili ka hartuar draftin e parë të Strategjisë dhe sipas planit paraprak kjo strategji do të finalizohet në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm.

9. Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe avancimi i procesit drejtë integritimeve në iniciativat dhe organizatat ndërkombëtare - Edhe gjatë vitit 2016, Ministri i FSK-së, Komandanti i FSK-së dhe Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së në kuadër të përgjegjësive ligjore të tyre kanë vazhduar intenzivisht aktivitetet në përfaqësimin ndërkombëtar gjatë gjithë vitit me vizita zyrtare dhe pune, pjesëmarrje në konferenca në nivel ministrash të mbrojtjes dhe shefave të mbrojtjes.

Gjithashtu edhe vizitat e shumta dhe pritjet e personaliteteve dhe delegacioneve të niveleve të ndryshme dëshmojnë për reputacionin e lartë që gëzon institucioni i MFSK dhe FSK-së bashkë me leadershipin e saj në arenën ndërkombëtare. MFSK, më 10.06.2016 ka nënshkruar "Marrëveshjen e bashkëpunimit bilateral ndërmjet Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Hungarisë".

Gjatë kësaj periudhe është koordinuar implementimi i planeve bilaterale për vitin 2015 dhe 2016 me të gjitha vendet me të cilat MFSK ka të nënshkruara planet përkatëse si SHBA-në, Shqipërinë, Kroacinë, Maqedoninë, Gjermaninë, Turqinë, Britaninë e Madhe, Lituaninë, Holandën dhe Slloveninë. Gjatë kësaj periudhe raportuese, me qëllim të sinkronizimit të mbështetjes së përgjithshme të ofruar për FSK-në nga partnerët bilateral dhe NATO, MFSK së bashku me strukturat e partnerëve në Prill dhe Tetor ka organizuar konferencat e përbashkëta me titullin "FSK dhe Partnerët". Gjatë kësaj periudhe janë realizuar edhe shumë takime me atashetë e akredituar në Kosovë dhe për Kosovën si dhe me përfaqësuesit tjerë të ambasadave të huaja që mbulojnë fushën e sigurisë. Këtë vit, MFSK ka ftuar për pjesëmarrje të njëjësive ushtarake të shteteve partnere në ushtrimin fushor të FSK-së "Shqiponja 5". Në këtë ushtrim kanë marrë pjesë US Army Europe (USAREUR), IOËA National Guard dhe SATM Team me ekipet e tyre si dhe në cilësinë e vëzhguesit kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Shqipërisë, Kroacisë, Maqedonisë dhe Sllovenisë. Strukturat përgjegjëse kanë vazhduar koordinimin e të gjitha aktivitetet e planifikuara në kuadër të planeve bilaterale për vitin 2016, si më poshtë:

Realizimi i gjashtëmbëdhjetë trajnimeve për pjesëtarët e FSK-së në shkollat e NATO-s nga të cilat janë certifikuar 19 pjesëtarë; FA të Gjermanisë me 5 trajnime/6 pjesëtarë dhe 14 aktivitete të shkëmbimit të përvojave; në FA të Kroacisë me 6 trajnime/13 pjesëtarë dhe 12 aktivitete të shkëmbimit të përvojave; në FA të Republikës së Shqipërisë me 6 trajnime/8 pjesëtarë dhe 18 aktivitete të shkëmbimit të përvojave; në FA të Republikës së Turqisë me 15 trajnime; në FA të Britanisë së Madhe me 8 trajnime; në FA të Lituanisë me 1 trajnim; në FA të Holandës me 1 trajnim; në FA të Sllovenisë me 1 trajnim.

Strukturat përgjegjëse të MFSK-së përmes US ODC si organizatore ka koordinuar pjesëmarrjen e pjesëtarëve të FSK-së në trajnimet/seminaret të mbajtura në Kosovë, SHBA dhe vende të tjera. Planifikimi dhe realizimi i trajnimeve të mbajtura në SHBA, në shtetet tjera dhe në Kosovë nga stafi i IOËA-s kanë qenë rezultat i bashkëpunimit të vazhdueshëm të Gardës Nacional të IOËA-s, ODC-së dhe Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri (DBS) të MFSK-së. Nga ky partneritet, MFSK/FSK ka përfituar trajnime të këmbësorisë, logjistikës, transportit, komunikimit, MKAB-së, inteligjencës, mbrojtjes kibernetike por edhe donacione të ndryshme për njësitë e MKAB-së dhe njësitë e EOD-së. Trajnimet dhe seminarat që janë mbajtur në bashkëpunim me Gardën Nacionale të IOËA-s janë përqëndruar në: mbrojtjen kibernetike, menaxhimin e resurseve njerëzore, zhvillimin profesional ushtarak, ndërveprueshmërinë dhe dislokimin e forcave të kombinuara tokësore, zhvillimet strategjike, kapacitetet reaguese gjatë fatkeqësive natyrore, partneritetin dhe bashkëpunimin regional, kapacitetet

operacionale të logjistikës, zhvillimin e doktrinës, si dhe planifikimin dhe ekzekutimin e ushtrimeve fushore. Krahas këtyre aktiviteteve të shumta kanë qenë edhe vizitat e niveleve të ndryshme, qëllimi i të cilave ka qenë rritja e bashkëpunimit në fusha të ndryshme për zhvillimin e mëtejshëm të FSK-së.

10. Avancimi i mëtejshëm i procesit drejtë integrimi në iniciativat dhe organizatat ndërkombëtare - Gjatë kësaj periudhe raportuese, MFSK me përfaqësuesit e vet ka marrë pjesë në këto konferenca dhe iniciativa rajonale: Pjesëmarrja në konferencën inicuese, kryesore dhe finale planifikuese për ushtrimet "Immediate Response 16" dhe "Joint Effort 16; Takimi vjetor i drejtorëve të politikave të mbrojtjes në kuadër të A-5 Kartës së Adriatikut, zhvilluar më 15 Prill 2016 në Zagreb; Pjesëmarrja në konferencën e Programit të Partneritetit Shtetëror në Qendrën Evropiane për Studime të Sigurisë „George C. Marshall”, në Garmish të Republikës Federale të Gjermanisë më 20-22 Korrik 2016; Pjesëmarrja në konferencën e përbashkët për trajnime “Combined Training Conference” të organizuar nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë, në shkollën e NATO-s në Oberammergau të Gjermanisë më 25-29 korrik 2016; Pjesëmarrja në takimin vjetor të drejtorëve të politikave të mbrojtjes të organizuar në kuadër të Kartës së Adriatikut A-5, zhvilluar më 12 Nëntor 2016 në Zagreb të Kroacisë; Pjesëmarrja në Konferencën e 20-të “SHBA-Karta e Adriatikut A-5” e shefave të mbrojtjes, zhvilluar më 30 nëntor 2016 në Split të Kroacisë. Edhe gjatë këtij viti kanë vazhduar kontaktet dhe takimet e rregullta me Ministrinë e Punëve të Jashtme me qëllim të koordinimit të aktiviteteve dhe politikave të jashtme dhe të sigurisë. Fokusi qendror ka qenë vlerësimi i mundësisë për zgjerimin e përfaqësimit të FSK-së jashtë me atashë të sigurisë ose përfaqësues të fushës së sigurisë pranë ambasadave tona në vende të ndryshme, si dhe anëtarësimit në iniciativat rajonale (A5, RACVIAC, SEECP, RCC, etj.).

11. Vazhdimi i pjesëmarrjes në ushtrime të përbashkëta me vendet anëtare dhe partnere të NATO-s - Gjatë kësaj periudhe raportuese, MFSK me ekipet dhe njësitë e saj ka marrë pjesë në këto ushtrime fushore: “Kampin Veror 2016” të zhvilluar në Krivollak të Maqedonisë zhvilluar më 13 korrik 2016; “Vigilant Guard” të organizuar nga Garda Nazionale e IOËA-s më 14 - 20.11.2016; “The Search and Rescue Exercise - Sea Lion 2016”, 03 - 06 Maj 2016 në Turqi (status të vëzhguesit); “Stërvitja Luftarake e Përbashkët Simulative YILDIZ-2016”, 17 - 18 Maj në Turqi (status të vëzhguesit); “The Anatolian Eagle - 2016”, me 01- 02 Qershor 2016 në Turqi (status të vëzhguesit), “The Search and Rescue Exercise - Martyred Ensign Caner GONIYELI 2016”, 06 - 09 Qershor 2016 në Turqi (status të vëzhguesit); “ISIK - 2016”, 27 - 28 Qershor 2016 në Turqi (status të vëzhguesit); Gara “Cambrian Patrol” zhvilluar me 19-21.10.2016 në Ëells të Mbretërisë së Bashkuar.

12. Angazhimi kontinuel në procesin e implementimit të rekomandimeve të Analizës së RSSS-së që ka të bëjë me transformimin e MFSK-së në MM dhe FSK-së në FAK - MFSK, përmes Komisionit të saj për Implementimin e Rekomandimeve të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS) dhe Departamentit për Transformim, gjatë vitit 2016 ka vazhduar me aktivitetet në funksion të përgatitjeve për procesin e transformimit të Ministrisë së FSK-së në Ministri të Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura të Kosovës, si në vijim: Analiza, rishikimi, plotësimi dhe finalizimi i Draft-Planit Gjithëpërfshirës të Transformimit (PGJT) me të dhënat e personelit, trajnimeve, operacionale, logjistike dhe financiare; Aktiviteti i ngushtë me ekipet amerikane të DIRI-t dhe DIB-it në lidhje me planifikimin e detajuar për çështje të përgatitjeve dhe procesit të transformimit të FSK në FAK; Përgatitja e konceptit për procesin e standardizimit në FSK i cili do të zhvillohet gjatë vitit 2017.

- MINISTERIA E INFRASTRUKTURËS

MI gjatë këtij viti ka menaxhuar buxhet në vlerë prej 205.5 mil euro (*pa përfshirë huamarrjen 24.2 mil euro*). Për investime kapitale janë realizuara rreth 204.4 mil euro* gjegjësisht 95.5%, duke përfshirë autostradën Prishtinë-Hani i Elezit, rekonstruimin e infrastrukturës ekzistuese, ndërtimin e rrugeve të reja si dhe bashkëfinancimet me kuvendet komunale. Në vëllimin fizikë janë trajtuar 130.46km rrugë. Gjatë këtij viti janë inicuar 148 procedura të prokurimit me vlera të mëdha, të mesme dhe të vogla, shumica prej tyre për investime kapitale. Ministria e Infrastrukturës gjatë vitit është kujdesur për zhvillimin e infrastrukturës publike si në autostradë, rrugë nacionale, regjionale dhe atyre me bashkëfinancim me pushtetin lokal. Angazhim i veçante është mbajtur në mirëmbajtjen e rrugëve nacionale, Regjionale dhe në Autostrada si gjatë sezonit veror ashtu edhe dimëror, si dhe në programin e sinjalizimit horizontal dhe atë vertikal. Vëmendje i është kushtuar inspektimeve si në infrastrukturë rrugore, transport, qendra të kontrollimit teknik të automjeteve, auto shkolla dhe kontrollin e masave boshtore të automjeteve. Është përcjell dhënia e lejeve në fushën e aviacionit ku ka një rritje të qarkullimit të pasagjerëve me fluturime direkte nga dhe përmes Kosovës. Gjatë këtij viti janë ngrit kapacitetet teknike në mbajtjen e provimit nga pjesa teorike dhe praktike në njësit e patent shoferëve (vendosja e kamerave për monitorimin e mbajtjes së provimit), me këtë është rritur edhe siguria dhe njëkohësisht transparenca e mbajtjes së provimit. Brenda këtij viti ka pasur rritje të konsiderueshme të kandidatëve dhe njëkohësisht shtypje e testeve në gjuhë shqipe, serbe dhe angleze. Në fushën e sundimit të ligjit janë miratuar në Qeveri dhe aprovuar nga Kuvendi i Kosovës dy ligje, Ligji për patent shofer dhe Ligji për rregullat e trafikut. Aktualisht në procedurë të trajtimit në Kuvend të Kosovës gjendet projektligji për automjete. Gjatë viti janë nënshkruar nga MI 8 udhëzime administrative që kryesisht mbulojnë fushën e transportit dhe të automjeteve të cilat liberalizojmë dhe lehtësojnë kushtet e të bërit biznes duke eleminuar barrierat e ndryshme administrative.

Objektivat e Infrastrukturës Rrugore, kanë qenë: Implementimi i projektit të Autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit, Vazhdimi i zgjerimit të rrugëve Nacionale N9 në drejtim të Pejës; Fillimi i punimeve në zgjerimin e rrugëve Nacionale N25 Prishtinë-Podujevë, Rehabilitimi dhe riorganizimi i rrugës nacionale N2 seg: Veternik (udhëkryqi për Gjilan) QMI; Zgjerimi i rrugës nacionale N25 seg: Suharekë – Korishë, Shtresimi me asfalt në rrugën N9 seg: Dheu i Kuq - Mutivodë; Vazhdimi i zgjerimit të rrugës regjionale R102 Komoran - Skenderaj segmenti: Klinë e Epërme – Morinë; Ndërtimi i rrugës Transiti i Shtimes - Belincë; Rehabilitimi i rrugës Kramovik - Xërxë; Rehabilitimi i rrugës Lypjan - Magurë; Programi i rehabilitimit të rrugëve Nacionale dhe Regjionale ;Programi i bashkëfinancimit me Komuna për përmirësimin e gjendjes së rrugëve lokale; Hartimi i projekteve për investime kapitale; Bashkëpunimi me Institucionet Financiare ndërkombëtare.

Projekte dhe Elaborate të shpronësimit të përfunduara: Hartimi i projektit kryesor për zgjerimin e rrugës N25 seg: rrethrotullimi Besi -Podujevë L=20km - Hartimi i projektit kryesor për rikonstruktimin e rrugës nacionale N2 seg: Udhëkryqi për Gjilan - QMI. - L=8.40km, Hartimi i projektit kryesor të rrugës Transiti në Komunën e Malishevës. L=13km, Hartimi i projektit kryesor për sanimin e fundamenteve të dy shtyllave të urës në lokacionin Kashan në rrugën N2 seg: Kaçanik - Hani i Elezit, i përfunduar, Hartimi i projektit kryesor për **sanimin e tunelin nr.2** në rrugën N2 seg: Kaçanik - Hani i Elezit, i përfunduar, Elaboratet e shpronësimit për , Zgjerimin e rrugës Rajonale R102 , segmenti Klinë e Epërme - Morinë , L=13km dhe proceduar në MMPH, Elaborati dhe për Rehabilitimi dhe Riorganizimi i rrugës Nacionale N2 (udhëkryqi për Gjilan - QMI) dhe Transiti i Shtimes - Belincë .

Realizimi i projektit të ndërtimit të Autostradës R6, Prishtinë - Hani i Elezit.Pas përfundimit të nënsegmentit C1 nga Kyqja R6/R7 - lidhja me rrugën nacionale N2 (Udhëkryqi i Gjilanit), me gjatësi të përgjithëshme prej 5.0 km, dhe rrugët për kycje dhe shkyçëse të njëjës kryesore të Autostradave R6/R7, me gjatësi prej 5.5 km, është duke vazhduar me punime në trasenë drejt Kyqjes në Lipjan - Kyqja në Babush - Kyqja Ferizaj- Kyqja Doganaj. Janë përfunduar 20 km te segmentit C1 deri ne Babush është bërë inaugurimi në fund të vitit. Është përgatitur dhe është miratuar nga ana e Ministrise se Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Ambiental dhe Social për segmentin C3 Doganaj - Hani i Elezit i projektit të Autostradës R6. Janë përgatitur elaboratet e shpronësimit dhe ka përfunduar procesi i shpronësimit per segmente C1 dhe C2 , dhe një pjesë e segmentit C3.

Vazhdimi i realizimit të drejtimit rrugor R7 Morinë - Prishtinë - Merdare. Pas lëshimit ne qarkullim te segmenteve të Autostradës R7, Morinë - Gjurgjicë (Lidhja me N9)- Bresje - Besi, Ministria e Infrastrukturës ne bashkëpunim me ËBIF-in dhe EIB-ne , ka filluar plotësimin e Studimit të Fizibilitetit dhe Ndikimit Mjedisor si dhe të projektit Preliminar për segmentin Besi - Merdare (Kufiri me Serbine). Kompania Konsulente COËI ka kryer studimin e disa alternative te koridorit te ardhëshëm të Autostradës nga Besi - Merdare (25 Km), keto alternativa te koridorit te Autostrades janë vlerësuar sipas një mekanizimi te përbërë nga kriteret teknike, financiare , sociale, mjedisore dhe te sigurisë dhe në bazë të të gjeturave është përgatitur Raporti Final , me variantin më të favorshëm, i cili është miratuar nga MI.

Vazhdimi i projektit të zgjerimit të rrugës Nacionale N9, Prishtinë - Pejë. Në bashkëpunim me ËBIF (Ëestern Balkan Investment Frameëork) dhe BERZH-ka filluar plotësimi i Studimit te Fizibilitetit dhe Ndikimit Mjedisor për segmentin Kijeva - Zahaq (32 Km) , si dhe plotësimi i projektit zbatues. Ministria e Infrastruktures ka miratuar trasenë e rrugës Nacionale N9 , nga Kijeva deri në Zahaq. Kompania Kosulente ka përfunduar Studimin e Fizibilitetit dhe Ndikimit Mjedisor. Në bashkëpunim me ËBIF dhe EIB/EBRD-në janë definuar Termat e Referencës për hartimin e Projektit Preliminar nga Kijeva - Zahaq (32 km), i cili pritet të filloj ne fillim të vitit 2017. MI ka në menaxhim gjithsejtë 1,925 km rrugë nacionale dhe rajonale dhe 84 km autostradë. Në kuadër të programit të mirëmbajtjes dimërore dhe verore të rrugëve, ka menaxhuar gjithsej 14 kontrata për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve në 7 rajone të Kosovës: Prishtinës, Mitrovicës, Pejës, Prizrenit, Gjilanit, Ferizajt dhe Gjakovës. Në çdo rajon kanë qenë të angazhuara nga dy kompani për mirëmbajtje të rrugëve. Ministria e Infrastrukturës gjatë këtij viti ka filluar punimet në zgjerimin e rrugës nacionale N9, segmenti Pejë - Zahaq, llot 5 dhe 6 në gjatësi prej 6.70 km si dhe zgjerimi i rrugës në hyrje të Qytetit të Pejës nga drejtimi i Prishtinës, segmenti nga transiti i Pejës deri në hyrje të qytetit në gjatësi prej 1.99 km. Është vazhduar me zgjerimin e rrugës rajonale R102 Komoran - Skenderaj segmenti: Klinë e Epërme - Morinë.Ky projekt përfshin 8 llot në gjatësi prej 27.02 km. Pjesa e konsiderushme është përfunduar, ndërsa, pjesa tjetër pas procedurës së shpronësimit dhe zgjidhjes së çështjes pronësore.

Në transportin rrugor të udhëtareve janë lëshuar 134 leje bilaterale; në transportin e rregullt ndërkombëtar 148 leje; 395 certifikata të autobusëve; 73 licenca te transportit te udhëtarëve 8 kontraktor për Transport Humanitar

të udhëtarëve me autobus – sipas relacioneve, 73 licenca për palë të tretë me qira dhe pagesë;13 licenca për nevoja personale;13 licenca për transport të mallrave të rrezikshme;2 licenca për terminale të mallrave;120 certifikata ADR për shofer dhe manipunues;395 Certifikata të kamionit të lëshuara(*dhe për palë të treta*);55 certifikata të bazuara në licencë për nevoja personale; 2118 leje për transport të mallrave (Bullgari 1293, Turqi 300, Itali 521, Hungari 28, Kroaci 5, Shqipëri 6 (leje për vende të treta) Austri 100 leje dhe Slloveni 5).

Në fushën e aviacionit civil janë aprovuar 11, lejet e operimit për Avio Kompani ajrore të rregullta dhe sezonale, janë aprovuar 208 leje të fluturimit Ad Hoc, nga 1 janari deri me 16 Dhjetor 2016,Sherbime te organizuara te fluturimit te rregullta dhe charter, kane ofruar deri me tani gjate ketij viti 26 kompani ajrore. Gjatë këtij viti, Trafiku Ajror është zhvilluar ne 27 destinacione, që po mundëson transportin e udhëtarëve dhe mallrave dhe po mundëson lidhjen e Kosovës me vendet e tjera. Ministria e Infrastrukturës e ka mirëpritur dhe mundësuar hyrjen në treg të Avio Kompanisë Easy Jet nga UK, i cili është transportues ajror britanik i pasagjerëve, i cili operon me çmime të ulta. Numri i pasagjerëve gjatë këtij viti ka shënuar rritje rekorde duke arritur në 1,744,202 që paraqet 12.6% rritje në krahasim me vitin 2015 (1,549,198 pasagjerë). Është bërë punimi i Animacionit për te drejtat e pasagjerëve dhe publikimi i tij disa herë ne televizionin publik, me qëllim te sensibilizimit te drejtave te pasagjerëve për mbrojtjen e tyre nga mashtrimet dhe aktivitetet e vazhdueshme preventive ka ndikuar qe te arrihet mbrojta e te drejtave te pasagjerëve dhe te arrihet efekti preventive.

Me qëllim të standardizimit të procedurave për kontrollim teknik mobil (në rrugë) CITA në bashkëpunim me COURT-en janë duke përgatitur procedurat fillestare për kontroll të automjeteve në rrugë duke u mbështetur në Direktivën 2014/47/EU. Janë testuar 609 kandidatë për shofer instruktorë, prej tyre 198 kanë kaluar, janë licencuar 21 autoshkolla dhe rilicencuar 38 autoshkolla për kategori të ndryshme, janë rilicencuar nëntë (9) qendra për kontrollimin teknik të automjeteve, janë monitoruar 282 983 automjete në kontrollim teknik sipas kategorive nga QKTA-ja, Homologimi individual dhe tipor i automjeteve është 30 841 sosh; Kontrollimi teknik sipas QKT në Kosovë 314 484 dhe mbi 20 000 automjete matja e gazrave në QKT (*nga muaji qershor 2016*).

Në periudhën janar-Nentor 2016, jane testuar kandidatet per te gjitha kategorit nga pjesa teorike gjithsejt **94,057**, ndersa ne pjesen praktike jane testuar kandidatet per te gjitha kategorit gjithsejt **53,757**

Me qëllim rritjen e cilësisë ne testime si dhe rregullimin e procesit te testimeve ne tërësi, janë ndërmarr tri iniciativa: **a)** iniciimi projektit për **testimin elektronik** te kandidateve. Funkcionalizimi i testimi elektronik do të bëhet nëpërmes kompjuterëve Touch Screen, **b)** për te rritur cilësinë dhe transparencën ne testimet praktike është bere **instalimi i kamerave duale** te cilat bëjnë inçizimin e te gjithë procesit te testimi nga prezantimi i pyetësit deri tek dhënia e rezultatit. Nga të dhënat e para rezulton një rënie e kalueshmërisë prej afro 15% në testin praktik, që nënkupton se numri i kandidatëve që e ka përsëritur testin praktik është rritur me ç ‘rast ne kemi angazhuar zyrtarë të cilët janë të licencuar si pyetës për te përballuar fluksin e kandidateve dhe **c) Aplikacioni "e-shoferi"** i cili do te rregullon te gjithë procesin e testimeve te kandidateve nga momenti kur kandidati regjistrohet ne autoshkolle deri ne momentin kur i njëjti pajiset me patente shofer. Me qëllim evitimin e ardhjes se kandidateve neper njësi për te paraqitur provimet, me ane te këtij aplikacioni është parapa qe paraqitja e provimeve te jete online. Ne fushen e mbikqyrjes nga Inspektoriati jane realizuar, inspektimet për transport rrugor: 2223; inspektimet për infrastrukturë rrugore: 779; inspektimet për kontrollat teknike: 1072 dhe Inspektimet për autoshkolla:1258.

- MINISTERIA E INTEGRIMIT EVROPIAN

Gjatë vitit 2016 janë shënuar përparime të rëndësishme në procesin e integrimit evropian, respektivisht janë avancuar marrëdhëniet me BE-në nga marrëdhënie kryesisht politike në marrëdhënie kontraktuale. Kjo është arritur përmes miratimit dhe hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA). Përparime të tjera kyçe të shënuara gjatë kësaj periudhe raportuese përfshijnë funksionalizimin e organeve të përbashkëta Kosovë - BE të krijuara me MSA për mbikëqyrjen e saj, vendosjen e kornizës së politikave për zbatimin e detyrimeve të MSA-së dhe monitorimit të zbatimit të saj, përafrimit të legjislacionit, asistencës së BE-së dhe asaj bilaterale, dhe komunikimit dhe informimit të publikut rreth procesit të integrimit evropian.

MSA ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016. Ajo është marrëveshja ndërkombëtare më e rëndësishme dhe më gjithëpërfshirëse që ka lidhur ndonjëherë Kosova, dhe ka vendosur kornizën e marrëdhënieve tona me shtetet anëtare të BE-në dhe institucionet e saj, si dhe mekanizmat dhe afatet zyrtare për reformat që në mënyrë progresive do ta për afrojnë Kosovën me standardet e BE-së, do të krijojnë stabilitet politik e institucione demokratike, dhe do ta bëjnë ekonominë e saj të integruar në BE dhe të aftë për të përballuar forcat e tregut dhe presionin e konkurrencës brenda tregut të brendshëm të BE-së. MSA mbulon të gjitha sferat e qeverisjes, në kuadër të 144 neneve, të ndarë në dhjetë (10) tituj, si dhe në shtatë (7) shtojca, pesë (5) protokolle e një deklaratë të përbashkët.

Së dyti, sa u përket *organeve të përbashkëta të stabilizim-asociimit* Kosovë – BE të, MSA ka krijuar Këshillin e Stabilizim-Asociimit (KSA), Komitetin, shtatë Nënkomitete dhe dy Grupe të Veçanta, si dhe Komitetin Parlamentar të Stabilizim-Asociimit. Në këto organe të detyrueshme sipas MSA-së do të diskutohet rregullisht zbatimi i saj dhe do të merren vendimet më të rëndësishme politike për fazat e ardhshme të aderimit në BE. Këto organe janë funksionalizuar në pjesën e dytë të vitit 2016. Në këtë drejtim, në bashkëpunim me institucionet e BE-së dhe institucionet e linjës, është hartuar baza ligjore për funksionimin e tyre (*Rregullorja e Punës* së këtyre organeve, e miratuar nga Këshilli i BE-së, më 28 korrik 2016, dhe nga Këshilli i Stabilizim-Asociimit, më 25 nëntor 2016, në mbledhjen e tij të parë, si dhe *Rregullorja nr. 13/2016-QRK mbi Funksionimin dhe Përfaqësimin e Institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Strukturat e Stabilizim-Asociimit*, e miratuar nga Qeveria më 16 shtator 2016, përmes Vendimit nr. 03/109.

Në bashkëpunim me KE-në është dakorduar kalendari i raundit të parë të takimeve të këtyre strukturave, dhe deri më tani janë mbledhur për herë të parë tri struktura: KSA (më 25 nëntor 2016, në Bruksel), Nënkomiteti për Inovacion, Politika Sociale dhe Shoqëri Informativ (më 15 dhjetor, në Bruksel) dhe Grupi i Veçantë për Reformën e Administratës Publike (më 3 dhjetor, në Prishtinë). Aktualisht po punohet në udhëzimet procedurale për funksionimin e këtyre strukturave, të cilat pritet të finalizohen në mars 2017. Në takimin e parë të KSA-së është diskutuar mbi zhvillimet më të fundit rreth marrëdhënieve politike Kosovë – BE, gjendjes në fushat e kriterëve ekonomike, zbatimit të MSA-së, bashkëpunimit rajonal dhe asistencës së BE-së.

Për të vendosur një bazë të qëndrueshme *politikash për zbatimin e reformave që kërkon MSA*, MIE, në bashkëpunim me institucionet e tjera, ka hartuar dhe koordinuar zbatimin e Programit të parë Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA). Ky program, i miratuar nga Qeveria, në dhjetor 2015, dhe nga Kuvendi, në mars 2016, ka vendosur një kornizë gjithëpërfshirëse të reformave të nevojshme përgjatë periudhës afatmesme për zbatimin e MSA-së dhe përfarimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së, si dhe zbatimin e legjislacionit të përafuar. Ai përmban masa afatshkurtra (që planifikohen në baza vjetore) dhe prioritete afatmesme (që kanë një perspektivë afatmesme), të ndara në dy kategori: masa e prioritetit legjislativ, dhe masa e prioritetit zbatues. Ai përbëhet nga tri blloqe: *Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike dhe Standardet Evropiane – Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me Acquis-në e BE-së*. Përveç reformave kyçe politike e ekonomike që kërkon MSA, ai parasheh masa konkrete në kuadër të 33 kapituj të *acquis*-së së BE-së. Programi është dokumenti kryesor strategjik nacional për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të të gjitha reformave të nevojshme deri në negociatat për anëtarësimin në BE dhe më tej. Përmbajtja e tij është në harmoni me Programin e Qeverisë, procesin e dokumentet e buxhetimit, si dhe me dokumente e mekanizma të tjerë vendorë. Ai gjithashtu reflekton prioritetet dhe masat e dala nga dialogu i politikave me BE-në dhe Raporti vjetor i Komisionit Evropian për Kosovën. Rishikimi vjetor i Programit është në finalizim e sipër, me fokus në masat afatshkurtra, dhe pritet të miratohet në shkurt 2017.

Përveç Programit gjithashtu është hartuar dhe miratuar Agjenda për Reforma Evropiane (ERA). Ajo është propozuar në prag të hyrjes në fuqi të MSA-së, dhe është lansuar zyrtarisht nga Kryeministri Mustafa dhe Komisioneri i BE-së për Negociata të Zgjerimit, Johannes Hahn, më 17 maj, në *Konferencën e Nivelit të Lartë Kosovë-BE për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit*, të mbajtur në Prishtinë. Pas finalizimit të prioritetëve dhe planit vjetor të veprimit për zbatimin e tyre, ERA është miratuar nga Qeveria më 9 nëntor, ndërsa zbatimi i saj është lansuar më 11 nëntor, në takimin e parë të Dialogut të Nivelit të Lartë Kosovë – BE mbi Prioritetet Kyçe. Qëllimi i ERA-s është fokusimi i zbatimit të MSA-së dhe që të shërbejë si instrument i Dialogut të rregullt të Nivelit të Lartë që do të zhvillohet prej tash e tutje krahas atij në kuadër të strukturave të stabilizim-asociimit. Për këtë qëllim, ERA u jep vëmendjen më të lartë politike realizimit të reformave kyçe ekonomike, fuqizimin e sundimit të ligjit dhe konsolidimin e qeverisjes së mirë, përfshirë përmes Dialogut të Nivelit të Lartë, të paktën çdo gjashtë muaj, për të mbikëqyrur dhe shtyrë përpara zbatimin e tyre. Prandaj ERA përmban edhe një plan veprimi vjetor, dhe do të rishikohet çdo vit duke i përditësuar prioritetet dhe aktivitetet

e saj. ERA përmban gjithsej 22 prioritete, të ndara në tri shtylla: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit (9 prioritete); Konkurrueshmëria dhe klima e investimeve (7 prioritete); dhe Arsimi dhe punësimi (6 prioritete).

Në fillim të vitit MIE ka zhvilluar dhe vënë në funksion një mekanizëm për *monitorim dhe raportim*, dhe ka hartuar tri raporte të rregullta mbi zbatimin e masave afatshkurtra të PKZMSA-së (nga një çdo tre muaj). Qëllimi i këtyre raporteve është vlerësimi dhe përmirësimi i zbatimit të Programit, duke shërbyer si bazë për përgjegjësi në kuadër të institucioneve, deri në nivelin më të lartë politik, si dhe për të siguruar transparencë ndaj aktorëve të tjerë dhe më gjerë publik për zbatimin e MSA-së. Gjetjet e tyre janë diskutuar në seanca të kabinetit të Qeverisë dhe do të shërbejnë edhe për punën e strukturave të stabilizim-asociimi. Në aspektin e përmbajtjes, raportet japin një pasqyrë sasiore të zbatimit të masave gjatë periudhës raportuese në nivel të Programit në tërësi, të secilit bllok dhe të secilit kapitull. Ata gjithashtu japin një vlerësim cilësor të gjendjes në çdo kapitull, duke përmbledhur sfidat kryesore në zbatim dhe ato të mundshme gjatë pjesës së mbetur të vitit (duke theksuar çështjet që kërkojnë vëmendje të veçantë në nivel të lartë politik). Gjatë vitit 2016 MIE ka hartuar tri raporte tremujore mbi zbatimin e PKZMSA-së, ndërsa raporti i fundit (që mbulon tërë vitin 2016) do të finalizohet gjatë muajit shkurt 2017.

Zhvillimi kryesor i këtij viti sa i përket *liberalizimit të vizave* është dhënia e rekomandimit nga ana e Komisionit Evropian, më 4 maj, dhe nga Parlamenti Evropian (respektivisht Komisioni për Liri Qytetare), më 7 korrik. Përveç kësaj, kanë vazhduar përpjekjet për zbatimin e dy rekomandimeve të mbetura: ratifikimi i marrëveshjes për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi dhe rezultatet në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ratifikimi akoma është në pritje, ndërsa sa i përket rekomandimit tjetër, janë prioritetizuar 33 raste të korrupsionit dhe krimit të organizuar të nivelit të lartë dhe janë ngritur 21 aktakuza (4 për krimin të organizuar dhe 17 për abuzim të detyrës zyrtare, mashtrim, ryshfet dhe falsifikim), me 150 të pandehur, përfshirë një numër të zyrtarëve të lartë publikë dhe politikë. Që nga dhënia e rekomandimit Kosova gjithashtu i ka dorëzuar KE-së dy raporte rreth përmbushjes së këtyre dy rekomandimeve të mbetura.

Më tej, *Marrëveshja Kornizë për Pjesëmarrjen e Kosovës në Programet e BE-së* është nënshkruar më 25 nëntor, në Bruksel. Kjo marrëveshje do të mundësojë qasjen e Kosovës në 17 programe të tilla.

Sa i përket *përafrimit të legjislacionit*, gjatë këtij viti MIE ka vlerësuar gjithsej 138 projekt-akte normative, respektivisht ka kryer kontrollin e përputhshmërisë së tyre me *acquis*-në e BE-së ka lëshuar opinione ligjore. Gjatë këtij viti gjithashtu janë mbajtur 9 raunde trajnimesh treditore për procesin e përafrimit të legjislacionit. Gjatë këtij viti janë përkthyer 165 akte të *acquis*-së nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, si pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit me Shqipërinë.

Me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të MSA-së dhe përafrimit të legjislacionit në fushat prioritare, gjatë vitit është përgatitur një projekt mbështetës dyvjeçar, përmes instrumentit të binjakëzimit, i cili pritet të fillojë së zbatuari në pranverë 2017, nga një konsorcium gjermano-polako-kroat. Qëllimi i tij është përmirësimi i planifikimit të politikave dhe përafrimit të legjislacionit përmes analizimit të gjendjes së përafrimit të legjislacionit vendor me *acquis* dhe zbatimit të tij (përfshirë kapacitetet institucionale të nevojshme), ngritjes së kapaciteteve për *acquis* dhe informimit të publikut dhe palëve të interesuara mbi MSA-në. Projekti do të fokusohet në tetë kapituj të *acquis*-së (1, 3, 5, 6, 7, 8, 23 dhe 24).

Sa i përket *asistencës së BE-së dhe koordinimit të donatorëve*, Lista e Projekteve Prioritare të Infrastrukturës (që mbulon katër sektorë: transportin, energjinë, mjedisin dhe sektorin social) është përditësuar dhe miratuar nga Qeveri, ndërsa Komiteti Kombëtar i Investimeve (KKI) ka miratuar të gjitha projektet e përfshira në Klauzolën e Investimeve. Në kuadër të Instrumentit të Ballkanit Perëndimor për Investime (ËBIF), gjatë këtij viti Kosova ka dorëzuar një projekt për raundin e 16 të granteve, për të kryer një studim fizibiliteti dhe projekt të detajuar për Rrugën N9, e cila lidh Kosovën me Malin e Zi. Programimi i IPA 2016 është finalizuar dhe të

gjitha dokumentet e nevojshme për programim (dokumentet planifikuese sektoriale dhe dokumentet e veprimt) janë zhvilluar dhe dorëzuar Komisionit Evropian. MIE gjithashtu ka filluar konsultimet paraprake me KE për prioritetet për IPA 2017, dhe ka propozuar që të përfshijë sektorë dhe prioritetet që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Programi për Reforma Ekonomike. Gjatë këtij viti gjithashtu janë nënshkruar dhe kanë hyrë në fuqi marrëveshjet financiare për bashkëpunim ndërkufitar (CBC) me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi në kuadër të IPA 2014 dhe 2015.

Më 18 tetor janë mbajtur negociatat vjetore ndërqeveritare Kosovë-Gjermani, kësaj radhe janë diskutuar zotimet për dy vite të asistencës gjermane për Kosovën, në vlerë prej 47 milionë eurosh. Pas negociatave, Gjermania dhe Kosova do të nënshkruajnë marrëveshje financiare dhe teknike të cilat do të rregullojnë zbatimin e projekteve të iniciuara në negociatat ndërqeveritare. Më 24 tetor janë nënshkruar marrëveshja bilaterale dhe memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Kosovës dhe Luksemburgut të cilat rregullojnë zbatimin e asistencës së Luksemburgut për Kosovën për periudhën 2017-2020, me një shumë prej 30 milionë eurosh. Më 15 dhjetor ka hyrë në fuqi marrëveshja financiare për programin IPA 2015, në kuadër të së cilit BE-ja financon projekte për Kosovën në vlerë prej EUR 78 milionë. Më 16 nëntor Qeveria ka miratuar vendimin për themelimin e grupeve punuese sektoriale dhe grupeve punuese nënsektoriale për koordinimin e donatorëve të jashtëm në Kosovë. Gjatë vitit 2016 gjithashtu është zbatuar raundi i dhjetë i Skemës së Profesionistëve të Rinj, si pjesë e së cilës janë ndarë 35 bursa për studime pasuniversitare të magjistraturës për administratë publike, ekonomi dhe drejtësi. Pas përfundimit të studimeve, përfituesit do të punësohen në institucionet publike si pjesë e politikave për reformën e administratës publike.

- MINISTRIA PËR DIALOG

Në kuadër të vizionit euroatlantik për shtetin e Kosovës dhe të politikave të fqinjësisë së mirë si njëri prej kushteve themelore për integrimin evropian dhe euro-atlantik të shtetit tonë, Qeveria e Republikës së Kosovës edhe gjatë këtij viti ka vazhduar angazhimet serioze në dialogun ndërshtetëror mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe të mbështetur fuqishëm nga SHBA-ja.

Qeveria e Republikës së Kosovës i ka kushtuar rëndësi të veçantë dialogut të Brukselit duke marrë parasysh rëndësinë e tij për realizimin e objektivave të saja strategjike për forcimin e shtetit siç janë: avancimi i integritit euroatlantik për Kosovën, promovimi i fqinjësisë së mirë, paqes dhe stabilitetit në rajon dhe Evropë ku njëri nga faktorët kyç është normalizimi i marrëdhënieve dhe njohja e ndërsjellë mes dy shteteve, dhe shtrirja e konsolidimi i sovranitetit në veri të vendit përmes integritit në rritje të komunitetit serb në sistemin shtetëror të Kosovës dhe procesit të shuarjes e strukturave paralele të Serbisë në Kosovë.

Ministria për Dialog si përgjegjëse për procesin e dialogut të Brukselit ka zhvilluar një veprimtari të vëllimshme dhe intensive për arritjen e marrëveshjeve, implementimin e tyre dhe monitorimin e cilësisë së zbatimit, me qëllim që ti çoj përpara objektivat strategjike të Qeverisë në këtë dialog, duke mbrojtur interesat kombëtare në pajtim të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, Rezolutat e Kuvendit dhe vlerat euro-atlantike, që janë vija të kuqe të qëndrimeve të Qeverisë së Kosovës në këtë dialog që nga fillimi i tij në vitin 2011.

Në bashkëpunim dhe bashkërendim me të gjitha institucionet e vendit dhe në koordinim të plotë me Zyrën e Kryeministrit, Ministria dhe Ministrja e dialogut Edita Tahiri, njëherësh kryenegociatore, kanë zhvilluar veprimtari negociatore kompetente dhe strategjike. Në punën e sajë, është mbështetur nga ekipi i përbërë nga këshilltarët e sajë që janë koordinator politik fushave dhe grupet punuese të ekspertëve cilësor që përfaqësojnë dhe delegohen nga Ministrinë e linjës varësisht nga fushat që janë trajtuar në procesin e dialogut. Platforma negociatore dhe arritja e marrëveshjeve kanë pasur për bazë vijat e kuqe të cekura më lartë, dokumentet programore dhe strategjike të Qeverisë, dhe njohuritë teorike dhe praktike të negociatave ndërkombëtare. Janë mbajtur një numër enormë i takimeve përgatitore me grupet punuese në konsultime të vazhdueshme me nivelin politik. Kemi marrë pjesë të gjitha raundet e bisedimeve të nivelit teknik në Bruksel. Në fillim të vitit është mbajtur dhe një takim në nivelin e Kryeministrave të dy shteteve dhe Përfaqësueses së lartë të BE-së Federica Mogherini, në të cilin ka marrë pjesë Kryeministri Isa Mustafa.

Ministrja e dialogut ka raportuar rregullisht në Qeverinë e Kosovës, Presidencë, Kuvendin e Kosovës, në komisionet parlamentare me qëllim të njohjes dhe avancimit të rrjedhave dhe rezultateve të dialogut të Brukselit. Po ashtu, kemi pasur bashkëpunim me mediat vendore dhe ndërkombëtare, qendra studimore, dhe pjesëmarrje në tryeza dhe konferenca ndërkombëtare.

Ministria për dialog ka zhvilluar aktivitete diplomatike, për të siguruar mbështetjen ndërkombëtare për qëndrimet shtetërore të Kosovës në dialog si dhe për avancimin e proceseve integruese euro-atlantike si shpërblim për seriozitetin e treguar në dialog, gjë që edhe rezultoi me përparimet konkretet të Kosovës së në raport me BE-në, NATO-në dhe anëtarësime të reja në organizata ndërkombëtare. Bashkëpunim të veçantë kemi zhvilluar me Qeverinë Amerikane dhe ambasadën amerikane në Kosovë, me BE-në dhe zyrën e BE-së në Kosovë, partnerët tjerë evropian sidomos Gjermaninë, Austrinë, Mbretërinë e Bashkuar, me pesë vendet e BE-së që ende nuk e kanë njohur Kosovën, e shumë vende tjera, korin diplomatik në Kosovë, dhe pjesëmarrje në forumin e shteteve anëtare të BE-së të organizuar nga zyra e BE-së në Kosovë, etj.

Rezultatet e dialogut të Brukselit

Të arriturat në Dialogun e Brukselit gjatë këtij viti mund konsiderohen mjaft substanciale duke marrë parasysh rëndësinë e tyre për vendin tonë. Një ndër arritjet më kryesore të këtij viti është se Kosova mori e kodit telefonik ndërkombëtar 383 nga ITU më 15 dhjetor 2016 duke forcuar shtetësinë dhe pavarësinë ndërkombëtare, pas gjashtë vite bisedimesh. Po ashtu, kemi hequr barrikadën nga ura e Ibrit më 14 gusht 2016 dhe revitalizimi i urës po finalizohet. Kosova po vendos institucionet qendrore në komunat veriore që ka

filluar këtë muaj, ka hapur zyrat e ARC-së për pajisje me dokumentet e shtetësisë dhe së shpejti hapen zyrat e gjendjes civile. Kosova ka shuar të ashtuquajturën “mbrojtje civile” në janar të këtij viti ndërsa gjykatat dhe policinë paralele në 2013. Kosova përfundimisht vendos sistemin unitar të drejtësisë në veri të vendit në janar 2017. Me marrëveshjen e IBM, Kosova ka vendosur kufirin ndërshtetëror me Serbinë në 2012, ndërsa gjatë këtij viti kemi finalizuar projektet për ndërtesat e përhershme në tri vendkalime kufitare mes Kosovës dhe Serbisë, ku vendi jonë është palë mikpritëse, ndërtimi i të cilave fillon në janar, me financimin nga BE-ja.

Marrëveshjet e reja të arritura sivjet janë si ajo për reciprocitetin në tabela të automjeteve mes dy shteteve në shtator 2016, njohja reciproke të certifikatave për mallra të rrezikshme (ADR) në maj 2016 si dhe zgjerimi i marrëveshjes për njohjen reciproke të diplomave që përfshinë të gjitha nivelet e arsimit. Ndërsa, në pritje të zbatimit ka mbetur çështja e pavarësimi të KOSTT-it, e bllokuar nga Serbia që nga 25 gusht 2015. Në bazë të marrëveshjes së Brukselit për energji, KOSST ka nënshkruar Marrëveshjen e lidhjes me organizatat evropiane për transmision të energjisë, ENTSO-E, në tetor 2015, por zbatimi i sajë është në pritje. Në pritje është edhe marrëveshja për Asociacioni i komunave me shumicë serbe në Kosovë, e arritur më 25 gusht 2015, në përputhje me Ligjin dhe Kushtetutën e Kosovës. Asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive dhe nuk do të jetë nivel i tretë i qeverisjes në Kosovë. Statuti i Asociacionit do të jetë në përputhje të plotë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 26 dhjetor 2016. Ky proces do shkojë paralelisht me heqjen e strukturave të mbetura paralele të Serbisë në Kosovë, për të cilat në Bruksel do të filloj punën grupi trepalësh.

Një e arritur tjetër e rëndësishme e dialogut është se Bashkimi Evropian ka kushtëzuar Serbinë në rrugën e integritimit evropian me kapitullin 35 ku nga Serbia kërkohet që të normalizoj marrëdhëniet fqinjësore me Kosovën përmes një marrëveshje ligjërish të obligueshme dhe të zbatoj marrëveshjet e arritura. Një kushtëzim i tillë ka ardhur si rezultat i raporteve të besueshme zyrtare që Ministria e Dialogut ia ka paraqitur Bashkimi Evropian rregullisht që nga fillimi i dialogut më 2011, ku në hollësi ka njoftuar mbi gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve dhe mos përmbushjen e obligimeve zbatuese nga ana e Serbisë.

Vlen të theksohet se procesi i dialogut është përballur me sfida të shumta si pasojë e qëndrimeve obstrukcionista të palës serbe. Fenomeni më shqetësues është dualizmi i Serbisë në zbatim që do të thotë se në njërin anë ajo zbaton marrëveshjet dhe në anën tjetër vazhdon të mbështesë strukturat e saj paralele në Kosovë, përfshirë edhe përpjekjet për destabilizim, siç është rasti i murit ilegal në Mitrovicë i shfaqur këtyre ditëve, në shkelje të Marrëveshjes së Brukselit. Institucionet e Kosovës kanë bërë të qartë qëndrimin për heqjen e këtij muri ilegal, sipas ligjeve të Kosovës dhe me kujdesin maksimal për ruajtjen e stabilitetit të vendit.

Kontributi i dialogut të Brukselit për forcimin e shtetit dhe agjendës euro-atlantike

Të arriturat në Dialogun e Brukselit gjatë këtij viti kanë kontribuar dukshëm në realizimin e objektivave strategjike Qeverisë për forcimin e shtetit brenda dhe jashtë vendit. Në planin e brendshëm, dialogu i Brukselit ka kontribuar për forcimin e shtetit, Kosova ka shtrirë dhe konsoliduar më tej sovranitetin shtetëror në veri të vendit përmes shuarjes së strukturave paralele serbe në fushat ku janë arritur marrëveshjet. Po ashtu dialogu ka ndihmuar në përmirësimin e përgjithshëm të jetës së qytetarëve në shumë plane, sundimit të ligjit, lëvizjes së lirë planin socio-ekonomik dhe në veçanti përmirësimin e stabilitetit politik, sigurisë, të marrëdhënieve ndëretnike dhe integritetit të komunitetit serb në pjesën veriore e vendit. Në planin e jashtëm, dialogu i Brukselit ka kontribuar për forcimin e pozicionit ndërkombëtar dhe avancimin e agjendës euro-atlantike.

1. Forcimi i shtetit – shtrirja dhe konsolidimi i mëtejshëm i sovranitetit në veri të vendit

Dialogu i Brukselit ka kontribuar dukshëm për forcimin e shtetit që është një ndër arritjet kryesore të angazhimeve tona në Dialogun e Brukselit. Kosova ka arritur të shtrijë dhe konsolidoj më tej sovranitetin shtetëror në veri të vendit, përmes proceseve të vendosjes së ligjshmërisë, demokracisë, rendit, vendosjes së institucioneve shtetërore në veri të vendit, integritit të komunitetit serb dhe të shuarjes së strukturave paralele serbe në fushat ku janë arritur marrëveshje. Ministria e Dialogut në bashkëpunim me institucionet e vendit kanë qenë plotësisht të angazhuara për realizimin e përgjegjësive të tyre në mënyrë që sovraniteti i shtetit të konsolidohet në tërë vendin përdërisa stabiliteti politik dhe siguria e qytetarëve ka shënuar progres të vazhdueshëm.

Si rezultat i Marrëveshjeve të Brukselit, kemi arritur shuarjen e strukturave paralele serbe në fushën e drejtësisë, shuarjen e strukturës ilegale të “mbrojtjes civile,” shuarjen e zyrave për dhënien e dokumenteve ilegale, ndërsa së fillon zbatimi i marrëveshjes për heqjen e targave ilegale nga përdorimi dhe shuarja e zyrave, etj. Heqja e barrikadës nga ura e Mitrovicës, më 14 gusht të këtij viti dhe revitalizimi të urës nga BE, ka një simbolikë të fuqishme në kuptimet e konsolidimit të sovranitetit, sepse pas shumë vitesh do kjo urë është bërë bashkuese dhe e lirë për qarkullim për të gjithë, qytetarët dhe automjetet. Ky dialog ka ndihmuar që të sigurohet lëvizja e lirë, të hiqen të gjitha barrikadat në veri. Ndryshimet janë të mëdha kur merret parasysh fakti se zyrtarët policor dhe doganor një kohë është dashur të shkojnë me helikopter në pikëkalimet kufitare Jarinjë dhe Bërnjak.

Kemi arritur të shtrijmë sovranitetin në veri të vendit përmes vendosjes së institucioneve qendrore, në shumicën e sektorëve, që gjatë këtij muaji fillojnë punën, të sfiduar për disa vite me radhë për shkaqe të njohura. Qeveria e Kosovës do të nis së shpejti për pajisjen me dokumenteve të shtetësisë dhe të gjendjes civile për qytetarët në katër komunat veriore, për të cilat kërkesat janë në rritje. Për këtë qëllim, zyrat e Agjencisë Kosovare të Regjistrimit Civil (ARCK) kanë nisur punën pas procesi i rekrutimit ligjor dhe trajnimit të stafit nga ana e ARC-së, ndërsa zyrat e Gjendjes Civile janë në përgatitje e sipër. Kosova vendos sistemin unitar të drejtësisë në veri të vendit në fillim të janarit, sipas Marrëveshjes së Brukselit. Do të vendoset një gjykatë themelore dhe një zyre prokurorie për shtatë komunat, në përputhje me të gjitha ligjet e Kosovës, ndërsa është finalizuar integrimin e gjykatësve, prokurorëve dhe stafit administrativ serb në sistemin e Kosovës, për të cilën marrëveshja finale zbatuese është arritur me 30 nëntor 2016. Gjatë këtij viti ka pasur përparime në funksionim ligjor në katër komunat veriore në disa fusha të rëndësishme, duke përfshirë edhe miratimin e buxheteve vjetore sipas ligjit për financat publike të shtetit, që është një tregues pozitiv, për dallim nga vitet e kaluara.

Kufiri ndërshtetëror dhe kontrolli kufitar është konsoliduar më tej ndërkohë që bashkëpunimi sipas Marrëveshjes së IBM (MIK) është në nivelin e kënaqshëm. Sivjet, kemi përfunduar projektet e ndërtesave të përhershme për vendkalimet kufitare në Merdarë, Bërnjak dhe Mutivodë, ku shteti ynë është palë mikpritëse, në bashkëpunim me BE që është financuese dhe realizuese e tyre. Punimet ndërtimore fillojnë në janar 2017. Kosova ka vendosur kufirin frekuencor ndërshtetëror me Serbinë, si rezultat i marrëveshjes së Brukselit për telekomin, me të cilën po ashtu shuhen operatorëve ilegal të telefonisë mobile që kanë vepruar jashtëligjshëm në vendin tonë.

2. Forcimi i sundimit të ligjit, të mirëqenies, integritit dhe sigurisë së qytetarëve

Marrëveshjet e arritura në dialogun e Brukselit kanë pasur ndikime të drejtpërdrejta pozitive në përmirësimin e përgjithshëm të jetës së qytetarëve, në veçanti në planin e sundimit të ligjit, sigurisë, lëvizjes së lirë, në planin socio-ekonomik si dhe në marrëdhëniet ndëretnike gjë e cila shihet në rritjen e dinamikave të integritit të komunitetit serb në sistemin e Kosovës dhe kërkesave për dokumente të shtetësisë. Sot gjendja në veri është

shumë më i mirë se sa që ishte para dialogut të Brukselit gjë që shihet edhe nga raportet zyrtare të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, fal përkushtimi të Qeverisë së Kosovës për zbatimin e marrëveshjeve, për integrim/punësim të individëve pas shuarjes së strukturave paralele në fusha të caktuara, akordimit të fondit për zhvillim dhe dialogut të vazhdueshëm të qeverisë me qytetarët atje.

Në planin socio-ekonomik, marrëveshjet si ajo e IBM, liria e lëvizjes, tregtia e lirë, grumbullimi i taksave doganore në pikëkalimet Jarinjë dhe Bërnjak, shkëmbimi sistematik elektronik i të dhënave doganore (SEED), kanë pasur efekte të drejtpërdrejta pozitive, sepse kanë ulur dukshëm veprimtaritë e jashtëligjshme, kanë forcuar sundimin e ligjit dhe kontrollin efektiv kufitar. Si rezultat, janë rritur dukshëm të hyrat në buxhetin e shtetit nga rritja e pagesë së taksave doganore. Po ashtu, qytetarët janë liruar nga tarifat shtesë për sigurimin e automjeteve që nga gushti i vitit të kaluar kur hyri në fuqi marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të sigurimeve kufitare. Është zgjidhur çështja import eksportit të produkteve ushqimore, farmaceutike dhe të atyre me rrezikshmëri të lartë (ADR) përmes njohjes së ndërsjellë të certifikatave përkatëse mes dy shteteve. Përfitime të mëdha ekonomike, milionëshe, janë siguruar me marrjen e kodit telefonik sepse nuk do të ketë pagesa për kode të huaja, ndërsa qytetarët marrin shërbime më të favorshme.

Në planin e stabilitetit politik dhe sigurisë kanë kontribuar një varg marrëveshjesh siç janë ajo për funksionimin ligjor të katër komunave veriore pas zgjedhjeve lokale të vitit 2013, vendosja e sistemit të policisë së Kosovës në veri dhe shuarja e policisë paralele të Serbisë, shuarja e gjykatave paralele, shuarja e ish-mbrojtjes civile, heqja e barrikadës nga ura e Ibrit dhe gjithë të tjerave, së bashku me vendosjen e institucioneve qendrore në veri dhe fillimin e punës së institucioneve të drejtësisë. Hapat vijues janë të fokusuara në kthimin e shqiptarëve në shtëpitë e tyre në veri dhe anasjelltas të serbëve në jug të Mitrovicës. Qeveria dhe institucionet përkatëse po punojnë për ndaljen e ndërtimeve ilegale në veri, etnikisht të motivuara nga Serbia, dhe për vendosjen e rendit dhe ligjit në zhvillimin urban komunal në dobi për të gjithë qytetarët pa dallim.

3. Forcimi i pozicionit ndërkombëtar të shtetit - Avancimi i agjendës euroatlantike

Në planin ndërkombëtar, Dialogu i Brukselit ka kontribuar për forcimin pozicionit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës dhe avancimin e agjendës euro-atlantike të vendit tonë.

Dialogu i Brukselit ka kontribuar për avancimin e rrugës së Kosovës për integrimin evropian. Kosova nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) me BE-në këtë vit, dhe realizoi dialogun e parë zyrtar me BE-në. Kjo ishte një arritje historike për Kosovën, si proces që filloi më 2011, vetëm pasi Kosova u angazhua në dialogun e Brukselit. Kosova sivjet vendosi lidhje zyrtare me NATO-në, që është dëshmi se shteti jonë vlerësohet pranohet si partnere serioze nga bashkësia ndërkombëtare. Po ashtu, Kosova mori kodin telefonik shtetëror ndërkombëtar nga ITU më 15 dhjetor të këtij viti, për të cilën aplikoi Austria, duke forcuar kështu shtetësinë e vet dhe pavarësinë ndërkombëtare në fushën e telekomit. Rëndësia ndërkombëtare lidhet edhe me faktin se për herë të parë një organizatë e OKB-së është në bashkëpunim zyrtar me shtetin tonë që shënon një fillim të ri në raportet zyrtare me OKB-në.

Në planin anëtarësimeve në organizata ndërkombëtare, dialogu i Brukselit ka ndihmuar në heqjen e pengesave për anëtarësim, prandaj Kosova si shtet me të drejta të plota si shtetet tjera është anëtarësuar në shumë organizata ndërkombëtare dhe rajonale. Vetëm gjatë këtij viti, Kosova është bërë anëtare në Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit, Konventën Apostille, Shoqatën Ndërkombëtare të Prokurorëve, Odën Ekonomike Evropiane. Kosova merr pjesë në Asamblesë parlamentare të NATO, të Këshillit të Evropës, në takimet

Kartës së Adriatikut A5 për çështjet e sigurisë dhe shumë organizata tjera. Kosova është anëtarësuar në gjitha organizatat e rëndësishme ndërkombëtare për sportin përfshirë edhe Komitetin Olimpik botëror.

Ministria e Dialogut në angazhimet diplomatike ka shfrytëzuar argumentin se Kosova si palë konstruktive në dialogun e Brukselit meriton të shpërblehet në integrimet euroatlantike. Ky argument ka sjellë përkrahjen edhe të pesë vendeve të BE-së jo njohëse të cilat i dhanë mbështetje Kosovës në proceset integruese euroatlantike përmes votimit të MSA-së, mbështetën lidhjet zyrtare të Kosovës me NATO-n, kodin telefonik ndërkombëtar nga ITU, dhe shumë anëtarësime të Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe rajonale që fillimi i dialogut më 2011.

- **MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM**

Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) edhe këtë vit ka vazhduar të ofrojë mbështetje financiare për nismat për kthim dhe ri-integrim. Ndërtimi i shtëpive është një shembull i qartë i përpjekjeve të vazhdueshme

të MKK-së për strehimin e të kthyerve të komuniteteve të ndryshme duke ju siguruar kushte të dinjitetshme për jetesë të cilat më pastaj do të kenë efekte përcjellëse pozitive në aspektet e tjera të jetës së tyre siç është punësimi, shëndeti, arsimiti etj.

Gjatë vitit 2016, përmes realizimit të aktiviteteve të planifikuara të MKK-së, mbështetjes së BE-së përmes projektit “Kthimi dhe Reintegrimi në Kosovë faza e katërt” si dhe projekteve të përbashkëta me partnerë tjerë ndërkombëtar, MKK-së ka ndihmuar një total prej 122 familjeve përkatësisht 653 personave të kthyer me ndërtimin e shtëpive dhe ofrimin e granteve për gjenerimin e të ardhurave.

Tabela : Numri i përgjithshëm i familjeve dhe numri i të kthyerve të asistuar përmes ndërtimit të shtëpive përkatësisht etnike dhe komunave

Viti 2016	Përkatësia etnike							
	Ashkali	Boshnjakë	Egjiptian	Rom	Serb	Kroat	Shqiptarë	Gjithësej
Komuna:	Numri i familjeve / personave	Numri i familjeve / personave	Numri i familjeve / personave	Numri i familjeve / personave	Numri i familjeve / personave	Numri i familjeve / personave	Numri i familjeve / personave	Numri i familjeve / personave
Gjakova	/	/	7 / 31	/	/	/	/	7 / 31
Gjilani	/	/	/	/	1 / 5	/	/	1 / 5
Istog	1 / 6	/	1 / 7	/	6 / 28	/	/	8 / 41
Klina	/	/	/	/	/	/	/	/
Obiliq	/	/	/	8 / 48	18/100	/	/	25 / 132
Pejë	/	1 / 8	2 / 17	3 / 25	3 / 10	/	/	9 / 60
Shtërpçë	/	/	/	/	16 / 87	/	/	12 / 67
Kamenica	/	/	/	/	1 / 8	/	/	1 / 8
Klllokot	/	/	/	/	/	1 / 2		1 / 2
Novobërdë	/	/	/	/	1 / 5	/	/	1 / 5
Prishtinë	/	/	/	/	1 / 4	/	/	1 / 4
Graçanicë	/	/	/	/	1 / 8	/	/	1 / 8
Lipjan	/	/	/	/	1 / 5	/	/	1 / 5
Shtime	1 / 7	/	/	/	/	/	/	1 / 7
Mitrovica	/	/	/	/	/	/	2 / 30	2 / 30

<i>Projekt et për Integri min e Komun iteteve</i>	Veriore								
	Vushtrri	/	/	/	/	1 / 7	/	/	1 / 7
	Zubin Potok	/	/	/	/	1 / 1	/	/	1 / 1
	Gjithësej	2 / 13	1 / 8	10 / 55	11 / 73	51 / 268	1 / 2	2 / 30	122 / 653

Ministria për Komunitete dhe Kthim, sikurse viteve paraprake, edhe në vitin 2016, ka qenë e përkushtuar dhe ka kontribuar me një pjesë të madhe të buxhetit të saj në stabilizimin e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, duke u munduar që standardin jetësorë të tyre ta ngrit në nivel sa më të lartë.

Përmes projekteve të ndryshme të ndërtimit dhe rekonstruimit të shtëpive, ndihmës për shkolla, ndërtimit të qendrave kulturore dhe sportive, rrugëve, rrjeteve të kanalizimit, urave, shesheve, ndriçimeve rrugore dhe projekteve për qëndrueshmërinë e tyre, MKK-ja është munduar që komuniteteve t'ju sigurojë kushte për jetë stabile dhe normale në tërë Kosovën.

MKK në bashkëpunim me Ambasadën Britanike përmes projektit „ Forcimi i mundësive për të arritur zgjidhje të qëndrueshme për të zhvendosurit në Kosovë ", që ka për qëllim riparime të të shtëpive në komunën e Prizrenit dhe riparime të apartamenteve apo shtëpive të të kthyerve në komunën e Mitrovicës së Veriut, janë rinovuar 5 shtëpi për 6 familjet e të kthyerve të komunitetit serb dhe riparime të vogla të 5 objekteve për komunitetin pritës të kategoriës të familjeve të rrezikuara sociale, ndërsa në komunën e Mitrovicës së Veriut për 6 familje të komunitetit shqiptar janë bërë riparime të vogla të banesave dhe riparime për 3 shtëpi për komunitetin pritës si komponent balancues.

Janë përkrahë 390 familje përfituese me kushte të rënda socio-ekonomike me material ndërtimor, të cilat janë në funksion të kthimit, riintegritimit dhe stabilizimit të komuniteteve në të gjitha regjionet e Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe raportuese MKK ka përfunduar projektet infrastrukturore si në vijim:

1. Rregullimi i rrugës dhe platos së kishës Shën Illija dhe kishës së Krishtit Shpëtimtarit në fshatin Cernicë komuna e Parteshit
2. Renovimi i kishës së Shën Nikollës në fshatin Banjska, komuna e Vsuhtrrisë
3. Rregullimi i oborrit së shkollës fillore Braca Aksic në fshatin Gracë e Vjetër, komuna e Lipjanit
4. Ndërtimi i çerdhës në fshatin Banjë, komuna e Skenderajit
5. Ndërtimi i sallës sportive në Hajnovc, komuna e Kamenicës
6. Shpuarja e bunarit për shkollën fillore në Uglarë, komuna e Graçanicës
7. Projektet infrastrukturore për komunitete (asfaltimi i rrugëve, ndërtimi i mureve anësore, ndërtimi i tereneve sportive, sanimi etj) komuna e Shtërpçës
8. Asfaltimi i rrugëve në fshatin Zhebincë, komuna Novobërdë
9. Rregullimi i kishës në fshatin në fshatin Drajkovce, komuna e Shtërpçës
10. Ndërtimi i qendrës rinore në fshatin Osojane, komuna e Istogut
11. Renovimi I shkollës në fshatin Hajnovc, komuna e Kamenicës
12. Rregullimi i hapsirës pranë shkollës fillore Braca Aksic në fshatin Gracë e Vjetër, komuna e Lipjanit

13. Vendosja e ngrohjes qendrore në shkollën fillore në shkollën filore Uglarë në fshatin Uglarë, komuna e Graçanicës
14. Furnizimi dhe vendosja e bankinave anësore për rrugët lokale në fshatrat Viça dhe Firajë, komuna e Shtërpcës
15. Ndërtimi i ngrohës dhe paisjeve përcjellëse për ngrohje qendrore në fshatin Vidanjë, komuna e Klinës
16. Ndërtimi i rrugës në fshatin Shillovë, komuna e Graçanicës
17. Transferimi i rjetit dhe trafos së tensionit të lartë për projektin e Brezovicës, komuna e Shtërpcës
18. Furnizimi me paisje për përkthim, komuna e Novobërdës
19. Zgjerimi dhe rregullimi i tregut ekzistues në Shtërpcë, komuna e Shtërpcës
20. Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Pasjak dhe Burim, komuna e Novobërdës
21. Vendosja e ngrohjes qendrore, sanimi i dysHEMEVE dhe ndërtimi i njëjës sanitare në shkollën fillore Braca Aksic, në fshatin Gracë e Vjetër, komuna e Lipjanit
22. Rregullimi i infrastruktures dhe ngrohjes qendrore në objektin sportive në fshatin Brod, komuna e Shtërpcës
23. Ndërtimi i teatrit veror në fshatin Hoçë e Madhe, komuna e Rahovecit
24. Asfaltimi i rrugës në lagjën Rusi, komuna e Shërpcës
25. Vendosja e kamerave të sigurisë në Shërpcë (faza e dytë), komuna e Shtërpcës
26. Instalimi i ngrohjes qendrore në manastirin e Virgjëreshës së Shenjtë, komuna e Gjakovës

Gjithashtu MKK në bashkëpunim me OJQ-të ka realizuar projekte të Ndryshme. Me iniciativat e qytetarëve dhe organizatave jo-qeveritare, MKK-ja ka financuar 44 projekte nga fusha e edukimit, kulturës, dialogut ndëretnik, sportit, manifestimeve fetare dhe shumë fushave të tjera që kanë rëndësi për kualitetin e jetës së qytetarëve.

Përmes Programit të BE për Stabilizimin e Komuniteteve, faza e tretë (BE- CSP III) , program i financuar nga Bashkimi Europian dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim i cili siguron nevojat e komuniteteve jo-shumicë për të gjeneruar të ardhura dhe për të përmirësuar kushtet e tyre të jetesës. Ndihma ofrohet përmes ofrimit të granteve dhe mbështetjes teknike të ndërmarrjeve të reja dhe ndërmarrjet të vogla ekzistuese si dhe iniciativat e përmirësimit të komunitetit.

Nëpërmjet këtyre veprimeve, programi synon të përmirësojë kushtet për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë dhe për të inkurajuar personat e zhvendosur që dëshirojnë të kthehen.

Në këtë vit, programi EU-CSP III ka zbatuar gjithsej 115 projekte prej 122 projekteve të zgjedhura, nga të cilat 98 projekte të vogla për zhvillimin e biznesit, 22 iniciativat me bazë komunitare dhe të dy të biznesit.

Në përgjithësi projektet e zbatuara kanë krijuar mbi 110 vende të punës me orar të plotë, mbi 80 vende pune me kohë të pjesshme dhe ka siguruar më tej vazhdimësinë e mbi 80 pozitave ekzistuese. 40% e bizneseve të mbështetura kanë qenë grupe të rrezikuara në aspektin e zhvillimit në mesin e komuniteteve jo-shumicë (gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, dhe të kthyerit nga komunitetet jo-shumicë)

Këto projekte indirekte kanë përfituar 28 598 njerëz nga komuniteti i gjerë. Nga projekte 38 prej tyre kanë pas në shënjestër në mënyrë specifike ata persona që janë kthyer në Kosovë si dhe komunitetin pritës.

- MINISTERIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka vazhduar me përkrahjen e kulturës institucionale të nivelit qendror gjatë vitit 2016 në realizimin e planprogramit të punës në përputhshmëri me politikat programore. Në aspektin legjislativ, janë finalizuar e proceduar në Sekretariatit Koordinues të Qeverisë tri (3) koncept-dokumente (për promovimin kulturor; librin dhe veprimtarinë botuese si dhe draft koncept dokumenti për Filharmoninë, Operën dhe Baletin. Me asistencën e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian është punuar në finalizimin e Draft Strategjisë për Kulturë 2017-2021. Janë realizuar të gjitha objektivat për pjesëmarrjen e Kosovës në bienalen e Venedikut për vitin 2017, gjithashtu Kosova për herë të parë ka marrë pjesë në Lojërat e Frankofonisë në Abidjan të Bregut të Fildishtë.

Sa i përket pjesëmarrjes së Kosovës në festivalet ndërkombëtare vlen të theksohet pjesëmarrja e QKK-së në festivalet ndërkombëtare të filmit, pjesëmarrja e artistëve në festivalet ndërkombëtare të profileve të ndryshme. Është bërë antarësimi i Kosovës në Federatën Ndërkombëtare të Këshillave të Artit dhe të Kulturës me seli në Sidnei të Australisë.

Për promovimin e artit dhe kulturës së pavarur dhe artistëve të rinjë brenda dhe jashtë vendit dhe krijimtarinë kulturore në arenën ndërkombëtare, gjatë vitit 2016 nga të gjithë sektorët e Departamentit të Kulturës janë proceduar projektet dhe eventet kulturore që janë përkrahur nga komisioni vlerësues të cilët kanë konkurruar në konkursin e vitit 2016 në fuhsat dhe sektorët me sa vijon: dialogun dhe diversitetin kulturor, barazinë gjinore, shoqërinë me aftësi të kufizuara, çmimet jetësore dhe vjetore për teatër, film, muzikë, letërsi, botimin dhe blerjen e librit si dhe ndërkombëtarizim i artit dhe kulturës kosovare.

Në vazhden e bashkëpunimit kulturor ndërkombëtar, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka vazhduar lidhur me formalizimin e marrëveshjeve për bashkëpunim kulturor me shtetet respektive. Në këtë kuadër gjatë viti 2016 janë nënshkruar marrëveshjet për bashkëpunim kulturor mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë si dhe mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Bullgarisë. Gjithashtu janë ndërmarr edhe nisma për zhvillimin e negociatave me shtetet respektive sikurse Mali i Zi, Turqia, Italia, Zvicra, Japonia dhe Franca. Gjatë vitit 2016 Ministria e Kulturës së Republikës së Kosovës ka vazhduar me zbatimin e Protollit të Bashkëpunimit Kulturor me Ministrinë e Kulturës së Republikës së Shqipërisë.

TRASHËGIMIA KULTURORE

Në kuadër të politikës programore: *Mbrojtja dhe ruajtja*, janë realizuar këto aktivitete: Rregullorja NR.09/2016 për Dhënie e Çmimeve në fushën e trashëgimisë kulturore; Rregullorja për Shpalljen e Parkut arkeologjik “Ulpiana”.

Me datë 30 dhjetor 2016 Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore 2017-2027.

Në zbatim të Rregullores NR.09/2016 për Dhënie e Çmimeve në fushën e trashëgimisë kulturore, për herë të parë është bërë shpallja/ thirrja për propozime.

Lista e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme, 1534 asete dhe Lista e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përhershme 23 asete.

Në kuadër të politikës programore: *Kërkimet dhe prezentimet*, janë realizuar projektet sipas planifikimit: Për kategorinë e trashëgimisë arkeologjike: Kalaja e Prizrenit; Lokaliteti i Dersnikut; Kalaja e Harilaqit; Kalaja e Novobardës; Gjurmimet në lokalitetin në Barilevë; Gëhimet arkeologjike në Kalanë e Korishës; Hapja e Parkut Arkeologjik “Ulpiana”.

Për kategorinë e trashëgimisë arkitekturore: Shtëpia e Katarina Josipit në Zym; Kulla në Aqarevë; Kompleksi i IMMK-së në Prishtinë; Kulla e Jusuf Gervallës në Dubovik.

Në këtë kuadër, nga institucionet vartëse të trashëgimisë kulturore (Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore) janë hartuar edhe 30 projekte për ndërhyrje në ndërtesa me status të mbrojtjes si dhe Studimi i Fizibilitetit për Muzeun e Historisë së Natyrës.

Gjatë këtij viti, janë realizuar edhe disa botime: Publikimi i rezultateve në fushën e trashëgimisë arkeologjike; Trashëgimia Kulturore e Gjilanit; Katalogu me eksponate nga Rajoni i Gjilanit; Guida arkeologjike: Trashëgimia Kulturore e Prishtinës; Trashëgimia Arkeologjike e komunës së Istogut; Broshura për parkun arkeologjike për Parkun Arkeologjik “Ulpiana” si dhe Botimi i punimeve të konferencës së parë “Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi”.

Në kuadër të politikës programore: *Promovimi*, janë realizuar këto aktivitete: Shënimi i Ditës ndërkombëtare për lokalitete dhe monumente; Shënimi i Ditës ndërkombëtare për Muzetë si dhe në përmbyllje të Ditëve të Trashëgimisë Kulturore Evropiane, është mbajtur konferenca e dytë ndërkombëtare: Menaxhimi dhe Promovimi i Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore”.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucione tjera, për DTK është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me Fakultetin Filozofik për angazhimin e studentëve të historisë arkeologjisë dhe etnologjisë në aktivitete të institucioneve vartëse të trashëgimisë kulturore.

RINIA

Gjatë vitit 2016 në Departamentin e Rinisë janë shënuar suksese të shumta, janë realizuar projekte të reja, është bërë plotësimi i legjislacionit (Udhëzimeve administrative për Edukim Joformal dhe Udhëzimi për Punë Vullnetare).

Në kuadër të rritjes së bashkëpunimit rajonal në fushën e rinisë, është nënshkruar Marrëveshja për Themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Paris më 04 Korrik 2016. Kjo zyre selinë kryesore e ka në Tiranë, Shqipëri. Kjo marrëveshje është negociuar në kuadër të Procesit të Berlin-it.

Afirmimi i rolit të rinjve dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së rinjve në sferën publike të nivelit lokal dhe qendror ka qenë prioriteti kryesor i yni. Për këtë qëllim, gjatë tërë vitit në mënyrë të vazhdueshme kemi mbështetur KVRL-ët dhe KQVR-ën, përmes mbështetjes së tyre në aspektin financiar, teknik, organizimit të sesioneve për ngritje të kapaciteteve, avokim për anëtarësimin e tyre në mekanizma tjerë institucional e kështu me radhë. Lidhur me politikën rinore në nivel lokal këto janë të hartuara nga komunat përkatëse dhe KVRL-të,

si dhe organizatat rinore, që janë të përmbledhura në Planin Lokal të Veprimit për Rini. Më saktësisht, 10 komuna (Malisheva, Vushtrria, Prizreni, Suhareka, Viti, Gjakova, Drenasi, Peja, Klina dhe Klllokoti) kanë të miratuar PKVR me buxhet, 5 të tjera e kanë të miratuar këtë plan por pa buxhet (Deçani, Juniku, Rahoveci, Istogu dhe Parteshi), kurse 8 komuna kanë hartuar planin në fjalë, por nuk e kanë të miratuar në Kuvend Komunal (Dragashi, Ranilluga, Ferizaji, Kaçaniku, Gjilani, Kamenica, Fushë Kosova dhe Prishtina), 2 komuna janë në proces të hartimit të Planit Lokal të Veprimit për Rini (Mitrovica dhe Shtimja), ndërsa 6 të tjera nuk e kanë filluar ende këtë proces (Skenderaji, Podujeva, Obiliqi, Hani i Elezit, Lipjani dhe Graçanica).

Gjithashtu, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të organizatave rinore, kemi mbështetur një numër të madh të punëtorive për aftësimin e organizatave rinore, si: Erasmus +, planifikim strategjik, këshillim dhe orientim në karrierë, pastaj sesioneve informuese dhe vetëdijësuese lidhur me legjislacionin, programet dhe projektet e ndryshme ku mund të përfshihen, si dhe konferenca të ndryshme me qëllim të bashkërendimit të hisedarëve dhe veprimeve në fusha të ndryshme. Në këtë aspekt, kontribut domethënës kanë ofruar edhe disa donatorë që veprojnë në Kosovë.

Lidhur me parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm janë mbështetur rreth 15 projekte.

Departamenti i Rinisë në bashkëpunim Friedrich Ebert Stiftung dhe OJQ-në Debate Center, kanë realizuar projektin "Debat" sipas modelit British Parliamentary, në mënyrë që të krijojmë mundësitë për të rinjtë e Qendrave Rinore që të zhvillojnë aftësitë e tyre argumentuese, retorikën dhe mendimin kritik si parakusht për pjesëmarrjen e tyre në proceset socio-politike dhe vendimmarrëse sipas modelit British Parliamentary. Projekti është realizuar gjatë muajve Prill - Maj 2016. Gjatë projektit janë certifikuar 189 të rinjë, femra 124 dhe 65 meshkuj dhe 10 përfaqësues të Qendrave Rinore.

Gjithashtu Sektori për Edukim Jo formal- në bashkëpunim me organizatën Friedrich Ebert Stiftung dhe D4D, kanë realizuar projektin "Sallonet" në tetë komuna të Kosovës. Sallonet janë një nismë nga Institutit Demokraci për Zhvillim (D4D). Sallonet kanë format gjysmë-formal sipas rregullës ChathamHouse. Diskutimet kanë mbledh rreth vetes ekspertë e analistë, politikanë e publicistë për të reflektuar dhe kërkuar konsensus mbi temat përzgjedhura. Koha e realizimit të projektit ka qenë Prill - Dhjetor 2016.

Në kuadër të bashkëpunimit mes Kosovës dhe Shqipërisë, njëherit zbatimit të marrëveshjes në fushën e rinisë mes dy vëndeve tona, të firmosur në korrik të vitit 2015 si dhe kalendarit të aktiviteteve të përbashkëta për vitin 2016, është mbajtur punëtorja e përbashkët tre ditore me të rinjë nga Kosova (20) dhe Shqipëria (20) me temën "Roli i tolerances fetare si mekanizem për parandalimin e ekstremizmit" dhe "Roli i mediave në tolerancën fetare si mekanizem për parandalimin e ekstremizmit" tema të cilat janë në kuadër të lëvizjes "No Hate Speech" e cila është pjesë e Këshillit të Evropës.

Në kuadër të bashkëpunimit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve/Departamenti i Rinisë/Sektori për Promovim, Ministrisë Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe nën mbështetjen financiare të organizatës Gjermane DVV Internacional kemi përkrahur organizatën "IRDNJ" në realizimin e projektit „Vëzhgo merr pjesë dhe mëso“ si pjesë e organizimit „Java së të mësuarit gjatë gjithë jetës“ në Kosovë. Qëllimi i projektit ka qenë promovimi i edukimit jo-formal për të rinjë përmes pesëmbëdhjetë seminareve në 15 komuna të Republikës së Kosovës ku përfitues ishin 450 të rinj.

Bazuar në Strategjinë Kosovare për Rini 2013-2017 dhe Planin e Veprimit 2016-2017, Departamenti i Rinisë/Sektori për Promovim ka realizuar audio/video reklamën "Promovimi dhe Nxitja e Edukimit Jo-formal" spoti do lëshohet gjatë vitit 2017 - 2018.

Në kuadër të komponentës së Ndërmarrësisë, Sektori për Punësim, ka realizuar aktivitetin trajnime për ndërmarrësi dhe zhvillim të planeve të biznesit për rinjtë (e moshës 18-24 vjeç). Objektivi i kryesor i këtij projekti ka qenë ofrimi i shërbimeve për zhvillimin e shkathësive për ndërmarrësi dhe zhvillim të planit të

biznesit për 200 të rinjë, nga të gjitha rajonet kryesore të Kosovës. Trajnimet kanë përfshi këto module: Hyrje në ndërmarrësi, Marketing, Planifikimi i biznesit, Planifikimi financiar. Implementues ka qenë organizata MDA.

Trajnimet janë ofruar për 200 të rinj nga 7 (shtatë) rajonet kryesore të Kosovës (Prishtinë 2 grupe, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjilan, Ferizaj) dhe në 1 (një) komunë me shumicë serbe përkatësisht në komunën e Graçanicës.

Në kuadër të projektit për ngritjen e shkathtësive për kërkim pune, Departamenti i Rinisë/Spektori për Punësim gjatë këtij viti, përmes programeve trajnuese për ngritjen e shkathtësive për punësim për rinjtë (e moshës 15-24), duke u fokusuar në përmbushjen e këtyre objektivave: Zhvillim personal i të rinjve; Rritja e shkathtësi për kërkim pune nga të rinjtë; Rritja e aftësive të komunikimit. Janë përkrahur 8 organizata (dy prej të cilave kanë qenë nga komuniteti serb) për të ofruar shërbime në lëmin e shkathtësive për kërkim pune. Podujevës, Mitrovicës, Lipjanit, Fushë Kosovës, Shtimes dhe Mitrovicës së Veriut.

Gjatë vitit 2016 me sukses është arritur finalizimi i hartimit dhe implementimit të Planit të Veprimit për Rini. Përkatësisht janë definuar objektivat, aktivitetet dhe rezultatet në mënyrë specifike për këtë vitë, në kuadër të divizionit që përfshinë Sektorin për Siguri Njerëzore; Sektorin Kulturë, Sport dhe Rekreacion si dhe Sektorin për Parandalim dhe Edukim Shëndetësor.

Është arritur të përmbyllët me sukses të plotë plotësim-ndryshim dhe aprovimi i Udhëzimit Administrativë për Punë Vullnetare për të Rinjë 01/2016, duke arritur që për herë të parë të ofrohet njohja e punës vullnetare për të rinjtë e grup-moshës 15-24 vjeçar. Po, ashtu kemi arritur falë mbështetjes të UNICEF të hartojmë dhe Platformën dhe Databazën për Punë Vullnetare shërbim elektronik institucional që është në dispozicion të të rinjëve falas për procesin e rekrutimit, promovimit dhe njohjes online të kontributit vullnetar rinor.

Është organizuar kampanja për zbatimin e objektivës për promovimin e mënyrës së shëndetshme të jetesës të të rinjtë. Janë përkrahur gjithsejtë 15 qendra rinore dhe OJQ rinore. Nga të cilat prite të përfitojnë gjithsejtë drejtpërdrejt ose tërthorazi 3700 të rinj.

SPORTI

Departamenti i Sportit në kuadër të Divizionit të Federatave,Infrastrukturës së sportit dhe sportit shkollor është angazhuar maksimalisht në përmbushjen e objektivave dhe detyrave të MKRS-së, me qëllim të realizimit të planit të paraparë e në përputhje me politikat programore dhe strategjinë e realizimit të objektivave të Departamentit të Sportit.

Pjesëmarrja në garat ndërkombëtare dhe seminarët ndërkombëtarë :

- Lojërat Olimpikë verore Rio 2016;
- Kampionatet Botërore, Evropiane, Mesdhetare dhe Ballkanike;
- Kupat Botërore, Evropiane, Mesdhetare dhe Ballkanike;
- Turne zyrtare ndërkombëtare të kategorive junior dhe senior;
- Turne mbarëkombëtare të karakterit tradicional.

Seminarët ndërkombëtare:

- Seminarët për trajner;
- Seminarët për gjyqtar sportiv;
- Seminarët për garues / lojtarë;
- Seminarët për menaxher dhe administrator të sportit;

Rezultatet dhe sukseset në arritjet sportive:

Federata e Xhudos, shpallja e Majlinda Kelmendit Kampione Bote në Rusi dhe Nora Gjakovës stolisja më medalje të bronzë ku për herë të parë zyrtarisht ngritët flamur dhe himni para gardës .

Federata e Karatesë, Reprerentacioni i seniorëve në Kampionatin Evropian për regjione nën kampione si dhe në U-21, Orges Arifi kampion në Kupën e Botes si dhe Alma Lokaj në kategorinë e të rejave Kampione.

Federata e Atletikës, Musa Hajdari nën kampion Ballkanike, si dhe prezantim dinjitoze në Turnet prestigjioze të atletikes në Evrope.

Pranimi i Federatës së Futbollit në UEFA dhe FIFA dhe pjesëmarrja e kombëtares së Kosovës në gara kualifikuese për botërorin që do te mbahet në „Rusia 2018“.

Pranimi më të drejta të plota të Federatës së Skijimit në Federatën ndërkombëtare (FIS).

Përgatitje e Federatës së Basketbollit në Kualifikime për Kampionatin Evropian për të dy gjinitë U-18.

Organizimi i Kampionatit Evropian në Shah për here të parë në Kosovë

Organizimi i Kampionatit Evropian në Minigolf për here të parë në Kosovë.

Organizimi Gjysme-maratonës në Prishtinë.

Pjesëmarrja e Federate së Boksit në Kampionatin Botëror në Azerbajxhan, si dhe në Kampionatin Evropian për junior në Hungari.

Pjesëmarrja e Federatës së Ping-pongut në Kampionatin Botëror në Malajzi.

Pjesëmarrja e Federatës së Shenjëtarisë në Kampionatin Evropian, si dhe pjesëmarrja në aktivitete të rëndësishme për këtë sport.

Pjesëmarrjen e Kosovës për herë të parë në Olimpiade në Rio të Brazilit si dhe suksesin e Majlinda Kelmendit që shënon një histori të re të Sportit të Kosovës (vendi i parë, medalja e artë në kategorinë -52 kg.) që për sportin e Kosovës është historike .

Ky rezultat është një nga ngjarjet më të rëndësishme që e karakterizon jo vetëm këtë vit, por në përgjithësi sportin e Kosovës. Suksesi i Majlinda Kelmendit është i lidhur pa dyshim ngushte më mbështetjen e vazhdueshme të Departamentit të sportit në 8-të vitet e fundit që ju është bërë Federatës së Xhudos , në veçanti Majlinda Kelmendit dhe trajnerit Driton Kuka, gjithmonë duke iu referuar buxhetit të vogël që ka poseduar Divizioni i Federatave.

Pjesëmarrja e Federatës së Basketbollit të Kosovës në garat Kualifikuese për Kampionatin Evropian për herë të parë në gara zyrtare të organizuara nga FIBA-Evropë, të cilat mund të cilësohen si prezantim solid duke pasur parasysh që jemi në hapat e parë të konsolidimit të Reprerentacioneve të Sporteve kolektive pas pranimi më të drejta të barabarta në Federata Ndërkombëtare.

Pjesëmarrja e Federatës së Boxit në Kampionatin Evropian për Junior në Bullgari, ku Donjeta Sadiku stoliset më medaljen e artë, vendi i parë në këtë Kampionat, që jep të kuptojmë që kemi të bëjmë më një sportiste mjaft cilësore e cila kërkon vëmendje të shtuar nga Institucionet e sportit .

Garat shkollore, universitare janë organizuar dhe zbatuar nga federata e sportit shkollorë, shoqata e pedagogëve të kulturës fizike, asociacioni i sportit universitar, ndërsa financimi është bërë nga MKRS - departamenti i sportit dhe organizatat tjera buxhetore.

Organizimi i garave është zhvilluar në këto nivele:

- Organizimi i garave ne nivel komunal
- Organizimi i garave në nivel regjional
- Organizimi i garave në nivel republikan

Gjatë këtij viti është vazhduar në investime të reja po ashtu në vazhdimin e ndërtimit të palestrave sportive të filluara nga viti paraprake siç janë Istogu, Rahovec, Shtimja, Deçani, Skenderaj, Dardana, Klina, Kaçanik, Viti dhe Dragash dhe Sallave të Palestrës së Sportit në Samadrexhë të Vushtrrisë dhe Zhegër të Gjilanit.

Ndërtimi i Poligoneve sportive në qendrat regjionale, ndërtimi i terreneve sportive në Komunën e Podujevës dhe Gjakovës, renovimi i palestrave ekzistuese në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, Palestra në Pejë, Palestra në Gjakovë, Palestra Shkollore „Bedri Pejani” në Pejë.

Rinovimi i disa prej objekteve ekzistuese të stadioneve, siç janë Renovimi i Stadiumit të Prishtinës, Fizibiliteti për Ndërtimin e Stadiumit Kombëtar, Renovimi i Stadiumit „Zahir Pajaziti” në Podujevë, Aneksat në stadiumin e Pejës, Renovimi i Stadiumit Lipjan, Ndërtimi i Stadiumit „Shahin Haxhiislami” në Pejë, Ndërtimi i Stadiumit Gjilan, Nderimi i Stadiumit për futboll në Komunën e Shtërpçës.

Ndërtimi i terreneve të Tenisit në Komunën e Gjakovës dhe Pjesë.

Rinovimi i disa prej objekteve ekzistuese si në Palestrën e Sportit në qendrat regjionale në komunat sipas kërkesave, Renovimi i Stadioneve në Qendrat Regjionale, inicimi për Ndërtimin e projektit për Ndërtimin e Stadiumit Ndihmës të Futbollit në Komunën, Prizrenit.

Rinovimi i reflektorëve në Stadiumin „Adem Jashari” në Mitrovicë, me qëllim të funksionalizimit të stadiumit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e garave me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar.

TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFERTA

Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (ZDA) ka vazhduar të luajë rol të rëndësishëm në krijimin e një sistemi funksional të të drejtave të autorit në Republikën e Kosovës, në funksion të zbatimit të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe në krijimin e politikave për fushën e të drejtës së autorit. Gjatë vitit 2016 ZDA duke zbatuar planin e punës së Qeverisë së Kosovës, ka realizuar seminare, punëtori, trajnime dhe një konferencë me qëllim të promovimit të drejtës së autorit dhe vetëdijesimit të publikut. Vlejnë të përmenden posaçërisht ligjëratat me studentë dhe mbajtës të të drejtave.

Koordinimi i luftës kundër piraterisë të Task Forcës kundër Piraterisë ka qenë prioritet i veçantë i ZDA-së, në të gjitha qytetet kryesore të vendit janë zhvilluar veprime kundër piraterisë, si rezultat janë sekuestruar me mijëra kopje pirate të librave, CD-ve dhe DVD-ve që kanë përmbajtur materiale të mbrojtura. Falë koordinimit të ZDA-së janë marrë edhe veprimet e para hetimore për shkeljet në fushën e piraterisë digjitale dhe priten vendimet e organeve kompetente të drejtësisë për bllokimin apo ndalimin e qasjes në shumë ueb-faqe pirate.

Organizimi i tre punëtorive për gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe institucione të zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, konsiderohet të jetë i një rëndësie të veçantë në përgatitjen e gjyqtarëve dhe pakurorëve për të vendosur dhe hetuar lëndët nga fusha e të drejtës së autorit. Të gjitha punëtoritë janë organizuar falë aplikimeve që janë bërë nga ana e ZDA-së në Programin e TAIEX të Komisionit Evropian, pra me fonde të BE-së.

Vlen të përmendet edhe pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e të drejtës së autorit duke përmendur këtu Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe raportet shumë të mira të krijuara me Zyrën e Mbretërisë së Bashkuar për të Drejtat Pronësore Intelektuale dhe me Zyrën për Patenta dhe Marka Tregtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zyra nga të cilat është përfituar me trajnime dhe ekspertë. Falë raporteve shumë të mira me Zyrën e Mbretërisë së Bashkuar për të Drejtat Pronësore Intelektuale, një nga ekspertet kryesor të zbatimit të drejtave pronësore intelektuale të kësaj zyre, është angazhuar në konsultime për hartimin e Strategjisë për Piraterinë 2017-2021 të Republikës së Kosovës. Përforcimi i kapaciteteve të ZDA-së përmes trajnimeve të mbajtura gjatë 2016 është shumë i rëndësishëm, që Kosova të ketë një ZDA me staf të trajnuar dhe përgatitur profesionalisht.

- MINISTERIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Gjatë vitit 2016, MMPH ka vazhduar me plotësimin e kornizës legislative. Nga legjislacioni primar është miratuar në Kuvend Ligji për performance eficiencës së energjisë në ndërtesa, kurse në Qeveri janë miratuar edhe dy projekt ligje: Projektligji për mbrojtjen nga zhurma, i cili aktualisht është në procedure të miratimit në Kuvend dhe Projekt ligji për Infrastrukturën e Informacionit Hapësinor. Gjithashtu janë miratuar edhe 3 koncept dokumente. Nga legjislacioni sekondar MMPH ka miratuar 13 akte nenligjore, prej të cilave : 10 Udhëzime Administrative (prej të cilave 5 janë nga fusha e mjedisit, 2 janë nga fusha e ujërave si dhe 3 janë nga fusha e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit); 1 Rregullore (nga fusha e ujërave); 2 Vendime (nga fusha e mjedisit) si dhe 3 koncept dokumente.

Në qellim të përmirësimit të vazhdueshëm të **gjendjes në mjedis**, MMPH ka vazhduar me ndërmarrjen e maasave zbatuese të cilat edhe ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe ka përmbushur aktivitetet në vijim:

Gjatë këtij viti, me Vendim të Qeverisë është themeluar Bordi Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, si një trup i rëndësishëm e këshillëdhënës për çështje të rëndësishme mjedisore.

Është përgatitur dhe miratuar nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit, në kuadër të së cilit është prezantuar gjendja dhe janë dhënë rekomandimet për përmirësim. AMMK ka përfunduar me përgatitjen dhe finalizimin e Inventarit të gazërave serrë për vitin 2014 si vit referues, sipas të cilit është vlerësuar se burimi kryesor i gazërave serrë në Kosovë është sektori i energjisë me 88 % të totalit të emetimeve. Gjithashtu është bërë matja e emisioneve nga Impiantet me djegie të mëdha (Termocentrali Kosova A dhe Termocentrali Kosova B) dhe është bërë ngritja e kapaciteteve teknike dhe humane për monitorimin e emisioneve në kuadër të projektit të mbështetur nga JICA.

Në kuadër të projektit të mbështetur nga Agjencia Evropiane e Mjedisit, për herë të parë në Kosovë, AMMK ka bërë ripërpunimin e të dhënave për vitin 2006, prodhimin e të dhënave për vitin 2012 dhe vlerësimin e ndryshimit të mbulushmërisë së tokave sipas kategorive për vitet 2006-2012. Projekti për mbulueshmërinë e sipërfaqes së tokave 2006-2012, sipas metodologjisë CORINE është finalizuar dhe është hartuar raporti final.

Sa i përket **menaxhimit të mbeturinave**, ka përfunduar Master Plani për menaxhimin e Mbeturinave, hartimi i të cilit është bërë nën përkrahje të KE. Poashtu, është përgatitë Studimi i parafizibilitetit për deponinë e mbeturinave komunale në Dragash. Vlerësimi për gjendjen e mbeturinave të rrezikshme në Kosovë, në të cilin është i përfshirë Inventari i mbeturinave të rrezikshme, vlerësimi dhe inventari kombëtar, ka përfunduar. Ueb aplikacioni për Sistemin Informativ për Menaxhimin e mbeturinave, përmes së cilit i jepet mundësia të gjitha institucioneve relevante (MMPH, Komunitat, KR të Mbeturinave etj) që të shkëmbejnë të dhënat në këtë system, është finalizuar. Poashtu në bashkëpunim me GIZ, është bërë evidentimin e deponive ilegale të mbeturinave në 16 komuna të Kosovës. Në funksion të menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme, nga Qeveria është marrë Vendim për themelimin e ndërmarrjes publike, me emërtimin "Ndërmarrja për magazinimin e mbeturinave të rrezikshme" si dhe është nxjerrë Vendimi i Qeverisë për përzgjedhjen e lokacionit për ndërtimin e Deponisë për rruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme.

Sa i përket **mbrojtjes dhe menaxhimit të resurseve ujore**, në këtë kuadër me zhvillimin e projektit përkrahës, është fuqizuar sektori i hidrologjisë dhe ka filluar monitorimi automatik i sasisë së ujërave (prurjet sipërfaqësore në lumenjtë e Kosovës). Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, për herë të parë ka përgatitur Vjetarin Hidrometeorologjik për 2014, ku janë prezantuar të dhënat të detajuara hidrologjike dhe meteorologjike. Poashtu, ky Institut ka arritur marrëveshje ndër-regionale me Institutet dhe Shërbimet tjera përkatëse në regjionin e Ballkanit, për shkëmbimin e të dhënave hidrologjike në kuadër të avancimit të paralajmërimi të hershëm për vërshime.

Lidhur me **mbrojtjen e natyrës**, ka vazhduar ndërmarrja dhe zbatimi i masave për këte qëllim. Nga ana e Qeverisë është miratuar Raporti për gjendjen e natyrës për periudhën 2010-2014. Në kuadër të hapave në identifikimin e zonave potenciale për NATURA 2000, është finalizuar dokumentit për caktimin e regjioneve biogeografike të Kosovës. Poashtu është bërë shenjëzimi i 130 monumenteve të mbrojtura të natyrës, në të gjithë territorin e Kosovës, ku janë prezantuar të dhënat bazike për secilin nga këto monumente.

Pas finalizimit të arsyeshmërisë profesionale, janë përgatitur 18 vendime për shpalljen e rezervateve striktë të natyrës, të cilat janë miratuar nga Qeveria e Kosovës.

Është përgatitur dhe finalizuar Plani Hapësinorë për Parkun Kombëtarë Bjeshkët e Nemuna dhe është në procedurë për miratim.

Me qëllim të mbrojtjes së resurseve natyrore në PK Bjeshkët e Nemuna, ka filluar monitorimi i tyre përmes vendosjes së kamerave vëzhguese 24 orëshe në hyrje daljet kryesore të territorit të Parkut, vendosjes së tabelave informuese në Park dhe forcimit të bashkëpunimit me komunitetin dhe autoritetet përkatëse, është fuqizuar.

Poashtu, është bërë edhe regjistrimi dhe kontrollimi i ndërtimeve në Parkun Kombëtarë Sharri dhe PK Bjeshkët e Nemuna si dhe është hartuar Plani për menaxhimin e produktet pyjore jo-drusore për PK Sharri dhe PK Bjeshkët e Nemuna.

Ka vazhduar monitorimi i faunës (gjitarëve) përmes kamerave kurthe në PK Sharri dhe PK Bjeshkët e Nemuna, nga janë mbledhur të dhëna për praninë e disa llojeve të rralla dhe të rrezikuara të faunës në këto zona. Gjithashtu, është përgatitur edhe baza e të dhënave për biodiversitetin në bazë të të dhënave aktuale që posedon Instituti për Mbrojtjen e Natyrës.

Nga fusha e **planifikimit hapësinor, ndërtimit, banimit dhe administrimi i tokës dhe zhvillimit të kadastrit**, gjatë vitit 2016, MMPH/IPH ka zhvilluar dhe trajtuar 35 indikatorë themelor për Planifikim Hapësinor, që do të shërbejnë për hartimin dhe vlerësimin e planeve hapësinore të nivelit qendror dhe lokal të planifikimit. Ky dokument i është prezentuar të dy niveleve .

Gjatë vitit 2016, në bazë të Vendimeve Përfundimtare të cilat janë në fuqi për të gjitha projektet nacionale **për shpronësim**, MMPH ka kompensuar 812 pronarë për 1087 parcela dhe buxheti prej 27,145,314 euro është realizuar 98%.

AKK ka vazhduar me regjistrimin e pronave të shpronësuara **në Kadastër** në nivel nacional, dhe gjatë këtij viti numri i pronave të regjistruara sipas Sistemit të Informacioneve të Kadastrit për tokën në Kosovë (SIKTK) është 83.571.

Sa i përket mbrojtjes së të dhënave kadastrale në rast të ndonjë fatkeqësie, është themeluar Qendra e dytë e Teknologjisë Informative dhe është bërë konsolidimi i harduerit, në koordinim edhe me Agjencinë e Regjistrimit Civil në kuadër të MPB.

Gjithashtu AKK gjatë këtij viti në përkrahje të zyrës së BE-së dhe Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë ka zhvilluar projektin për vendosjen fizike të tabelave të rrugëve në 10 Komuna dhe vendosjen fizike të numrave të hyrjeve të objekteve të banimit në 8 Komuna. Vendosja e tabelave ka përfunduar në 5 komuna është në përfundim e sipër në katër të tjera përveç në komunën Ranillug, për arsye teknike pezullohet përkohësisht. Vendosja fizike e numrave të hyrjeve të objekteve të banimit është duke përfunduar, përveç në Glllogoc ende nuk ka filluar për shkaqe teknike.

Në kuadër të **aktivitetit të Inspektoratit**, për ndalimin e të gjitha ndërhyrjeve në zonat e veçanta të mbrojtura të natyrës, janë zhvilluar aktivitete ri-inspektive për ndërtimet e paligjshme në zonën e Ujëvarës së Mirushës dhe MMPH ka inicuar procedurë kundërvajtëse. Gjithashtu, inspektorati në funksion të monitorimit të zbatimit të legjislacionit mjedisor në fuqi ka kryer 577 inspektime me procesverbal të operatorëve ekonomik, ka lëshuar 29 vendime; 57 inicime në Gjykatë; 530 rekomendime, dhe vërejtje dhe ka kryer 35 inspektime të përbashkëta me KFOR-in, FSK-në, etj. rreth menaxhimit dhe mbikëqyrjes së materialeve të rrezikshme.

Për zbatimin e legjislacionit në fuqi, MMPH ka kryer edhe aktivitetet e rregullta në lëshimin e lejeve, kushteve dhe pëlqimeve tjera sin ë vijim:

- Nga **fusha e mbrojtjes së mjedisit** janë lëshuar: 10 Licenca për menaxhimin e mbeturinave, një leje për import të kimikateve, 28 leje për produkte Biocide, 25 leje për import për qese plastike pa aditiv, 8 leje për eksport të mbeturinave, 2 leje për hulumtime shkencore në natyrë, 1 Leje për importimin e Tre arinjve të shpëtuar, 131 Pëlqime Mjedisore, 11 Pëlqime Mjedisore Strategjike dhe 52 Leje Mjedisore.
- Nga **fusha e ujërave** janë lëshuar 29 Leje Ujore, 37 Konkluzione, 27 Kushte ujore, 8 pëlqime Ujore, 9 Vendime për vazhdime të Lejeve ujore dhe 8 Ndryshim Vendime.
- Nga **fusha e planifikimit dhe ndërtimit** janë lëshuar 3 kushte Ndërtimore për objekte të kategorisë së tretë dhe 4 për kategoritë tjera dhe janë lëshuar katër 4 Leje Ndërtimore dhe 1 Certifikatë e Përdorimit. Te hyra nga taksat për Lejet e Ndërtimit për vitin 2016 janë **87.569,62 €**.

- **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Në luftën kundër krimeve të rënda, terrorizmit, krimet të organizuar dhe korrupsionit, Policia e Kosovës ka zhvilluar 887 operacione, ka goditur 38 grupe kriminale, arrestuar 1246 persona, si dhe ushtruar 1154 kallëzime penale. Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka kryer rreth 4,500 ekspertiza forenzike si ka akredituar sipas standardit ISO17025 pesë laboratorë të saj. Është bërë rishikimi dhe vlerësimi i strategjive nacionale në fushën e drogave, krimet të organizuar, terrorizmit, sigurisë kibernetike dhe policimi i udhëhequr nga inteligjenca. Janë finalizuar strategjitë e reja për sigurinë në bashkësi dhe kontrollin e armëve të vogla, lehta dhe eksplozivëve. Gjithashtu, Policia e Kosovës ka hartuar Vlerësimin e Rrezikut nga Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar (SOCTA) 2015-2015 sipas standardeve të EUROPOL. Në fushën e terrorizmit, Policia e Kosovës ka trajtuar 47 raste, ka arrestuar 33 persona, ka ngritur 30 kallëzime penale ndaj 78 personave si dhe ka realizuar 9 operacione dhe 32 bastisje. Për më tepër, si rezultat i zbatimit të policimit të udhëhequr nga inteligjenca dhe bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndërkombëtar janë parandaluar sulmet terroriste në vend dhe nuk janë evidentuar raste të reja të luftëtarë të huaj në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak.

Sa i përket **rritjes së sigurisë publike**, fokus i veçantë është drejtuar në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm. MPB ka realizuar një sërë aktivitete me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve dhe institucioneve, mediave, shoqërisë civile e bashkësive fetare sa i përket dukurisë së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. MPB ka organizuar dhe ka marrë pjesë në 24 takime të forumeve lokale të sigurisë, në 4 tryeza të përbashkëta me qytetarë dhe institucione të ndryshme, si dhe ka hartuar një strategji komunikimi në këtë fushë dhe është në finalizim të fushatave dhe spoti i cili do të jetë në funksion të ngritjes së vetëdijesimit të qytetarëve të Kosovës. Është themeluar Mekanizmi Referues në Gjilan, i cili ka për qëllim identifikimin e hershëm të individëve të radikalizuar dhe ofrimit të mbështetjes për personat e prekur me qëllim të parandalimit të radikalizmit të mëtutjeshëm të tyre dhe ri-socializimit në komunitetin që e rrethon. Në 2016 janë pezulluar aktivitetet e 5 OJQ-ve të cilat janë identifikuar se angazhohen në përhapje të ekstremizmit të dhunshëm.

Inspektorati Policor i Kosovës gjatë vitit 2016 ka pranuar dhe ka menaxhuar me 1246 ankesa dhe informata, prej tyre 748 ankesa që janë klasifikuar si shkelje disiplinore e profilit të ultë dhe janë përcjellë për t'u trajtuar në Drejtorinë e Standardeve Profesionale në Policinë e Kosovës. Nga 162 raste me elemente të veprës penale, 98 janë dërguar me kallëzim penal nga Departamentet e Hetimeve në prokuroritë kompetente, ndërkaq me raport të veçantë janë dërguar 32 raste. Në total 238 punonjës të Policisë kanë qenë si subjekt i hetimit nga IPK. Deri me 1 dhjetor të vitit 2016 IPK ka ndërmarrë këto masa dhe rekomandime: 69 arrestime, 93 rekomandime për suspendime dhe 4 rekomandime për transfer. Gjithashtu, IPK-ja ka hetuar 44 raste të veprave penale me elemente të korrupsionit dhe veprave tjera kundër detyrës zyrtare .

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të institucioneve të sigurisë publike, Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka organizuar 110 trajnime dhe janë trajnuar 2, 613 pjesëmarrës. AKSP ka finalizuar draft-marrëveshjen me Agjencinë e BE-së për Trajnim të Agjencive të Zbatimit të Ligjit (CEPOL). AKSP ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Akademinë Policore të Malit të Zi. Agjencia për Menaxhim Emergjent ka përfituar nga projekti rajonal "IPA FLOODS II" me qëllim rast Njësia Shpëtim në Ujëra është pajisur me të gjitha pajisjet logjistike të nevojshme për veprim. Është aprovuar Strategjia Shtetërore për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i Veprimit 2016-2019 si dhe janë themeluar Ekipet Reaguese për Emergjencë Kompjuterike (CERT) në MPB dhe PK.-MPB ka finalizuar projekt-ligjin për Infrastrukturën Kritike i cilit pritet të dërgohet për miratim në Qeveri në fillim të 2017.

Procesi i **integritit Evropian dhe bashkëpunimit ndërkombëtar**, MPB dhe agjencitë e saj kanë qenë përgjegjëse për 70 prej 95 kritereve të Udhërrëfyesit për Liberalizmin e Vizave dhe të gjitha janë përmbushur

plotësisht. Në kuadër të Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, MPB është përgjegjëse për zbatimin e 99 masave zbatuese dhe 14 masave legislative, nga të cilat 24 janë përfunduar, 34 janë në realizim e sipër dhe 55 masa adresohen në vazhdimësi dhe raportohen përmes të dhënave statistikore. Është nënshkruar marrëveshja për vendosjen e bashkëpunimit operativ me FRONTEX. Është iniciuar procesi për nënshkrim të marrëveshjes me EUROPOL dhe kanë vazhduar përpjekjet intensive për anëtarësim në INTERPOL. Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor, është nënshkruar marrëveshja me Lituaninë ndërsa janë në fazë të negocimit marrëveshjet me Turqinë, Estoninë, Italinë, Belgjikën, Danimarkën.

MPB dhe agjencitë e saj, gjatë vitit 2016 kanë arritur rezultate konkrete në **menaxhimin i migrimit dhe riintegrimin të qëndrueshëm**. Si rezultat i masave dhe politikave të ndërmarra numri i kërkesave për azil nga qytetarët e Kosovës në vendet e BE dhe Zonës Schengen ka rënë nga 73,2015 të vitit 2015 në 10,220 në vitin 2016. Ndërsa, numri i përgjithshëm i shtetasve të Kosovës të ri-pranuar deri në fund të nëntorit 2016 është mbi 13,000. Është miratuar Profili i Migrimit i cili përmban të dhënat dhe analizën e trendeve të migrimit për vitin 2015 dhe është emëruar Koordinatorin Nacional për Migrim përgjegjës për Monitorimin e Lëvizjeve të Migrimit dhe koordinimin e të gjitha institucioneve përgjegjëse në fushën e migrimit. Me qëllim të menaxhimit të flukseve të mundshëm me refugjatë është hartuar Plani i Reagimit i cili do të azhurnohet varësisht nga gjendja në terren. MPB gjithashtu është fokusuar në përmirësimin e politikave për **riintegrimin e personave të riatdhesuar** përmes fondit të posaçëm për Ri-integrim. Janë hartuar dhe miratuar Planet Komunale për ri-integrim në 34 komuna të Republikës së Kosovës. Është hartuar dhe miratuar Udhëzuesi për Ripranimin dhe Riintegrimin e Fëmijëve të Pashoqëruar. Nga Programi i Riintegrimit kanë përfituar gjithsej 5,507 persona ndërsa nga skemat e riintegrimit të dhënat janë si në vijim: 130 persona kanë përfituar nga shërbimet e konsulencës, 1767 persona nga trajnimi dhe aftësimi profesional, 252 persona janë punësuar, 575 përfitues të financimit të biznesit, 347 fëmijë kanë përfituar nga kurset e gjuhës, janë aprovuar kërkesat për rindërtimin e shtëpive të 4 familjeve ndërsa 5 familje kanë përfituar nga mbështetje për renovim të shtëpive.

Agjencia e Regjistrimit Civil ka vazhduar me ngritjen e infrastrukturës dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarë me qëllim që të krijohet **Regjistër civil i besueshëm dhe modern**. ARC ka digjitalizuar të gjithë regjistrat themeltar (te ri-kthyer nga Serbia) të gjendjes civile verifikimi i të cilave është në proces e sipër. ARC ka përmirësuar infrastrukturën fizike, duke i ofruar shërbimet më afër qytetareve si objekti i ri i Qendrës për Regjistrimin e Automjeteve në Kaçanik dhe ka vazhduar punimet në ndërtimin e dy objekteve të reja dhe renovimin e më shumë se 13 qendrave, si dhe ka ngritur sigurinë e objekteve duke instaluar kamera në të gjitha qendrat e saj. ARC ka filluar të ofrojë shërbimet e saj të regjistrimit civil dhe regjistrimit të automjeteve në 4 komunat veriore. Në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP), ARC ka trajnuar dhe certifikuar të gjithë zyrtarët konsullor dhe zyrtarët e nivelit lokal të Komunave të Kosovës në fushën e gjendjes civile. Për më tepër, është bërë avancimi i sistemit elektronik të gjendjes civile në Konsullatat e Republikës së Kosovës, duke ia mundur qytetarëve të Kosovës të cilët qëndrojnë jashtë vendit që të pajisjen me dokumente të gjendjes civile.

- MINISTERIA E PUNËVE TË JASHTME

Njohja ndërkombëtare e Kosovës

Gjatë pjesëmarrjes në samite dhe forume të ndryshme ndërkombëtare, ministri Hoxhaj ka takuar mbi 100 delegacione të huaja, dhe nga një pjesë e madhe e përfaqësuesve të vendeve jonjohëse ka marrë zotime se do ta njohin Kosovën.

Gjatë këtij viti, procesi i lobimit ka zënë një vend të rëndësishëm në agjendën e MPJ-së. Në Neë York, nga fundi i qershorit, janë zhvilluar takime me delegacione të shteteve të akredituara në OKB, kurse gjatë korrikut në Samitin e vendeve të Karaibeve, ministri Hoxhaj ka takuar Presidentin e Surinamit dhe vetëm disa ditë pas këtij takimi Suriname ka njohur Kosovën.

Gjatë nëntorit 2016, ministri Hoxhaj ka marrë pjesë në samitin dy-ditor të Frankofonisë dy vite pas anëtarësimit të Kosovës si shtet vëzhgues anëtar. Gjatë këtij samiti, ministri Hoxhaj është takuar me sekretaren e Frankofonisë ku është diskutuar për synimin e Kosovës për t'u bërë shtet anëtar edhe në Agjensionin e Universiteteve Frankofone dhe në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë. Janë zhvilluar takime edhe me përfaqësues të tjerë si me ministren kanadeze për zhvillim ekonomik Francine Landry, ku është biseduar për bashkëpunimin ekonomik mes dy vendeve dhe mundësinë e projekteve konkrete të përbashkëta nga të cilat do të përfitojnë qytetarët e Kosovës. Takime të veçanta janë zhvilluar edhe me ministrat e Jashtëm të Belgjikës, Xhibutit dhe Burundit.

Në përgjigje të letrës së ministrit Hoxhaj, dërguar ministrit të Jashtëm të Singaporit, në vitin 2014 dhe pas takimeve të mbajtura, më 1 dhjetor 2016, Singapori ka njohur pavarësinë e Kosovës, me ç'rast kemi vendosur edhe marrëdhënie diplomatike.

Republika e Kosovës do të përfitojë nga programi i bashkëpunimit të Singaporit, duke filluar nga fillimi i vitit të ardhshëm. Singapori do të ndajë përvojën dhe ekspertizën e tij, në mënyrë të veçantë, në zhvillimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin ekonomik me Kosovën, duke ofruar specializime për nëpunësit publikë të

Kosovës. Nga ky program, Kosova çdo vit do të dërgojë nëpunësit civilë të saj për të marrë njohuri nga përvoja e Singaporit në zhvillimin ekonomik.

Gjatë dhjetorit 2016, ministri i jashtëm Hoxhaj ka takuar homologun e tij nga Hungaria z.Peter Szijjarto, me të cilin kanë biseduar për bashkëpunimin ndërshtetëror ekonomik mes Kosovës dhe Hungarisë. Gjatë vizitës së ministrit hungarez, u nënshkrua marrëveshja për themelimin e një programi kornizë për bashkëpunim financiar në mes të dy shteteve.

Gjatë kësaj periudhe, ministri Hoxhaj ka zhvilluar takime edhe me ambasadorë jorezident për Kosovën të Hondurasit, Australisë dhe Izraelit, ku ka diskutuar lidhur me thellimin e bashkëpunimit politik dhe ekonomik si dhe mbështetjen e këtyre shteteve në anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.

Ministri Hoxhaj gjatë dhjetorit ka pritur homologun e tij italian me ç'rast janë pajtuar për thellimin e bashkëpunimit në fushën e ekonomisë si dhe në luftën kundër terrorizmit.

Marrëdhëniet Diplomatike

Gjatë vitit 2016, Kosova ka vendosur marrëdhënie diplomatike me Gambinë, Malaëin, Bregun e Fildishtë dhe Singaporin.

Disa shtete të tjera janë në proces të finalizimit të procedurave të tyre të brendshme dhe Kosova pret të finalizojë vendosjen e marrëdhënieve diplomatike gjatë vitit të ardhshëm. Aktualisht, Kosova ka vendosur marrëdhënie diplomatike me 86 shtete në tetë vitet e pavarësisë së saj.

Kosova ka hapur edhe tri konsullata të përbashkëta me Shqipërinë në Milano, Bari dhe Mynih, ndërsa shumë shpejt do të kemi edhe dy të reja në Danimarkë dhe Turqi.

Anëtarësimi në Organizata Ndërkombëtare

Sa i përket anëtarësimin në organizata në 2016, të arriturat janë konkrete dhe paraqiten si më poshtë:

Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit: Republika e Kosovës është bërë anëtarja e 121 me të drejta të plota e Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, me seli në Holandë në qershor 2016. Anëtarësimi në këtë institucion ndërkombëtar është një arritje shumë e rëndësishme për faktin se Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit është një ndër organizatat më prestigjioze dhe më të vjetra ndër-shtetërore. Anëtarësimi në këtë organizatë konsolidon më tej subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës, dhe e pajisë shtetin tonë me një mjet të rëndësishëm për të trajtuar e zgjidhur mosmarrëveshje të ndryshme ndërkombëtare me shtete apo palë të tjera publike e private.

Konventa Apostile: Që nga muaji Korrik, pas aderimit së Kosovës në Konventën e Hagës për Heqjen e Kërkesës së Legalizimit të Dokumenteve publike të huaja, qytetarët e Kosovës përveç se do të shpenzojnë buxhet më pak, do të kursejnë edhe kohë, pasi që vërtetësinë e dokumenteve publike mund ta bëjnë në Departamentin për Çështje Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Agjenda Euroatlantike

Gjatë këtyre muajve fokus i veçantë për agjendën euratlantike të Kosovës i është kushtuar vizitës së ministrit Hoxhaj në kryeqytete të shteteve anëtare të BE-së: Bruksel dhe Strasburg, lidhur me zbatimin e MSA-së dhe liberalizimin e vizave. Rritja e përkrahjes për Kosovën dhe agjendën e saj brenda institucioneve të BE-së dhe në nivel të shteteve anëtare të BE-së, janë dy dimensionet kryesore të MPJ-së në realizimin e Agjendës Evropiane.

Për sa i përket zbatimit të MSA-së, në nëntor 2016, është mbajtur takimi i parë i Këshillit për Stabilizim Asociim Kosovë-BE, në Bruksel. Mbajtja e këtij takimi ka rëndësi të madhe pasi që siguron përcjellje të

vazhdueshme të zbatimit të MSA-së dhe ndihmon në përcaktimin më të lehtë të prioriteteve në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Gjithashtu është krijuar korniza institucionale për zbatimin e MSA-së dhe grupet punuese përkatëse sigurojnë përfshirje të gjerë të të gjitha institucioneve qendrore dhe lokale si dhe palëve tjera me interes për zbatimin e MSA-së.

Një përmbledhje e zbatimit të MSA-së i është dërguar me 1 Shtator Komisionit Evropian si kontribut i Kosovës për Raportin e KE-së për Kosovën.

Agjenda e Reformave Evropiane – Nënshkrimi i ARE (11 nëntor 2016) ndihmon në përshpejtimin e zbatimit të suksesshëm të MSA-së, duke specifikuar 22 prioritete kyçe në 3 fusha kryesore I. Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit; II. Konkurrueshmëria dhe klima e investimeve; III. Punësimi dhe arsimi. Përmes ARE-së synohet që të rritet fokusi në këto 22 prioritete kyçe. Zbatimi i këtyre reformave është mjaft kompleks dhe kërkon angazhim maksimal të institucioneve të përfshira në këtë proces, mirëpo në anën tjetër fokusimi në 22 prioritete do t'ia lehtësojë Kosovës adresimin dhe zbatimin e reformave në fushat e cekura.

Marrëveshja Kornizë për Qasje të Kosovës në Programe të BE-së - Më 25 nëntor 2016, është nënshkruar marrëveshja kornizë mes ministrit Hoxhaj dhe Shefes së Politikës së Jashtme të BE-së, Federica Mogherini, për qasje në programet e BE-së. Marrëveshja e nënshkruar është marrëveshja e dytë kontraktuale pas marrëveshjes së Stabilizim Asociimit mes Kosovës dhe BE-së. Programet kanë fushëveprimtari të ndryshme si hulumtimi dhe inovacioni, energjia dhe transporti, shëndetësia, kultura, arsimi, sporti, rinia, zhvillimi i ndërmarrësisë dhe konkurrencës, mbrojtja e ambientit, punësimi, politikat sociale e shumë fusha të tjera.

Nga 15 dhejtori i këtij viti është ratifikuar dhe ka hyrë në fuqi Marrëveshja Financiare për IPA 2015 në kuadër të instrumentit në asistencën e para-anëtarësimit (IPA II) 2015/038-065 – 2015/038-066, në mes të Qeverisë së Kosovës përfaqësuar nga MIE dhe Komisionit Evropian si përfaqësues i Bashkimit Evropian.

Bashkëpunimi rajonal dhe anëtarësimi në organizata rajonale

Gjatë kësaj periudhe, ministri Hoxhaj ka marrë pjesë aktive në forume dhe samite me karakter rajonal: Dubrovnik, Bled, Vishegrad si dhe takime në kuadër të SEECP zhvilluar në margjinat e AP-së së OKB-së në Neë York. MPJ poashtu është pjesë e të gjitha nismave që derivojnë nga procesi i Berlinit. Zv.Ministri Murtezaj është bashkëkryesues i Sekretariatit të përbashkët Kosovë-Shqipëri që merret me dinamikën e zbatimit të detyrave të dala nga mbledhjet e përbashkëta të dy qeverive, ku takimi i parë i këtij sekretariati është mbajtur në nëntor 2016.

Janë zhvilluar konsulta politike me shumicën e vendeve të rajonit si dhe Kosova ka qenë pjesë e ministerialit rajonal “Eëstern Balkans” me fokus në koordinimin ndërshtetëror për realizimin e projekteve në infrastrukturë dhe energjetikë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk është finalizuar ende procesi i anëtarësimit në Eëstern Balkan Fund (EëBF), poashtu edhe procesi i anëtarësimit në RYCO nuk është finalizuar ende (ratifikimi i tyre pritet të bëhet gjatë 2017). Kuota financiare për anëtarësim në RYCO është pjesë e planifikimeve buxhetore për vitin e ardhshëm (2017).

NATO/Siguria

Kosova në dhjetor të këtij viti ka marrë një letër nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-së, ku jepen pika dhe instruksione të qarta për Kosovën në mënyrë që të hapet një kapitull i ri i marrëdhënieve me këtë institucion.

Ky përaftrim mes Kosovës dhe NATO-s, është dëshmia më e mirë që Kosova por edhe NATO janë shumë të interesuara ta mbajnë Ballkanin Perëndimor zonë euroatlantike me perspektivë të qartë për anëtarësim në të ardhmen.

Kosova është e interesuar që në kohë sa më të shkurtë të bëhet pjesë e Partneritetit për Paqe dhe të zyrtarizojë marrëdhënie kontraktuale me NATO-n.

Gjate vitit 2016, Kosova mori pjesë dhe shënoi progres të konsiderueshëm në Kartën e Adriatikut + SHBA (A5) dhe vendeve vëzhguese. Në frymën e vlerave të përbashkëta euro-atlantike Kosova tashmë merr pjesë në organizata e forume rajonale edhe të karakterit të sigurisë. Pjesëmarrja në këto tryeza sjell vlerë të shtuar, por gjithashtu ka nevojë që pjesëmarrja dhe anëtarësimi të bëhet në baza të perhershme në të gjitha nivelet në organizatat ndërkombëtare. Kjo duhet të përcillet me plan të afatizuar periodik. Në këtë kontekst, në deklaratën finale të miratuar nga të gjitha vendet pjesëmarrëse, është reflektuar edhe kërkesa e Republikës së Kosovës për anëtarësi në Kartën e Adriatikut. Në deklaratën finale thuhet se: *“Kosovo’s official request to join the Charter remains a pending issue. We look forward that this issue will be resolved and we will be able to provide an answer during the next 12 months.”*

MPJ për herë të parë ka dhënë kontribut financiar prej 24.000 eurosh për vitin 2016 për organizatën RACVIAC me seli në Zagreb. Gjatë këtij viti, 30 pjesëtarë të institucioneve kosovare janë dërguar për të ndjekur trajnime të ndryshme në evente të ndryshme.

Diplomacia Ekonomike

Angazhimet konkrete për tërheqjen e investimeve dhe avancimin e marrëdhënieve ekonomike janë pjesë substanciale e aktiviteteve të MPJ-së.

MPJ ka realizuar forume ose platforma të prezantimit të avantazheve ekonomike për të investuar në Kosovë, ku synimi kryesor është tërheqja e investimeve të huaja: bashkëorganizimi i dy konferencave për tregti dhe investime në Stamboll (18.10.2016) dhe Londër (03.11.2016).

Gjithashtu MPJ ka organizuar takime me Kryetarë të komunave në mënyrë që të njoftohen për diplomacinë ekonomike dhe cilat janë mundësitë e tërheqjes së investimeve nga jashtë.

Deri më tani, organizimi i forumeve ose platformave të tilla është diskutuar dhe dakorduar konkretisht me Italinë, Gjermaninë, Austrinë, Kroacinë, Greqinë dhe së fundmi me Hungarinë, si dhe me gjashtë vendet e gjirit ku do të udhëhiqen nga Emiratet e Bashkuara.

Zv. Ministri i Jashtëm Murtezaj është emëruar bashkë kryesues i Komisionit të përbashkët për Bashkëpunim Ekonomik me Hungarinë, ku pritet të mbahet takimi i parë i këtij komisioni vitin e ardhshëm dhe të vlerësohen projektet konkrete.

Është dhënë perkrasje dhe ndihmesë në organizimin e Forumit Ekonomik për Investime me Malin e Zi, ndërmjet OEK dhe Odes Ekonomike të Malit të Zi, në Prishtinë.

Është organizuar një aktivitet përgatitor koordinues me përfaqësuesit e komunave, ku janë bërë prezantime nga MPJ rreth promovimit të Kosovës përmes diplomacisë ekonomike.

Konferencat

Brexit - MPJ me 16 korrik 2016 ka organizuar konferencën “Evropa pas BREXIT dhe procesi i integritimit evropian në Kosovë dhe rajon”, ku edhe është nxjerrë një dokument lidhur me rekomandimet e dhëna nga panelistët e konferencës.

Konferenca ndërjetare - Kosova për herë të pestë ka organizuar konferencën ndërkombëtare, me titull “Roli i Gruas në Promovimin e dialogut ndërjetar dhe luftimin e ekstremizmit”, ku kanë marrë pjesë më shumë se 50 shtete. Kjo Konferencë është zhvilluar tre ditë, kurse pjesëmarrës kanë qenë edhe dy nobelistët e paqes Shirin Ebadi (Iran) dhe Taëakkol Karman (Jemen).

Konferenca e Ambasadorëve - MPJ ka organizuar konferencën e ambasadorëve nga 19-22 dhjetor 2016, ku kanë marrë pjesë personalitete të shquara nga vendi dhe jashtë: presidenti, kryeministri, kryetari i parlamentit, zv. kryeministra, ministra nga Kosova dhe Shqipëria, deputetë, kryetarë komunash, ambasadorë të akredituar në Kosovë, ambasadorët e RKS-së nëpër misionet diplomatike si dhe ekspertë të fushës, për të diskutuar lidhur me tema të ndryshme si: siguria e Kosovës dhe marrëdhënia e re me NATO-n; Marrëdhëniet e Kosovës me BE-në dhe aplikimi për statusin e kandidatit; Diplomacia Ekonomike dhe tërheqja e investimeve të huaja, Diplomacia multilaterale: përfitimet nga anëtarësimet dhe aplikimet e reja.

Pas përfundimit të konferencës është hartuar një dokument final ku përfshin të gjitha temat që janë diskutuar nëpër panele.

Dokumentet e lëshuara nga departamenti konsullor në MPJ dhe MDK

Gjatë vitit 2016, departamenti për çështje konsullore në MPJ ka lëshuar rreth 29,305 dokumente të legalizuara; 13,172 dokumente me vulë apostile si dhe një numër i madh i dokumenteve të ndryshme janë lëshuar nga misionet diplomatike të RKS-së.

Ngritja e kapaciteteve të stafit të MPJ-së dhe rritja e diplomatëve në MDK

Pjesëmarrja e stafit të MPJ-së në trajnime, seminare të ndryshme në Gjermani, Bullgari, Austri, Poloni, Bruksel, Sarajevë, Zagreb, Mal të Zi, dhe Hagë. Akademia Diplomatike ka organizuar edicionin e tretë të shkollës pranverore për diplomatë të rinj nga Kosova, rajoni dhe bota.

Gjatë këtij viti është rritur numri i diplomatëve nëpër MDK - gjithsej 10 (diplomatë me grada të ndryshme) dhe 2 konsuj të përgjithshëm.

Marrëveshjet e nënshkruara

AD në kuadër të MPJ-së ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me "L'Ecole National d'Administration" në Francë, AD-në e Republikës Çeke, AD-në e Shqipërisë dhe Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Është përgatitur draft MoU me AD-në e Hondurasit, ka mbetur vetëm të nënshkruhet nga të dy palët.

AD ka inicuar aktivitetet për nënshkrimin e MoU-ve me AD-të e Malajzisë, Kanadasë, Omanit, Katarit, EBA, Pakistanit, Jordanisë, Bahrejnit, Omanit, Kuvajtit.

Pjesëmarrja e Kosovës në koalicionet me interes gjeostrategjik - Kosova vazhdon të marrë pjesë në mënyrë aktive në koalicionin kundër DAESH.

- MINISTERIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

Punësimi dhe Aftësimi Profesional: Në bazë të statistikave, të cilat nuk përfshijnë programet e ministrive tjera përmes të cilave janë hapur vende të reja të punës, MPMS, përmes shërbimit publik të punësimit, respektivisht përmes Zyrave të Punësimit, ka regjistruar **19,367 punëkërkues apo 4,153 më shumë se vitin e kaluar. Numri i identifikuar i vendeve të lira të punës nga ana e Zyrave të Punësimit, për vitin 2016 del të jetë 14040**, apo 2013 vende më shumë se vitin e kaluar. Nga ky numër, nga Zyrat e Punësimit, në punësim të

rregullt janë ndërmjetësuar 3973 persona, apo 638 persona më shumë se vitin e kaluar. Nga pushimi i lehonisë kanë përfituar 1717, ndërsa shërbime në fushën e migrimit kanë marrë 1227. MPMS përmes bashkëpunimit me partnerë ka ofruar mundësi punësimi, aftësimi apo trajnimi përmes një serie të projekteve në fushën e bujqësisë, prodhimit, punëve publike, ndërmarrësisë, vetëpunësimit. Nga numri total i përfituesve 3973, përmes Masave Aktive të Tregut të Punës është rritur ndjeshëm numri i grave përfituese, i personave me nevoja të veçanta, pjesëtarëve të familjeve në nevojë, minoriteteve, si dhe të rinjve. Gjatë vitit 2016, **janë ngritur kapacitetet e Zyrave të Punësimit** si dhe është zyrtarizuar sistemi i performancës në të gjitha Zyrat e Punësimit. Po ashtu ka filluar ka filluar zbatimi i konceptit të ri për ofrimin e shërbimeve të punësimit duke u bazuar në profilizimin e punëkërkuësve. Në bazë të këtij koncepti, punëkërkuësit do të profilizohen në tri kategori kryesore dhe në bazë të kategorizimit do të bëhet edhe ofrimi i shërbimeve dhe masave. Në lidhje me **Aftësimin Profesional**, për periudhën janar-dhjetor **2016 janë përfshirë në trajnime 6818 punëkërkuës**, nga të cilët 1874 janë femra, të kthyerit 2058, minoritete 549 kandidat, persona me aftësi të kufizuara 39 kandidat. Nga ky numër, të certifikuar sipas qendrave brenda kësaj periudhe janë 5781.

Mirëqenia dhe Ndhimat Sociale: Në kuadër të fushëveprimit të vet, MPMS, përmes skemave sociale vazhdon të përkrahë një numër të gjerë të kategorive sociale. Gjatë vitit 2016, në bashkëpunim me KE, GIZ dhe UNICEF, **janë zhvilluar 12 standarde për shërbime sociale. Janë licencuar 145 ofrues të shërbimeve sociale**, prej tyre 87 ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare për nivel superior, dhe 58 për nivel bazik. Po ashtu **janë licencuar 18 organizata jo qeveritare** që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Në bashkëpunim me Projektin e Komisionit Evropian, **janë trajnuar 150 zyrtarë nga niveli menaxherial dhe nivelet e Drejtorive Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**, dhe nga Qendra për Punë Sociale. Gjatë vitit 2016 ka vazhduar **përkrahja për strehim familjar brenda familjes për 557 fëmijë**, me kompensim prej 75.00 në muaj, dhe strehim alternativ jashtë familjes për 84 fëmijë me pagesë 150.00 në muaj. Në fushën e bashkëpunimit me OJQ, **janë ofruar shërbime në 6 strehimore regjionale për mbrojtje nga dhuna në familje**. MPMS ka përzgjedhë dhe mbështetë financiarisht projekte të 20 OJQ-ve, me mbi 50% të financimit të shpenzimeve të secilit projekt i destinuar për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. **Janë ofruar shërbime sociale për 423 raste të dhunës në familje**, nga të cilat 237 gra, respektivisht 186 fëmijë viktime të dhunës në familje. Janë strehuar 29 persona që kanë pësuar nga trafikimi me qenie njerëzore, nga të cilat 11 të moshës madhore, dhe 18 të mitur. Në fushën e eliminimit të formave të rënda të punës së fëmijëve, **56 fëmijë janë larguar nga këto punë**. Është bërë decentralizimi i shërbimeve për Shtëpitë e Personave të Moshuar në Istog (Gurakoc), Graçanicë dhe Shtëpitë e Personave me Aftësi të Kufizuara në Shtime, Vushtrri, Deçan Ferizaj, Lipjan dhe Kamenicë. Po ashtu janë decentralizuar edhe tri Qendra për Punë Sociale komunale, Leposaviq, Zubinpotok dhe Zveçan. MPMS në vazhdimësi ka monitoruar shërbimet që ofrohen në të mirë të klientëve në nevojë. Numri i përgjithshëm i klientëve të cilët marrin shërbime dhe janë nën përkujdesje 24 orë në dy institucionet e mëdha (ISSH, SHPMPF) dhe në 11 shtëpitë të komunitetit është 242. Kurse në Skemën e Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme përfitues 2749 fëmijë me nga 100 euro në muaj. Nga numri i përgjithshëm i 819 ankesave, MPMS ka aprovuar 265 prej tyre në shkallë të parë, dhe pas refuzimit edhe 23 të tjera në shkallë të dytë. Në kuadër të **Ndihmave Sociale**, në kuadër të Skemave të Ndhimës Sociale, gjatë vitit 2016, **ndihmë sociale kanë përfituar 26.302 me 107.575 anëtarë të familjeve**. Varësisht nga numri i anëtarëve, **familjet kanë përfituar mes 50 deri 150 euro**.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2016 nga ana e Komisionit Mjekësor, shkalla I-rë, është bërë vlerësimi i paaftësisë (mbi 80 %) për 21.902 kërkesa të parashtruara për ndihmë sociale në kategorinë e I-rë. Nga 21.902 kërkesat e parashtruara për vlerësim mjekësor, **19.654 kërkesa ose 89 % e tyre janë vlerësuar si të pa aftë për punë**, 1.224 kërkesa ose 6 % janë vlerësuar si të aftë për punë. Po ashtu gjatë kësaj periudhe, është bërë shqyrtimi i 541 ankesave, prej tyre 101 ankesa apo 18.66 % janë aprovuar, ndërsa 440 apo 81.33 % ankesave janë refuzuar si të pa baza. MPMS ka ushtruar kontroll të rregullt në 13 QPS dhe ka kontrolluar 966 lëndë të shfrytëzuesve

të ndihmave sociale, prej tyre ka rezultuar që 666 ose 68.94 % e lëndëve-dosjeve kanë qenë të kompletuara me dokumentet e nevojshme, ndërsa 300 ose 31.06 % dosjeve-lëndëve u mungon ndonjë nga dokumentet që parasheh Ligji. Po ashtu është bërë verifikimi i drejtpërdrejtë i 891 familjeve në vendbanimet e tyre. Nga këto verifikime ka rezultuar se 743 ose 83.39 % familje kanë qenë të përzgjedhshme në harmoni me kushtet dhe kriteret që parashihen me ligj, ndërsa 148 ose 16.61 % të familjeve në SNS kanë qenë të pa përzgjedhshme.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2016, Komisioni Vlerësues i MPMS-së ka shqyrtuar 329 kërkesa për ndihmë të njëhershme sociale. Me nga 100.00 € kanë përfituar 186 familje/individë, nga 150.00 € e deri në 300.00 € kanë përfituar 54 familje/individë. Gjithsej shuma e shpërndarë për ndihma të njëhershme sociale gjatë kësaj periudhe ka qenë 32,900.00 €. Po ashtu është përmbyllur **Memorandumi për lirim nga pagesa e energjisë elektrike mes MPMS, MZHE, KEK-KEDS** për Skemën e Ndihmës Sociale dhe Familjet e Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës.

Pensionet dhe beneficinet (përfshirë negocimin me jashtë): MPMS, konform rregullativës ligjore në fuqi, në kuadër të veprimtarisë së vetë, ka vazhduar suksesshëm operacionalizimin e politikave dhe implementimin e skemave ekzistuese, më saktësisht është arritur që me sukses të trajtohen mbi 95% kërkesave dhe ankesave të parashtruara për realizimin e të drejtës në skemat pensionale. Ka ndodhur kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve – stazhit pensional si dhe njohja e stazhit të punës për punëtorët e arsimit për vitet 1989-1999, dhe po ashtu është duke zhvilluar procesi në lidhje me skemat e reja, atë të pensionit familjar dhe invalidor, përderisa në këtë drejtim është bërë kalkulimi i përafërt i kostos buxhetore për dy skemat e reja. Si rezultat i menaxhimit më efektiv koordinimit si dhe nxjerrjes së UA, për procedurat e lajmërimit, suspendimit dhe riaplikimit janë suspenduar nga pagesa e skemave të pensioneve bazë dhe kontributiv ata pensionist që nuk kanë mundur të vërtetojnë adresat e banimit në Kosovë dhe si rrjedhojë buxhetit të Kosovës i janë kursyer rreth 12 milion euro. **Në përputhje me rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm, MPMS është angazhuar në disiplinimin e skemës pensionale dhe sociale, me theks kthimin e mjeteve pa bazë ligjore, gjë e cila po arrihet në bashkëpunim me Agjencinë e Regjistrimit Civil, Administratën Tatimore të Kosovës, Bashkësitë Fetare.** Në kuadër të negocimit në fushën sigurimeve sociale, janë zhvilluar takime konsultative me delegacione të Maqedonisë, Belgjikës, dhe Zvicrës. Në këtë drejtim, **vlen të përmendet nënshkrimi i marrëveshjes pilot me Zvicrën dhe miratimi i qeverisë zvicerane për nisjen e negociatave për marrëveshjen e përgjithshme si rezultat i zbatimit të suksesshëm nga MPMS të marrëveshjes pilot.** Ky proces pritet të zgjerohet edhe me Kroaci, Slloveni, Gjermani, Austri. Në përputhje me legjislacionin **ka vazhduar përkrahja për kategoritë e luftës, më saktësisht numri i përfituesve familjare për vitin 2016 12,680, ndërsa i atyre veteran ka qenë 28,207.** Janë përmbyllur **Marrëveshje që ndihmojnë rehabilitimin e kategorive përkatëse, si dhe Memorandum për lirim nga pagesa e energjisë elektrike mes MPMS, MZHE, KEK-KEDS.**

Legjislacioni: Gjatë vitit 2016 janë miratuar 3 ligje, më saktësisht Ligji nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-019, për Aftësim, *Riaftësim Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara*; Ligji nr. 05/1 -077 për *regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve për të papunët*, punëkërkuesit dhe punëdhënësit; dhe *Ligji për Ndërmarrjet Sociale* i miratuar me datë 14.12.2016 në mbledhjen e 120 të Qeverisë së Kosovës, përderisa janë në *procedure projektligjet për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko Social*; si dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131, për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

Në fushën e punësimit, aktet nënligjore të miratuara nga qeveria në 2016 janë Vendimi për Themelimin e Këshillin Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, dhe Miratimi i Plani të veprimit 2015-2016, për eliminimin e të gjitha formave me të këqija të pune së Fëmijëve në Kosovë. Në kuadër të Rregulloreve dhe

Udhëzimeve Administrative MPMS ka miratuar rregulloren nr. 01/2016 për funksionimin dhe punën në strehimoren për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, rreg. nr. 02/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës, rreg. nr. 03/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për mbrojtjen e të punësuarave lidhur me punën e krahut me ngarkesa, rreg. nr. 04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë, rreg. nr. 05/2016, për kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin në punë të punësuarave në risk nga ambientet shpërthyes, rreg. nr. 06/2016, për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqës.

Në kuadër të harmonizimit të legjislacionit vendor me *acqui communautaire*, në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë janë në procedurë projekt rregulloret për mbrojtjen nga zhurma në vendin e punës, për kushtet minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë, për ekspozimin ndaj rreziqeve tjera si dridhja apo asbesti. Po ashtu janë në procedure edhe rregulloret për subvencione dhe grante, për paraplegjik dhe tetraplegji.

Koordinimi, IPA: Gjatë vitit 2016, MPMS ka bërë **"Koordinimin e Procesit për Rishikimin dhe Monitorimin e PKZMSA"** përkatësisht monitorimin dhe raportimin periodik për zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA). Si pjesë e dialogut ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës, MPMS, me 15 dhjetor 2016, ka marrë pjesë në takimin e parë të Nënkomitetit për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politika Sociale. Për herë të parë, është hartuar Plani i Brendshëm i Punës i MPMS-së për vitin 2016, i cili shërben si instrument i planifikimit dhe vlerësimit të performances se punës se departamenteve të MPMS. Në kuadër të zhvillimit dhe përmirësimit të politikave, MPMS ka dhënë kontribut për hartimin e Udhërrëfyesit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtarë, në shtyllën e saj të parë të Kapitalit Njerëzor. Në kuadër të Programit të Reformave Ekonomike është dhënë kontribut në kuadër të propozimit të masave për punësim dhe tregu i punës si dhe përfshirja sociale, ulja e varfërisë dhe mundësitë e barabarta. Në kuadër të programimit IPA 2016, kemi zhvilluar Dokumentin e Veprimit për IPA 2016 të miratuar nga KE ku përfshihen 3 projekte, dhe vlera totale e kontributit të KE është 8 milion euro.

Inspektorati: Inspektorati i Punës ka realizuar 6716 inspektime, nga të cilat 4611 kanë qenë inspektime të rregullta, 1576 ri inspektime të cilat janë bërë me qëllim që të verifikohet nëse palët i kanë eliminuar të metat sipas raportit zyrtar që ju është lënë me rastin e inspektimit fillestar nga Inspektoret e Punës, 417 inspektime me anë të parashtresave të palëve të cilat kanë konsideruar që ju janë shkelur të drejtat e tyre ligjore, si dhe 112 inspektime në bashkëpunim me organet tjera të cilat kanë kompetence të mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit.

Nga këto inspektime IP ka arritur të ndikoj që të formalizohet marrëdhënia e punës se 1262 punëtorëve të cilët janë gjetur duke ushtruar aktivitetin e tyre të punës në mënyrë jo formale.

Gjatë kësaj periudhe IP ka shqiptuar 115 gjoba, dhe shumica e tyre është variabile (e ndryshme), varësisht nga natyra dhe lloji i shkeljeve që janë evidentuar gjatë procesit inspektues që ka ndodhur. Gjithashtu janë shqiptuar edhe 808 vërejtje me shkrim subjekteve ku janë evidentuar që nuk kanë respektuar legjislacionin në fuqi.

Numri i përgjithshëm i punëtorëve të inspektuar gjatë kësaj periudhe ka qenë 55749, ku nga ata 44252 kanë qenë meshkuj, 11383 kanë qenë femra, si dhe 36 meshkuj të huaj dhe 44 femra të huaja. Në këtë vit kemi filluar që të bëjmë inspektime të planifikuara. Kjo është një politike e re, ku qëllimi kryesor i kësaj forme të inspektimit është ngritja e nivelit të vetëdijes se palëve për respektimin e legjislacionit në fuqi. Me tej, është themeluar komisioni për dhënien e provimit profesional nga Siguria dhe Shëndeti në Punë, ndërsa ka filluar aplikimi i të interesuarave për të dhënë këtë provim. Është themeluar dhe funksionalizuar komisioni

për licencimin e personave juridik të cilët kryejnë punë nga SShP. Është hartuar **Plani Zhvillimor Strategjik për Inspektoratin e Punës, 2017-2021.** Po ashtu kemi organizuar fushata inspektuese dhe vetëdijësuese lidhur me kornizën ligjore të marrëdhënies se punës, si legjislacionit nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Financa: Për vitin 2016, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale i janë ndarë **377,518,382.53 euro**, prej të cilave deri me tani janë shpenzuar 377,000,000.00 euro. Sipas projeksioneve aktuale, deri në fund të vitit **2016, pritet të shpenzohen mes 95-98% e buxhetit.** Pavarësisht kërkesave për buxhet shtesë, MPMS ka respektuar kufijtë e lejuar për vitin buxhetor 2017, dhe konform parashikimeve në kuadër të KASH 2017-2019, janë përgatitur edhe politikat dhe prioritetet programore të MPMS-së.

- MINISTERIA E SHËNDETËSISË

Me qëllim të orientimit strategjik të reformës në sektorin e shëndetësisë Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Strategjinë Sektoriale Shëndetësore 2017-2021 që synon ruajtjen e shëndetit, promovimin e mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe ofrimin e shërbimeve cilësore të sigurta, me qasje të lehtë, të barabartë, pa rrezik financiar dhe kosto-efektive.

Plotësimi i kornizës ligjore ka vazhduar me amandamentimin e ligjit për shërbim emergjent, miratimin në qeveri të projektligjit për inspektorat shëndetësor. Poashtu, janë miratuar në qeveri koncept dokumenti për sigurime shëndetësore dhe koncept dokumenti për shëndetësi. Është miratuar statuti i Fondit të sigurimeve shëndetësore dhe Rregullorja për Menaxhim Financiar e Fondit të Sigurimeve shëndetësore.

Gjatë vitit 2016 janë miratuar këto udhëzime administrative: Udhëzimi Administrativ Nr.01/2016 për Edukimin e vazhdueshëm mjekësor, Udhëzimi Administrativ Nr.02/2016 për Rregulloren për arkivin dhe lëndën arkivore, Udhëzimi Administrativ Nr.03/2016 për trajtim mjekësor jashtë institucionet shëndetësore publike, Udhëzim Administrativ Nr.04/2014 për tarifatat e shërbimeve të ofruara në AKPPM, Udhëzimi Administrativ Nr.05/2016 për plotësim ndryshimin Udhëzim Administrativ Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta spitalore, Udhëzim Administrativ Nr.06/2016 për administrimin dhe përdorimin e Metadonit për programe zëvendësuese, Udhëzimi Administrativ Nr.07/2016 Mbledhja e premiumeve për sigurimin shëndetësor të obligueshëm, Udhëzimi administrativ nr. 08/2016 Kushtet për kualifikimin dhe trajnimin e personave që kryejnë transplantimin.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018 ka përcaktuar se sistemi i ri shëndetësor i vendit do të mbështetet në Ministrinë e riorganizuar të Shëndetësisë të fuqizuar në rolin e saj politik-bërës, rregullator, vlerësues dhe monitorues, si dhe funksionalizimin e plotë të institucioneve të reja. Në këtë drejtim Ministria e Shëndetësisë ka funksionalizuar Odat e Profesionistëve Shëndetësorë përmes nxjerrjes së statuteve dhe akteve tjera nënligjore dhe ka bartur kompetencat siç është përcaktuar me ligj. Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës është funksionalizuar si formë e integruar e shërbimeve në nivelin dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor.

Me qëllim funksionalizimi të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, përveç miratimit të Statutit të Fondit të sigurimeve shëndetësore dhe Rregullores për Menaxhim Financiar e Fondit të Sigurimeve shëndetësore, Qeveria gjithashtu ka marrë vendim për datën e mbledhjes së premiumeve. Në këtë drejtim janë miratuar edhe Rregullorja e brendshme e Agjencisë së Financimit Shëndetësor, Rregullorja e brendshme e Këshillit përgatitor të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, është themeluar dhe funksionalizuar Këshilli përgatitor i FSSH si dhe është miratua forma (DRG) e kontraktimit të shërbimeve spitalore Si dhe është përgatitur Strategjia e Komunikimit për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore.

Me qëllim të ngritjes se kapaciteteve spitalore në sistemin shëndetësor me mbështetje të Emirateve të Bashkuara Arabe është inauguruar Spitali i Vushtrrisë, projekt i cili ka kushtuar 6 milion euro. Në kujdesin parësor shëndetësor është përruar Qendra Kryesore Familjare (QKMF) në Kaçanik, projekt i cili ka kushtuar 6,500,00 euro si dhe është përfunduar ndërtimi i Qendrës Kryesore Familjare (QKMF), në Skenderaj ku janë investuar 1.1 milion euro. Me qëllim të avancimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës janë siguruar pajisje për institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor në vlerë prej 1,6 milion euro. Janë siguruar tri autoambulanca për nevoja të institucioneve shëndetësore.

Në këtë vit kanë filluar procedurat për ndërtimin e Klinikës Pediatrike donacion nga EBA në vlerë 22 milion euro. Poashtu është vendosur gurë-themeli i ndërtimit të Klinikës së re Emergjente, është vendosur gurë-themeli i Institutit Rajonal të Shëndetësisë Publike në Gjilan dhe Ferizaj si dhe gurë-themeli i QKMF-Gjilan.

Sa i përket shërbimeve të reja këtë vit janë realizuar 106 operime në kardiokirurgji që janë kursyer afër 1.500.000 euro.

Duke marrë parasysh zotimin për më shumë fonde për të gjitha komunat, Qeveria ka ngritur grantin shëndetësor për komuna nga 40 milion euro në 44 milion euro për vitin 2017. Poashtu zotimi për personel mjekësor të rritur është realizuar me punësim të përkohshëm të 153 specialistëve si dhe specialistët voluntarë janë sistemuar me pagesë nga performanca. Furnizimi me barna dhe materiale mjekësore ka arritur mbi 70% në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor.

Sa i përket grupeve të qytetarëve në nevojë janë trajtuar jashtë institucioneve shëndetësore publike rreth 960 paciente në vlerë prej 7,366,502.00€. Sa i përket luftimit të kancerit janë realizuar 2792 mamografi si dhe Klinika e Onkologjisë ka trajtuar të gjithë pacientët në nevojë. Ka filluar programi i vizitave shëndetësore në shtëpi për kujdesin e nënës dhe fëmijë.

Ministria e Shëndetësisë me qëllim të shpërndarjes adekuate të infrastrukturës dhe të kuadrit mjekësor në të gjithë territorin e vendit, arritje të standardeve ndërkombëtare sa i përket numrit të personelit mjekësor në raport me popullsinë ka filluar procedurat për hartimin e Planit për burime njerëzore në shëndetësi si dhe ka bartur kompetencat për organizim të profesionistëve shëndetësor te Odat.

Me qëllim të adresimit të aspekteve të llogaridhënës Ministria e Shëndetësisë është duke e zbatuar Planin e Integritetit Institucional që është hartuar në bashkëpunim me UNDP. Me qëllim të fuqizimit të komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët është vënë në funksion linja telefonike ku në këtë vit janë proceduar 160 ankesa të qytetarëve.

Në vitin 2017 dhe nuk është shënuar asnjë rast me Ethe Hemorragjike Krime Kongo. Janë siguruar vaksinat kundër gripit sezonal për qytetarët. Konsumimi i duhanit në mesin e të rinjve të moshës 13-15 vjeçe ka rënë nga 6.7% në 2004, në 4.4% në 2016 (GYTS). Janë siguruar shtatë (7) automjete për funksionalizimin Qendrën e Ujit të pijshëm IKSHPK.

Ministria e Shëndetësisë këtë vit ka filluar procesin e ri-licencimit të profesionistëve shëndetësor. Me qëllim të mbështetjes së edukimit specialistik dhe sub-specialistik janë lejuar 199 specializime për profesionistët shëndetësor. Ndërsa përmes programit të edukimit të vazhdueshëm profesional kanë përfituar 114 profesionist shëndetësor dhe 18 shoqata profesionale në vlerë prej 114,320€;

Duke pasur parasysh që përgjegjësia kryesore për të qëndruar të shëndetshëm i takon vetë qytetarëve, Ministria e shëndetësisë përmes mbështetjes së asistencës teknike të Komisionit Evropiane ka hartuar Strategjinë për Promovim dhe edukim shëndetësor. Në kuadër të aktiviteteve për shëndetin e nënës dhe fëmijës janë përfshirë edhe organizata të shoqërisë civile dhe vet qytetarët që kanë pasur qëllim ngritjen e vetëdijes për shëndetin riprodhues në komunitet.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar është bërë ratifikimi nga Kuvendi i Marrëveshjes me Austrinë për modernizimin e shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në QKUK. Po ashtu është nënshkruar marrëveshje për Akreditimin ndërkombëtar të Specializimit të Mjekësisë Familjare të Kosovës nga Kolegji Britanik. Kosova e Shqipëria kanë nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e shëndetësisë publike si dhe marrëveshje bashkëpunimi në mes Inspektoratit Shëndetësor i Kosovës dhe Shqipërisë.

Edhe mbështetja e donatorëve për sektorin e shëndetësisë është siguruar përmes nënshkrimit të marrëveshjeve me Qeverinë e Luksemburgut në vlerë prej 9.5 milion euro, Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim 6 milion euro dhe, Emiratet e Bashkuara Arabe 22 milion euro. Sektori i shëndetësisë është mbështetur edhe nga "Globus Relief" nga SHBA në vlerë 3.5 milion euro. Ministria e Shëndetësisë dhe TIKA kanë nënshkruar Marrëveshjen për Njësinë e re të Kujdesit Intensiv në QKUK.

- **MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË**

Të dhëna të përgjithshme në shifra:

- Shkëmbimet tregtare (Janar - Tetor 2016) = 2 536 000 000.00 €
- Mallrat e eksportuara = 253 milion €
- Mallrat e importuara = 2 283 000 000.00 €
- Biznese të regjistruara 2016 = 10,289
- Biznese të shuara = 2,290
- Biznese me pronarë të huaj = 656
- Investimet e huaja direkte (Janar - Shtator 2016) = 184 000 000.00 €
- Produkte kosovare të ekspozuara brenda dhe jashtë vendit = 1166; Kontrata të lidhura për eksport = 33
- Fondi Kosovar për Garanci Kreditore = rreth 63 kredi për bizneset vendore
- Zbatimi PKZMSA-së = Legjislacioni = 90%; Masat = 75%

LEGJISLACIONI - Janë miratuar 4 ligje (Ligji për Falimentim, Ligji për Investime Strategjike, Ligji për Kamatëvonesat në Transaksionet Tregtare dhe Ligji për Akreditim); Projektligji për Shërbimet është miratuar në parim në Kuvendin e Republikës së Kosovës; Projektligji për Shoqëritë Tregtare, projekt-ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe projekt-ligji për Produktet e Ndërtimit janë në fazën e harmonizimit me legjislacionin e BE-së. Gjatë këtij viti kemi nxjerrë 17 udhëzime administrative, 6 rregullore dhe 4 koncept dokumente. Është proceduar në Zyrën për Planifikim Strategjik (ZKM) Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2016-2020.

Këshilli Kombëtar Për Zhvillim Ekonomik Të Kosovës (KKZHE) - KKZHE ka mbajtur tri takime gjatë kësaj periudhe raportuese. KKZHE si platforma më e rëndësishme e dialogut publik-privat ka diskutuar çështje të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit, si MSA, Raportin e Bankës Botërore për të Bërit Biznes, adresimi i shumë kërkesave të ardhura nga komuniteti i biznesit në funksion të mënjanimin të barrierave dhe byrokracisë së panevojshme e çështje të tjera dhe ka marrë një sërë vendimesh me interes për përmirësimin e klimës së të bërit biznes.

Integrimi evropian dhe koordinimi i politikave - Janë përgatitur raportet periodike dhe analiza për Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA-së dhe rishikimin e tij, Planin e Punës (PVPQ) si dhe dokumenteve tjera strategjike. Në raport me informimin e bizneseve rreth MSA-së, janë mbajtur konferenca me 6 sektorët industrialë me potencial për eksport: përpunimi i drurit, metalit, ushqimit, teknologjisë informative dhe komunikimit, si dhe sektori i tekstilit. Janë përgatitë projekt propozimet për IPA 2016 të cilat ndërlihen me MTI-në; është përditësuar dokumenti planifikues sektorial 2014-2020 (IPA). Janë përgatitur raporte dhe janë mbajtur takime lidhur me Dialogun e Stabilizim Asocimit si dhe është mbajtur takimi koordinues me donatorë në muajin qershor 2016. MTI ka kryer funksionin e koordinatorit nacional të zbatimit të Strategjisë së Evropës Juglindore 2020, në kuadër të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Në këtë aspekt, janë realizuar takimet e taskforcës për monitorim, bordit drejtues të strategjisë, komitetit programues, komitetit për investime, si dhe nëngrupet e këtij komiteti si nëngrupi për investime, industri, dhe turizëm. Në kuadër të objektivit të hartimit të dokumenteve strategjike, është hartuar programi i Agjendës së Reformave Evropiane (ERA) si dhe masat për zbatimin e Programit për Reforma në Ekonomi (PRE).

Politikat Tregtare - Është krijuar platforma elektronike për raportimin e barrierave tregtare dhe është përgatitur broshura për ueb-platformën; Është përfunduar memorandumi i bashkëpunimit në mes të agjencive kufitare, si obligim i dalë nga negociatat e lehtësimit të tregtisë në mes vendeve të CEFTAs; Është nënshkruar marrëveshja mbi njohjen e tahografeve me Shqipërinë. Është finalizuar analiza ekonomike për Marrëveshjen e CEFTAs për periudhën 2005-2015; Është realizuar pjesëmarrje aktive në negociatat e shërbimeve në kuadër të CEFTA-s; Është përfunduar draft-memorandumi dhe plani i veprimit për aplikim në OBT; Është themeluar Komiteti Nacional për Lehtësimin e Tregtisë, si obligim i dalë nga CEFTA. Me qëllim të mbrojtjes së prodhuesve vendorë është përgatitur raporti analitik për produktet në vijim: vezët, grurin, materialin ndërtimor me bazë argjilore, qumështit dhe produkteve të tij; Janë adresuar të gjitha çështjet/barrierat tregtare me Shipërinë (çështja e barërave farmaceutike, grurit, patatës, rrushit, çokollatës etj). Republika e Kosovës ka vendosur masa reciproke ndaj Serbisë për njohjen e certifikatave të ADR-së dhe nuk kemi larguar masën derisa janë pranuar edhe dokumentet e transportuesve nga Kosova.

Shkëmbimet tregtare të Kosovës për periudhën Janar – Tetor 2016 arritën vlerën prej 2 miliard e 536 milionë €. Mallrat e eksportuara kanë shënuar vlerën prej 253 milion €, ndërsa importet shënuan vlerën prej mbi 2 miliard e 283 milion €.

Politikat Industriale - Janë autorizuar 6 trupa për vlerësim të konformitetit në fushën e naftës dhe ashensorëve; është hartuar raporti studimor lidhur me zhvillimin e klastereve/grupimeve në Kosovë. Janë krijuar 4 bërthama: tour operatorët, kopshtet private të fëmijëve, përpunimi i produkteve ushqimore dhe shtëpitë akomoduese; janë hartuar dy studime të profileve të sektorëve industrialë të plastikës dhe gomës; Është hartuar Udhëzuesi për Praktikën e Mira Rregullatore që do të përdoret edhe nga Ministrinë e linjës që hartojnë legjislacion në fushën e Infrastrukturës së Cilësisë, në veçanti politikat rregullatore teknike; Është hartuar një raport studimor me qëllim të një analize rreth mundësive, kostos dhe shpenzimeve dhe përfitimeve për anëtarësimin e Kosovës në Organizatën Botërore të Turizmit (UNËTO); Është hartuar Studimi për zhvillimin e resurseve njerëzore në sektorin e turizmit dhe hotelierisë.

Mbikqyrja e Tregut dhe Rregullimi i Tregut të Naftës - Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar 473 licenca; janë refuzuar 16; janë revokuar 13. Janë gjithsej 863 pika për shitje me pakicë të dizelit dhe benzinës. Prej tyre: 646 janë në funksion, dhe 217 janë jashtë funksionit.

Janë realizuar 733 inspektime të tregut; janë tërhequr nga tregu 2,440 produkte. Është zbatuar Plani i Monitorimit të cilësisë së naftës dhe derivateve të naftës, janë marrë 580 mostra në pikat shitëse me pakicë, deponitë dhe kompanitë publike, ku nga 580 mostrat e marra, 534 kanë rezultuar konform standardeve (ose 92.1%), dhe 46 mostra jo konform (ose 7.9%). Krahasuar me 2015 numri i mostrave të marra gjatë këtij viti është rritur për 58%; Ka filluar programi i inspektimit të pikave shitëse të karburanteve që ushtrojnë veprimtarinë tregtare pa licenca në komunat Mitrovicë e veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan; Është krijuar trupi koordinues nacional për mbikëqyrjen e tregut; Janë kompletuar pajisjet për laboratorin mobil me të cilin do të rritet numri i verifikimit të cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës në tregun e brendshëm të Kosovës; Është krijuar dhe funksionalizuar databaza për shkëmbim të produkteve të pa sigurta konform databazës evropiane RAPEX. MTI ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" lidhur me forcimin e infrastrukturës e cilësisë, laboratorëve që posedon MTI dhe mbikëqyrjen e tregut.

Kontrolli i tregut të mallrave strategjike - Është miratuar në Qeveri lista e mallrave ushtarake dhe lista e mallrave me përdorim të dyfishtë të harmonizuara dhe përshtatur me Listat e BE-së; Janë identifikuar afër 117 biznese që konsiderohet që zhvillojnë aktivitete/veprimtari me mallra strategjike. Janë regjistruar 31 kompani të cilat janë pajisur me certifikata; Janë lëshuar 4 licenca individuale; Janë mbajtur 6 trajnime rreth informimit të bizneseve për procedurat e regjistrimit në regjistra si dhe procedurat e licencimit; është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit në mes të MTI-së dhe MB/Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksportit, Republika e Shqipërisë për fushën e bashkëpunimit të kontrollit të eksporteve dhe shkëmbimit të informatave dhe përvojave në këtë sferë; Është finalizuar Programi i Brendshëm i Pajtueshmërisë (PBP) dhe janë identifikuar 3 kompani të cilat duhet ta kenë këtë program.

Mbrojtja e konsumatorit - Ka vazhduar informimi i konsumatorëve përmes aktiviteteve, si: mbajtja e tryezave konsultative; shtypja e 7000 kartolinave për vetëdijësimin; shpërndarja e SMS-ve dhe e fletëpalosjeve mbi të drejtat dhe vetëdijësimin e konsumatorëve nëpër qendrat tregtare; është hartuar dhe miratuar Plani i veprimit mbi Programin për Mbrojtjen e Konsumatorit (2016-2020); Është realizuar anëtarësimi në ICPEN, Konferenca e Rrjetit Ndërkombëtar mbi Mbrojtjen e Konsumatorit; Është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me Qeverinë Hungareze me qëllim të bashkëpunimit për Mbrojtjen e Konsumatorit; kemi pranuar rreth 6500 thirrje/këshillime telefonike dhe rreth 250 ankesa për pirje të duhanit të cilat janë përcjell tek 'Autoriteti i Ushqimit dhe Veterinarisë.'

Akreditimi - Gjatë kësaj periudhe të raportimit janë realizuar 12 Akreditime; 3 ri-akreditime; 35 mbikëqyrje të rregullta; 9 vlerësime; 1 pezullim; 13 aplikime; ndërsa në procedurë për riakreditim janë 2 laboratorë testues dhe 1 kalibrues; ndërsa softueri për akreditimin 'online' DAK-SMIS është në fazën e fundit të testimit.

Metrologjia - Janë verifikuar 465 pika të karburantit, 1,695 ujëmatës, 48 autobotë, 13 koka mbushëse, dhe janë realizuar 340 aktivitete të kalibrimit; Është punuar në ngritjen e Sistemit për Menaxhimin e Cilësisë, ku janë përgatitur manualët e cilësisë për laboratorin e masës, vëllimit dhe rrjedhjes, forcës dhe termometrisë, janë përgatitur procedurat e kalibrimit, si dhe dokumente të tjera të parapara sipas standardit SK ISO/IEC 17,025. Janë organizuar ndërkrahasime laboratorike me vendet e rajonit dhe BE-së; Është bërë ndryshim në Manualin e Cilësisë së AMK-së ku versionit të dytë i janë shtuar anexi 1 i cili i referohet standardit ISO/IEC 17025; 2005 dhe anexi 2 i cili përmban listën e procedurave të AMK-së; Agjencia e Metrologjisë së Kosovës është anëtarësuar në cilësinë e anëtarit të asociuar në EELMEC (Bashkëpunimi Evropian për Metrologji Ligjore).

Regjistrimi i Bizneseve - Në funksion të përmirësimit të ambientit të biznesit kemi bërë unifikimin e numrit të regjistrimit të biznesit me numrin për eksport dhe import; po punohet edhe me ATK-në që bizneset ta kenë vetëm një numër. Është shkurtuar afati kohor për regjistrimin e bizneseve dhe janë implementuar rekomandimet e task forcës "Doing Business" të udhëhequr nga MTI. Prej 3.5 ditëve sa është dashur më heret

për regjistrimin e biznesit është shkruar afati kohor në 1.9 ditë. Në raportin e Bankës Botërore në të bërit biznes jemi renditur në vendin e 13 për regjistrim të biznesit. Janë bërë eliminime dhe reduktime të tarifave për shërbimet e ofruara për bizneset në procesin regjistrimit të tyre. Është zhvilluar moduli për regjistrimin online të bizneseve. Është avancuar regjistri i pengut dhe ofron shërbime shumë të avancuara sipas kërkesave të bankave. Janë regjistruar 10,549 biznese ndërsa janë shuar 2,328 biznese. Nr. i bizneseve me pronarë të huaj – 656; shoqëri me përgjegjësi të kufizuar – 3868.

Standardizimi - Janë adoptuar 1,201 standarde evropiane dhe ndërkombëtare si standarde kosovare; është vazhduar me shitjen e standardeve sipas kërkesave të bizneseve; është punuar në avancimin e ueb-platformës së Agjencisë Kosovare të Standardizimit dhe softverit SMIS.

Investimet e Huaja Direkte - Vlera e IHD-ve për periudhën Janar - Nentor 2016 (sipas BQK-së) është 218.4 milionë €. Shtetet që kanë investuar më së shumti janë: Zvicra, Britania e Madhe, Turqia, Shqipëria, Gjermania, Amerika, Austria. Ndërsa, sektorët ku është investuar janë: patundshmëria, qiradhënia dhe aktivitetet tjera biznese, ndërtimi, shërbimet tregtare, shërbime tjera, shërbime financiare, dhe energjeka.

Aktivitet promovuese: MTI (KIESA) ka marrë pjesë në pesë (5) konferenca, dy (2) forume, një (1) vizitë studimore, një (1) punëtori-panair dhe një (1) event i ndërlidhjes së bizneseve të huaja me ato kosovare; Janë përkrahur në mënyrë direkte dhe indirekte 12 kompani të huaja të cilat kanë investuar apo kanë bërë zgjerimin e aktiviteteve të tyre në Kosovë; Janë realizuar 300 vizita investitorëve të huaj që kanë investuar në Kosovë, identifikimi i problemeve dhe barrierave që ballafaqohen investitorët aktual; Përmes analizës dhe raportit 'after care' është bërë adresimi i sfidave përmes draft dokumenteve të përpiluara nga ana e Agjencisë; Dërgimi i broshurave dhe materialeve promovuese në: Shqipëri, Mal të Zi, Kroaci, Hungari, Çeki, Gjermani, Suedi, Belgjikë, Francë, Luksemburg, Turqi, Bullgari, Itali, Slloveni, Austri, Zvicër, Emiratet e Bashkuara Arabe, Angli, Holandë dhe Amerikë.

Promovimi i Eksportit dhe Turizmit: Janë organizuar 17 aktivitete jashtë dhe brenda vendit për sektorët, janë ekspozuar 1166 produkte, ja lidhur 33 kontrata dhe janë duke u negociuar 97 kontrata. Me qëllim të promovimit të potencialeve turistike të Kosovës si dhe angazhimit të operatorëve turistik në promovim të sektorit të turizmit janë organizuar 5 aktivitete te ndryshme promovuese.

Përkrahja e NVM-ve: Është vazhduar me monitorimin e implementimit të Aktit Evropian të Biznesit të Vogël. Janë organizuar panair si: panairi "Gratë në Biznes 2016". Në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë në bashkëpunim me ICK, janë përzgjedhur 6 planet (idetë) e bizneseve më të mirë. Është mbajtur aktiviteti "Ditët e Biznesit të Vogël" ku janë organizuar 9 konferenca, tri në nivel lokal dhe 6 në nivel rajonal, poashtu në organizimin "NMVM-të më konkurrense" kanë marrur pjesë mbi 600 ndërmarrje. Në kuadër të programit 'Internship Biznesi' 136 studentë janë duke vazhduar praktikën dymujore si dhe përmes skemës voucher të këshillimeve janë mbështetur 45 ndërmarrje. Nga muaji janar deri më 19.12.2015 janë vizituar 164 biznese.

Zonat Ekonomike: Parku i Biznesit në Drenas (PBD) - Është hartuar projekti dhe përzgjedhur operatori ekonomik që do ta implementojë projektin e mbikalimit dhe ndërtimin e dy stacioneve të autobusëve si dhe është duke u monitoruar mirëmbajtja e parkut. Janë marrë hapa konkret për zgjerimin e Parkut të Drenasit edhe për 75 ha të tjerë; ka përfunduar elaborati i shpronësimit, Qeveria ka marre vendim për fillimin e shpronësimit. MTI ka financuar dhe përkrahur edhe tri komuna për ndërtimin e zonave ekonomike: Zona Ekonomike në Shtime; Zona Ekonomike e Suharekës; Zona Ekonomike e Lipjanit. Është përfunduar renovimi i Inkubatorëve të Biznesit në Bërnice dhe PBD. Është nxjerrë UA për Inkubatorët e Biznesit dhe pas shpalljes publike është përzgjedhur subjekti për zhvillimin e inkubatorit të Teknologjisë Informative në Bërnice.

Përmirësimi i qasjes në financa dhe certifikimi i produkteve: Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë është funksionalizuar dhe deri tani ka lëshuar rreth 63 kredi për bizneset vendore. Nga projekti për certifikimin e produkteve kosovare me standarde të cilësisë të njohura ndërkombëtarisht, i cili po implementohet nga BERZH në bashkëpunim me USAID dhe donatorët tjerë, kanë përfituar rreth 20 ndërmarrje kosovare.

Pronësia Industriale - Ekzaminimi i aplikimeve - Agjencia e Pronësisë Industriale (API) ka ekzaminuar aplikimet dhe kërkesat për ndryshime, vazhdime dhe të tjera, me ç'rast ka kryer 27,685 veprime në sistemin IPAS. Veprimet në sistemin IPAS përfshijnë kalimin e aplikimit nga një fazë të ekzaminimit në fazën tjetër. API

ka publikuar 7 buletine të cilat përmbajnë 4798 objekte të Pronësisë Industriale; Është trajtuar çështja e djathit të Sharrit përmes treguesve gjeografik; janë organizuar 5 tryeza me qëllim të rritjes së vetëdijesimit lidhur me rëndësinë e pronësisë industriale.

Rezervat shtetërore - Është përgatitur dhe aprovuar Plani Strategjik dhe Programi Vjetor 2016-2018. Sa i përket rritjes së fondit të rezervave, fondi i rezervës shtetërore për naftë është furnizuar me sasinë prej 117,469 litra; ndërsa fondi i rezervës shtetërore të grurit është furnizuar me sasinë prej 1,072.82 tonë grurë. Është duke u bërë analiza e gjetjes së formave alternative lidhur me krijimin e rezervave shtetërore të obligueshme të naftës duke marrë parasysh obligimet kontraktuale të Kosovës në Komunitetin e Energjisë.

- MINISTERIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), është e angazhuar t'i kontribuoj zhvillimit të standardit të jetesës dhe mirëqenies së qytetarëve, duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të energjisë me theks të veçantë EE, BRE dhe Bashkëprodhimin, sektorit gjeologo-minerar dhe të TIK-ut në Republikën e Kosovës. MZHE do të siguroj shfrytëzim të qëndrueshëm, efikas dhe efektiv të resurseve energjetike, minerare dhe frekuencore në pajtueshmëri me praktikën me të mira evropiane dhe ndërkombëtare. Po ashtu ngritja e konkurrencës së ekonomisë përmes krijimit të një klime të favorshme për investime në vend, ristrukturimi i ekonomisë përmes transformimit të pronësisë, modernizimit dhe ngritjes së efikasitetit të ndërmarrjeve publike, me qëllim të krijimit të një ekonomie funksionale të tregut.

Sektori i Energjisë

Strategjia & Ligjet - Në kuadër të Sektorit të Energjisë është finalizuar drafti i Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026. Gjatë vitit 2016 nga MZHE është finalizuar pakoja e ligjeve të sektorit të energjisë dhe janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës këto ligje të cilat janë në përputhje me paketën e tretë të direktivave të BE-së. Ligjet e miratuara janë si në vijim: Ligji për Energjinë nr. 05/L-081; Ligji për Energjinë Elektrike me nr. 05/L-085; Ligji për Rregullatorin e Energjisë nr. 05/ L- 084; Ligji për Gazin natyror me nr. 05/L- 082.

Gjithashtu, përgjatë vitit 2016 në zbatim të Ligjeve të Energjisë kanë filluar aktivitetet për rishikimin dhe hartimin e disa akteve nënligjore, të cilat priten të finalizohen në vitin 2017.

Po ashtu gjatë fazës raportuese MZHE ka hartuar Koncept Dokumenti për Pajisjet nën Presion të cilat i nënshtrohen presionit punues më të madh se 0.5 Bar manometrik dhe është miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Efiçienca e Energjisë (EE) - Në funksion të rregullimit më të mirë të fushës së EE është draftuar ligji për Efiçencën e Energjisë është përgatit draft Raporti i Progresit për Planin e detyrues afatmesëm kombëtar të Veprimit për Efiçencë të Energjisë 2013-2015; është përgatit draft Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencë të Energjisë 2016-2018; Agjencia e Kosovës për Efiçencë të Energjisë në bashkëpunim me komunat (Klinë, Junik, Malishevë, Zveçan, Viti, Kaçanik, Partesh, Shtërpçë dhe Zubin Potok), kanë përgatitur Planet Komunale për Efiçencë të Energjisë 2016-2020, të cilat janë aprovuar në asambljetë komunale përkatëse. Në kuadër të realizimit të projekteve për zbatimin e masave të efiçencës së energjisë, e të cilat financohen përmes kredisë nga Banka Botërore, është bërë përzgjedhja e kompanisë për implementim të projektit për 14 ndërtesa dhe për 5 Objekte që do të financohen nga MZHE. Gjithashtu janë përzgjedh 20 ndërtesa të reja, ku kompania për përgatitjen e dizajneve për këto 15 ndërtesa është përzgjedhur dhe ka filluar punën. Auditimet energjetike për projektin që financohet nga BB kanë përfunduar.

Në kuadër të zbatimit të masave të EE, të financuara nga MZHE, është bërë instalimi i sistemit të ngrohjes qendrore në tri shkolla fillore "Avni Rrustemi"-Irnziq-Deçan; "Faik Dragaj"-Leçin-Skenderaj; dhe "Jahë Salihu"-Molliq-Gjakovë. Ky projekt vazhdon edhe përgjatë vitit 2017 në shkollat tjera.

Projekti i TC Kosova e Re - Bisedimet për mbylljen e fazës së parë të projektit "Mbyllja Komerciale" kanë vazhduar intensivisht edhe gjatë kësaj periudhe, dhe nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve pritet të bëhen në fillim të vitit 2017. Njëkohësisht, po punohet në përgatitje të finalizimit të fazës së dytë të projektit "Mbyllja financiare", e cila pritet të kryhet në K3-2017

TC Kosova B dhe Dekomisionimi - Aktiviteti për realizimin e Studimit të Fizibilitetit për Rehabilitimin e TC Kosova B, projekt i cili mbështetet në kuadër të IPA 2015 është duke vazhduar dhe pritet të përfundoj në pjesën e parë të vitit 2017. Për procesin e dekomisionimit të objekteve të gazifikimit, azotikut dhe ngrohjes në lokacionin e TC Kosova A, është duke vazhduar procedura e tenderimit nga Zyra e BE në Kosovë për përzgjedhjen e kompanisë konsulente në kuadër të programit IPA 2014. Në ndërkohë grupi i parë punues për dekomisionim, ka përgatitur dokumentacionin teknik të objekteve të cilat pritet të nënshtrohen dekomisionimit.

Transmisioni i energjisë elektrike - Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve në nivel të transmisionit, përgjatë vitit 2016 janë realizuar projektet kapitale si: Vendosja e infrastrukturës për rregullimin sekondar të Linjës së Transmisionit Kosovë-Shqipëri; Furnizimi dhe instalimi i TR3, 40 MVA në NS Prishtina 2; Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS 110/10 kV - Prizreni 3; Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në Nën Stacionin (NS) 110/10 kV - Gjakova 2; Instalimi i TR2 në NS 110/10 kV - Berivojcë dhe NS Viti; Instalimi i grupeve matëse në kufirin e ri komercial KOSTT - KEDS/OSSH (përfundon në K1 2017); Instalimi i TR 2 në NS 110/10(20) - Skenderaj dhe NS Burim (përfundon në K1 2017).

Në kuadër të monitorimit të përmbushjes së obligimeve që dalin nga kontrata e Privatizimit të KEDS ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe KCLE/KEDS, deri tani nuk ka asnjë çështje ligjore të ngritur në mes palëve nënshkruese të Marrëveshjes për Shitblerjen e Aksioneve.

Sektori i Minierave

Në kuadër të zbatimit të politikave për zhvillimin e sektorit minerar: është hartuar Raporti i Progresit për vitin 2015 për zbatimin e Strategjisë Minerare; është përgatit dhe është miratuar nga MZHE Plani i Menaxhimit të Resurseve minerale për vitin 2016.

Në lidhje me rregullimin e statusit të ndërmarrjes "Trepça" është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës Ligji për Trepçën nr. 05/L-120.

Në bashkëpunim me Komisionin Parlamentar për Zhvillim ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri është hartuar dhe miratuar ligji Nr. 05/L-062 për Siguri në punë në veprimtarinë minerare.

Gjithashtu janë realizuar projektet kapitale të financuara nga MZHE: Riaftësimi i vend punishteve në horizontet VIII dhe IX Miniera TREPÇA Stanterg; Hapja e vendpunishteve të reja në horizontet X-XI Miniera TREPÇA; Përmirësimi i kushteve të punës në Rafinerin - Zveqan; Mbështetja e ndërmarrjes Trepça- AKP përmes subvencioneve për pagimin e pagave dhe stipendioneve për punëtorët e Trepçës; Studimi lidhur me identifikimin e efekteve anësore të aktivitetëve minerare në komunitet; Po ashtu është realizuar Studimi lidhur me Identifikimin e Efekteve Anësore të Aktivitetëve Minerare në Komunitet.

Ndërsa sa i përket Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, janë zhvillu këto aktivitete: Funkcionalizimi i laboratorit të SHGJK-së me pajisje; Përpilimi i planshetës (hartës) gjeologjike të Kosovës me shkallën 1: 25000. Gjithashtu është miratuar koncepti dokumenti për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

Sektori i TIK

Është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës Strategjia Nacionale për Teknologji Informative e cila përmban planin e detajuar të veprimit për periudhën 2016-2018.

Po ashtu janë realizuar projektet si në vijim: Projektet me Bankën Botërore: Zbatimi i Programit për Ekonominë Dixhitale të Kosovës - KODE përfshinë infrastrukturën brezgjere telekomunikuese të Kosovës. Projekti për këtë infrastrukturë ka hyrë në klauzolën e investime dhe do të zbatohet viteve në vijim. Pilot projekti Gratë në Punët Online (Ëomen in Online Ëork) - ËOË është realizuar në dy komuna Lipjan dhe Gjakovë; Ka filluar Pilot Projekti Gratë në Punët Online (Ëomen in Online Ëork) - ËOË 2 - Ky pilot përfshin trajnimin e së paku 65 grave të ndara në tri grupe/module të ndryshme për trajnim dhe përfshin rajonin e Prishtinës.

Grumbullimi i të dhënave për infrastrukturën brezgjere në Kosovë - Projekti për Krijimin e Atlasit Elektronik të infrastrukturës brezgjere (në kuadër të të cilit projekt do të mblidhen këto të dhëna) është në fazën e tenderimit.

Përgatitja e Programit Vjetor të Pullës Postare për vitin 2017 dhe përzgjedhja e motiveve fituese nga programi vjetor i pullës postare të vitit 2016- "Komisioni për Pullë Postare ka përgatitur dhe propozuar për miratim Programin Vjetor të Pullës Postare për vitin 2017 me gjithsejtë 12 tema, i cili është miratuar nga MZHE.

Gjithashtu Komisioni për Pullë Postare ka përzgjedhur dizajnet dhe ka miratuar mostrat e para me temat: Shenjtërimi i Nënë Terezës; Specjet në zhdukje; Veshja e Rekës; Gastronomia - Pemtaria."

Drafti i Koncept Dokumentit për Shërbimet Postare (KDSHP) është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Ndërmarrjet Publike

Ndërmarrjet Publike janë mbështet nga MZHE në ngritjen e kapaciteteve të anëtareve të bordeve të ndërmarrjeve publike përmes zhvillimit të trajnimeve. Në kuadër të zbatimit të politikave të Qeverisë, përmes përkrahjes financiare nga buxheti i Kosovës, ndërmarrjet publike janë mbështet në: Subvencionimin e energjisë elektrike - Rastet sociale (4,500,000 € subvencione); Ngrohja Qendrore (400,000 € subvencione); Uji dhe Hedhurinat (9,590,050 € kapitale dhe 1,059.381.00 € subvencione); Trainkos (850,000 € kapitale; 500,000

subvencione); Infrakos (871,274 € kapitale dhe 700,000 € subvencione); Posta e Kosovës (100,000 € kapitale), Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë KMDK (200,000.00 € subvencione) Kompania Rajonale e Mbeturinae - Uniteti (183,151.26 € subvencione), Aeroporti i Gjakove (130.000.00 € subvencione)

Shtojca 1: ZBATIMI I PLANIT VJETOR TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE PËR VITIN 2016

Përmbledhje ekzekutive

Procesi i hartimit të Plani Vjetor i Dokumenteve Strategjike (PVDS) kryhet në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe Udhëzimit Administrativ 02/2012 për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e hartimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre). Duke u bazuar në rregullativën e lartpërmendur, ZPS ka kërkuar nga ministritë përkatëse të raportojnë lidhur me gjendjen e procesit të hartimit të këtyre dokumenteve. Pas raportimit nga ministritë e linjës, ZPS ka hartuar edhe këtë vit raportin mbi zbatimin e

Planit Vjetor të Dokumenteve Strategjike për vitin 2016, ku janë paraparë të hartohen 41 dokumente strategjike, nga të cilat deri më tani janë miratuar vetëm 8 prej tyre, 5 dokumente strategjike nuk kanë filluar fare të hartohen, 28 dokumente strategjike janë në proces të hartimit, ku 26 prej tyre janë bartur nga viti paraprak, ndërsa 12 dokumente strategjike janë bartur tri vitet e fundit – 2014, 2015 dhe 2016.

Ndër problemet më të theksuara gjatë këtij procesi janë: mungesa e bashkëpunimit të departamenteve përkatëse përgjegjëse për hartimin e dokumenteve strategjike me Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në ministritë e linjës; mosrespektimi i Rregullores së Punës së Qeverisë dhe Udhëzimit Administrativ 02/2012; mosrespektimi i afateve të përcaktuara në Planin Vjetor të Dokumenteve Strategjike dhe mospërputhja me Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe buxhetin vjetor; mungesa e qasjes sektoriale; mungesa e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të dokumenteve strategjike; mos-raportimi tek Zyra për Planifikim Strategjik (mosrespektimi i Planin Vjetor të Dokumenteve Strategjike, përkatësisht Planit Vjetor të Punës së Qeverisë).

Ndër rekomandimet më kryesore të nxjerra nga ZPS në këtë raport përfshijnë: propozimet e ministrive të linjës për hartimin e dokumenteve strategjike të jenë në përputhje me standardet e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 02/2012 dhe të respektohet Rregullorja e Punës së Qeverisë, si dhe dokumentet tjera përkatëse që kanë të bëjnë me procesin; bashkëpunim më i mirë me DIEKP-të dhe departamentet përkatëse përgjegjëse për hartimin e dokumenteve strategjike në ministritë e linjës; përcaktimi i afateve reale për hartimin e dokumenteve strategjike; kostoja e dokumenteve strategjike në përputhje me KASH-in dhe buxhetin vjetor; ndërlidhje më e ngushtë me Programin e Qeverisë, Strategjinë Kombëtar për Zhvillim (SKZH), si dhe me masat që lidhen me zbatimin e Programit për Reforma Ekonomik, procesin e integritimit Evropian dhe dokumentet e tjera strategjike, në mënyrë që të shmanget mbivendosja (dyfishimi) e dokumenteve strategjike ekzistuese.

Hyrje

Planit Vjetor i Dokumenteve Strategjike (PVDS), përpilohet sipas propozimeve të ministrive të linjës, dhe miratohet si pjesë e Planit Vjetor të Punës së Qeverisë⁴. ZPS në fund të vitit të kaluar ka përgatitur Planin Vjetor të Dokumenteve Strategjike për vitin 2016, i miratuar si pjesë e Planit të Punës së Qeverisë për vitin 2016. Ky Plan është përgatitur përmes një procesi të koordinuar me të gjitha ministrinë dhe rrjedhë si rezultat i propozimeve të ministrive apo institucioneve tjera përkatëse. Planit përfshinë strategjitë, programet, planet e veprimit dhe dokumentet tjera strategjike sipas Udhëzimit Administrativ 02/2012.

Roli i ZPS është të sigurojë që planifikimi dhe hartimi i dokumenteve strategjike të parapara me PVDS të bëhet në pajtim me prioritetet, dokumentet kryesore strategjike dhe të politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Raporti në fjalë mbulon periudhën 01 janar- 31 dhjetor, 2016 dhe qëllimi kryesor i këtij raporti është analiza, vlerësimi dhe pasqyrimi i gjendjes së procesit të hartimit të dokumenteve strategjike nga ana e ministrive të linjës, zbatimi i Udhëzimit të lartpërmendur për hartimin e dokumenteve strategjike, nënvizimi i çështjeve dhe problemeve kryesore të hasura gjatë kësaj periudhe, angazhimi i ZPS-së në proces, gjetjet si dhe rekomandimet për zgjidhjen e këtyre problemeve.⁵ Raporti identifikon gjithashtu dokumentet strategjike të cilat janë bartur vazhdimisht vitet e fundit dhe për të cilat ZPS do të kërkojë rishikimin e tyre nga ana e ministrive përkatëse të linjës, që në përputhje me objektivat e Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave të Kosovës, të merret parasysh vendosja e tyre në aspektin sektorial dhe ndër sektorial.

Koordinimi i procesit të hartimit të dokumenteve strategjike sipas PVDS 2016

Qëllimi kryesor i PVDS është koordinimi më i mirë i procesit të hartimit të dokumenteve strategjike dhe sigurimi që të jenë në përputhje me prioritetet strategjike dhe politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës. ZPS ka koordinuar dhe monitoruar procesin e hartimit të dokumenteve strategjike sipas PVDS 2016. Gjithashtu ZPS ka marr pjesë në të gjitha ato proceset e hartimit të këtyre dokumenteve, si në grupet punuese dhe procesin e shqyrtimit të dokumenteve strategjike në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria dhe konsistenca me prioritetet strategjike të Qeverisë të dhëna në Programin e Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, Programin për Reforma Ekonomike, si dhe me Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar në përgjithësi gjendja e procesit të hartimit dhe miratimit të dokumenteve strategjike gjatë vitit 2016.

TABELA 1. Gjendja e hartimit dhe miratimit të dokumenteve strategjike për vitin 2016

⁴ Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS) në bazë të Rregullores së Punës së Qeverisë, gjegjësisht në përputhje me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2012, është përgjegjëse për koordinimin e procesit të hartimit të dokumenteve strategjike në kuadër të Qeverisë së Kosovës. Rregullorja përcakton përfshirjen në procesin e hartimit të dokumenteve strategjike disa nga institucionet kyçe në Qeverinë e Republikës së Kosovës si: Zyrën për Planifikim Strategjik, Ministrinë e Financave, Departamentin përkatës për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, Departamentin e Buxhetit të Ministrisë përkatëse.

⁵ Zyra për Planifikim Strategjik gjatë përpilimit të këtij raporti është bazuar fillimisht në punën e grupeve punuese, pjesë e të cilëve është edhe ZPS sipas rregullativës në fuqi. Pastaj, më datën 12 gusht, 2016, ZPS ka dërguar email tek të gjitha ministrinë të linjës, për të raportuar lidhur me gjendjen e përgjithshme të procesit të hartimit të dokumenteve strategjike sipas planifikimit të parapara me PVDS 2016.

A: Plani në vitin 2016


Numri i dokumenteve strategjike të planifikuara të hartohen gjatë vitit 2016	41
• Dokumentet Strategjike të bartura nga viti paraprak (2015)	26
• Dokumentet Strategjike të bartura tri vitet e fundit (2014, 2015, 2016)	12

B: Realizimi i Planit për Vitin 2016

1. Dokumentet Strategjike të miratuara	8
2. Dokumentet Strategjike të cilat janë ende në proces të	28
3. Dokumentet Strategjike të cilat nuk filluan të hartohen gjatë vitit 2016	5

Pra, siç shihet gjatë vitit 2016 në PVDS u përfshinë 41 dokumente strategjike të propozuara nga Ministrinë për t'u hartuar dhe miratuar gjatë vitit 2016. Procesi i përfundimit të tyre sipas tremujorëve është si në grafikun e dhënë më poshtë:

Grafiku 1: Plani i hartimit të dokumenteve strategjike sipas tremujorve-2016





Të dhënat e mësipërme pasqyrojnë një gjendje jo të kënaqshme dhe ngrenë disa shqetësime të cilat janë evidentuar edhe më parë nga ZPS-ja.

Këto probleme janë:

1) *Mungesa e kapaciteteve të ministrive të linjës që të hartojnë në kohë dokumentet e planifikuara.* Nëse shohim të dhënat e në tabelën e mësipërme, kemi një numër të madh të dokumentesh strategjike të cilat për shkak të vonësave dhe mungesës së kapaciteteve të ministrive përcillen nga vitit në vit. Grafikët e mëposhtëm paraqesin numrin e dokumenteve strategjike që barten nga një vit në tjetrin. Në vitin 2016, 12 dokumente strategjike, apo 29% e tyre ishin të bartura nga vitet 2014 dhe 2015, ndërsa për vitin 2016, si rezultat i mos-realizimit, ky numër është akoma më i madh: në total nga 42 vetëm 8 përfunduan dhe u miratuan, kurse 32 strategji ose 80% e planit të dokumenteve të parashikuara të hartoheshin në vitin 2016 nuk u përfunduan.

Grafiku 2: PVDS 2016 - Planifikimi

Grafiku 3: PDSV 2016 - Realizimi



Nga ky numër 28 dokumente, apo 68% e atyre të planifikuara nuk arritën të përfundoheshin në vitin 2016, kurse 5 ose 20% nuk filluan fare të hartohen gjatë vitit 2016.

Në tabelën e mëposhtme jepet informacion i detajuar mbi gjendjen e hartimit të dokumenteve strategjike të planifikuara në vitin 2016, dhe dokumentet strategjike të bartura nga vitet e kaluara.

Tabela 2: Lista e dokumenteve strategjike sipas statusit të tyre

Të hartuara dhe miratuara në 2016	Nuk filluan fare të hartohen në 2016
<ul style="list-style-type: none"> Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike për vitet 2016-2020 dhe Plani i Veprimit 2016-201 (Ministria e Financave) Strategjia për Trajnime të Nëpunësve Civilë 2015-2017 Programi për Rezervat Shtetërore të Mallrave 2016-2018; Strategjia për Trashëgimi Kulturorë 2015-2020; Strategjia për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2015-2020; PSAK 2017-2021; Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 	<ul style="list-style-type: none"> Strategjia kombëtare e zhvillimit të aviacionit civil 2017-2021 Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës (2016-2020) Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2016-2020 (ABGJ) - është bartur më 2017 Strategjia për rregullimin e çështjes së Piraterisë në fushën e të drejtës së autorit 2017-2021 (MKRS); Strategjia për Gratë në TIK (MZHE).

Të bartura nga vitet e mëparshme

- Strategjia për avancimin e ndërmarrjeve agro-ushqimore (AVUK) – për këtë dokument strategjik ekziston Vendimi i nxjerrë më 28.09.2012 për krijimin e grupit punues për hartimin e strategjisë nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë. Rekomandimi i ZPS-së është që të nxirret vendim i ri për këtë strategji në përputhje me Udhëzimin Administrativ 02/2012.
- Strategjia për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore si dhe Plani i Veprimit i Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore (AKMBRr) - tani është para miratimit.
- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2016-2020.
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës (2016-2020) (ZQM).
- Plani Strategjik për të Drejtat e Fëmijëve 2016-2020 (ZQM).

- Strategjia për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave Gjuhësore (ZKGj)
- Strategjia Shtetërore për Ujëra (MMPH)
- Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike (MMPH)
- Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit (MMPH)
- Strategjia Nacionale për sektorin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë (2015 - 2020) – që nga viti 2014 (MBPZHR)
- Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 – që nga viti 2014 - (MBPZHR)
- Strategjia për Produkte Malore Jo-drusore 2015-2020 (MBPZHR);
- Programi Nacional për Pyllëzime (MBPZHR)
- Programi për Identifikimin e Sëmundjeve dhe Dëmtuesve (MBPZHR)
- Strategjia për Zhvillimin e Sportit 2015-2020 (MKRS)
- Strategjia për Trashëgimi Kulturorë 2015-2020 (MKRS)
- Strategjia për Zhvillimin e Kulturës (MKRS)
- Programi për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë të Kosovës për periudhën trevjeçare (MZHE)
- Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës për periudhën dhjetëvjeçare (MZHE)
- Strategjia për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Plani i Veprimit 2016-2020 (MPB)
- Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat (MTI)
- Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2015-2020 (MSH) – që nga viti 2014 në proces të hartimit.
- Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit (MDR)
- Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore
- Strategjia për Trajnime të Nëpunësve Civilë 2015-2017 – e miratuar
- Strategjia për Qeverisje Elektronike 2016-2020 (MAP).

2) Fluksi i madh i dokumenteve strategjike dhe fragmentimi i tyre. Aktualisht Kosova ka 55 dokumente strategjike. Problem nuk mbetet vetëm numri i madh i strategjive por dhe fragmentimi i tyre. Disa nga ministritë kanë një numër të madh të dokumenteve strategjike, secila ministri të paktë 1 strategji, ndërkohë që numri i strategjive ndërsektoriale apo ndërinstytucionale mbetet i limituar. ZPS ka arritur në konkludim se ka edhe fragmentim si dhe dyfishim të dokumenteve strategjike, ndërkohë që shume prej tyre mund të fuzionohen në një dokument të vetëm strategjik.

3) Probleme të menaxhimit të procesit nga ministritë e linjës. Bartja e strategjive nga viti/et paraprak dhe vonesa për të finalizuar procesin e hartimit dhe miratimit të tyre rezultojnë me mos-vazhdimësi të grupit punues për hartimin e dokumentit strategjik përkatës e si rrjedhojë kjo shkakton probleme qoftë në mos-respektimin e planifikimit sipas planit vjetor apo edhe shpeshherë edhe në vetë përmbajtjen e dokumentit strategjik.

4) Mungesa e aftësive planifikuese lidhur me afatet kohore të duhura për hartimin e dokumenteve strategjike. Ministritë e linjës zakonisht planifikojnë që brenda një tremujori të hartohet dokumenti strategjik, ndërsa sipas kalkulimeve tona dhe praktikës së deritanishme hartimi i një dokumenti strategjik mund të marr kohë nga tre - deri në gjashtë muaj ose edhe më shumë. Kjo varet edhe në masë të madhe edhe nga natyra e dokumentit strategjik. Ministritë e linjës duhet t'i kushtojnë kujdes shumë më të madh përcaktimit saktë të afateve për hartimin e dokumenteve strategjike.

5) Mungesa e koordinimit të procesit brenda ministrive dhe me ZPS-në. ZPS ka marr pjesë në të gjitha ato procese të hartimit ku jemi informuar me kohë dhe në përputhje me rregullativën në fuqi nga ministritë

përkatëse, por kemi konstatuar raste kur fillon dhe mbaron i tërë procesi i hartimit të një dokumenti strategjik dhe ZPS-ja njoftohet në fund fare. Për këtë ZPS në vazhdimësi ka kontaktuar DIEKP-të si përgjegjëse për koordinimin e planifikimit strategjik dhe zhvillimit të politikave në ministritë e linjës në mënyrë që të informohemi sa më mirë lidhur me procesin e hartimit të dokumenteve strategjike. Nga këto kontakte, është konstatuar se shpesh vetë DEIKP-të lihen jashtë procesit të hartimit të strategjive nga strukturat përgjegjëse për hartimin e dokumentit strategjik. Kjo përbën një shkelje të Rregullores nr.01/2011 për rolin e Departamenteve për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në kuadër të ministrive. Në anë tjetër, roli i DIEKP-së nuk konsiston vetëm në përmbledhjen e propozimeve të përgatitura nga departamentet sektoriale pa i analizuar dhe verifikuar ato. Sipas Rregullores nr.01/2011 për DIEKP, ato duhet të kujdesen për cilësinë e propozimeve të politikave, planeve dhe strategjive të ministrive të tyre përkatëse.⁶

6) *Probleme me mos respektimin e kritereve të përcaktuara lidhur me dokumentet strategjike.* Një mungesë e tillë koordinimi ka çuar shpesh në mospërputhjen e dokumentit të hartuar me rregullativën në fuqi dhe me vonesë të finalizimit të dokumenteve strategjike. Mosrespektimi i Udhëzimit Administrativ 02/2012 për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e hartimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre, mbetet njëra ndër të metat më të mëdha të procesit të hartimit të dokumenteve strategjike. Ky Udhëzim ka për qëllim të krijojë një praktikë unike në procesin e planifikimit dhe hartimit të dokumenteve strategjike përmes vendosjes së kritereve dhe metodologjisë së unifikuar si dhe përcaktimit të detajuar të gjitha hapave procedurale rreth përgatitjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike.⁷ Nenet 7, 8, dhe 9 të këtij Udhëzimi përcaktojnë qartë hapat të cilët duhet të ndiqen nga ministritë e linjës dhe institucionet tjera përkatëse me rastin e hartimit të dokumenteve strategjike.

Gjithashtu, veç probleme të mësipërme që lidhen më aftësinë e ministrive, ZPS konstaton edhe disa probleme të tjera:

7) *Mungesa e kostimit të qartë dhe mbulimit financiar* që nuk garanton se të gjitha dokumentet strategjike kanë edhe mbulesë financiare (KASH dhe buxheti vjetor).

8) *Mungesa e monitorimit dhe raportimit të dokumenteve strategjike nga ministritë.* Kjo mangësi rezulton me mungesë informacioni të duhur për nivelin politik të realizimit të dokumenteve strategjike, rezultateve të arritura nga zbatimi i tyre, dhe si rrjedhojë, mangësi në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjegjshmërisë institucionale për realizimi e objektivave strategjike të Qeverisë. Po ashtu, ministritë e linjës e kanë të vështirë krijimin e treguesve specifikë dhe lehtë të matshëm të cilët janë të ndërlidhur në mënyrë të qartë me arritjen e objektivave/zbatimin e aktiviteteve të propozuara dhe në të shumtën e rasteve ato përdorin vetëm treguesit në bazë të rezultateve për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve. Si rezultat i kësaj, shpesh kemi raste kur objektivat përsëriten apo mbivendosen në dokumentet e ndryshme strategjike apo edhe ato që pasojnë dokumentet e skaduara strategjike.

9) *Mosrespektim i kërkesave të transparencës dhe informimit publik.* Jo të gjitha ministritë e linjës publikojnë dokumentet strategjike të miratuara në faqet elektronike zyrtare të tyre apo edhe kur e bëjnë një gjë të tillë publikimi është i pjesshëm (dokumente strategjike nuk publikohen në të gjitha gjuhët zyrtare). Gjithashtu, gjatë hartimit të dokumenteve strategjike ministritë e linjës shpesh dështojnë edhe në realizimin e procesit të konsultimit publik.

⁶ Për më shumë shih në veçanti nenet 1.2, 1.4 dhe 1.5 të Rregullores nr.01/2011 për Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në kuadër të Ministrive.

⁷ http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Draft_Udhezimi_Administrativ_Per_Strategjite_FINAL_2012__2_.pdf

Pavarësisht mangësive të mësipërme të cilat mbetën shumë shqetësuese, ka pasur arritje në disa drejtime, si në vijim:

Hartimi i Planeve të Veprimit: Duhet theksuar se në krahasim me vitet tjera është arrit përparim sa i përket hartimit të dokumenteve strategjike sipas nenit 10 'Përgatitja e Planit të Veprimit për zbatimin e dokumentit Strategjik' të Udhëzimit Administrativ 02/2012, pasi që të gjitha dokumentet strategjike të dorëzuara për opinion tek ZPS përcillen me planet e veprimit.

Me qëllim përmirësimin e kësaj situatë, si pjesë e shtyllës së dytë të Reformës së Administratës Publike, orientimi strategjik i Qeverisë së Republikës së Kosovës është edhe ndërtimi i **Sistemit të Planifikimit të Integruar, nëpërmjet Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë, e rishikuar dhe e miratuar më 21 dhjetor, 2016.** Në veçanti, sa i përket hartimit të dokumenteve kjo Strategji synon të eliminojë fragmentimin dhe dyfishimin ndërmjet proceseve qendrore të planifikimit të politikave dhe atij financiar. Fokusi kryesor i përmirësimit do të jetë në dy korniza qendrore që duhet të mbulojë të gjitha proceset planifikuese të qeverisë:

- **Korniza e Planifikimit Strategjik:** Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH); dhe strategjitë sektoriale përcaktojnë kornizën strategjike të qeverisë, duke përfshirë synimet afatmesme dhe afatgjate dhe strategjitë për të gjithë sektorët; dhe
- **Korniza e planifikimit buxhetor:** Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH), që kërkon që secila ministri të zhvillojë plane tre vjeçare për arritjen e objektivave dhe synimeve brenda kufijve të shpenzimeve.

Po ashtu, në kuadër të kësaj, ZPS është duke bërë plotësim/ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 02/2012 dhe me këtë synohet që të aplikohet një qasje sa më sektoriale (aplikimi i strategjive sektoriale duke pasqyruar sektorët e prezantuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve); pastaj fokusimi në forcimin e rolit të ZPS-së dhe Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik me rastin e propozimit të dokumenteve të reja strategjike; forcimi i monitorimit dhe vlerësimit, zbatimit të përdorimit të treguesve të matshëm të performancës në nivel të objektivave; ndërtimin e një sistemi të raportimit për zbatimin e strategjive sektoriale, ku pas vendosjes së raportimit në mënyrë graduale, në një fazë të mëvonshme vlerësimi sistematik afatmesëm dhe final i zbatimit të strategjive do të bëhet i detyrueshëm.

Në fund, Zyra për Planifikim Strategjik në këtë periudhë ka përditësuar edhe Regjistrin e Dokumenteve Strategjike në fuqi si dhe ka publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Kryeministrit të gjitha ato dokumente strategjike të cilat i ka marr nga ministrinë e linjës.

Konkludime

Në vazhdim janë dhënë problemet e nënvizuara si konkludim i përmbajtjes së këtij raporti gjatë kësaj periudhe, për të cilat duhet theksuar se janë përsëritje e viteve të kaluara edhe pse ZPS vazhdimisht ka ftuar të gjitha DIEKP-të në takim për të sqaruar problemet rreth hartimit të dokumenteve strategjike dhe respektimit të afateve të përcaktuara nga Qeveria e Kosovës. Një çështje e cila është shumë akute që duhet të adresohet nga Ministrinë që sa më parë është edhe monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të dokumenteve strategjike.

Si **konkluzion i përgjithshëm**, bazuar në analizën e detajuar të realizuar më lart, sistemi i hartimit të dokumenteve strategjike në Kosovë ka ende mangësi lidhur me:

- (i) kapacitetet planifikuese;

- (ii) fluksi i madh i dokumenteve dhe fragmentarizimi i tyre;
- (iii) mungesa të koordinimit institucional dhe ndër-institucional;
- (iv) mosrespektimi i Rregullores së Punës së Qeverisë;
- (v) mosrespektimi i Udhëzimit Administrativ 02/2012;
- (vi) tejkalimi i kostimit të dokumenteve strategjike dhe mospërfshirja në Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe buxhetin vjetor;
- (vii) mungesë monitorimi dhe vlerësimi për zbatimin e dokumenteve strategjike që janë në fuqi;

Rekomandime

Në mënyrë që të tejkalohen problemet e nënvizuara më lartë, Zyra për Planifikim Strategjik jep këto rekomandime:

- Objektivat e parapara me dokumentet strategjike të jenë në përputhje të plotë me prioritetet e dhëna në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, Programin e Qeverisë, Programin për Reforma Ekonomike, procesin e integritit evropian (Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së);
- Dokumentet strategjike duhet të orientohen nga vizioni kombëtar dhe jo nga qasja organizative, apo tematike. Kjo kërkon aplikimin e qasjes më sektoriale me rastin e propozimit të dokumenteve strategjike për t'u miratuar si pjesë e Planit Vjetor të Dokumenteve Strategjike. Në këtë pikë, ministrinë e linjës duhet të kujdesen për ato dokumente strategjike të cilat janë propozuar viteve të fundit (2014, 2015, 2016) dhe ende nuk janë hartuar, të fuzionohen në një dokument ose edhe të largohen nga plani vjetor. Kjo duhet të bëhet e objektivat e S
- Të rritet bashkëpunimi me DIEKP-të dhe departamentet përkatëse përgjegjëse për hartimin e dokumenteve strategjike në ministrinë e linjës. Propozimet për dokumente strategjike nga ministrinë e linjës duhet të përgatiten si rezultat i punës së përbashkët të departamenteve sektoriale, departamentit të buxhetit dhe DIEKP.
- DIEKP-të në ministrinë e linjës në përputhje me rregullativën e lartëpërmendur të luajnë rol udhëheqës në përgatitjen e dokumenteve strategjike;
- Hartimi i dokumenteve strategjike të bëhet në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ 02/2012;
- Të përcillet zbatimi dokumenteve strategjike të miratuara (monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të tyre);
- T'i kushtohet më shumë vëmendje përcaktimit të afateve gjatë kohës së dërgimit të propozimeve për hartimin e dokumenteve strategjike nga ministrinë e linjës për vitin vijues;
- Përcaktimi i kostos së dokumenteve strategjike duhet të bëhet në mënyre realiste dhe procesi i financimit të realizohet në përputhje me KASH-it dhe buxhetin vjetor. Nëse implikimet buxhetore janë në mënyre të ndjeshme mbi planifikimet buxhetore të KASH-it dhe buxhetit vjetor, atëherë duhet të ketë një arsyetim të detajuar se si do të mbulohen kostot shtesë;
- Ministrinë duhet të kujdesen që të publikojnë të gjitha dokumentet strategjike në fuqi në faqet e tyre të internetit.

Shtojca 2: ZBATIMI I PROGRAMIT LEGJISLATIV PËR VITIN 2016

Me Rregulloren nr. 09/2011 e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës përcaktohen rregullat dhe procedurat për hartimin e legjislacionit dhe rekomandimeve të politikave nga Qeveria dhe Ministrinë.

Qeveria e Republikës së Kosovës në përputhje me Rregulloren e punës së saj çdo vit përgatit Planin Vjetor të Punës, i cili përfshin aktivitetet legjislative dhe jo-legjislative. Aktivitetet legjislative përmbledhen në një Shtojcë të veçantë të Planit Vjetor të Punës me qëllim të lehtësimit të menaxhimit dhe monitorimit të iniciativave legjislative të Qeverisë- Programi Legjislativ.

Programi Legjislativ përmban ministrinë bartëse të projektligjeve si dhe datat se kur parashihet që Ministrinë t'i dërgojnë projektligjet për shqyrtim dhe miratim në Qeveri.


Për më tepër ky program më tutje përdoret nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për të planifikuar seancat gjatë tërë vitit, si dhe hartimin e planeve të punës për komisionet parlamentare.

Zyra e Kryeministrit monitoron zbatimin e Programit Legjislativ të Qeverisë dhe në këtë raport mund të gjeni të dhënat për realizimin e Programit Legjislativ gjatë vitit 2016.

Programi Legjislativ 2016 përmban gjithsej 112 Projektligje, prej të cilave janë miratuar gjithsej **53 Projektligje**.

Në kuadër të 112 Projektligjeve të parapara për vitin 2016, prej tyre 51 janë parapa në PKZMSA, ku vetëm 12 prej tyre janë miratuar ndërsa 39 nuk janë miratuar.

Me qëllim të pasqyrimit të realizimit të Programit legjislativ gjatë vitit 2016, më poshtë gjeni të paraqitur gjendjen e realizimit të projektligjeve.



Institucionet	ZKM	MF	MD	MPB	MKRS	MTI	MPMS	MAP	MASHT	MSH	MZHE	MFSK	MAPL	MMPH	MBPZHR	MI	MPJ	MIE
---------------	-----	----	----	-----	------	-----	------	-----	-------	-----	------	------	------	------	--------	----	-----	-----

nr i gjithshëm i aktligjeve planifikuara	12	19	19	9	2	10	5	1	2	4	2	1	2	9	8	3	3	1	
realizimi	7	15	11	2	1	3	2	1	2	1	1	0	0	3	0	1	2	1	
realizimi	5	4	8	7	1	7	3	0	0	3	1	1	0	6	8	2	1	0	
total																			53/59

Shtojca 3: PROCESI I HARTIMIT TË KONCEPT DOKUMENTEVE

Me qëllim të zhvillimit të politikave qeveritare dhe realizimit të aktiviteteve të caktuara në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2016 dhe pas një procesi të gjatë të konsultimit dhe verifikimit me të gjitha ministrinë është hartuar lista e koncept dokumenteve⁸ e cila fillimisht ka paraparë hartimin e 74 koncept dokumenteve. Kjo listë përmban edhe 14 koncept dokumente të cilat janë bartur nga viti paraprak. Ndërsa tani lista përmban 69 koncept dokumente e plotësuar dhe ndryshuar me 13.06.2016, 19.09.2016 dhe 23.11.2016.

Ky raport përmban të dhëna gjithëpërfshirëse për procesin e hartimit të koncept dokumenteve për vitin 2016. Raporti përmban të dhëna për Koncept Dokumentet e miratuara nga Qeveria, atyre që kanë kaluar nëpër fazat e përgatitjes dhe konsultimit të parapara në Rregulloren e Punës së Qeverisë nr. 09/2011, si dhe draft koncept dokumentet të cilat nuk kanë filluar së përgatituri në bazë të afateve kohore të parapara në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë 2016 dhe Listës së Koncept Dokumenteve 2016.

Koncept Dokumentet e planifikuara për vitin 2016 sipas ministrive: ZKM ka pasur 2 KD të parapara, MASHT 4 KD të parapara, MD 4 KD të parapara, MZHE 4 KD të parapara, MF 5 KD të parapara, MMPH 7 KD të parapara, MAPL 5 KD të parapara, MPB 2 KD të parapara, MPMS 3 KD të parapara, MKK 2 KD të parapara, MSH 4 KD të parapara, MAP 2 KD të parapara, MKRS 7 KD të parapara, MI 2 KD të paraparë, MBPZHR 6 KD të planifikuara, MTI 9 KD të planifikuara dhe

MeD ka pasur 1 KD të paraparë për vitin 2016. Në grafikun e mëposhtëm janë të paraqitura të dhënat e koncept dokumenteve për ministrinë sipas afateve kohore.

⁸Në janar të vitit 2016 sipas Rregullos nr.09/2011 të Punës së Qeverisë të përcaktuar në nenin 48 paragrafi 7 dhe nenit 29 paragrafi 3, duke marrë parasysh propozimin e Sekretariatit Koordinues të Qeverisë




Figura nr.1 Grafiku i paraqitjes se Koncept dokumenteve të planifikuara sipas periudhave për vitin 2016

Gjatë vitit 2016 në procesin e hartimit të koncept dokumenteve dhe shqyrtimit të tyre nga institucionet përgjegjëse sipas Rregullores së Punës së Qeverisë, Ministria e Financave, Ministria e Integritit Evropian, Zyra Ligjore dhe Zyra për Planifikim Strategjik kanë dhënë kontributin e tyre.

Të dhënat e paraqitura për Koncept Dokumentet për vitin 2016

Nga numri i përgjithshëm prej 69 koncept dokumenteve të parapara të miratohen në periudhën janar-dhjetor të vitit 2016, janë miratuar 26 KD apo shprehur në përqindje 38%, 8 KD janë në procedurë të të dy fazave të shqyrtimit sipas nenit 7 dhe 35 apo 11% ndërsa 35 KD nuk kanë filluar ende fazat e shqyrtimit dhe nuk kemi informata se a kanë filluar në përgatitjen e KD apo 51%.

Pra më poshtë është paraqitur në mënyrë grafike përqindja për KD e miratuara, atyre në procedurë, KD që nuk kanë filluar asnjë procedurë dhe KD e planifikuara për periudhën janar-dhjetor 2016:




Figura nr.3 Paraqitja në përqindje për KD e miratuara, atyre në procedurë dhe KD që nuk kanë filluar asnjë procedurë

Të dhënat e paraqitura për Koncept Dokumentet për vitin 2016

Në vazhdim, në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur të dhënat për numrin e koncept dokumenteve të planifikuara dhe atyre që janë miratuar në vitin 2016 sipas ministrive.




Figura nr.4 Pasqyra e Koncept dokumenteve të planifikuara dhe të miratuara për vitin 2016 sipas ministrive

Cilësia e analizës së politikave

Me qëllim të ngritjes së cilësisë së hartimit të politikave të reja SKQ gjatë gjithë vitit krahas shqyrtimit të Koncept Dokumenteve sipas Rregullores së Punë ka zhvilluar aktivitete të ndryshme.

Me iniciativën e SKQ-së dhe përkrahjen nga ekspertët e SIGMA-së dhe mbështetje financiare nga SIDA, është organizuar punëtori me përfaqësuesit e të gjitha ministrive me qëllim të hapjes së diskutimit për rishikimin e **Udhëzuesit për Hartimin e Koncept Dokumenteve dhe Memorandumeve Shpjeguese Nr.074/2012**. Këtij procesi i kanë parapri raportet vjetore mbi procesin e hartimit të KD-ve dhe intervistat e realizuara nga ekspertët e SIGMA-së të angazhuar nga Sekretariati me ekipet dhe zyrtarët përgjegjës për hartimin e koncept dokumenteve të gjashtë ministrive. Gjithashtu SKQ ka organizuar takime konsultuese shtesë dhe ka dhënë komente shtesë në faza të ndryshme të hartimit të koncept dokumenteve.

Definimi i problemit - Në përgjithësi koncept dokumenteve të përgatitura u mungon analizë e mirëfilltë e definimit të problemit dhe opsioneve që propozohen për adresimin e tij.

Te identifikimi i çështjes/problemit nuk është vënë theks i qartë në problemin kryesor. Këtij kapitulli i ka munguar shtjellimi i politikës ekzistuese pa marr parasysh bazën ligjore specifike për rregullimin e saj. Jo në të gjitha rastet janë shpjeguar qartë shkaktarët e problemit përfshirë ndikimet dhe kohëzgjatjen e problemit. Propozimet për rregullim të çështjes së trajtuar në Koncept Dokument, nuk janë specifikuar konkretisht cilat kanë qenë problemet që kanë shtyrë në ndërmarrjen e hapave për plotësim/ndryshimin e politikës ekzistuese. Në disa raste nuk janë identifikuar fushat e ndikimit dhe nuk janë përfshirë institucionet që kanë qenë të përfshira në rregullimin apo trajtimin e problemit.

Te përvojat nga shtetet tjera, në disa raste jepen shumë pak informata se si shtetet që i marrin si shembull e kanë adresuar çështjen konkrete! P.sh. vetëm përmendet se ky apo ai shtet e ka rregulluar me ligj këtë çështje, por nuk jepen detaje se si e ka adresuar konkretisht!

Analiza e opsioneve – Kryesisht opsionet e propozuara nga ministritë nuk dallojnë fare në esencë. Zakonisht, si opsione ministritë kanë paraqitur përgatitjen e ligjeve të reja, ose plotësim/ndryshime të atyre ekzistuese, por nuk kanë dhënë informata të mjaftueshme rreth përmbajtjes. Fokusi nga ministritë zakonisht është te opsioni i rekomanduar dhe nuk merren parasysh opsionet tjera psh. Nuk analizohen mundësitë për zgjidhjen e problemit përmes ndryshimit të qasjes ekzistuese e cila nënkupton adresimin e problematikave pa plotësim ndryshim të bazës ligjore.

Disa nga draft koncept dokumentet e dorëzuara në SKQ gjatë fazës së parë të shqyrtimit kanë pasur qëllim vetëm të arsyetojnë vendimin e marr paraprakisht nga hartuesi/sponsorizuesi i dokumentit. Në këto raste i është kushtuar shumë pak rëndësi mbledhjes së të dhënave statistikore për identifikimin e problemit, analizës së opsioneve, ndikimit të tyre si dhe vlerësimit të kostos financiare.

Procesi i Konsultimit - Karakteristikë e përgjithshme e mungesës së cilësisë së përmbajtjes së koncept dokumenteve është mungesa dhe mospërfshirja e komenteve/rekomandimeve të dhëna nga institucionet e tjera të përfshira apo të ndikuara nga politika e re.

Komentet, sugjerimet të cilat ministria ka mundur ti pranoje në formë të shkruar apo format tjera të konsultimeve (takime, tryeza, punëtori) nuk janë prezantuar në tekstin e koncept dokumenteve nëse janë marr apo jo parasysh apo arsyeja e mos përfshirjes së tyre në përmbajtjen e dokumentit.

Vlerësimi i ndikimit buxhetor – Edhe gjatë vitit 2016 vlerësimi i ndikimit buxhetor është bërë vetëm për opsionin e rekomanduar në rastet kur politika është paraparë të ketë kosto shtesë buxhetore.

Procesi i Komunikimit – Komunikimi është një nga kapitujt që më së paku i është kushtuar rëndësi nga ministritë. Mbetet që procesi i komunikimit të politikës të zhvillohet paralel me dokumentin e politikës.

Planifikimi - Në veçanti duhet pasur kujdes në planifikimin e përgatitjes apo hartimit të koncept dokumenteve sepse disa ministri kanë planifikuar përgatitjen e deri në 9 koncept dokumenteve gjatë vitit. Bazuar në raportet paraprake të vlerësimit të këtij procesi ky nuk është një planifikim serioz dhe nuk kontribuon në zhvillimin e mirëfilltë të politikave ekzistuese dhe propozimeve të politikave të reja. Kjo tregon se ministritë duhet kushtuar më shumë kujdes planifikimit të punës në përgatitjen e tyre, por edhe përzgjedhjes së çështjeve për të cilat duhet përgatitur koncept dokumentet.

Planifikimi i mirëfilltë dhe real në hartimin e koncept dokumenteve vlerësohet si njëri nga faktorët kyç që do të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së përmbajtjes së koncept dokumenteve.

Konsultimi ndërministror dhe shqyrtimi përfundimtarë - Gjatë shqyrtimit të koncept dokumenteve sipas nenit 7 së Rregullores së Punës së Qeverisë, SKQ ka dhënë komentet për të gjitha koncept dokumentet e pranuar apo 21 opinione dhe njëherit vlerësojmë se shumica e tyre janë reflektuar në përmbajtjen e koncept dokumenteve të cilat pas kalimit të kësaj faze janë propozuar për shqyrtim dhe miratim në Qeveri. Duhet të cekim se opinionet e zyrove (ZL, ZPS, ZKP, MIE dhe MF)⁹ kanë ndihmuar SKQ-në në dhënien e opinionit përfundimtarë për miratim të KD apo plotësim ndryshim të dokumentit.

⁹ Opinionet e dhëna për shqyrtim të propozimeve sipas nenit 35
Sekretariati Koordinues i Qeverisë 30
Zyra Ligjore 27
Zyra për Planifikim Strategjik 4
Ministria e Financave 25
Ministria e Integritimit Evropian 12
Zyra për Komunikim me Publikun 9

Pajtueshmëria me politikat qeveritare - Jo të gjitha Koncept Dokumentet e propozuara janë në pajtueshmëri me Planin Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2016, me prioritetet që dalin nga procesi i integritimit evropian dhe politikat sektoriale të ministrive në veçanti.

Konkluzione dhe Rekomandime

SKQ pas shqyrtimit të koncept dokumenteve të pranuar gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2016 sa i përket respektimit të procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Punës së Qeverisë, pajtueshmërisë me politikat qeveritare dhe kualitetit të dokumenteve të hartuara vlerëson se:

Respektimi i procedurave të rregullores së Punës së Qeverisë dhe koordinimi ndërinstytucional

- Nga 26 koncept dokumentet e miratuara në periudhën janar-dhjetor për vitin 2016 në Qeveri, 8 Koncept Dokumente kanë kaluar vetëm fazën e shqyrtimit sipas nenit 35 të Rregullores, 1 KD është miratuar në procedurë të përshpejtuar dmth nuk ka kaluar asnjë fazë të konsultimit, 17 KD kanë kaluar nëpër fazat e shqyrtimit sipas nenit 7 dhe 35 të RrPQ;
- Në nivelin qendror, SKQ - ja, ZL, ZKP, MIE dhe MF kanë qenë proaktive gjatë procesit të shqyrtimit të draft koncept dokumenteve dhe dhënies së opinionëve me shkrim. Ndërsa ZPS nuk ka dhënë mjaftueshëm kontribut në dhënien e opinionëve. Megjithatë, asnjë nga koncept dokumentet e miratuara në Qeveri nuk ka qenë i shoqëruar me të gjitha opinionet e këtyre zyrave, ashtu siç kërkohet sipas nenit 36 pika 1 të RrPQ;
- Dokumenteve u mungon tabela ku listohen komentet e pranuar nga institucionet tjera, ashtu siç kërkohet në nenin 36 pika 1.6 të RrPQ si dhe Udhëzuesit për Përgatitjen e Koncept Dokumenteve;
- Ministritë në përgjithësi nuk kanë respektuar afatet e përcaktuara për përgatitjen e draft Koncept Dokumenteve, kjo ka ndikuar në përgatitjen e tyre me vonesa të konsiderueshme, ku nga 69 KD të parapara të hartohen për vitin 2016, vetëm 26 prej tyre janë miratuar;
- Përkundër faktit që Ministritë i dërgojnë propozimet e tyre për komente qysh në fazën e parë të shqyrtimit, në të shumtën e rasteve nuk marrin komente nga institucionet përgjegjëse,
- Ende ka raste ku përgatitja e Koncept Dokumenteve bëhet nga departamentet ligjore të ministrive dhe jo nga departamentet profesionale përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e politikave të reja;

Bazuar në konkluzionet e mësipërme rekomandohet që të gjitha institucionet e përfshira në hartimin dhe shqyrtimin e koncept dokumenteve të ndërmarrin veprimet e nevojshme sipas përgjegjësisë së tyre të përcaktuara në Rregulloren e PQ për përmirësimin dhe avancimin e mëtutjeshëm i procesit të hartimit të Koncept Dokumenteve në drejtim të zbatimit të procedurave dhe ngritjes së cilësisë së KD.

Të dhënat e paraqitura për Koncept Dokumentet për K4 2016

Për 7 koncept dokumente të miratuara në tremujorin e fundit janë dhënë: 6 opinione nga Zyra Ligjore, 6 opinione nga Ministria e Financave, 2 opinione nga Ministria për Integritim Evropian, 3 opinione nga Zyra për Komunikim me Publikun dhe 1 opinion nga Zyra për Planifikim Strategjik. Ndërsa nga Sekretariati Koordinues i Qeverisë janë dhënë 6 opinione për 7 Koncept Dokumente të miratuara.

Koncept Dokumentet për Metrologji, për Rregullimin e Fushës së Masave Mbrojtëse në Importe dhe për Fushën e Kërkesave Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konfirmimit nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, janë miratuar sipas afatit kohor të përcaktuar në tremujorin e fundit të vitit 2016, Koncept

Dokumenti për Bankën Qendrore të RKS nga Ministria e Financave është miratuar në afatin kohor të përcaktuar K4 2016, Koncept Dokumenti për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka qenë e paraparë të miratohet në muajin qershor por është miratuar në tremujorin e katërt, Koncept Dokumenti për Shërbimet Postare nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik është miratuar në afatin kohor të përcaktuar K4 2016 si dhe Koncept Dokumenti për Rregullimin e Fushës së Pensioneve të Veteraneve dhe Kategorive tjera të luftës nuk ka qenë në listë të Koncept Dokumenteve por është miratuar në procedurë të përshpejtuar nga Qeveria në muajin nëntor të vitit 2016.

Lista e Koncept Dokumenteve të miratuara 01.10.2016-31.12.2016

Nr.	Koncept Dokumenti	Institucioni	Nr. i vendimit	Data
1	Koncept Dokumenti për Metrologji	MTI	03/112	18.10.2016
2	Koncept Dokumenti për Bankën Qendrore të RKS	MF	17/113	31.10.2016
3	Koncept Dokumenti për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës	MZHE	01/114	07.11.2016
4	Koncept Dokumenti për Rregullimin e Fushës së Pensioneve të Veteranëve dhe Kategorive tjera të luftës	MPMS	03/116	16.11.2016
5	Koncept Dokumenti për Shërbimet Postare	MZHE	11/116	16.11.2016
6	Koncept Dokumenti për Rregullimin e Fushës së Masave Mbrojtëse në Importe	MTI	08/122	23.12.2016
7	Koncept Dokumenti për Fushën e Kërkesave Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konfirmimit	MTI	09/122	23.12.2016

Tabela nr.1 Lista e Koncept dokumenteve të miratuara sipas ministrive për K4 2016

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur numri i Koncept dokumenteve të miratuara kundrejt atyre të planifikuara sipas ministrive për tremujorin e katërt të vitit 2016. Siç shihet edhe nga grafiku, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë ka pasur numrin më të madh të Koncept Dokumenteve për këtë periudhë, 4 KD të planifikuara prej të cilave 2 KD kanë kaluar fazën e shqyrtimit sipas nenit 35 dhe janë në pritje të miratimit nga Qeveria, ndërsa 2 Koncept Dokumente janë miratuar në periudha paraprake K1 dhe K2, MBPZHR për 3 KD nuk kanë kaluar asnjërin nga fazat e shqyrtimit, MTI për 3 KD të planifikuara, 2 KD janë miratuar në afatin kohor të përcaktuar ndërsa për 1 KD nuk ka kaluar asnjërin nga fazat e shqyrtimit, MF për 3 KD, 1 KD është miratuar në afatin kohor të përcaktuar ndërsa për 2 KD nuk kanë kaluar asnjërin nga fazat e shqyrtimit, MAP për 2 KD të parapara, 1 KD është miratuar në përdhën paraprake ndërsa për 1 KD nuk ka kaluar asnjërin nga fazat e shqyrtimit, MZHE ka pasur 1 KD dhe është miratuar brenda afatit kohor të planifikuar, ZKM dhe MSH për 1 KD të planifikuar janë në fazën e shqyrtimit ndërsa institucionet tjera që janë të paraqitura në grafik me nga 1 KD të planifikuar nuk ka kaluar asnjërin nga fazat e shqyrtimit. Ndërsa institucionet tjera që nuk janë përfshirë në këtë tabelë nuk kanë pasur të planifikuara hartimin e koncept dokumenteve për periudhën e katërt të vitit 2016.




Figura nr.2 Grafiku i paraqitjes se Koncept dokumenteve të parapara dhe ato të miratuara sipas ministrive K4 2016

Të dhënat e Koncept dokumenteve të miratuara për vitin 2016

Koncept Dokumentet e miratuara në vitin 2016				
Nr.	Koncept Dokumenti	Institucioni	Nr. I vendimit	Data
1	Koncept Dokument për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike	MF	05/72	29.01.2016
2	Koncept Dokument për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje	MMPH	03/81	23.03.2016
3	Koncept Dokument për Kadastër	MMPH	04/81	23.03.2016
4	Koncept Dokument për Skemat të Pensionale Financuara nga Shteti	MPMS	02/81	23.03.2016
5	Koncept Dokument për Shërbimet Private të Sigurisë	MPB	05/81	23.03.2016
6	Koncept Dokumenti për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme	MKK	01/87	13.05.2016
7	Koncept Dokumenti për Kompensim të Veçantë	MKRS	04/84	15.04.2016
8	Koncept Dokument për Produkte të Ndërtimit	MTI	11/91	08.06.2016
9	Koncept Dokument për Trajtimin e Pajisjeve nën Presion të cilat i Nënshtrohen Presionit Punues më të madh se 0.5 Bar Manometrik	MZHE	12/91	08.06.2016

10	Koncept Dokument për Rregullimin e Profesionit të Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit	MMPH	03/96	22.06.2016
11	Koncept Dokumenti për Ligjin për Rrugët	MI	02/96	22.06.2016
12	Koncept Dokument për Transportin Rrugor 01/97 24.06.2016	MI	01/97	24.06.2016
13	Koncept Dokumenti për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shëndetësi	MSH	02/98	29.06.2016
14	Koncept Dokumenti për Inovacion dhe Transfer të Dijes	MASHT	07/104	10.08.2016
15	Koncept Dokumenti për Rregullimin e Funksionimit të Organizatave Joqeveritare	MAP	03/105	19.08.2016
16	Koncept Dokumenti për botimin e teksteve dhe mjeteve shkollore, lekturës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik	MASHT	08/106	25.08.2016
17	Koncept Dokumenti për Politikën e Bujqësisë dhe Zhvillim Rural	MBPZHR	04/110	30.09.2016
18	Koncept Dokumenti për Sigurime Shëndetësore	MSH	05/110	30.09.2016
19	Koncept Dokumenti për Diasporën	MeD	06/110	30.09.2016
20	Koncept Dokumenti për Metrologji	MZHE	03/112	18.10.2016
21	Koncept Dokumenti për Bankën Qendrore të RKS	MF	17/113	31.10.2016
22	Koncept Dokumenti për shërbimin Gjeologjik të Kosovës	MZHE	01/114	07.11.2016
23	Koncept Dokumenti për Rregullimin e Fushës së Pensioneve të Veteraneve dhe Kategorive tjera të Luftës	MPMS	03/116	16.11.2016
24	Koncept Dokumenti për Shërbimet Postare	MZHE	11/116	16.11.2016
25	Koncept Dokumenti për Rregullimin e fushës së Masave Mbrojtëse në Importe	MTI	08/122	23.12.2016
26	Koncept Dokumenti për Fushën e Kërkesave Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konfirmimit	MTI	09/122	23.12.2016

Tabela nr.2 Pasqyra e Koncept dokumenteve për vitin 2016, të miratuara